

ANDREA LLUKANI

PATROLOGJIA

Botimet “Trifon Xhagjika”

Tiranë, 2007

Redaktor: prof. em. dr. Pavli Haxhillazi

Recensues: av. Armand Afezolli

Konsulentë: Robert Pelushi

Kristo Kume

PARATHËNIE

Patrologjia studion jetën, shkrimet dhe mësimdhënien e Etërve të Kishës. “Atë” është titulli më i nderuar dhe i respektuar që mund t’i akordojë Kisha një klerriu. Këtë titull ua jep vetëm atyre që kanë shkëlqyer në kulturë, shenjtërim dhe në mendimin ortodoks. Etër në kohët e vjetra quheshin mësimdhënësit. Në Dhiatën e Vjetër dëgjuesit dhe nxënësit e profetëve quheshin “Etër të nxënësve të tyre”. Në Dhiatën e Re, Apostull Pali i quan “bijtë e tij” ata që u rilindën me Krishtin, ndërsa ata e quajtën Apostullin që i mësoi “Atë” (Korinth. 4:15). Etër të Kishës quhen shkrimtarët e vjetër kishtarë, tek të cilët kombinohen këto të dhëna: 1- Mësimdhënia ortodokse. 2-Jeta e shenjtëruar. 3- Njohja nga Kisha. Kuptimin për termin “Etër të Kishës” e sqarojnë edhe shumë dëshmi të teksteve të Kishës së hershme. Shën Irineu thotë: “Ai që mësohet nga goja e tjetrit quhet biri i tij, ndërsa mësuesi quhet Atë i nxënësve”. Vasili i Madh e quan mësuesin e tij Athanasin “Atë të përnderuar”.

Patrologjia shqyrton Etërit e tetë shekujve të parë, ndërsa Shkrimtarët Kishtarë të mëvonshëm përfshihen në Literaturën Kishtare. Për arsye studimore Patrologjia ndahet në tri periudha kryesore.

- 1- Themelimi i Literaturës pateristike (fundi i shek. I–325)
- 2- Lulëzimi i Literaturës pateristike (325–451)
- 3- Rënia e Literaturës pateristike (451–749)

Literatura pateristike përfundon me fjetjen e Damaskinit për Lindjen (636) dhe të Isidorit të Seviljes për Perëndimin.

Dëshirën për të hartuar një libër Patrologjie e kam pasur që herët. Në vitin 1998 u emërova lektor për lëndën e Patrologjisë dhe të Historisë Kishtarë në Akademinë Teologjike të Shën Vlashit në Durrës. Që nga ajo kohë kam punuar me zell për të përkthyer jetëshkrimet e Etërve të Kishës dhe për të grumbulluar shkrimet e tyre. Njohuritë e mia në lëmin e pateristikës u thelluan në vitin 2000 kur isha për specializim në Pravoslavna Akademia të Çekisë, ku u njoha me koleksionet origjinale të Etërve të Kishës. Kryeepiskopi i Pragës dhe i gjithë tokës Çeke, Kristofori, kishte një bibliotekë ku nuk mungonte asnjë prej koleksioneve pateristike. Raftet e bibliotekës së tij ishin harkuar nga pesha e vëllimeve që mbanin mbi shpinë. Ato muaj kanë qenë me vlerë për mua, sepse munda të kundroj diçka nga bota magjepsëse e Etërve të Kishës. Që nga ajo kohë më lindi dëshira për të hartuar një antologji me pjesë të zgjedhura nga jeta dhe shkrimet e Etërve të Kishës.

Në vitin 2005 kam botuar librin “Apostujt, Etërit e Kishës dhe Shkrimtarët Kishtarë”, i cili u prit mirë nga lexuesit. Ky fakt më inkurajoi që disa kapituj të librit t’i shtjelloja më thellë duke i plotësuar me shkrime pateristike. Për të plotësuar librin përveç përkthimeve që kam bërë vetë, kam shfrytëzuar materiale që janë publikuar kohët e fundit në internet dhe shtypin në kishtar të përkthyer nga Joan Lena, Ana Baba, Kristo Kume etj. Gjithashtu kam shfrytëzuar pjesë nga përkthimet e Dr. Vasil Tushit, Gjergji Pulisë dhe të mikut tim më të mirë Maksim Çukos, i cili u këput herët nga kjo jetë. Mendoj se ky libër modest do t’u vlejë lexuesve për të njohur mësimet e Etërve të Kishës, të cilat janë visaret më të çmueshme të ortodoksisë.

KREU I PARË

FILLIMET E LITERATURËS PATERISTIKE

(100-325)

ETËRIT APOSTOLIKË

Etërit Apostolikë qenë shkrimtarë kishtarë, të cilët ishin nxënës ose dëgjues të apostujve. Emërtimi “Etër Apostolikë” është përdorur për herë të parë në vitin 1672 nga dijetari francez Cotelier në botimin me titull “Etërit Apostolikë”. I gjithë koleksioni i veprave të Etërve Apostolikë nuk paraqet ndonjë unitet doktrinor, por e vetmja gjë që i bashkon këto vepra është koha në të cilën u shkruan, midis shekujve të parë e të dytë pas Krishtit. Karakteristika kryesore e tyre është të qenurit nxënës të apostujve, shoqërues dhe dëshmitarë të tyre. Veprat e Etërve Apostolikë ruhen nëpër bibliotekat më të famshme të botës. Letrat pastorale të Etërve ruajnë tradita apostolike dhe përmbajnë mjaft të dhëna të rëndësishme. Etërit Apostolikë janë: Klimi i Romës, Ignati i Antiokisë, Polikarpi i Smirnit, Didakia e 12 Apostujve, Ermas, Barnaba, Papi i Jerapolit. Shkrimet e tyre përbëjnë dëshmitë më të vjetra të epokës pasapostolike.

KLIMI I ROMËS (92-101)

Sipas dëshmisë së Eusebit, Klimi u dorëzua nga Apostull Petro, Episkop i Romës dhe udhëhoqi kishën në vitet 92-101. Nga informacionet që na jep Irineu, Klimi që njohur personalisht nga Apostujt Petro dhe Pal. Klimi ishte i krishterë i ardhur nga rrethet judaike. Kjo dëshmohet nga njohuritë e thella të tij për Dhiatën e Vjetër. Dëshmi të ndryshme flasin për vdekjen martire të Klimit. Kujtimin e tij e kremtojmë më 24 nëntor.

Shkrimet: 1) *Letra e parë drejtuar Korinthisve*, e cila përbëhet nga 65 kapituj dhe është shkruar rreth viteve 92-96 pas Krishtit. Letra ka vlera të veçanta historike. Shkaku i shkruarjes së letrës qenë disa trazira që kishin ndodhur në komunitetin e krishterë të Korinthit, të shkaktuara nga disa anëtarë të rinj të atij komuniteti, të cilët kishin larguar priftërinjtë nga detyrat e tyre. Kisha e Romës me Klimin në krye ndërhyri për t'i dhënë fund trazirave. *Letra e parë drejtuar Korinthisve* trajton problemin e hierarkisë kishtarë, duke theksuar nevojën e bindjes ndaj tyre. 2) *Letra e dytë drejtuar Korinthisve* përbëhet nga 20 kapituj. (*Dhimitër Beduli, Leksione, Patrollogjia, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1998, faqe 39*).

Letra e parë drejtuar Korinthisve

Kisha e Perëndisë, që jeton si koloni në Romë, drejtuar kishës së Perëndisë, që jeton si koloni në Korinth - ndaj jush që jeni thirrur dhe shenjtëruar prej vullnetit të Perëndisë, nëpërmjet Zotit tonë Jesu Krisht. Hiri i plotë dhe paqja qoftë juaja prej Perëndisë së madh nëpërmjet Jesu Krishtit.

I. 1. Të dashur miq, për shkak të fatkeqësive të papritura, të njëpasnjëshme dhe aksidenteve që kemi hasur, e pranojmë që kemi qenë paksa të ngadalë në kthimin e vëmendjes drejt grindjeve tuaja. Ne i referohemi skizmës së neveritshme dhe jo të shenjtë, konsideruar të huaj prej atyre të cilët Perëndia i ka zgjedhur, ku disa jobesëmirë dhe kokëfortë janë flladitur në një marrëzi të tillë që emri yt i mirë, një herë e një kohë kaq i famshëm dhe i dashur për ne të gjithë, ka rënë në famëkeqësinë më të rëndë. 2. A ka qëndruar ndokush me ju pa vërtetuar shkëlqyeshmërinë dhe qëndrueshmërinë e besimit tuaj, pa admiruar besimin tuaj të ndjeshëm dhe të respektueshëm të krishterë, pa admiruar shpirtin tuaj plot me mikpritje të pakufizuar, pa nderuar njohuritë tuaja të përsosura dhe të vlefshme? 3. Sepse ju gjithmonë veproni pa anësi dhe ecni sipas ligjeve të Perëndisë. Ju iu bindët drejtuesve tuaj dhe u dhatë të moshuarve respektin e duhur. Ju disiplinuat mendjet e të rinjve në përmbytje dhe denjësi. Ju mësuat gratë tuaja për të kryer çdo gjë pa fajësi dhe me ndërgjegje të plotë, dhe t'u japin burrave të tyre ngrohtësinë që duhet. Ju i mësuat ato të qëndrojnë me anë të ligjit të bindjes dhe të drejtojnë shtëpitë e tyre me denjësi dhe me dëshirë.

II. 1. Ju ishit të përrulur dhe pa pretendime, u bindeshit urdhërave më tepër se sa krijonit të tillë, me më tepër gëzim jepnit sesa merrnit. Të gëzuar me pjesët e Krishtit dhe të njëmendshëm për to, ju e mbajtët fjalën e tij me kujdes në zemrat tuaja dhe kaluat vuajtjet e tij përpara syve tuaj. 2. Si pasojë, mbizotëronte ndër ju një paqe e thellë dhe e pasur, dhe dëshira e palodhur për vepra të mira. Shpirti i Shenjtë ishte mbi të gjithë ju. 3. Ju ishit plot me këshillues të shenjtë me zell për besim, ju i shtrinit duart tek Perëndia i tërëfuqishëm, duke i kërkuar mëshirë nëse në mënyrë të

pavullnetshme ratë në mëkat. 4. Ditë e netë ju punuat për gjithë vëllazërinë, në mënyrë që prej besimit dhe ngushëllimeve tuaja, shumica e të zgjedhurve të tij të mund të shpëtohej. 5. Ju keni qenë të sinqertë, pa djallëzi dhe nuk i mbajtet mëri askujt. 6. Çdo rebelim dhe skizmë ishte e urryeshme për ju. Ju vajtonit për gabimet e të afërmit tuaj dhe të metat e tyre i konsideronit dhe tuajat. 7. Asnjëherë s’u penduat për të mirat që bëtë dhe ishit “gati për çdo punë të mirë”. 8. Të stolitur me sjelljen tuaj të virtytshme dhe të respektueshme, ju bëtë gjithçka me frikën e Tij. Porositë e Perëndisë ishin të shkruara në fletët e zemrës suaj.

III. 1. Ju ishte dhënë çdo lavdi dhe mburrje, dhe ndodhi ajo që është shkruar: “I dashuri im hëngri, piu, u majm e u trash dhe filloi të shkelmojë”. 2. Nga kjo u ngrit rivaliteti dhe cmira, grindja, rebelimi, përndjekja dhe anarkia, lufta dhe robëria. 3. Dhe kështu “të pandershmit” u ngritën “kundër atyre që mbaheshin me nder”, ata pa famë kundër të famshmëve, të marrët kundër të zgjuarve, “të rinjtë kundër të vjetërve”. 4. Për këtë arsye, drejtësia dhe paqja janë larg jush, që kur secili ka braktisur frikën e Perëndisë dhe rritet i verbër në besimin e tij, i ka dhënë fund ecjes sipas rregullave të porosive të tij, ose për t’u sjellë në një mënyrë të denjë për Krishtin. Për më tepër, secili ndjek epshin e zemrës së tij djallëzore, duke ringjallur atë pandershmëri dhe rivalitet jo të shenjtë prej të cilit me të vërtetë “vdekja erdhi në botë”.

IV. 1. Dhe Shkrimi shkon kështu: “Me kalimin e kohës, Kaini i bëri një ofertë frutash të tokës Zotit; por Abeli i ofroi edhe ai të parëlindurit e kopesë së tij dhe dhjamin e tyre. 2. Dhe Zoti e çmoi Abelin dhe dhuratën e tij, por nuk pranoi Kainin dhe ofertën e tij. 3. Dhe kështu Kaini u pezmatua shumë dhe fytyra e tij mori një pamje të dëshpëruar. 4. Atëherë Zoti i tha Kainit: “Pse je

pezmatuar dhe pse fytyra jote është dëshpëruar? Nëse ke bërë një flijim të drejtë, por të ndarë jo në mënyrë të drejtë, a nuk ke mëkatuar? Ki kujdes. 5. Vëllai yt do të kthehet ndaj teje dhe ti do të sundosh mbi të”. 6. Dhe Kaini i tha vëllait të tij Abelit: “Eja të shkojmë në fushë”. Dhe ndodhi që ndërsa ishin në fushë Kaini sulmoi vëllanë e tij, Abelin, dhe e vrau”. 7. E shikoni vëllezër, rivaliteti dhe smira janë përgjegjëse për zemërimin. 8. Për shkak të rivalitetit, stërgjyshi ynë Jakobi u largua me të katra nga prania e vëllait të tij, Esaut. 9. Ishte rivaliteti i cili i shkaktoi Jozefit përndjekje deri në vdekje e rënie në skllavëri. 10. Rivaliteti e detyroi Moisiun të largohej prej pranisë së Faraonit, mbretit të Egjiptit, kur ai dëgjoi njërin prej njerëzve të grupit të thoshte: “Kush të bëri ty drejtues ose gjykatës mbi ne? Do që të më thërresh sikurse dje there egjiptianin?” 11. Për shkak të rivalitetit Aaroni dhe Miriami u përjashtuan prej kampit. 12. Rivaliteti flaku Datanin dhe Abiramin të gjallë në Had sepse u revoltuan kundër Moisiut, shërbëtorit të Perëndisë. 13. Për shkak të rivalitetit Davidi jo vetëm shkaktoi smirën e të huajve, por u përdoq prej Saulit, mbretit të Izraelit.

V. 1. Duke kaluar prej shembujve të hershëm, le të vijmë te heronjtë më pranë kohërave tona. Le të marrim shembujt më të mirë të brezit tonë. 2. Për arsye të rivalitetit dhe smirës shtyllat më të mëdha dhe më të drejta [të Kishës] u përdoqën dhe luftuan deri në vdekje. 3. Le të vendosim para syve tanë apostujt madhështorë. 4. Pjetrin, i cili për arsye të zilisë së pandershme, jo vetëm një apo dy herë, por shpesh duroi vuajtje dhe si rrjedhim, duke dëshmuar, shkoi në vendin e lavdishëm që meritonte. 5. Për shkak të rivalitetit dhe të grindjes Pali tregoi si të fitonte çmimin për durim dhe qëndrueshmëri. 6. Shtatë herë u lidh me zinxhirë; u internua, u qëllua me gurë, u bë lajmëtar [i ungjillit] në Lindje dhe

Perëndim, dhe fitoi famën e madhe të cilën besimi i tij e meritonte. 7. Në tërë botën mësoi drejtësinë, duke arritur kufijtë e Perëndimit ai dha dëshmi para drejtuesve. Dhe kështu, i liruar prej kësaj bote, u ngrit në vendin e shenjtë dhe u bë shembull i madh i durimit dhe i qëndrueshmërisë.

VI. 1. Këtyre njerëzve, të cilët bënë jetë të tilla kaq të shenjta, iu bashkua një grumbull njerëzish të zgjedhur, që, për shkak të rivalitetit, qenë viktime të shumë veprave të dhunshme dhe torturave, e më vonë u bënë shembujt më të lartë midis nesh. 2. Për shkak të rivalitetit gra u persekutuan në rolin e Danaeve dhe Dirkesë. Viktima të shpifjeve të tmerrshme dhe të blasfemive, ato ndoqën me siguri garën e besimit për në mbërritje, dhe, me gjithë dobësitë e tyre fizike, fituan një çmim të madh. 3. Ishte rivaliteti që i largoi gratë prej burrave dhe zhvlerësoi thënien e atit tonë Adam: “Kjo është kockë e kockave të mia dhe mishi i mishit tim”. 4. Rivaliteti dhe grindja kanë përmbysur shumë qytete dhe kanë çrrënjësuar shumë kombe të mëdhenj.

VII. 1. Po i shkruajmë këto, të dashur miq, jo vetëm me qëllim që t’ju këshillojmë, por dhe të kujtojmë veten. Ne jemi në të njëjtën arenë dhe marrim pjesë në të njëjtën përpjekje. 2. Që sot e tutje ne duhet të hedhim tutje interesat tona boshe të pavlera dhe të kthehemi në rregullin e lavdishëm të shenjtë të traditës sonë. 3. Le të vëmë re çfarë është e mirë, çfarë është e kënaqshme dhe e pranueshme prej atij i cili na krijoi. 4. Le të ngulim sytë tanë në gjakun e Krishtit dhe le të kuptojmë sa i çmueshëm është për Atin e tij qëkur hodhi mbi ne shpëtimin dhe sollti hirin e pendimit ndaj tërë botës. 5. Le të shohim gjithë brezat dhe që prej një brezi në tjetrin të vështrojmë se Zoti “ka ofruar një mundësi pendimi” ndaj atyre që janë të gatshëm të kthehen tek ai. 6. Noeja predikoi

pendimin dhe ata që ia vunë veshin shpëtuan. 7. Jonai predikoi shkatërrimin e Ninevitëve dhe kur ata u penduan për mëkatet e tyre u pajtuan me Perëndinë nëpërmjet lutjeve dhe fituan shpëtimin, megjithëse nuk ishin popull i Perëndisë.... (Marrë nga *Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks, shkrimet e hershme*).

IGNATI I ANTIOKISË (70-107)

Ignati i Antiokisë ishte i dyti sipas radhës Episkop i Antiokisë rreth viteve 70-107. Ai quhej *Hyjmbajtësi*, sepse kur ishte fëmijë Krishti e solli si shembull: “Jesui, pasi thirri një fëmijë të vogël pranë vetes, e vuri në mes tyre dhe tha:- Nëse nuk ktheheni dhe të bëheni si fëmijët e vegjël, ju nuk do të hyni në Mbretërinë e Qiejve. Ê ushdo që pranon një fëmijë të vogël si ky në emërin tim, më pranon mua” (Matheu 18, 2-5). Ignati ishte nxënës ungjillor Joanit së bashku me Polikarpin, i cili u bë episkop i Smirnës. Ai u dorëzua episkop i Antiokisë dhe udhëhoqi grigjën gjatë viteve 68-70. Gjatë përndjekjeve të Trajanit, atë e kapin dhe e dërgojnë në Antioki. Prej andej nëpërmjet liqenit të Selevkisë duke udhëtuar me anije arriti në brigjet e Kilikisë, në vijim ndoqi rrugën tokësore nëpërmjet Azisë së Vogël dhe shkoi në qytetin e Filadelfias ku pushoi pak. Më pas në Smirni dhe Troadha ku e shoqëronte dhjaku Vuross, e prej aty në Neapoli që i përket Kavallës së sotme. Nga Neapoli nëpërmjet Maqedonisë kalon udhën Egnatia ku mbërriti në Iliri. Nga porti i Durrësit me linjë detare vajti në Brindizi dhe që andej duke marshuar më këmbë e shpunë në Romë ku u martirizua rreth vitit 107. Kisha e shpalli shenjt dhe kujtimin e tij e festojmë më 20

dhjetor. (Edvin E. Jacques, *Shqiptarët, vëllimi I, Kartë e Pendë, Tiranë 1995, faqe 212*).

Shkrimet: Ignati i Antiokisë shkroi shtatë letra, katër prej të cilave drejtuar *Efesianëve, Magnezëve, Tralianëve dhe Romakëve*. Këto letra Ignati i shkroi në Smirni ndërsa e shpinin për në Romë. Tri letrat e tjera drejtuar *Filadelfias, Smirneut dhe Polikarpit të Smirnit* i shkroi në Troadhë.

Pasi lanë Smirnen, Ignati dhe rojet e tij shkelën në Troas, ku bënë një ndalesë përpara se të kalonin me det në Neapoli. Nga Troasi, Ignati shkroi tre letrat e tij të fundit. Ndërsa temat e tyre janë ato të njohurat, njëshmëria e Kishës dhe herezitë, e veçanta e rëndësisë së tyre është se ato u drejtohen kishave të cilat Ignati tashmë i ka vizituar. (Filadelfia ndodhet në rrugën që çon nga Laodicea në Smirne). Sidoqoftë, letrat pasqyrojnë çështjet e mësimëve të rreme në detaje. Letra për filadelfianët tregon natyrën e gabimeve judaike të cilat janë prekur më parë në letrën për magnezianët; ndërsa ajo për smirneasit shtrihet mbi docetizmin. Dy miq të Ignatit, dhiakonët Filo dhe Reus Agathopus, duket se janë bashkuar me të në Troas pas një qëndrimi në Filadelfi. Ata sollën të reja nga Kisha e atjeshme si dhe mbi faktin se elementët kundërshtues të atjeshëm i kishin fyer dhe kishin sulmuar dëshmorin (kryet 6:3, 11). Për t'iu përgjigjur këtyre akuzave dhe për të çjerre maskën e gabimeve të kundërshtarëve të tij, Ignati shkroi këtë letër.

Për Kishën e Filadelfisë Nga Ignati i Antiokisë

Unë Ignati, që quhem dhe Theoforus, Kishës së Perëndisë Atë dhe Zotit Jesu Krisht që gjendet në Filadelfi të Azisë, të

mëshiruarës dhe të mbështeturës në njëshmërinë e Perëndisë, e cila gëzohet me pësimin e Zotit tonë, pa dallime, dhe është e sigurt për ngjalljen me çdo përdëllim, të cilën e përshëndes me gjakun e Jesu Krishtit që përbën gëzim të përhershëm dhe të përjetshëm, sidomos kur është e bashkuar me peshkopin, priftërinjtë dhe dhiakonët, të cilët janë të përkushtuar së bashku me të në mendjen e Jesu Krishtit, të cilët në përputhje me vullnetin e Tij i mbështeti në besim dhe me Frymën e Tij të shenjtë.

Unë e di se ky peshkop nuk e fitoi nga vetja shërbesën që i përket popullit, “as nuk e mori nga njerëzit”, as me mendjemadhësi, por me dashurinë e Perëndisë Atë dhe të Zotit Jesu Krisht, për butësinë e të cilit qëndroj i habitur, sepse ai kur hesht thotë më tepër nga ata që flasin pa u menduar. Sepse u përshtat me urdhërimet, ashtu si kitara me telat. Prandaj lumëron shpirti im qëndrueshmërinë dhe gjakftohtësinë e tij, brenda kuadrit të çdo butësie të Perëndisë së gjallë. Pra, bij të dritës së vërtetë, t’i shmangeni përçarjes dhe mësimëve të këqija dhe ku ndodhet bariu, atje të shkoni, si dele. Sepse shumë ujqër që frymëzojnë besueshmëri me kënaqësinë e keqe robërojnë ata që ndjekin rrugën e Perëndisë, por, kur jeni të bashkuar, nuk kanë vend mes jush. Mënjanoni egjërin të cilin nuk e kultivon Jesu Krishti, sepse ajo nuk është e mbjellë e Atit . I shkruaj këto ngaqë nuk gjeta mes jush përçarje, por pastrim. Sepse sa janë të Perëndisë dhe të Jesu Krishtit, ata ndodhen bashkë me peshkopin. Sa pendohen dhe kthehen në njëshmërinë e Kishës, ata do të bëhen të Perëndisë, që të jetojnë në përputhje me vullnetin e Jesu Krishtit. Vëllezërit e mi, mos u mashtroni; ai i cili pason atë që shkakton ndarje “nuk trashëgon Mbretërinë e Perëndisë” . Ai që ndjek mendje të huaj nuk është dakort me pësimin. Pra kujdesuni të merrni pjesë në një

falenderim, sepse një është trupi i Zotit tonë Jesu Krisht dhe një potir na bashkon me gjakun e Tij; një therore, ashtu si një peshkop bashkë me priftërinjtë dhe dhiakonët, bashkëshërbëtorët e mi, në mënyrë që çfarëdo që të bëni, ta bëni ashtu si e do Perëndia. Vëllezërit e mi, jam shumë i kënaqur sepse ju dua dhe u siguroj me ngazëllim të jashtëzakonshëm, sigurisht, jo unë, por Jesu Krishti, për të cilin jam i lidhur në pranga, por edhe frikësohem ngaqë nuk jam ende i plotësuar .

Lutja juaj do të më plotësojë sipas Perëndisë, që të arrij shortin që më ka rënë, duke pasur si përikje Ungjillin, si të jetë trupi i Jesuit dhe apostujt, si të jenë priftërinjtë e Kishës. Madje të duam edhe profetët, sepse edhe ata predikuan në Ungjill, shpresuan në të, e pritën pasi besuan në të, u shpëtuan, duke qenë të bashkuar me Jesu Krishtin, shenjtorë të dashur dhe të admirueshëm, të shpallur nga Jesu Krishti dhe të bashkuar në Ungjillin e shpresës së përbashkët. Por, nëse dikush ju interpreton judaizmin, të mos e dëgjoni , sepse është më mirë që një burrë rrethprerë të dëgjojë për krishterimin, sesa ai që nuk është rrethprerë të dëgjojë për judaizmin. Nëse të dy nuk flasin për Jesu Krishtin, këta për mua janë qivure dhe varre të vdekurish, mbi të cilët janë shkruar emra njerëzish. Si përfundim, largojuni punëve të liga dhe kurtheve të sunduesit të kësaj bote, sepse ndoshta të dhunuar nga mendja e tij dobësohet dashuria juaj dhe mblidhuni të gjithë së bashku me zemër të pandarë. E falenderoj Perëndinë tim sepse nuk më vret ndërjegjja ime për ju dhe askush nuk mund të mburret as fshehtas as dukshëm se u bëra barrë e ndonjërit, e vogël ose e madhe dhe uroj që të gjitha sa thashë të mos i mbajnë si elemente treguese. Sepse, megjithëse disa dëshiruan të më mashtronjë si njeri, por fryma që

është prej Perëndisë nuk mashtrohet. “Sepse e di nga vjen dhe ku shkon” dhe heton të fshehtat .

Thirra fort midis atyre që fola, me zë të lartë, me zë Perëndie: t’i përkushtoheni peshkopit, priftërisë dhe dhiakonëve. Nëse disa dyshojnë se i thashë këto sepse e di largimin e disave, dëshmitari im është ai për të cilin jam i lidhur në pranga, se nuk e mësova nga njeriu, por fryma më tregoi duke thënë këto: “Pa peshkopin të mos bëni asgjë”. Të ruani trupat tuaj si tempuj të Perëndisë, duajeni njëshmërinë, shmangni përçarjen, bëhuni imituesit e Krishtit, ashtu si dhe ai është imitues i Atit të tij. Edhe unë bëra të njëjtën gjë, si njeri i edukuar për njëshmërinë. Sepse atje ku ka përçarje dhe zemërim, nuk banon Perëndia. Të gjithë, pra, ata që pendohen, i fal Zoti, nëse pendohen që të bashkohen me Perëndinë dhe të pasojnë peshkopin. Besoj në hirin e Jesu Krishtit, i cili do të shkëputë prej jush çdo lidhje robërie . Gjithashtu, ju lutem të mos bëni asgjë me dëshirë grindjeje, por si nxënës të Krishtit; sepse dëgjova disa që thoshin: “Nëse nuk e gjej në arkiva, nuk i besoj Ungjillit” dhe kur u thashë: “Është i shkruar”, m’u përgjigjen se kjo çështje është ende në diskutim. Për mua arkiv është Jesu Krishti, arkiva të pacënuar janë kryqi i tij, vdekja, ngjallja e Tij dhe besimi nëpërmjet Tij, për të cilat dëshiroj të bëhem i denjë me lutjen tuaj. Të mirë janë edhe priftërinjtë, por më i lartë është kryepriifti, të cilit i janë besuar të shenjtat e të shenjtave, të vetmit që i janë besuar misteret e Perëndisë.

Kjo është dera e Atit, nëpërmjet së cilës hyjnë Abrahami, Isaku, Jakobi, profetët, apostujt dhe Kisha. Të gjitha këto për njëshmërinë e Kishës. Por Ungjilli ka diçka të veçantë: praninë e Shpëtimtarit, Zotit tonë Jesu Krisht, pësimin e tij dhe ngjalljen. Sepse profetët e dashur e shpallën, por Ungjilli është përmbushje

pavdekësie. Të gjitha së bashku janë të mira, nëse besoni me dashuri. Meqë, sipas lutjes suaj dhe dashurisë që keni të bashkuar me Jesu Krishtin, mora vesh se Kisha e Antiokisë në Siri është në paqe, ju takon ju, si Kishë e Perëndisë, të caktoni një dhiakon që të dërgohet atje si ndërmjetës i Perëndisë, që të gëzohet bashkë me ta kur të mblidhen të gjithë dhe të lavdërojnë emrin e Perëndisë. Është i lumur në emrin e Jesu Krishtit ai që do të bëhet i denjë të marrë përsipër këtë shërbesë, por edhe ju do të lavdëroheni. Nëse dëshironi ju, nuk është e pamundur të dërgohet për emrin e Perëndisë, gjë që e bënë dhe Kishat e afërta, të cilat dërguan peshkopë, priftërinj dhe dhiakonë. Për Filon, dhiakon nga Kilikia, burrë i provuar, i cili dhe tani më shërben në fjalën e Perëndisë, bashkë me Reus Agathopus, burrë i zgjedhur, i cili më pason nga Siria duke braktisur jetën, të cilët dhe ju japin siguri, dhe unë falenderoj Perëndinë për ju që i pranuat, ashtu si dhe Zoti ju pranoi ju. Por ata që nuk i nderuan uroj të shpëtohen me hirin e Jesu Krishtit. Ju përshëndet dashuria e vëllezërve të Troasit, nga ku ju shkruaj nëpërmjet Burrusit, i cili u dërgua ndershmërisht bashkë me mua nga efesianët dhe nga smirneasit. Uroj t' i nderojë Zoti Jesu Krisht, në të cilin shpresojnë me trup, shpirt, besim, dashuri dhe njëshmëri. Qofshi shëndoshë, të bashkuar me Jesu Krishtin, i cili është shpresa jonë e përbashkët. *(Marrë nga Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks, shkrimet e hershme, përkthyer nga Ana Baba).*

POLIKARPI I SMIRNIT (70-156)

Polikarpi i Smirnit ka lindur rreth viteve 70 pas Krishtit në Smirni. Ai ishte nxënës i Apostull Joanit, prej të cilit u dorëzua Episkop i Smirnit. U dallua në ndeshjet me heretikët Makrianon dhe Ualetianion. Në debatet për festimin e Pashkës, që u zhvilluan rreth vitit 155 në Romë, ai luajti rol aktiv. Më 23 shkurt të vitit 156, Polikarpi u kap nga Antonio Piu në Smirni dhe u martirizua në stadiumin e qytetit. Në kohën e martirizimit ai ishte në moshën 86-vjeçare. Kujtimin e tij e festojmë më 23 shkurt.

Shkrimet: *Letër drejtuar Filipianëve*, e cila është shkruar në vitin 108 dhe përbëhet prej 14 kapitujsh. Originalitetin e kësaj letre e dëshmojnë Irineu, Eusebi, Jeronimi dhe Foti.

Letër drejtuar Filipianëve Nga Polikarpi i Smirnit

Polikarpi dhe priftërinjtë që janë bashkë me të, Kishës së Perëndisë që gjendet në Filipi i urojnë t' i jepet me bollëk mëshira dhe paqja nga Perëndia i Gjithëfuqishëm dhe nga Jesu Krishti, Shpëtimtari ynë.

1. U gëzova bashkë me ju në emrin e Zotit tonë Jesu Krisht që pranuat shembujt e dashurisë së vërtetë dhe i përcollët të lidhurit me pranga të shenjtëruara ashtu siç patët mundësi, të cilat janë diademë e atyre që janë me të vërtetë të zgjedhur prej Perëndisë dhe Zotit tonë. Gëzohem, gjithashtu, sepse rrënja e qëndrueshme e besimit tuaj, që shpallet nga kohët e vjetra, qëndron deri tani dhe jep fryte në Zotin tonë Jesu Krisht, i cili vuajti për mëkatet tona sa arriti deri në vdekje, “të cilin e ngjalli Perëndia, duke shpërbërë ankthin e Ferrit”. “Në të cilin besuat pa e parë, me gëzim të

lavdërueshëm dhe të patregueshëm”, në të cilin shumë dëshirojnë të futen, duke ditur se “jeni të shpëtuar nëpërmjet hirit, jo nëpërmjet veprave”, por me dëshirën e Perëndisë me anë të Jesu Krishtit.

2. “Prandaj duke ngjeshur meset tuaj, shërbejini Perëndisë me frikë” dhe me të vërtetë, duke braktisur fjalët e shumta të paqëllimshme dhe mashtrimin e turmës, “mbasi i besuat Atij që ngjalli Zotin tonë Jesu Krisht nga të vdekurit dhe i dha lavdi” dhe fron në të djathtën e Tij, “të cilit iu nënshtruan të gjitha, qielloret dhe tokësoret”, të cilin e adhuron “çdo gjë që merr frymë”, i cili vjen të gjykojë “të gjallët dhe të vdekurit”, dhe gjakun e të cilit do të kërkojë Perëndia prej atyre që nuk iu bindën Atij. “Ai që e ngjalli Atë nga të vdekurit do të na ngjallë edhe ne”, nëse bëjmë dëshirën e Tij dhe ecim sipas urdhërimeve të Tij, dhe duam ato që Ai deshi, duke larguar çdo padrejtësi, lakmi, paradashje, akuzë, dëshmi të rreme, “duke mos kthyer të keqen me të keqe, apo sharjen me sharje”, ose grusht në vend të grushtit, apo mallkim në vend të mallkimit. Duke kujtuar ato që Zoti i tha duke mësuar: “Mos gjykoni që të mos gjykoheni, falni dhe do të faleni, mëshironi që të mëshiroheni, me atë masë që matni do të mateni edhe ju”, dhe “të lumtur janë të varfërit dhe ata që përndiqen për hir të drejtësisë, sepse Mbretëria e Perëndisë do të jetë e tyre”.

3. Vëllezërit e mi, këto fjalë për drejtësinë nuk i shkruaj duke marrë vendimin nga vetja ime, por ngaqë ju më nxitni të parët. Sepse as unë, as ndonjë tjetër i ngjashëm me mua, nuk mund të konkurojë me urtësinë e të lumurit dhe të lavdëruarit Pal, i cili kur erdhi te ju ju mësoi personalisht njerëzve të atëhershëm me përpikmëri dhe siguri “fjalën e së vërtetës”, dhe kur mungonte ju shkroi letra, të cilat, nëse i studioni me kujdes, do të mund të ndërtoheni në besimin që ju është dhënë, “i cili është nëna e të

gjithëve ne”, shoqëruar nga shpresa dhe paraprirë nga dashuria ndaj Perëndisë, Krishtit dhe të afërmit. Sepse nëse dikush jeton brenda këtyre përmbush porosinë e drejtësisë; sepse ai që ka dashuri ndodhet larg çdo mëkati.

4. “Fillimi i gjithë të këqjave është paradashja”. Duke ditur pra se “asgjë nuk kemi sjellë në botë, atëherë nuk kemi dhe asgjë që të marrim”, le të armatosemi me armët e drejtësisë dhe le të mësojmë së pari vetet tona të ecin sipas urdhrit të Zotit. Pastaj dhe gratë tuaja me besimin, dashurinë dhe pastërtinë që ju dha atyre t’i kenë burrat e tyre me çdo besnikëri, t’i duan të gjithë njësoj me çdo përmbajtje dhe të edukojnë fëmijët me edukimin e frikës së Perëndisë. Vejushat të jenë të urta përsa i përket besimit të Zotit, të lutën për të gjithë pa pushim, duke qëndruar larg çdo dinakërie, keqgjykimi, dëshmie të rreme, fjalëve të shumta dhe çdo të keqeje, duke ditur se janë therore e Perëndisë dhe se Ai i vështron të gjitha dhe nuk i shpëton asnjë mendim, as imagjinatë, “as ndonjë gjë prej të fshehtave të zemrës”.

5. Duke ditur pra se “Perëndia nuk tallet”, kemi për detyrë të sillemi denjësisht ndaj porosisë dhe lavdisë së Tij. E njëjta gjë edhe për dhjakonët, të jenë të paqortueshëm përpara drejtësisë së Tij, si shërbëtorët e Perëndisë dhe të Krishtit dhe jo të njerëzve. Të mos jenë shpifës, as të dykuptimtë, por joparadashës, të përmbajtur në gjithçka, të mëshirshëm, të kujdesshëm, të ecin sipas ndihmës së Zotit i cili u bë “shërbëtor i të gjithëve”, të cilit, nëse i pëlqejmë në këtë botë do të shijojmë edhe të ardhmen, ashtu siç na premtonte se do të na ngjallë prej së vdekurësh, dhe nëse jetojmë denjësisht ndaj tij, “do të mbretërojmë bashkë me të”, natyrisht nëse besojmë. Gjithashtu edhe më të rinjtë të jenë të përsosur në gjithçka, duke u kujdesur para së gjithash të jenë të pastër dhe t’i

vënë fre vetes së tyre nga çdo e keqe. Sepse është mirë të përmbahen nga dëshirat e botës, sepse çdo “dëshirë qëndron kundër frymës” dhe “as kurvarët, as homoseksualët, as të zhburrëruarit, nuk do të trashëgojnë Mbretërinë e Perëndisë”, as ata që bëjnë veprime të pavend. Prandaj, duhet të largohen nga të gjitha këto, duke iu bindur priftërinjve dhe dhjakonëve ashtu si Perëndisë dhe Krishtit. Virgjëreshat të jetojnë me ndërgjegje të pastër dhe të dliirë.

6. Priftërinjtë të jenë të mëshirshëm, përdëllyes ndaj të gjithëve, të kujdesen për kthimin e të mashtruarve, të vizitojnë të sëmurët, të mos lënë pas dore vejushat, jetimin apo të varfërin, “por të kenë kujdes gjithmonë të mirën përpara Perëndisë dhe njerëzve”. Të qëndrojnë larg çdo zemërimi, anësie, gjykimi të padrejtë, larg çdo paradashjeje, të mos besojnë shpejt diçka kundër tjetrit, të mos jenë të rrëmbyeshëm në gjykimet e tyre, duke ditur se të gjithë jemi fajtorë të mëkatit. Pra, përdërisa i lutemi Zotit të na falë, duhet edhe ne të falim, sepse ndodhemi përballë syve të Zotit dhe të Perëndisë dhe “të gjithë duhet të dalim në gjykatoren e Krishtit dhe secili prej nesh të japim llogari për veten e vet”. Kështu pra, le “t’i shërbejmë me frikë dhe çdo respekt”, ashtu si na porositi Ai vetë dhe apostujt që na shpallën Ungjillin, dhe profetët të cilët parathanë ardhjen e Zotit tonë. Të jemi të zellshëm për të mirën, t’u shmangemi skandaleve dhe vëllezërve të rremë dhe atyre që përdorin emrin e Zotit me hipokrizi dhe mashtrojnë njerëzit e paditur.

7. Sepse kushdo “që nuk pohon, se Jesu Krishti u bë njeri, është antikrisht” dhe ai i cili nuk pohon vuajtjen e kryqit “vjen nga Djalli”, ndërsa ai i cili përshtat fjalët e Zotit me dëshirat e veta dhe thotë se nuk ekziston as ngjallje, as gjykim, ky është i parëlinduri i Satanait. Prandaj, duke braktisur kotësinë e të shumtëve dhe

mësimet e rreme, le të kthehemi në fjalën që na u dha që në fillim, “duke qëndruar të kthjellët në lutje”, duke këmbëngulur në kreshmime dhe duke kërkuar me përgjërime nga Perëndia i padyshimtë “të mos lejojë të biem në ngasje”, ashtu si tha Zoti: “Sepse fryma është e gatshme, por trupi është i dobët”.

8. Pra, le të këmbëngulim pandërprerë në shpresën tonë dhe në garancinë e drejtësisë, që është Jesu Krishti, “i cili lartësoi mbi kryq mëkatet tona, me vetë trupin e Tij” dhe që “nuk bëri mëkat dhe as që u gjet fjalë mashtrimi në gojën e Tij”, por për hirin tonë i duroi të gjitha, që të jetojmë me Të. Atëherë, le të bëhemi imituesit e durimit të Tij dhe nëse vuajmë për emrin e Tij, le ta lavdërojmë, sepse këtë shembull na dha me veten e Tij dhe ne në atë besuam..... (*Përktheu nga anglishtja, Kristo Kume*).

ÂARNAÂA

Sipas dëshmisë së Klimit të Aleksandrisë, Origjenit dhe shkrimtarëve të tjerë kishtarë, shkruesi i letrës anonime nuk është Apostull Barnaba, bashkpunëtori i Apostull Palit. Këtu bëhet fjalë për një tjetër Barnaba me origjinë idhujtare dhe mësues kishtar.

Shkrimet: Me emrin e *Barnabës* ka shpëtuar një letër e cila është shkruar në Aleksandri pas vitit 115 dhe përpara 130. Letra përbëhet nga 21 krerë dhe ndahet në dy pjesë. E para përmban krerët 2-17 dhe flet për rëndësinë e Dhiatës së Vjetër, ndërsa pjesa e dytë krerët 18-20 bën fjalë për dy këngë. Kreu i parë është prologu dhe kreu 21 është epilogu.

HERMAS (142-155)

Sipas Kanonit të Muratorit shkruesi i *Bariut*, ka qenë vëllai i episkopit të Romës Piu I, i cili ka udhëhequr kishën nga viti 142 deri më 155. Gjatë këtyre viteve mendohet të jetë shkruar *Bariu i Hermasit*. Sipas dëshmisë që na jep Origjeni shkruesin e *Bariut të Hermasit* e përmend apostull Pali në letrën e tij drejtuar Romakëve (16,14). Vetë Hermasi tek *Bariu* na jep të dhëna të rëndësishme rreth jetës së tij.

Shkrimet: Hermasi ka shkruar *Bariun*, që ndahet në pesë vegime, dymbëdhjetë porosi dhe dhjetë parabola.

Bariu i Hermasit

–Vizionet. Vizioni i parë. Kundër mendimeve të këqija dhe krenare dhe pakujdesisë së Hermasit në ndëshkimin e bijve të tij.

Kreu I

Ai i cili më rriti, më shiti te një farë Rade në Romë. Pas shumë vitesh unë e njoha atë dhe fillova ta doja atë si motër. Disa kohë pas kësaj unë e pashë atë duke u larë në lumin Tiber; i dhashë dorën dhe e nxora nga uji. Pamja e bukurisë së saj më bëri të mendoj: “Do të jem një burrë i lumtur nëse do të mund të gjej një grua të tillë si në bukuri, si në sjellje”. Ky ishte mendimi i vetëm që më erdhi në mend. Kjo dhe asgjë më tepër. Pas pak kohe, ndërsa isha duke ecur në fshatra dhe po admiroja krijesat e Perëndisë dhe po mendoja sa të mrekullueshme, të bukura dhe të fuqishme ato janë, më zuri gjumi dhe Shpirti më mori dhe më dërgoi në një vend të pakalueshëm në të cilin asnjë njeri nuk mund të ecte sepse ishte

vendosur në mes të shkëmbinjve; ai ishte i thepisur dhe i pakalueshëm për shkak të ujit. Pasi kalova lumin, arrita në një rrafshinë. Pastaj rashë në gjunjë, fillova t’i lutem Zotit dhe t’i rrëfejt mëkatet e mia. Dhe ndërsa po lutesha, qiejt u hapën dhe unë pashë atë gruan që unë e kisha dëshiruar, e cila më përshëndeti nga qielli dhe më tha: “Përshëndetje Hermas!” Dhe duke parë nga ajo, unë thashë: “Zonjë, çfarë bën ti këtu?” Ajo m’u përgjigj: “Unë jam marrë këtu lart për të të akuzuar ty për mëkatet e tua përpara Zotit”. “Zonjë”, -thashë unë,- “ti do të më akuzosh mua?” “Jo”, -tha ajo,- “por dëgjo fjalët që unë do të të them. Perëndia, i cili banon në qiej, dhe që krijoi nga asgjëja gjërat që ekzistojnë, që i shumoi dhe i rriti ato për hir të Kishës së Tij të Shenjtë , është egërsuar kundër teje sepse ti ke mëkatuar ndaj meje”. Unë iu përgjigja asaj: “Zonjë, unë kam mëkatuar kundër teje? Si a kur thashë unë fjalë të pahijshme kundër teje? A nuk kam menduar gjithmonë për ty si një zonjë? A nuk të kam respektuar gjithmonë si një motër? Përse më akuzon në mënyrë të rreme për këto poshtërsira dhe papastërtira?” Duke buzëqeshur ajo m’u përgjigj: “Dëshira për keqësi u ngjall në zemrën tënde. A nuk mendon ti që njeriu i drejtë kryen mëkat kur një dëshirë mëkatore lind në zemrën e tij? Në një rast të tillë, mëkati ekziston dhe ky mëkat është i madh”, -tha ajo. “Sepse mendimet e njeriut të drejtë duhet të jenë të drejta. Sepse duke menduar në mënyrë të drejtë, lavdia e tij është ngritur në qiej dhe ai ka me vete Zotin e mëshirshëm në çdo punë që bën. Por këto mendime të këqija zbavitëse, të ngulura në mendjen e tij, sjellin me vete vdekjen dhe robërinë; dhe i vendosin kënaqësitë e tyre në këtë botë dhe lavdinë te pasuria e tyre, dhe nuk shohin përpara për bekimet e jetës së ardhshme. Sepse për shumë do të ketë keqardhje; ata nuk kanë asnjë shpresë sepse

kanë humbur çdo shpresë për veten dhe jetën e tyre . Por ti lutju Perëndisë dhe ai do të të shërojë nga mëkatet e tua, nga mëkatet e shtëpisë sate dhe të të gjithë shenjtorëve” .

Porositë

Porosia e parë

1. Para së gjithash beso se një është Perëndia, ai që i krijoi dhe i rregulloi të gjitha, dhe solli gjithçka nga e paqena në qenie, dhe i nxë të gjitha, ndërsa Ai vetë është i vetmi i panxënë. 2. T’i besosh, pra, dhe t’i kesh frikë, dhe i frikësuar të përmbahesh. Ruaji këto dhe largo çdo ligësi nga vetja jote dhe vish çdo virtyt drejtësie, dhe do të jetosh me Perëndinë, nëse ruan këtë urdhërim.

Porosia e dytë

1. Më thotë: “Ki thjeshtësi dhe ji pa ligësi, dhe bëhu si foshnjat që nuk e njohin ligësinë, atë që shkatërron jetën e njerëzve. 2. Dhe së pari mos gjyko asnjë, as mos dëgjo me kënaqësi atë që gjykon, sepse ndryshe dhe ti që dëgjon do të jesh fajtor i mëkatit që bën ai që gjykon, nëse beson në gjykimin që do të dëgjosh. Sepse nëse beson, do të kesh dhe ti diçka kundër vëllait tënd. Prandaj do të jesh edhe ti fajtor i mëkatit të atij që përgojon. 3. Përgojimi është i keq, është demon i paqëndrueshëm, që nuk qetësohet kurrë, por banon gjithmonë brenda grindjeve. Pra, qëndro larg këtij, dhe do të kesh bollëk gjithmonë bashkë me të gjithë. 4. Vish hijeshinë, në të cilën nuk ekziston asnjë pengesë e ligë, por të gjitha janë normale dhe të gëzueshme. Bëj të mirën, edhe prej mundimeve të tua, të cilat t’i jep Perëndia, jepu me thjeshtësi të gjithë atyre që nuk kanë, pa ngurruar te kush të japësh dhe te kush të mos japësh. Jepu të gjithëve, sepse Perëndia dëshiron të jepen tek të gjithë prej dhuratave të Tij. 5. Por ata që marrin, do të japin

Ilogari te Perëndia, pse i morën dhe për çfarë i përdorën. Ata që marrin ngaqë kanë nevoja nuk do të dënohen, por ata që marrin me hipokrizi, do të ndëshkohen. 6. Pra, ai që jep është i pafajshëm, sepse shërbimin që mori nga Perëndia për ta kryer, thjesht e kreu, pa bërë dallim te kush të japë dhe te kush jo. Pra, kjo shërbesë që u krye kështu thjesht, u bë e lavdërueshme te Perëndia. Ai, pra, që i shërben kështu thjesht Perëndisë, do të jetojë. 7. Ruaji, pra, këto porosi, ashtu si të thashë, në mënyrë që pendimi yt dhe i shtëpisë tënde të jetë i thjeshtë dhe zemra jote e pastër dhe e panjollueshme.

Parabola e parë

Më thotë: “E dini që ju shërbëtorët e Perëndisë banoni në qytet të huaj, sepse qyteti juaj ndodhet larg këtij qyteti? Përderisa, pra, e dini qytetin që duhet të banoni, atëherë përse përgatitni këtu ara, pallate luksoze, ndërtesa dhe banesa të kota? 2. Sepse ai që i përgatit këto në këtë qytet, nuk pret të kthehet në qytetin e tij. 3. Njeri i marrë, i paqëndrueshëm dhe i mjerë, nuk e kupton se të gjitha këto janë të huaja dhe i përkasin pushtetit të një tjetri? Sepse do të thotë Zoti i këtij qyteti: “Nuk dua të banosh në qytetin tim, dil nga ky qytet, nuk zbaton ligjet e mia”. 4. Ti, pra, që ke ara dhe banesa dhe shumë prona të tjera, pasi do të dëbohesh prej tij, ç’do t’i bësh arës dhe shtëpisë dhe gjithë të tjerave që përgatite për veten tënde? Sepse Zoti i këtij vendi të thotë, dhe me të drejtën e tij: “Ose zbato ligjet e mia, ose ik nga vendi im”. 5. Ti, pra, çfarë do të bësh, duke pasur ligj në qytetin tënd? Për shkak të arave të tua dhe pasurisë tjetër do të mohosh ligjin tënd dhe do të ecësh sipas ligjit të këtij qyteti? Kujdes, mos ndoshta është pa dobi të mohosh ligjin tënd; sepse nëse dëshiron të rikthehesh në qytetin tënd, nuk do të pranohesh, sepse mohove ligjin e qytetit tënd, dhe ti do të mbyllesh jashtë tij. 6. Ti, pra, ki kujdes, ngaqë jeton në

vend të huaj, mos përgatit asgjë për veten tënde, veçse vetëm ato që të janë të domosdoshme, dhe ji gati, që, kur të dojë Zoti i këtij qyteti të të dëbojë, për shkak se kundërshtove ligjin e tij, të ikësh nga qyteti i tij dhe të shkosh në qytetin tënd, dhe të zbatosh ligjin tënd, pa u sharë dhe me ngazëllim. 7. Kujdesuni, pra, ju që i shërbeni Zotit dhe e keni në zemrën tuaj; bëni veprat e Perëndisë duke kujtuar porosinë dhe premtimet që ju dha, dhe besojini Atij, sepse do t' i ruajë, nëse ruhen urdhërimet e Tij. 8. Atëherë, në vend të arave blini shpirta që ndjejnë dhimbje, secili sipas fuqisë së tij, vizitoni vejtashat dhe jetimet dhe mos i përbuzni ata, dhe pasurinë dhe të gjithë gjërat tuaja i harxhoni në shtëpi dhe ara të tilla, të cilat i morët nga Perëndia. 9. Sepse, prandaj ju bëri të pasur Zoti, që t' i ofroni shërbime të tilla. Është shumë më mirë të blini ara dhe prona dhe shtëpi të këtij lloji, të cilat do t' i gjesh në qytetin tënd, kur do të shkosh në të. 10. Ky luks është i mirë dhe i fortë, sepse nuk ka hidhërim as frikë, por gëzim. Pra, mos blini luksin e idhujtarëve, sepse është pa dobi për ju shërbëtorët e Perëndisë. 11. Përkundrazi, blini luksin tuaj, me të cilin mund të gëzoheni, dhe mos e falsifikoni, as mos u afroni, as mos dëshironi gjënë e huaj, sepse është keq të dëshironi gjërat e huaja. Por bëj punën tënde dhe do të shpëtohesh"... (Marrë nga *Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks, shkrimet e hershme*).

PAPIA I JERAPOLIT (70-150)

Papia i Jerapolit ishte dëgjues i Apostull Joanit dhe më vonë i Polikarpit. Ai kishte lindur rreth viteve 70-75 pas Krishtit. Papia ishte dorëzuar Episkop i Jerapolit të Frigisë. Vdekja e tij mund të supozohet rreth viteve 150.

Shkrimet: Papia i Jerapolit shkroi veprën me titull *Logjion i të Dielave dhe komentime të pesë librave*. Kjo vepër u shkrua rreth viteve 130-140 dhe fatkeqësisht ka humbur.

DIDAKIA E 12 APOSTUJVE

Didakia e 12 Apostujve u zbulua në vitin 1875 në Kostandinopojë nga Mitropoliti Filothe Vrioni. Teksti përbëhet prej 16 kapitujsh, të ndarë në tri pjesë. Pjesa e parë është një katikezë morale (kreu I-IV), pjesa e dytë është përshkrim liturgjik (kreu VII-X) dhe e treta ka udhëzime për kishën (kreu XI-XV). Epilogu flet për ardhjen e dytë të Krishtit. *Didakia e 12 Apostujve* na jep shumë informacione për komunitetin e parë të krishterë. (*Dhimitër Beduli, Leksione, Patrologjia, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1998, faqe 38*).

Didakia e dymbëdhjetë apostujve

I. 1. Dy janë udhët, njëra e jetës dhe tjetra e vdekjes. Ato ndryshojnë shumë nga njëra-tjetra. 2. Udha e jetës është kjo: së pari, “do të duash Perëndinë që të krijoi”; së dyti, “të afërmin tënd si veten tënde”, gjithçka që nuk dëshiron të të ndodhë ty, dhe ti mos ia bëj dikujt tjetër. 3. Mësimi që del prej këtyre fjalëve është ky: “Bekoni ata që ju mallkojnë dhe lutuni për armiq të tuaj”, agjëroni

për ata që ju përndjekin: “Çfarë hiri do të keni nëse doni vetëm ata që ju duan? A nuk bëjnë kështu edhe kombet? Por ju duajini ata që ju urrejnë”, dhe nuk do të keni ndonjë armik. 4. Qëndro larg dëshirave mishore dhe trupore. “Nëse dikush të fshikullon në faqen e djathtë, ktheji edhe tjetrën, dhe do të jesh i përsosur. Nëse dikush të detyron të ecësh një milje, bëj dy me të. Nëse dikush të merr tunikën, jepi edhe mantelin. Nëse dikush të merr diçka tënden, mos ia kërko të ta kthejë”, përndryshe nuk do të mundesh. 5. “Jepi kujtdo që të kërkon dhe mos kërko të ta kthejë”; sepse Ati dëshiron që të japim nga vetë hiret tona. Lum ai që jep sipas urdhërimit, sepse është i pafajshëm. Mjerë ai që merr, sepse nëse dikush merr ngaqë ka nevojë, atëherë do të jetë i pafajshëm; ndërsa ai që nuk ka nevojë, do të japë llogari për atë që mori dhe përse e mori; dhe, kur të kapet, do të hetohet për ato që bëri dhe nuk do të dalë prej andej derisa “të mos ketë dhënë edhe qindarkën e fundit”. Por edhe për këtë thuhet: Le të djersijë lëmosha në duart e tua, derisa të marrësh vesh se kujt i jep.

II 1. Urdhërimi i dytë i mësimit: 2. “Nuk do të vrasësh, nuk do të bësh tradhëti bashkëshortore”, nuk do të prishësh fëmijët, nuk do të kurvërosh, “nuk do të vjedhësh”, nuk do të bësh magji, nuk do të helmosh njeri, nuk do të bësh abort apo të vrasësh foshnjën që do të lindë, nuk do të dëshirosh gjërat e fqinjët. 3. “Nuk do të thyesh betimin, nuk do të bësh dëshmi të gënjeshtërt”, nuk do të flasësh keq, nuk do të mbash inat. 4. Nuk do të jesh me dy mendje, as me dy gjuhë; sepse dygjuhësia është lak i vdekjes. 5. Fjala jote nuk do të jetë e gënjeshtërt, as boshe, por e përmbushur në vepra. 6. Nuk do të jesh i pangopur, as grabitqar, as hipokrit, as i mësuar keq, as krenar. Nuk do të marrësh vendim të lig kundër fqinjët tënd. 7. Nuk do të urresh asnjë njeri, por ndërsa disa do t’i

qortosh, të tjerë do t' i mëshirosh dhe do të lutesh për ta; disa do t' i duash më shumë se shpirtin tënd.

III 1. Biri im, largohu nga çdo ligësi dhe nga çdo gjë e ngjashme me të. 2. Mos u bëj zemërak, sepse zemërimi të çon në vrasje. Mos u bëj as ziliqar, as grindavec, as njeri që nxehet shpejt, sepse prej këtyre të gjithave lindin vrasjet. 3. Biri im, mos u bëj njeri i dhënë pas dëshirimeve, sepse dëshirimi të çon në kurvëri. Mos u bëj as gojështurur, as sylart, sepse prej këtyre të gjithave lindin kurvëritë. 4. Biri im, mos u bëj parashikues, sepse të çon në idhujtari. Mos u bëj as yshtar, as parashikues yjesh, as magjistar, madje mos dëshiro as t' i shohësh këto gjëra, sepse prej këtyre të gjithave lind idhujtaria. 5. Biri im, mos u bëj gënjeshtar, sepse gënjeshtria të çon në vjedhje. Mos u bëj as argjenddashës, as njeri që kërkon lavdi të kotë, sepse prej këtyre të gjithave lindin vjedhjet. 6. Biri im, mos u bëj njeri që ankohet, sepse të çon në blasfemi. Mos u bëj as arrogant, as me mendime dinake, sepse prej këtyre të gjithave lindin blasfemitë. 7. Po ji i butë, sepse “të butët do të trashëgojnë dhenë”. 8. Bëhu i ngadaltë në zemërim, i mëshirshëm, pa ligësi, i qetë, i mirë dhe njeri që gjithmonë dridhet nga të gjitha këto që dëgjoje. 9. Nuk do ta lartësosh vetveten dhe nuk do të lejosh mendjemadhësinë të zërë vend në shpirtin tënd. Shpirti yt të mos ngjitet pas të lartëve, por të shoqërohet me të drejtët dhe të përlulurit. 10. Ato gjëra që të ndodhin t' i pranosh si bamirësi, duke ditur se asgjë nuk ndodh pa Perëndinë.

IV 1. Biri im, ta kujtosh natë e ditë “atë që të flet fjalën e Perëndisë”, ta nderosh atë si Zotin, sepse atje ku flitet rreth Zotit, atje është vetë Zoti. 2. Çdo ditë do të kërkosh fytyrat e shenjtorëve, që të prehesh në fjalët e tyre. 3. Nuk do të bësh ndarje, por të paqësosh ata që luftojnë me njëri-tjetrin. Do të gjykos me drejtësi,

dhe kur të gjykosh për shkelje nuk do të mbash anë për shkak të personave. 4. Nuk do të dyshosh nëse diçka është apo jo. 5. Mos u bëj i atillë që shtrin duart për të marrë dhe dorështrënguar për të dhënë. 6. Po të kesh dhe të japësh nga duart e tua, do të japësh shpengim për mëkate të tua. 7. Nuk do të ngurrosh të japësh dhe nuk do të ankohesh kur të japësh, sepse do të dish kush është shpërblyesi i shpagimit. 8. Nuk do t' i kthesh krahët atij që të kërkon, do t' i ndash të gjitha me vëllanë tënd dhe nuk do të thuash se janë të tuat, sepse kur jeni bashkëkungues të të pavdekshmes, sa më tepër duhet të jeni edhe të të vdekshmeve. 9. Nuk do të heqësh dorë nga biri yt apo nga bija jote, por që nga mosha e rinisë do t' u mësosh frikën e Perëndisë. 10. Nuk do të urdhërosh skllavin tënd apo skllaven tënde, që besojnë tek i njëjti Perëndi me ty, në hidhërim e sipër, se mos pastaj nuk kanë më frikë Perëndinë që është mbi të dy. Sepse ai nuk vjen të thërresë personalisht, por vjen tek ata që ka përgatitur Shpirti. 11. Dhe ju skllavër t' u nënshtroheni zotërinjve tuaj, si të ishin një si lloji i Perëndisë me ndrojtje dhe frikë. 12. Do të urresh çdo hipokrizi dhe gjithçka që nuk i pëlqen Zotit. 13. Nuk do t' i braktisësh urdhërimet e Zotit dhe do të ruash ato që more në dorëzim, as mos u shto, as mos u hiq. 14. Në kishë të rrëfesh shkeljet e tua dhe nuk do të shkosh në lutje me ndërgjegje dinake. Kjo është udha e jetës.

V 1. Ndërsa udha e vdekjes është kjo. Pikë së pari dhe mbi të gjitha është e keqe dhe e mbushur me mallkime. 2. Vrasje, tradhëti bashkëshortore, dëshirime, kurvëri, vjedhje, idhujtari, magji, helmime, grabitje, dëshmi të rreme, hipokrizi, dyftytyrësi, mashtrime, krenari, ligësi, arroganca, lakmi, gojështhurje, zili, guximshmëri, lartësim, mburrje. 3. Njerëz që përndjekin të mirat, që urrejnë të vërtetën, që dashurojnë gënjeshtren, që nuk njohin pagën e

drejtësisë, që nuk ngjiten pas së mirës apo gjykimit të drejtë, që vigjëlojnë, jo për të mirën, por për ligësinë. Njerëz të cilëve u qëndron larg butësia dhe durimi, njerëz që duan kotësira, që kërkojnë shpërblime, që nuk mëshirojnë të varfërit, që nuk vuajnë me ata që vuajnë, që nuk e njohin atë që i krijoi, vrasës fëmijësh, që prishin krijesat e Perëndisë, që u kthejnë krahët atyre që u kërkojnë, që mendojnë atë që vuan, mbrojtës të të pasurve, gjykatës të paligjshëm të të varfërve. Bij, shpëtoni prej gjithë këtyre.

VI 1. Tani, asnjë të mos të të mashtrojë të largohesh nga kjo udhë e mësimit, sepse të mëson gjëra të huaja për Perëndinë. 2. Sepse nëse mund të ngresh të gjithë zgjedhën e Zotit, do të jesh i përkryer. Nëse nuk mundesh, bëj atë që të mundesh. 3. Përsa i përket ngrënies, mbaj atë që mundesh, por nga flijimi i idhujve ki shumë kujdes, sepse është adhurim i perëndive të vdekura.

VII 1. Përsa i përket pagëzimit, të pagëzoni kështu, duke thënë gjithnjë më parë këto: “Pagëzoni në emër të Atit dhe të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë në ujë të rrjedhshëm”. 2. Nëse nuk ke ujë të rrjedhshëm, pagëzo në ujë tjetër. Nëse nuk mundesh në ujë të ftohtë, pagëzo në të ngrohtë. 3. Nëse nuk i ke të dyja, derdhi ujë mbi kokë tri herë në emër të Atit dhe të Birit dhe të Shpirtit të Shenjtë. 4. Por përpara pagëzimit le të kreshmojë ai që pagëzohet dhe ai që pagëzon, si dhe ata që munden. Do ta urdhërosh atë që pagëzohet të kreshmojë një ose dy ditë përpara.

VIII 1. Dhe kreshmat tuaja të mos jenë bashkë me ato të hipokritëve. Ata kreshmojnë të hënën dhe të enjten, ndërsa ju do të kreshmoni të mërkurën dhe të premten. 2. As mos u lusni si hipokritët, por siç porositi Zoti në Ungjillin e tij, kështu të luteni: “Ati ynë që je në qiell, u shenjtëroftë emri yt, ardhhtë mbretëria jote, u bëftë dëshira jote si në qiell dhe mbi tokë; bukën tonë të

përditshme jepna neve sot dhe falna fajin tonë, sikurse edhe ne ua falim fajtorëve tanë, dhe mos na shtjer në ngasje, por na shpëto nga i ligu; sepse jotja është fuqia dhe lavdia në jetët”. 3. Të luteni kështu tri herë në ditë.

IX 1. Përsa i përket falenderimit, të falenderoni kështu. 2. Së pari për kupën: Të falenderojmë, Ati ynë, për vreshtin e shenjtë të Davidit, birit tënd, që na e bëre të njohur nëpërmjet Jesuit birit tënd; ty të përket lavdia në jetët. 3. Përsa i përket thyerjes së bukës: Të falenderojmë, Ati ynë, për jetën dhe njohurinë që na e bëre të njohur me anë të Jesuit birit tënd; ty të përket lavdia në jetët. 4. Ashtu si kjo bukë e thyer dhe e shpërndarë mbi malet, pasi u mbledh, u bë një, kështu u mbledhtë edhe Kisha jote nga anët e dheut në mbretërinë tënde; se ty të përket lavdia dhe fuqia nëpërmjet Jesu Krishtit në jetët. 5. Askush të mos hajë apo të pijë nga falenderimi juaj, përveç të pagëzuarve në emrin e Zotit, sepse për ata Zoti ka thënë: “Mos ua jepni të shenjtat qenve”.

X 1. Pasi të jeni ngopur falenderoni kështu: 2. Të falenderojmë, Atë i shenjtë, për emrin tënd të shenjtë, që e tendësove në zemrat tona, si dhe për njohurinë, për besimin dhe pavdekësinë, që na e bëre të njohur nëpërmjet Jesuit, Birit tënd; ty të përket lavdia në jetët. 3. Ti, o Zot i tërëfuqishëm, i ndërtove të gjitha për emrin tënd, ushqimin dhe pijen ua dhe njerëzve për kënaqësi, që të të falenderojnë ty, ndërsa neve na dhe ushqimin dhe pijen shpirtërore si dhe jetën e përjetshme nëpërmjet Birit tënd. 4. Së pari të falenderojmë se je i fuqishëm; ty të përket lavdia në jetët. 5. Kujto, o Zot, Kishën tënde dhe shpëtoje atë nga çdo ligësi dhe përsosë atë në dashurinë tënde. Mblidhe atë nga të katër anët e erës, mblidhe atë që u shenjtërua në mbretërinë tënde që e bëre gati për të; se ty të përket fuqia dhe lavdia në jetët. 6. Le të vijë hiri dhe le të shkojë

kjo botë: Hosana Perëndisë së Davidit. Kush është i shenjtë, le të vijë, të pendohet. “Maran atha”. Amen. 7. Ndërsa profetët i lejoni të thonë falenderime sa të duan... (*Marrë nga Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks, shkrimet e hershme*).

PËRNDJEKJET NDAJ TË KRISHTERËVE NGA PERANDORËT ROMAKË

Pothuajse të gjithë perandorët romakë, duke filluar që nga Neroni (54-68) e deri te Diokliciani (248-305), i kanë përndjekur të krishterët. Përndjekjet qenë të shumta, por historiani Honore e përcaktoi në dhjetë numërin e tyre, duke i karakterizuar këto si më të përgjakshmet. Dhjeta u pranua si numër simbolik duke u krahasuar me dhjetë plagët (fatkeqësitë) e Faraonit, të cilat janë konsideruar si prototip i përndjekjeve ndaj të krishterëve. (*Tajar Zavalani, Histori e Shqipnis, Londër 1966, faqe 43*).

Jesu Krishti e kishte parathënë: “Atëherë do t’ju mendojnë dhe do t’ju vrasin. Të gjithë popujt do t’ju urrejnë për shkakun e emrit tim. Atëherë shumë do të lënë fenë, do ta tradhëtojnë njëri-tjetrin dhe do të kenë mëri njëri-tjetrin. Shumë profetë të rremë do të ngrihen dhe do të gënjejnë shumë veta. Do të shtohet padrejtësia dhe dashuria e të shumtëve do të ftohet. Por kush do të durojë deri në fund, do të shpërblehet” (Mat. 24, 9-13).

Përndjekja e tretë u bë në kohën e Perandorit Trajan (98-117) dhe ishte e përgjakshme. Trajani, sapo hipi në fron, përtëriu ligjin, me anën e të cilit ndaloheshin mbledhjet e të krishterëve. Prokonsulli i Betanisë, Plini i Ri (62-113) me anën e një letre e pyet perandorin Trajan si duhet të silllet me të krishterët.

Kjo letër ka një rëndësi të madhe historike, sepse dëshmon për praninë e të krishterëve në atë trevë. Plini e pyeste: -Nëse duhej t’i dënonte me vdekje të krishterët që mblihdeshin një ditë të caktuar dhe i këndonin himne Krishtit, por që në përgjithësi qenë njerëz paqësorë e të moralshëm? Në përgjigjen e tij, Trajani i thotë që të dënonte jo të gjithë të akuzuarit, por vetëm ata që nuk pranonin t’u bënëin therore idhujve dhe e pranonin hapur se qenë të krishterë. Gjatë kësaj përndjekjeje u martirizuan Klimi i Romës, Flavia Domitilla, Ignati i Antiokisë, Simeoni i Jerusalemit etj. (*Zef Mirdita, Krishtenizmi ndër shqiptarë, Drita, Zagreb 1998, faqe 125*).

Të krishterët në Betani Dilema e Plinit

Plini ishte dërguar në Betani, në vend të Guvernatorit Senatorial të zakonshëm, nga Trajani për të riorganizuar çështjet e provincës, në veçanti ato të qyteteve të vetëqeverisura, të cilat kishin rënë në një gjendje të vajtueshme për shkak të keqkujdesjes së “autoriteteve lokale”. Korrespondenca ekzistuese midis tij dhe perandorit e tregon Plinin “të paanshëm dhe të ndërgjegjshëm, por të pavendosur, pedant dhe tërësisht të paaftë për të menduar dhe vepruar i vetëm në çdo rrethanë të pazakontë”. Të krishterët ishin në një nga rrethanat e pazakonta.

1. Është në zakonin tim, zot dhe perandor, t’ju drejtoj të gjitha pyetjet për të cilat kam dyshime. Kush mund të më drejtojë më mirë kur jam në pozitë ose të më ndriçojë kur jam në padije? Unë nuk kam marrë kurrë pjesë në hetimet e të krishterëve; prandaj nuk e di se cili krim është dënuar apo hetuar zakonisht, ose çfarë tolerimesh janë bërë.

2. Kështu, kam pasur jo pak paqartësi nëse ekziston një dallim moshe, apo nëse shkelësit më të dobët janë trajtuar njësoj si të fuqishmit; nëse falja u është dhënë atyre që janë penduar, apo një person që ka qenë dikur i krishterë nuk ka përfituar asgjë edhe pasi ka pushuar së qeni i tillë; nëse dënimi i bashkangjitet thjesht emrit veçan nga krimet e fshehta, apo krimet e fshehta janë të lidhura me emrin. Ndërkohë, ky është mësimi që unë kam marrë nga ata që ishin të akuzuar përpara meje si të krishterë.

3. I pyesja ata nëse ishin të krishterë, dhe nëse ata pohonin i pyesja së dyti e së treti me kërcënime dënimi. Nëse ata këmbëngulnin, unë urdhëroja të ekzekutoheshin; sepse unë nuk kisha asnjë dyshim se çfarëdo të ishte ajo që ata pranonin, në çdo rast, kokëfortësia dhe mbrapshtia e papërlur e meritoi të ndëshkohen.

4. Kishte dhe të tjerë të së njëjtës marrëzi, por meqenëse ata ishin shtetas romakë unë shënova që të dërgoheshin në Romë. Si në çdo rast, pa kaluar shumë kohë, fakti se çështja ishte përhapur e bëri atë të përbashkët dhe lindën disa çështje të veçanta.

5. U paraqit një letër e panëshkruar, e cila jepte emrat e shumë vetave. Për sa u përket atyre që thanë se as ishin dhe as kanë qenë ndonjëherë të krishterë, e mendova të drejtë t'i lë të ikin, pasi thanë një lutje te perënditë nën diktimin tim, bënë fljime me temjan dhe verë përpara statujës suaj, të cilën unë urdhërova të sillej në oborr për këtë qëllim së bashku me imazhet e perëndive, dhe për më tepër mallkuan Krishtin—gjë të cilën (siç thuhet) ata që vërtetë janë të krishterë nuk mund të detyrohen ta bëjnë.

6. Të tjerë, emrat e të cilëve ishin përmendur nga njoftuesi, thanë se ata kishin qenë të krishterë, por më pas e mohuan duke shpjeguar se ata kishin qenë, por kishin pushuar së qeni të tillë,

disa tre vjet më parë, disa prej shumë vitesh dhe madje disa të paktë edhe prej njëzet vitesh. Gjithashtu, dhe këta njëkohësisht adhuruan statujën tuaj dhe imazhet e perëndive dhe mallkuan Krishtin.

7. Sidoqoftë, ata pohuan se faji apo gabimi i tyre ishte ky: ishte zakon i tyre të mblidheshin në një ditë të caktuar përpara agimit të ditës dhe me radhë të thonin një formulë fjalësh për Krishtin si Perëndi; dhe ata e lidhnin veten me një betim, jo për ndonjë krim, por për të mos kryer vjedhje, grabitje apo tradhëti bashkëshortore, për të mos thyer fjalën dhe për të mos mohuar dëshminë kur u kërkohet. Pasi bëhej kjo, zakoni i tyre ishte të shpërndareshin dhe të takoheshin përsëri për të marrë ushqimin, por ushqim të zakonshëm dhe të padëmshëm; por edhe nga kjo (thanë ata) kishin hequr dorë, pasi u publikua dekreti im, me anë të të cilit, në përputhje me urdhrat tuaja, unë kisha ndaluar ekzistencën e klubeve.

8. Këtë unë e kosiderova më të rëndësishme të zbuloja me anë torturash prej dy shërbyesesh, të cilat quheshin dhjakonesha, se sa e vërtetë ishte. Por nuk zbulova asgjë tjetër veç një supersticioni të mbrapshtë dhe të paarsyeshëm.

9. Megjithatë, unë e shtyva për më vonë çështjen dhe shpejtova të këshillohem me ju. Çështja m' u duk e vlefshme për t' u shqyrtuar, veçanërisht duke menduar numrin e madh të atyre që janë në rrezik; sepse shumë nga të gjitha moshat dhe nga të gjitha shtresat, dhe gjithashtu nga të dyja gjinitë, janë në rrezik të tashëm ose të ardhshëm. Përhapja e këtij supersticioni ka hyrë jo vetëm në qytete, por dhe në fshatra e provinca; tashmë ngjan e mundur të ndalohet dhe riparohet.

10. Ciladoqoftë shpejtësia, është mjaft e sigurt se tempujt gati të braktisur filluan të rimëkëmben, se ceremonitë e gjata fetare të dala jashtë përdorimit janë rigjallëruar dhe se ushqimi për flijimet ka gjetur treg, ndërsa deri tani blerësit ishin shumë të pakët. Prej kësaj lehtë mund të supozohet se sa numër i madh njerëzish mund të korrigjohen, nëse do të kishte një vend pendimi.

Përgjigja e Trajanit

1. Ti ke përvetësuar drejtimin e duhur, i dashur Sekundus, në shqyrtimin e çështjes së atyre që ishin akuzuar përpara teje si të krishterë, por asgjë nuk mund të përcaktohet si rregull i përgjithshëm duke përfshirë diçka si një formë të vendosur procedure. 2. Për ata nuk nevojitet të bëhen kërkime; por nëse janë të akuzuar dhe shpallur fajtorë, duhet të dënohen – në këto rrethana, ai që mohon të jetë i krishterë dhe e vërteton faktin me veprimet e tij, domethënë duke adhuruar perënditë tona, do të marrë falje për pendimin e tij, sado e dyshimtë qoftë e shkuara e tij. Gjithsesi, letrat që paraqiten të panëshkruara nuk duhet të pranohet në asnjë mënyrë, pasi ato janë një shembull i keq dhe pavlerë për kohën tonë. *(Përktheu nga anglishtja, Kristo Kume).*

Përndjekja e katërt shpërtheu në kohën e Mark Aurelit (161-180). Ky ishte një filozof stoik dhe jetën e të krishterëve e shihte me fanatizëm. Urrejtja ndaj të krishterëve sa vinte e rritej, megjithatë edhe numri i të krishterëve rritej gjithnjë e më tepër. Mark Aureli i pyetur nga një qeveritar francez që shprehur se të krishterët që nuk e mohojnë Krishtin duhet të dënohen me vdekje. Gjatë kësaj përndjekjeje janë martirizuar: apologjiti dhe filozofi

Justin me gjashtë nxënës të tij rreth viteve 163. Në Lion të Francës në vitin 178 gjetën vdekjen prej martiri rreth 50 të krishterë, ndërmjet të cilëve edhe Episkopi i Lionit Fotini. Në Pergan të Azisë së Vogël u martirizuan Episkopi i qytetit Karpi së bashku me dhjakonët Papili dhe Agathoniku. Në kohën e sundimit të birit të Mark Aurelit, Komodit (180-192) pozita e të krishterëve u përmirësua për shkakun se gruaja e tij Marcia ishte e krishterë. Falë ndikimit të saj të krishterët ranë disi në qetësi.

Përndjekja e pestë u bë në kohën e Septin Severit (191-211), i cili në fillimin e mbretërimit të tij u soll mirë me të krishterët, sepse qe shëruar prej një të krishteri nga një sëmundje e rëndë. Por në vitin 202, kur pa se numri i të krishterëve qe shtuar, nxori ediktin me të cilin ndalohej kalimi në judaizëm dhe filloi persekutimet ndaj të krishterëve. Përndjekjet filluan në Gali, Egjipt e sidomos në Afrikë, ku gurbanatori i provincës së Skapulës, i vazhdoi përndjekjet edhe mbas vdekjes së Severit. Gjatë kësaj përndjekjeje u martirizuan Leonidha, i ati i Origjenit nga Aleksandria, Shën Irineu, Episkopi i Lionit si dhe fisnikja Perpetua dhe skllavja Felicita. Mbas vdekjes së Severit, përndjekjet ndaj të krishterëve pushuan disi. I biri i Severit, Karakali (211-217) kishte që nga fëmijëria e tij përshtypje të mira për krishterimin. Ky me një edikt në vitin 212 ua dha lirinë të gjithë qytetarëve të perandorisë romake duke përfshirë edhe të krishterët.

Më pas me Aleksandër Severin (222-235) kemi një atmosferë tolerante ndaj të krishterëve. Nën ndikimin e nënës së tij Julia Manesë perandori i mbrojti të krishterët. Ai përveç statujave të Apolonit e Orfeas vendosi edhe statujën e Krishtit. Gjithashtu nëpër muret e anaktorëve të tij, pati shkruar pjesë nga Ungjilli sipas Lukës dhe Didakinë e 12-të Apostujve.

Përndjekja e gjashtë u bë në kohën e Maksim Thrakasit (235-238) gjendja e të krishterëve ndryshoi, sepse perandori mendonte se të krishterët qenë ithtarë të paraardhësit të tij Aleksandrit. Kjo përndjekje u zbatua kryesisht ndaj klerit. Gjatë kësaj përndjekjeje u persekutuan Shën Hipoliti dhe Papë Ponciani (230-235). Ata u dërguan në internim nëpër minierat e Sardenjës ku vdiqën nga keqtrajtimet. Ndonëse kjo përndjekje qe e shkurtër, sepse Maksimin e vranë ushtarët e tij, megjithatë mund të themi se ishte e përgjakshme. Mbas vdekjes së Maksimit, pasardhësit e tij kanë qënë perandorë ushtarakë. **Përndjekja e shtatë** u bë në kohën e Perandorit Decius (249-251). Në vitin 249 ai nxori një edikt me të cilin i detyronte të krishterët që t’u ofrojnë flijime hyjnine. Shkaku i persekutimit ishte sulmi i gotëve ndaj Perandorisë Romake dhe për këtë u akuzuan të krishterët. Kjo përndjekje u drejtua më tepër ndaj priftërinjve dhe episkopëve. Kështu në Romë u martirizua Episkop Fabiani (236-250), më pas Aleksandri i Jeruzalemit dhe Vavila i Antiokisë. Në Aleksandri martirizohet Shën Apolonia së bashku me 23 të krishterë. Në Smirni u dogj prezbiteri Pioni etj. Të gjithë të Krishterët që u kishin ofruar flijime idhujve dhe ishin shënuar nëpër listat e paganëve u quajtën ramë. Mbas vdekjes të Decit një numër i madh prej tyre u kthye sërish në Krishterim. Në Sinodin e Kartagjenës, Shën Qipriani theksoi se të gjithë ramët n.q.s. janë penduar duhet të pranohen në krishterim. Kthimi i ramëve, shkaktoi përçarje në gjirin e Kishës sepse presviteri Novati nga Kartagjena ju kundërvu Shën Qiprianit, duke krijuar kështu skizmën Novatiane. Novati (251-253) pretendonte se ramët nuk mund të pranohen në krishterim, përveçse në momentin e vdekjes. Për t’ju kundërvënë Novatit Shën Qipriani shkroi traktatin “Mbi unitetin e Kishës”.

Përndjekja e tetë u bë në kohën e perandorit Valerian (253-260). Ky i fundit në vitin 257 nën ndikimin e Makrianit, që ishte Ministër i Arkës Perandorake nxori ediktin për të persekutuar priftërinjtë duke ua marrë pasuritë për të mbushur arkën perandorake. Gjatë kësaj përndjekjeje u martirizuan Episkopi i Kartagjenës Shën Qipriani, Dionisi i Aleksandrisë, Papa Stefani i Romës (254-257), Papa Siksti II (257-258), dhjakoni Lorenc etj. Valeriani në vitin 260 u zu rob nga mbreti i persianeve Sapor. I biri i Valerianit, Galieni (260-268), nën ndikimin e gruas të tij Saloninës, e cila e përkrahte krishterimin në vitin 262 nxori një dekret, me anën e të cilit i lejonte të krishterët të praktikonin lutjet në liri të plotë në vendet e grumbullimit e nëpër varrezat e tyre.

Përndjekja e nëntë u bë në kohën e Perandorit Aurelian (270-275), i cili qe nga Iliria. Aureliani kishte lindur në Smirnum, që ishte kryeqendra e Panonisë e ndërtuar mbi lumin Savë dhe banohej prej Ilirëve. Aureliani mbretëroi më pak se pesë vjet. Gjatë këtyre viteve ju desh të luftonte me gotët, alemanët, vandalët etj. Në vitin 271 e rrethoi Romën me mure të cilat u quajtën “moenia Aureliane” (muret e Auerlianit). Por Aureliani në vitet e fundit të mbretërisë së tij nxori një dekret më 274 kundër të krishterëve. Shkaku i ediktit u bë një nga këshilltarët e tij, Porfiri, i cili ishte themelues i neoplatonizmit. Ai shkruan një vepër me 15 volume “Kundër të Krishterëve”. Aureliani besonte në kultin e Mitrës dhe të hyjnisë së Diellit. Të gjithë shtetasit e Perandorisë Romake kanë qenë të detyruar të nënshtrohen këtij kulti. Meqenëse të krishterët nuk pranuan, u shpallën armiq të shtetit. Gjatë kësaj përndjekjeje u martirizua Papa Feliksi (269-274) kurse në Gali u martirizua Peshkopi Reverian e presbiteri Pal. Mirëpo edhe Aureliani vritet

pas një komploti në vitin 175. Përndjekja e Aurelianit ka qenë e shkurtër dhe më pak e përgjakshme.

Përndjekja e dhjetë shpërthen në kohën e perandorit Dioklecian (285-305). Ky i fundit ishte nga fisi i Dioklesë në Malin e Zi të sotëm. Diokleciani qëndroi në krye të Perandorisë Romake për 21 vjet. Në vitin 293 ai mori masa të karakterit administrativ, duke e ndarë perandorinë në katër njësi, dy në Lindje e dy në Perëndim. Kujdesi për unitetin e perandorisë, e shtyu Dioklecianin që të organizojë përndjekjet ndaj të krishterëve, të cilët nëpër bashkësitë e tyre silleshin si të ishin të pavarur. Në fakt deri në fillim të shekullit të IV, Diokleciani nuk sillej keq me të krishterët, madje dhe bashkëshortja e tij dhe e bija Valeria ishin të krishtera. Numri i të krishterëve rritej gjithmonë e më shumë dhe nëpër radhët e shtresave ushtarake. Por nga fundi i mbretërimit të tij, filloi të ndryshojë qëndrimin ndaj të krishterëve. Ky ndryshim erdhi nga ndikimi i Galerit prej Heroklitit, një filozof neoplatonik dhe armik i betuar i të krishterëve.

Kështu Diokleciani iu kthye problemit të fesë me qëllim që të rivendoste rilegjonin e lashtë romak. Në zbatimin e këtij vendimi ai filloi të spastronte ushtritë nga të krishterët. Në vitin 299 në Numidi, një i krishterë i quajtur Maksimilian, nuk donte të rekrutohej në ushtri. Ndërsa kryeqindëshi Marceli, i cili ishte i krishterë nuk dëshironte të vazhdonte shërbimin ushtarak sepse ishte detyruar të adhuronte kultet pagane. Diokleciani që në vitin 300 kishte urdhëruar që ushtarët duhet t'u ofronin flijime hyjnine romake. Në shkurt të vitit 303 në ditën e hyjnisë Termin, Diokleciani shpall ediktin në emër të katër perandorëve që të rrënohen të gjitha kishat e krishtera dhe të digjen librat e shenjtë. Gjithashtu ndalohej edhe kryerja e riteve fetare. U martirizuan disa zyrtarë të oborrit

perandorak si p.sh. Dhorotheu e Petri, Episkopi i Nikomedisë Autimon etj. Mbasi edikti ishte shpallur në emrin e katër sundimtarëve, përndjekje të përgjakshme u bënë dhe në Thrakë, Egjipt, Palestinë, Iliri e deri në Danub. Në vitin 303, me shpërthimin e kryengritjes në Siri dhe në Armeni, ku të krishterët ishin në numër të madh, Diokleciani shpalli ediktin dytë, sipas të cilit e gjithë para e kishës duhet të burgoset. U burgosën mjaft episkopë e priftërinj. Më vonë në vitin 304 Diokleciani nxjerr një edikt tjetër, sipas të cilit ata që nuk flijojnë sakrifica para hyjnive duhet të vdesin. Ky u quajt edhe Edikti i Gjakut. U martirizua Anjeza dhe Anastasia në Romë, Luçia në Sirakuzë, Shën Katerina në Aleksandri, Shën Gjergji, Shën Dhimitri, Shën Pandleimoni, Shën Varvara etj. (*Dhimitër Beduli, Leksione, Historia e Kishës, Tiranë 1998, faqe 91*).

SULMET NDAJ KRISHTERIMIT NGA FILOZOFËT PAGANË

Krishterimi u sulmua nga ana e paganëve jo vetëm në planin fizik me anë të persekutimeve, por edhe në planin doktrinor, në mënyrë direkte dhe indirekte. Në mënyrë indirekte krishterimi, u luftua më anë të shkollave filozofike të neopitagorianëve dhe neoplatonistëve, të cilët u orvatën të krijonin një besim fetar të ri duke përzjerë atë çka ishte e mirë nga filozofia e kohës, me elemente të huazuara nga paganizmi. Një përpjekje të tillë bëri neopitagoriani Apolloni i Tianës, në shekullin e parë.

Në mënyrë direkte krishterimi u sulmua nga të ashtuquajturit polemistëpaganë, të cilët e bënë krishterimin, objekt talljesh dhe u përpoqën ta sakatonin si doktrinë, me synimin që ta diskreditonin

dhe të bënin që paganët ta përbuznin dhe mos ta përqafojnë. Më të rëndësishmit prej tyre qenë: Çelsi, Luçiani nga Samosata dhe Porfiri. Përveç këtyre tre polemistëve të rëndësishëm, mund të citohet edhe Heriokle, prefekti i Betanjës, i cili në fillim të shekullit IV, përmbledhi në një libër të vetëm gjithçka që ishte shkruar deri atëherë kundër kristianizmit nga polemistët e vjetër. Gjithashtu perandori Julian Apostati ishte kundërshtar i krishterimit.

ÇELSI

1. Çelsi ishte filozof pagan, i cili nga mesi i shekullit të parë, shkroi një vepër me titullin “Doktrina e vërtetë”, që binte ndesh me krishterimin. Dijetari famshëm Çelsi, akuzat e tij kundër krishterimit nuk i paraqet drejtpërsëdrejti, por i vë në gojën e një judeu, i cili e prezanton Jesu Krishtin si një magjistër dhe mashtrues, ndërsa mrekullitë që kishte bërë dhe Ngjalljen e tij si të ishin përralla; Virgjëreshën Mari si një grua me moral të diskutueshëm etj. Por Çelsi tallet edhe me judaizmin, të cilin e konsideron absurd dhe të bazuar në gënjeshtëri. Ai i krahason kristianët dhe judejtë si një tufë lakuriqësh nate ose si një grumbull mizash dheu ose si krimba. Çelsi e njihje mjaft mirë doktrinën kristiane, pasi kishte lexuar shumë vepra të shenjta dhe kishte asistuar në disa mbledhje të kristianëve. Duke u tallur me kristianët dhe duke kritikuar kristianizmin, ai shpresonte t’i nxiste të krishterët që të ktheheshin në paganizëm, që sipas tij ishte si feja e shtetit romak dhe i vetmi besim fetar i vërtetë. Ai e përfundon veprën e tij me një thirrje të ngrohtë drejtuar kristianëve, që të mos i kundërvihen rendit publik, por t’i japin

perandorit mbështetjen e tyre që të mund të mbajë e të ruajë të lulëzuar perandorinë me tërë institucionet e saj.

LUÇIANI I SAMOSATËS

2. Luçiani i Samosatës ka qenë shkrimtari më i madh satirik i kohës. Nga talljet e tij therëse nuk mund të shpëtonin as zotat paganë, as filozofët grekë. Ai e luftoi kristianizmin me anën e një romani me titull *Perengrinus proteus*, që e shkroi nga fundi i shekullit të dytë. Luçiani merret me kristianizmin kalimthi, aq sa për ta satirizuar, mbasi në thelb të romanit të tij ishte tallja e filozofëve cinikë të kohës. Heroi i romanit ishte Peregrinus Proteu, një filozof cinik. Peregrini duke u bërë mëkatar, largohet nga vendi i vet dhe duke shkuar në një vend tjetër ku bëhet kristian. Ai arrin të dorëzohet prift dhe shkruan vepra profetike. Për shkak të zellit të tij në përhapjen e kristianizmit përfundoi në burg, por e shpëtuan të krishterët. Më vonë ata e zbuan nga komuniteti i tyre, sepse ai ishte qesharak dhe për faktin se kishte ngrënë nga një gjellë e ndaluar. Pas kësaj kthehet e bëhet përsëri filozof cinik. Luçiani e sulmoi kristianizmin vetëm kalimthi duke e satirizuar. (Atë Joan Mihalcesku, *Historia universale e kristianizmit, përkthyer nga rumanishtja prej Teodor Papapavlit, Tiranë 1993, faqe 27*).

PORFIRI (234-304)

Porfiri ka lindur në vitin 234 në Tir dhe ka qenë kundërshtari i fundit kundër kristianizmit në fushën letrare. Kishte qenë nxënës i Plotinit (204-270). Ky i fundit ishte themeluesi i neoplatonizmit. Porfiri e njohte me themel doktrinën kristiane, sepse kishte ndjekur kurset e Origjenit dhe thuhet se madje e kishte përqaftuar kristianizmin, por pastaj ishte kthyer përsëri në paganizëm, për shkakun se ishte rrahur nga disa të krishterë. Porfiri vdiq në Romë në vitin 304 pas Krishtit.

Shkrimet: Porfiri ka shkruar komentaret e veprave të Platonit (427-347 para Krishtit) dhe të Aristotelit (384-322 para Krishtit). Qëllimi i tij ishte të kultivonte idetë e neoplatonizmit kundra doktrinës kristiane. Ai shkroi një vepër *Kundra kristianëve* me 15 volume. Libri i tij ishte kritika më e egër kundër kristianizmit. Autori përpiqet të zbulojë kontradikta në mësimet kristiane. Sipas tij, Dhiata e Vjetër vjen në kundërshtim me Dhiatën e Re, Jesu Krishti me Apostujt dhe këta të fundit me njëri-tjetrin. Për personin e Jesu Krishtit, kishte shumë respekt dhe miratonte disa nga mësimet e Tij, ato që ngjasonin me idetë e neoplatonizmit. (*Zef Mirdita, Krishtenizmi ndër shqiptarë, Zagreb 1998, faqe 134*).

APOLOGJISTËT KRISTIANË

Kundër sulmeve të tërbuara të filozofëve, që ishin kundërshtarë të egër të kristianizmit, u përgjigjën një numër shkrimtarësh kristianë, që quhen apologjistë, d.m.th. mbrojtës të kristianizmit. Më të rëndësishmit ndër ta janë: Kodrati, Aristidhi i

Athinës, Ariston i Pelës së Palestinës, Justin Filozofi, Tatian Siriani, Miltiadihi, Apolinari i Hierapolit, Athinagora i Athinës, Theofili i Antiokisë, Melito i Sardës dhe Hermia filozofi. Disa nga apologjistët u drejtuan apologji Perandorit dhe Senatit të Romës, apologjistë të tjerë u shkruajtën paganëve me influencë, ndërsa disa iu përgjigjën polemistëve paganë. Të gjithë apologjistët treguan se të krishterët janë njerëz besimtarë, të moralshëm dhe paqedashës, sepse i falen një Perëndie, vënë në jetë virtytin dhe i nënshtrohen ligjeve të shtetit. Akuzat e paganëve në adresë të tyre edhe për të cilat i persekutojnë, janë gjëra të imagjinuara dhe nuk kanë bazë, veçse thjesht mosnjohjen nga ana e persekutuesve të fesë së të persekutuarve.

Akuza se të krishterët janë ateistë nuk qëndron, sepse ata nuk u falen idhujve dhe nuk duan t' u bëjnë fli. Në fakt të krishterët janë njerëzit më fetarë, sepse i falen Perëndisë së vërtetë, të përfaqësuar nga Trinia e Shenjtë. Kulti i tyre është shpirtëror me të cilin nuk mund të krahasohet asnjë nga kultet e feve të tjera. Përsa i përket idhujve, të cilëve u falen paganët, këta nuk përfaqësojnë veçse drutë, gurët dhe metalet nga të cilat janë bërë statujat e tyre. Vënia e këtyre sendeve në vendin e Perëndisë dhe lutjet drejtuar atyre përbën ateizëm dhe si përfundim, paganët janë ateistë dhe jo të krishterët. Akuza tjetër se krishterimi është kundër rendit shtetëror ishte e pabazë, sepse të krishterët vërtet mblidheshin fshehurazi, por në mbledhjet e tyre nuk thurnin komplete kundër shtetit. Ata celebronin shërbesën hyjnore. Nëse këtë gjë e bënin fshehtëzi qenë të detyruar nga paganët që i persekutonin. Prova më mirë që të krishterët nuk ishin kundër rendit shtetëror është fakti se ata qenë njerëz paqedashës dhe u nënshtrohen të gjitha ligjeve me përjashtim të atyre që cenonin fenë e tyre.

Fatkeqësitë që ndodhin në perandori nuk ishin efekti i shfryrjes së zotave sepse të krishterët nuk u falen atyre, por përkundrazi qenë nga shkaku i dënimit të Perëndisë kundër paganëve. Gjithashtu të pabaza ishin akuzat se doktrina kristiane përmbledh ide të gabuara dhe absurde; se midis Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re, madje midis Jesu Krishtit dhe apostujve të Shenjtë ekzistojnë kontradikta flagrante; se Jesu Krishti na ishte mashtrues, ndërsa apostujt sharlatanë; në mbledhjet e kristianëve bëheshin eksese dhe imoralitete të tmerrshme etj. Për falsitetin e këtyre akuzave mund të bindej kushdo, në qoftë se merr mundimin të studiojë doktrinën kristiane, e cila predikon virtytin dhe ndershmërinë. Me anë të këtyre përgjigjeve apologjistët arritën të shpërndanin pjesërisht shpifjet e përhapura për llogari të jo të krishterëve dhe të paraqesin krishterimin në dritën e tij të vërtetë duke përgatitur në këtë mënyrë rrugën për triumfin e tij përfundimtar në të gjitha drejtimet. Apologjistët mbrojtën besimin e vërtetë jo vetëm kundër herezive të krishtera, por edhe kundër paganizmit dhe judaizmit. (*Protoprezviter Thomas Hopko, Besimi Orthodhoks, vëllimi III, Shkrimi i Shenjtë dhe Historia e Kishës, përkthyer nga Imzot Joan Pelushi, Tiranë 2000, faqe 175-176*).

KODRATI

Kodrati është apologjisti më i vjetër i krishterimit. Ai ishte një nxënës i apostujve, të cilët e hirotonisën Kryeepiskop të Athinës. Nëpërmjet predikimit të tij shumë paganë përqaftuan krishterimin. Ndër ta kishte shumë grekë të ditur, të cilët Kodrati me fjalët tij arriti t' i tërheqë te besimi i Krishtit. Apostull Kodrati u tregoi njerëzve

rrugën e vërtetë, por shumë filozofë të asaj kohe duke mos e duruar këtë gjë, e dëbuan me forcë nga Athina. Për të shpëtuar nga përndjekja shkoi në Magnisia të Azisë së Vogël, ku predikoi me zell Ungjillin. Ai i shkroi perandorit një apologji për të mbrojtur kristianizmin. Perandori Adrian urdhëroi që Kodrati të vritej. Kështu pohuesi i madh i besimit mori kurorën e martirit. Lipsani i Kodratit ndodhet në Magnisia.

Eusebio te *Historia Kishtare* (4; 3,1-2) shkruan: “Kur Trajani kishte mbretëruar për nëntëmbëdhjetë vite e gjysmë, Adriani e pasoi në mbretërim. Kodrati i drejton një trajtesë, duke hartuar një apologji për besimin tonë, sepse disa njerëz të ligj po përpiqeshin t’u nxirrnin ngatërresa të krishterëve. Ky shkrim ekziston ende mes shumë prej vëllezërve, dhe ne kemi vetëm një kopje. Prej këtij shkrimi mund të shihet prova e qartë e intelektit dhe e ortodoksisë së tij apostolike. Ai tregon datën e hershme të tij prej asaj që ai thotë, siç vijon me vetë fjalët e tij: “Por punët e Shpëtimtarit tonë ishin gjithmonë të pranishme, sepse ishin të vërteta: ata që u shëruan dhe ata që u ngritën nga të vdekurit, të cilët u panë jo vetëm kur u shëruan dhe u ngjallën, por ishin vazhdimisht të pranishëm; dhe jo vetëm kur Shpëtimtari ishte gjallë, por edhe pasi ai kishte ikur, ata ishin në jetë për një kohë të gjatë, kështu, shumë prej tyre mbijetuan, madje deri në ditët tona”. Fjalët e cituara nga Eusebi, janë fragmenti i vetëm i kësaj apologjie. Kodrati ia paraqiti apologjinë perandorit Adrian në vitet 124-125, gjatë qëndrimit të tij në Azinë e Vogël.

ARISTIDHI I ATHINËS

Apologjia më e hershme është ajo e Aristidhit të Athinës. Eusebi në *Historinë kishtare* thotë: “Aristidhi, gjithashtu, një njeri i besës dhe i përkushtuar ndaj besimit tonë, ashtu si Kodrati, ka lënë një apologji të besimit drejtuar Adrianit. Shkrimet e tij janë ruajtur prej shumë vetash” (*Historia Kishtare* 4, 3;2). Aristidhi ishte filozof nga Athina. Për një kohë të gjatë vepra e tij konsiderohej e humbur deri në vitin 1878, kur murgjit mehtaristë të manastirit të shën L Lazarit në Venecia botuan dorëshkrimin e shekullit X, një pjesë në armenisht të një apologjie që mbante titullin: “Perandorit Adrian nga filozofi athinas, Aristidhi”. Pjesa më e madhe e studiuësve e pranuan fragmentin si mbetjet e një përkthimi në armenisht të apologjisë së Aristidhit. Në vitin 1889 studiuesi amerikan J.R. Harris zbuloi në manastirin e shën Katerinës të Sinaï një përkthim të plotë të apologjisë në gjuhën siriane. Ky dorëshkrim ka mundësi të jetë shkruar ndërmjet shekullit të gjashtë dhe të shtatë, por vetë përkthimi daton rreth viteve 350 pas Krishtit. Kohët e fundit Muzeu Britanik ka botuar dy pjesë të mëdha të tekstit origjinal në greqisht (krerët pesë dhe gjashtë).

Shkrimet: *Apologjia e Aristidhit* ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë përmban kapitujt 1-14 dhe ka karakter luftarak ndaj idhujtarëve, grekëve dhe judenjve. Pjesa e dytë përmban kapitujt 15-17 dhe flet për të krishterët. Hyrja përshkruan Qenien Hyjnore sipas formulimit të termave stoikë. Gjithashtu na thotë se Aristidhi arriti një njohje të Krijuesit dhe Ruajtësit të gjithësisë nëpërmjet përsiatjes së tij mbi botën.

Apologjia e Aristidhit

“Ata kanë porositë e vetë Zotit Jesu Krisht, dhënë në zemrat e tyre, dhe ata ruajnë vetëm këto, duke pritur për ngjalljen e të vdekurve dhe për jetën në botën që do të vijë. Ata nuk kryejnë tradhëti bashkëshortore, as kurvëri, nuk bëjnë dëshmi të rreme, nuk lakmojnë gjënë e tjetrit; nderojnë mëmë e atë, duan fqinjët e tyre; japin gjykim të drejtë dhe asnjëherë s’u bëjnë të tjerëve atë që s’do të donin t’u bëhej atyre. Ngushëllojnë ata të cilët u bëjnë keq dhe bëhen miq me ta. Janë të aftë t’u bëjnë mirë armiqve të tyre. Janë të butë dhe të sjellshëm. E përmbajnë veten prej çdo marrëdhënieje seksuale të jashtëligjshme dhe prej çdo papastërtie. Nuk e braktisin të venë dhe nuk e shtypin jetimin. Ai që ka i jep pa kursim atij që s’ka. Nëse shohin një të huaj, e marrin atë nën strehën e tyre dhe gëzohen me të, si të ishte vëllai i tyre. Sepse ata e quajnë veten vëllezër, jo sipas mishit, por sipas shpirtit. Ata janë gati të japin jetën e tyre për hir të Krishtit. I ruajnë porositë e tij pa dredhuar, duke jetuar një jetë të drejtë dhe të shenjtë, ashtu si Zoti, Perëndia i tyre, i ka porositur. Dhe ata e falenderojnë Atë çdo çast për mishin, pijen dhe gjithë bekimet e tjera. Pikërisht kjo është udha e së vërtetës, e cila i drejton ata që udhëtojnë në të, në mbretërinë e përjetshme të jetës së ardhme, premtuar nga Krishti”.

ARISTON I PELËS SË PALESTINËS

Për apologjetin Ariston nuk kemi të dhëna, përveç faktit që e kishte origjinën nga Pela e Palestinës. Apologjeti Ariston ka shkruar *Debat i Jasonit dhe Papiskut rreth Krishtit*. Kjo vepër ka humbur. Jasoni vjen nga rrethet judeokristiane, ndërsa Papisku është çifut nga Aleksandria e Egjiptit. Sipas thënieve të Origenit, apologjia e Aristonit që sulmuar nga filozofi pagan Çelsi në veprën e tij *Debati i vërtetë*, sepse autori i apologjisë shfaqte një parapëlqim për interpretimin alegorik të Dhiatës së Vjetër. Debati mbaron me njohjen e Krishtit si Biri i Perëndisë. Pas kësaj njohjeje çifuti Papisku kërkoi të pagëzohej. Apologjia gjendet pjesërisht në përkthimin në gjuhën latine të dhënë gabimisht nga Qipriani në titullin *Ad Virgilium Episcopum de Judaica Incredulitate*. Ariston i Pelës mendohet ta ketë shkruar apologjinë në vitin 140 pas Krishtit, kur gjendej në Aleksandri.

JUSTIN FILOZOFI (100-167)

Justin filozofi ka lindur në vitin 100 në qytetin Siqem të Samarisë. Ai kishte studiuar filozofinë pagane të filozofëve të mëdhenj duke marrë leksione nga profesorë të famshëm. Megjithatë shpirti i tij nuk gjeti qetësi dhe kënaqësi prej këtyre filozofëve. Njëherë, kur shëtiste anës së detit dhe duke menduar se ç'gjë tjetër mund të lexonte, i doli përpara një burrë plak, i cili e pyeti përse ishte i shqetësuar. Justini i rrëfeu pikëllimin e shpirtit të tij, atëherë plaku i rekomandoi të lexonte shkrimet e shenjta, të cilat pasi i lexoi, u konvertua në fenë kristiane duke u bërë nga mbrojtësit

më të flaktë të kristianizmit. Justini mbrojti me zell doktrinën kristiane, gjithashtu udhëtoi nëpër Azinë e Vogël, Greqi dhe Itali. Justini u martirizua në Romë në kohën e persekutimeve të perandorit Mark Aurelit (163-167). (*Arkimandrit Justini, Nga thesari i shenjtoreve, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2004, faqe 179-180*).

Shkrimet: 1) Në *Apologjinë e parë*, të cilën ia drejton perandorit Antonio, bën të njohur se çfarë besojnë të krishterët dhe përpiket ta bindë që të ndalojë përndjekjet kundër tyre. Kjo apologji u shkrua në Romë rreth viteve 150 dhe përbëhet nga 68 kapituj. 2) Në *Apologjinë e dytë*, shkruar në vitin 160, të cilën ia drejton senatit të Romës, vërteton se të krishterët ndiqen sepse besojnë të vërtetën. 3) Në një *Dialog me judeun Trifon*, që përbëhet nga 142 kapituj, tregon se Testamenti i Ri është plotësimi i Testamentit të Vjetër etj. *Dialog me Trifonin* është apologjia më e vjetër e krishterë kundër judenjve.

Apologjia e Parë Nga Justin Filozofi

1. Perandorit Tit Elit Hadrian Anton Piut August Çezarit dhe birit të tij Verisimus Filozofit dhe Lusit Filozofit, bir i Çezarit nga natyra dhe i adoptuari i Augustit, një dashurues i kulturës dhe i Senatit të Shenjtë e i të gjithë popullit Romak – nga ana e njerëzve të çdo kombi të cilët padrejtësisht janë urreyer dhe fyer, unë Justini, biri i Priskut dhe nipi i Bakut nga Flavia, Neapoli, në Siri, Palestinë, duke qenë dhe unë vetë një nga ata kam hartuar një mbrojtje dhe kërkesë.

2. Arsyeja e do që ata që janë vërtet besnikë dhe filozofë duhet të nderojnë dhe të kujdesen për të vërtetën duke përbuzur

ndjekjen formale të mendimeve të të lashtëve, nëse ata janë të pavyeshme. Dhe arsyeja as nuk do as kërkon që të ndiqni ata që bëjnë ose mësojnë atë çfarë është e padrejtë; ai që do të vërtetën duhet të zgjedhë në çdo mënyrë, qoftë edhe me çmimin e jetës së tij, nëse duhet të flasë dhe të bëjë atë që është e drejtë, megjithëse vdekja do ta marrë. Kështu bëni pra ju, qëkurse quheni të devotshëm dhe filozofë dhe ruajtës të drejtësisë dhe dashës të kulturës; më së paku na dëgjoni, dhe ashtu do të duket në do të jeni vërtetë të tillë . Sepse në këto faqe ne nuk vijmë përpara jush me lajka ose të bëjmë një fjalim për të fituar përkrahjen tuaj, por për t'ju kërkuar juve të jepni gjykime duke u mbështetur në hetimet e sakta dhe strikte, dhe jo të shtyrë nga paragjykimet ose respekti për njerëzit bestytë ose nga impulse iracionale dhe thashetheme të këqija që kanë zënë vend, duke dhënë një votë, e cila në të vërtetë do të ishte kundra vetes tuaj. Sepse jemi plotësisht të bindur se ne mund të vuajmë vetëm në qoftë se provohet se jemi keqbërës ose të tregohet që jemi kriminelë. Ju mund të na vrisni, por nuk mund të na bëni ndonjë dëm të vërtetë.

3. Por që asnjë të mos mendojë se kjo është një shprehje e paarsyeshme dhe mendjemadhe, ne kërkojmë që akuzat kundër nesh të hetohen. Nëse vërtetohet që ato janë të vërteta, le të dënohemi si të tillë. Por nëse askush nuk ka prova kundër nesh, arsyeja e vërtetë nuk ju lejon [ju] t' u bëni dëm njerëzve të pafajshëm për shkak të një thashethemi të keq, ose për më tepër të dëmtoni veten tuaj kur ju vendosni të merrni vendimin mbi bazën e pasionit dhe jo të gjykimit. Çdo njeri i nderuar duhet të dijë që kjo është një sfidë e sigurtë dhe drejtësi e vetme që qytetarët duhet të japin një tregim të drejtë të jetës dhe të mendimeve të tyre dhe që qeveritarët, po ashtu, duhet të japin vendimin si ithtarë të

devotshmërisë e të filozofisë e jo me dhunë tiranike. Nga kjo, si qeveritarët edhe të qeverisurit do të fitojnë. Siç ka thënë diku një i vjetër “në qoftë se qeveritarët me ata që qeverisin nuk bëhen dashurues të mençurisë, qytetet nuk do të përparojnë “. Ndaj na bie neve t’u ofrojmë të gjithëve rastin që të hetojnë jetën tonë dhe mësimet tona se mos ne vetë mbajmë fajin, që ata që nuk na njohin siç duhet të veprojnë nga padija. Por juve ju bie, siç e kërkon arsyeja, të na dëgjoni dhe kështu të tregoheni gjyqtarë të mirë. Sepse në qoftë se ata që nxënë të vërtetën nuk bëjnë atë që është e drejtë, ata nuk mund të mbrohen përpara Perëndisë.

4. Nami i thjeshtë i emrit s’do të thotë asgjë të mirë ose të keqe, përveç veprimeve që lidhen me atë emër. Në të vërtetë sipas këtij emri, ne jemi njerëz të hirshëm . Por ne nuk e mendojmë të drejtë të kërkojmë falje për shkak të emrit nëse është provuar që ne jemi kriminelë dhe nga ana tjetër, nëse as mbrojtja e emrit, as sjellja jonë nuk tregon që ne jemi keqbërës, ju duhet të përballoni një problem: duke dënuar padrejtësisht njerëz për të cilët nuk u provua asgjë, ju i keni borxh një dënim drejtësisë. As fitimi as dënimi nuk do ta përlligjte emrin veçse në qoftë se diçka e admirueshme ose e keqe do të provohej vërtet prej tij. Ndër ju nuk dënohet i akuzuari para se të provohet fajësia; kurse me ne ju merrni emrin si provë, megjithëse pikërisht për këtë emër ju duhet më tepër të dënoni akuzuesit tanë. Sepse ne jemi akuzuar që jemi të krishterë; dhe nuk është e drejtë të urresh hirin. Përsëri, nëse ndonjë nga të akuzuarit mohon akuzën duke thënë se ai nuk është [i krishterë], ju e lironi atë si të mos kishit kundër tij provë për sjellje të keqe, por atë që pohon se është i tillë, ju e dënoni për pohimin e tij. Do të duhej më mirë të hetoni jetën e rrëfyesit dhe të femohuesit, kështu do të dilte nga veprimet e tyre se çfarë personi është çdonjëri. Ka

nga ata që duke mësuar nga Krishti, mësuesi i tyre, kur vihen për të dëshmuar, u japin zemër të tjerëve që të mos mohojnë, dhe po ashtu të tjerë, sjellja e keqe e të cilëve u jep shkak atyre që pëlqejnë të akuzojnë të gjithë të Krishterët për padevotshmëri dhe krim. Kjo është tërësisht e padrejtë. Ka nga ata që marrin emrin dhe veshjen e filozofëve, por nuk bëjnë asgjë të denjë për profesionin që kanë; siç e dini, njerëz ndër të lashtët që mbronin dhe predikonin pikëpamje të kundërta, janë përfshirë në emrin e filozofit. Disa nga ata mësuan madje dhe paperëndishmërinë dhe ata që u bënë poetë shpallën papastërtinë e Zeusit me gjithë bijtë e tij. Dhe ju nuk i ndaloni ata që ndjekin mësim të tilla, por u ofroni dhe çmime e ndere atyre që në fjalë të bukura i fyejnë ato [perënditë].

5. Çfarë do të thotë kjo? Në rastin tonë nuk bëni hetime, megjithëse ne s'jemi të prirur as të kryejmë krime as të kemi idera të tilla të paperëndishme. Kurse ju na dënoni padrejtësisht pa vendim, të udhëhequr nga pasione të paarsyeshme dhe fshikullat e demonëve të këqij. E vërteta duhet të thuhet. Në kohët e vjetra demonët shfaqnin veten e tyre duke joshur gratë, duke mashtruar djemtë e rinj dhe duke u fanitur njerëzve pamje tmerruese, kështu ata që nuk i gjykonin drejt këto ndodhi ishin të mbushur me tmerr. Robër të frikës dhe pa kuptuar që këta ishin demonë të këqij, ata i quajtën ato perëndira dhe i dhanë secilit prej këtyre demonëve emrin që ai kishte zgjedhur për veten e tij. Kur Sokrati u përpoq me arsye të vërtetë dhe me hetimet e duhura të bënte të qarta këto gjëra dhe ta largonte njeriun nga demonët, ata, duke punuar ndërmjet njeriut të ngazëllyer në ligësi komplotuan që ta dënojnë me vdekje si të pabesë dhe të paperëndishëm duke hapur fjalë që po fuste hyjni të reja. Dhe tani ata bëjnë të njëjtën gjë me ne. Për këto gabime, u dënuan jo vetëm mes Grekëve me arsye, përmes

Sokratit, por ndër barbarët, nga vetë Arsyeja, që mori formë dhe u bë njeri e u quajt Jesu Krisht. Duke iu bindur atij ne themi që demonët të cilët bëjnë gjëra të tilla jo vetëm që nuk janë quajtur me të drejtë perëndira, por në fakt janë të këqij, demonë jo të shenjtë, veprimet e të cilëve në asnjë mënyrë nuk janë si të njerëzve të dhënë pas virtytit.

6. Kështu pra, ne jemi quajtur të paperëndishëm. Ne sigurisht rrëfejmë që jemi të paperëndishëm kundrejt qenieve të tilla që mendohen si perëndira, por jo kundrejt Perëndisë më të vërtetë, Atit të drejtësisë, përmbajtjes dhe virtyteve të tjera, i cili është i paprekshëm nga i ligu. Atë dhe Birin që erdhi prej atij dhe na mësoi këto gjëra dhe ushtrinë e engjëjve të mirë të cilët e ndjekin atë dhe janë bërë si ai dhe Shpirti profetik, që ne adhurojmë dhe lavdërojmë duke i dhënë ndere në arsye dhe në të vërtetë dhe kujtdo që dëshiron të mësojë duke transmetuar [të vërtetën] pa u lëkundur siç ne e kemi mësuar.

7. Por dikush do të thotë “Disa të krishterë janë arrestuar dhe dënuar si kriminelë”. Ndoshta shumë në kohë të ndryshme, nëse ju shqyrtoni në çdo rast sjelljen e atyre që janë të akuzuar; por të mos dënohen [të gjithë] për shkak të burgosjes së tyre të mëparshme. Ne pranojmë se mes grekëve, ata të cilët mësonin çka dukej më e mirë për ta, janë të gjithë të rreshtuar nën emrin e filozofisë edhe pse mësimet e tyre janë plot kontradikta, kështu emri që sulmohet është i njëjtë për ata që janë e ata që duken si të mençur. Ata të gjithë renditen si të Krishterë. Prandaj ne kërkojmë që veprimet e atyre që bota i kallëzon te ju, të hetohen, që çdo i dënuar të dënohet si kriminel, por jo si i krishterë, dhe kushdo që provohet i pafajshëm të lirohet, sepse nuk është krim të jesh i krishterë. Por nuk duam nga ju të dënoni akuzuesit tanë, se mjaft

vuajnë nga veset e tyre dhe nga mosdija e së mirës....(Marrë nga *Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks*).

TATIAN SIRIANI (120)

Tatiani ka lindur rreth vitit 120 në Siri nga prindër paganë. Ai përvetësoi filozofinë dhe u bë nxënës i Justin Filozofit në Romë, ku u konvertua në fenë e krishterë. Pas vdekjes së mësuesit të tij, Tatjani u kthye në Mesopotami dhe Siri ku krijoi një shkollë filozofike të vetën. Tatiani përqafoi herezinë e gnostikut Ualiano dhe në vitin 172 themeloi sektin e Enkratitëve, domethënë i të përmbajturve. Kjo herezi e konsideronte martesën si kurvëri, ndalonte përdorimin e çfarëdo forme të mishit, pirjen e verës etj. Tatiani në shërbesën e Falënderimit Hyjnor shkëmbeu verën me ujë. Për këtë arsye anëtarët e këtij sekti u quajtën *Aquarii*-t. Për vdekjen e Tatianit nuk kemi të dhëna.

Shkrimet: 1) *Për grekët* mund të jetë shkruar pas vdekjes së Justinit, por nga të dhënat që jepen në tekst duket qartë se Tatiani nuk ka qenë në Romë. Mbetet e paqartë nëse e shkroi para apo pas apostazisë së tij. Ligjërimi nuk është thjesht një apologji për të mbrojtur krishterimin, por një fjalim i përkushtuar që përmban një ftesë për të ndjekur shkollën e autorit. Debatimi për grekët mendohet të jetë shkruar përpara vitit 165. 2) *Dhiatesaroni* është vepra më e rëndësishme e Tatianit, e cila duket si një përpjekje e krijimit të një ungjilli të ri. Tatiani e quajti “nga të katërt”, sepse ka grupuar pjesë nga katër ungjijtë në një tregim të vetëm ungjillor. Ky libër është përdorur si tekst zyrtar i kishës Siriane dhe vetëm në shekullin V u zëvendësua nga katër ungjijtë kanonikë.

Dhiatesaroni është shkruar në kohën që Tatiani ishte kthyer në Lindje. Shkrimet e tjera të Tatianit kanë humbur.

MILTIADHI

Miltiadhi i njohur si orator, ka lindur në Azinë e Vogël dhe ishte bashkëkohës i Tatianit. Ka shumë mundësi të ketë qenë nxënës i Justinut. Fatkeqësisht, të gjitha shkrimet e tij kanë humbur; por Tertuliani dhe Hipoliti dëshmojnë se ai mbrojti krishterimin nga paganët dhe heretikët.

Shkrimet: Sipas dëshmisë së Eusebit, Miltiadhi ka shkruar 1) *Kundër grekëve*, e cila përbëhet nga dy libra, si dhe një vepër tjetër, 2) *Kundër judenjve*, po ashtu në dy libra. 3) *Apologji ndaj sundimtarëve njerëzorë*, të cilën ua drejtoi perandorit Mark Aurelit (161-180) dhe bashkëregjentit Lukion Uiron (161-169). 4) *Kundër montanistëve* dhe 5) *Kundër ualentinianëve*, të cilat kanë humbur.

APOLINARI I HIERAPOLIT

Klaud Apolinari ishte peshkop i Hierapolit të Frigisë në kohën e mbretërimit të Mark Aurelit (161-180). Sipas Eusebit, Apolinari ka shkruar një apologji *Kundër perandorit Mark Aurelit*, pesë libra *Kundër grekëve*, dy libra *Mbi të vërtetën*, dy libra *Kundër judenjve*, dhe pas kësaj, trajtesa që ai shkroi kundër herezisë së montanistëve. Autori i *Kronikave paskale* dëshmon se Apolinari ka shkruar *Rreth Pashkës*. Dy shprehjet që autori i

Kronikave citon, sugjerojnë se Apolinari ishte kundër datimit “quatrodeciman” të Pashkës. Librat e Apolarit kanë humbur. Ai është shpallur shenjt dhe kremtohet më tetë janar.

ATHINAGORA I ATHINËS

Athinagora është një filozof, jeta e të cilit ka mbetur e panjohur, por që dihet se në vitin 177 i ka drejtuar perandorit Mark Aurelit një apologji shumë të bukur dhe të argumentuar. Gjithashtu ka shkruar veprën tjetër me titull: *Mbi Ngjalljen e të vdekurve*, e cila ka karakter apologjetik.

Shkrimet: 1) *Ndërmjetime për të krishterët*, e cila përbëhet prej 37 kapitujsh dhe u shkrua rreth viteve 176-178. Iu dërgua perandorëve Mark Aurelit dhe të birit Komodit, i cili hypi në fronin perandorak në vitin 176. Hyrja (krerët 1-3) tregon se kujt i drejtohet autori dhe në formë të përgjithshme shfaq qëllimin e veprës: “Prej këtij diskutimi, ju do të mësoni se ne vuajmë padrejtësisht, kundër të gjitha ligjeve dhe kundër çdo arsyeje, dhe se u takon sovranëve, që me anë të ligjit, të shmangin këtë trajtim përçmues”. Në vijim Athinagora hedh poshtë tre akuzat (krerët 4-36), që paganët thurnin kundër të krishterëve.

2) *Mbi ngjalljen e të vdekurve*. Në fund të *Apologjisë* (kreu 36) Athinagora hap një diskutim në lidhje me ngjalljen. Ky shkrim ruhet nën titullin “Mbi ngjalljen e të vdekurve”. Në “Arethas Codex” të vitit 914, thuhet se është vepër e Athinagorës. Trajtesa mbi ngjalljen ka karakter filozofik dhe provon doktrinën e ngjalljes nëpërmjet arsyes. Përbëhet nga dy pjesë. E para (kreu 1-10) flet për Perëndinë dhe ngjalljen. Pjesa e dytë (kreu 11-25) flet për njeriun dhe ngjalljen.

Apologjia e Athinagorës

1. Të krishterët nuk janë ateistë. Megjithëse ata nuk u besojnë perëndive, ata i besojnë Perëndisë. Të krishterët janë monoteistë. Prirjet monoteiste mund të ndeshen dhe në disa prej poetëve dhe filozofëve paganë. Por, askush, kurrëndonjëherë nuk i akuzoi këta njerëz për ateizëm, megjithëse ata dhanë prova të dobëta për idetë e tyre. Të krishterët, nga ana tjetër, patën një mësim dhe një zbulesë hyjnore për këto çështje, prej profetëve të tyre, të cilët ishin të frymëzuar nga Fryma Hyjnore. Për më tepër, besimi i tyre është ai që u jep prova. Koncepti i krishterë për Perëndinë është më i pastër dhe më i përsosur sesa ai i të gjithë filozofëve. Ky është një fakt që demonstron prej të krishterëve, jo vetëm me fjalë, por me vepra: “Cili prej tyre (filozofëve paganë) ka pastruar kaq shumë shpirtin e tij, saqë, në vend që të urrejë armiqtë e tij, t’i dojë ata; dhe, në vend të flasë keq për ata që i kanë bërë keq, t’i bekojë, dhe të lutet për ata që kanë ndër mend t’i marrin jetën? ... Por mes nesh do të gjeni njerëz të pakulturuar, artizanë dhe gra të moshuara, të cilët, nëse janë të pazotë që nëpërmjet fjalëve të provojnë dobinë e doktrinës sonë, nëpërmjet veprave të tyre e shfaqin këtë dobishmëri, e cila buron nga të zotëruarit e të vërtetës” (Apol. 11). Për të njëjtën arsye, duke qenë monoteistë, të krishterët nuk janë politeistë. Prandaj nuk kanë theorre si të paganëve dhe nuk u besojnë perëndive. Për më tepër, ata nuk e adhurojnë botën, e cila është një vepër arti më e madhe se çdo idhull, por ata adhurojnë Krijuesin.

2. Të krishterët nuk janë fajtorë për kanibalizëm. Ata nuk vrasin njeri. Për këtë arsye ata nuk janë spektatorë vrasjesh, një kënaqësi e veçantë kjo për paganët, siç na e provojnë shfaqjet e

gladiatorëve. Të krishterët e respektojnë jetën njerëzore më shumë se paganët. Për këtë arsye ata e dënojnë braktisjen e fëmijëve. Vetëm besimi i tyre në ngjalljen e trupit do t'i ndalonte të hanin mish njerëzor.

3. Akuza për inçestin e Edipit s'është asgjë tjetër, veç një shpërthim urrejtjeje. Historia na tregon se virtyti ka qenë përndjekur gjithmonë prej vesit. Të krishterët janë kaq larg nga kryerja e krimeve të tilla, sa që ata nuk lejojnë të kryejnë mëkat as me anë të mendimit, të cilin e ruajnë të pastër. Ajo çka të krishterët mendojnë në lidhje me martesën dhe virgjërinë tregon se sa lart e çmojnë ata qashtërsinë. Mbyllja e *Apologjisë* (kreu 37) është një lutje për të gjykuar me drejtësi:

“Tani që kam hedhur poshtë disa akuza dhe kam provuar se ne jemi besimtarë, të butë dhe të matur në shpirt, përkulni kokën tuaj mbretërore në shenjë miratimi. Pasi, cilët janë ata që dëshirojnë të marrin ç'kërkojnë, përveçse ata të cilët, ashtu si ne, luten për qeverinë tuaj, që, ashtu siç është më e arsyeshme, ju të trashëgoni mbretërinë, siç trashëgon biri prej atit, dhe që perandoria juaj të rritet dhe të shtohet dhe të gjithë njerëzit t'i nënshtrohen pushtetit tuaj? Kjo është në të mirën tuaj dhe që ne të mund të jetojmë një jetë të qetë dhe në paqe dhe, që të zbatojmë atë që na porositet”.

THEOFILI I ANTIOKISË (169-180)

Sipas Eusebit, Theofili ishte peshkopi i gjashtë i Antiokisë së Sirisë gjatë viteve 169-180. Nga dëshmia e tij mësojmë se ka lindur pranë lumenjve Tigër dhe Euftrat, nga prindër paganë me origjinë nga Mesopotamia. Pasi studioi shkrimet e shenjta u konvertua në krishterim. Ja si e përshkruan vetë ai këtë ngjarje të jetës:

“Mos u bëj dyshues, por besues; unë nuk e besoja se kjo (ngjallja e të vdekurve) mund të ndodhte; por tani, duke parë këto gjëra, unë besoj. Në të njëjtën kohë, njihem me shkrimet e shenjta të profetëve, të cilët, nëpërmjet shpirtit të Perëndisë, i parathanë gjërat që kanë ndodhur, pikërisht ashtu siç ato do të ndodhnin, dhe parathanë ato që po ndodhin, pikërisht ashtu siç po ndodhin, dhe parathanë ato që do të ndodhin, ashtu siç do të përmbushen. Pra, duke pranuar provën se ngjarjet ndodhin ashtu siç janë parathënë, nuk dyshoj, por besoj, i bindur ndaj Perëndisë” (1, 14).

Shkrimet: 1) *Kundër Autolikut* në tri libra dhe mund të jenë shkruar pas vitit 180. Në librin e parë flet për providencën hyjnore të Perëndisë dhe sqaron kuptimin e fjalës “kristian”. Gjithashtu thekson esencën e Perëndisë, e cila mund të shihet vetëm me sytë e shpirtit: “Perëndia shikohet nga ata të cilët janë të aftë ta shohin atë, kur i kanë sytë e shpirtit të hapur; të gjithë kanë sy, por sytë e disave janë të mbuluar dhe nuk e shohin dritën e diellit. Kjo nuk vjen ngaqë të verbërit nuk shohin, apo sepse rrezet e diellit nuk shkëlqejnë; të verbërit le të akuzojnë veten dhe sytë e tyre... Si një pasqyrë që shkëlqen, kaq i pastër duhet të jetë dhe shpirti i njeriut. Kur pasqyra zë ndryshk, fytyra e njeriut s’ mund të shihet në të; po kështu, kur mëkati është te njeriu, ai nuk mund ta shikojë

Perëndinë” (1,2). Në vijim flet për kotësitat e idhujtarisë, për ndryshimin mes nderit që i jepet perandorit dhe adhurimit të Perëndisë: “Perandorin do ta nderoj, nuk do ta adhuroj, por do të lutem për të. Është Perëndia, Perëndia i gjallë dhe i vërtetë, ai i cili unë adhuroj, duke e ditur se perandori është krijuar prej tij” (1,1). Në fund, Theofili trajton kuptimin dhe rëndësinë e emrit “i krishterë”. Libri përfundon me fjalët: “Meqenëse ti më thua “Tregomë Perëndinë tënd”, ky është Perëndia im, dhe të këshilloj ta kesh frikë e t’i besosh” (1,14).

Libri i dytë bën fjalë për Gjenezën, krijimin e botës dhe rreth mëkatit të parëlindur. Autori krahason mësimet e profetëve, të cilët ishin të frymëzuar nga Shpirti i Shenjtë. Tregimi në lidhje me krijimin e botës dhe të njerëzimit, parajsën dhe rënien, analizohet dhe shpjegohet në mënyrë alegorike. Në fund autori citon disa nga mësimet e profetëve për mënyrën e adhurimit të drejtë të Perëndisë.

Libri i tretë flet për akuzat e idhujtarëve ndaj të krishterëve. Autori thekson epërsinë e krishterimit nga këndvështrimi moral, kundërshton sajesat e paganëve dhe paditë për imoralitet ndaj të krishterëve. Theofili mbron krishterimin nga kundërshtimet e mikut të tij pagan, Autolikut.

MELITO I SARDËS

Melito ka qenë peshkopi i Sardës së Lidhisë, gjatë viteve të sundimit të Mark Aurelit (161-180). Rreth vitit 170 pas Krishtit i drejtoi një apologji perandorit Mark Aurel, fragmente prej së cilës gjenden tek Eusebi në librin *Kronika Paskale*. Mes këtyre fragmenteve është një thënie e cila paraqet interes në lidhje me idetë e Melitos rreth marrëdhënieve mes kishës dhe shtetit. Ai është i pari që mbron solidaritetin e kishës me perandorinë. Perandoria e botës dhe besimi i krishterë janë motra të mëndura nga i njëjti gj.

“Filozofia jonë u bë një ogur i së mirës për perandorinë tuaj, pasi që prej asaj kohe (kohës së Augustit) fuqia e Romës është rritur në masë dhe shkëlqim. Ju jeni pasardhësi i tij, dhe kështu do të mbeteni përgjithmonë, së bashku me birin tuaj, nëse ju ruani filozofinë, e cila u rrit së bashku me perandorinë dhe filloi me Augustin. Pasardhësit tuaj e ruajtën atë në vend nderi, bashkë me besimet e tjera. Prova më bindëse se begatia e besimit tonë ka qenë përfitim për perandorinë, tregohet nga fakti se perandoria nuk ka vuajtur asnjë peripeci, që prej mbretërimit të Augustit, por, përkundrazi, gjithçka e ka rritur shkëlqimin dhe famën e saj, sipas lutjes së përgjithshme” (Eusebi *Hist. Kisht.* 4; 26,7-8). Ai u quajt prej Eusebit “eunuku, i cili jetoi plotësisht në Shpirtin e Shenjtë”. Melito mendohet të ketë vdekur në vitin 180. Veprat e tij të pjesshme i kanë ruajtur Eusebi dhe Anastas Sinaiti.

HERMIA FILOZOFI

Hermia ishte filozof i krishterë dhe ka jetuar rreth viteve 150. Me emrin e tij ka shpëtuar një vepër *Satirë për filozofët profanë*, që përbëhet nga 19 kapituj. Kjo vepër mendohet të jetë shkruar në fillim të shek. III. Gjatë dhjetë kapitujve të këtij libri, Hermia provon të demonstrojë, nëpërmjet sarkazmës, kotësinë e filozofisë pagane, duke shfaqur kundërshtitë në doktrinat e tyre në lidhje me esencën e Perëndisë, të botës dhe të shpirtit. Hermia ishte një folozof profesionist, sepse njohuritë e tij filozofike i zotëron jo si pasojë e një studimi intensiv të filozofëve të vjetër, por i ka marrë nga një përmbledhje e zakonshme filozofike. Vepra e tij është satirike e jo didaktike.

LITERATURA APOKRIFE DHE ANONIME

Fjala “Apokrif” do të thotë “fshehtësi” i panjohur. Me termin Literatura apokrife dhe anonime kuptojmë gjithë shkrimet që trajtojnë temat teologjike dhe kishtare, të cilat u shkruan gjatë tre shekujve të parë, ose edhe më vonë, dhe ku shkrimtarët mbetën anonimë. Literatura apokrife dhe anonime ka një rëndësi të madhe, sepse na jep shumë informacione rreth jetës dhe aktivitetit të kishës së parë.

APOKRIFËT E DHIATËS SË RE

Ungjijtë apokrifë merren zakonisht me ngjarjet e jetës së Jesuit, të cilat nuk përmenden në ungjijtë kanonikë. Apokrifët kanë edhe pjesë nga ungjijtë kanonikë.

Ungjilli sipas Hebrenjve. Nga copëzat e para që kanë mbetur vërtetohet se kishte shumë ngjashmëri me ungjillin kanonik sipas Matheut. U shkrua në vitin 150 në aramaisht me shkronja hebraike dhe u përdor nga evionitët dhe nga nazabinët. Ky ungjill njihej prej Klimit të Aleksandrisë dhe Jeronimit.

Ungjilli i Egjiptianëve qarkullonte ndërmjet kristianëve të Egjiptit dhe ishte shkruar pas vitit 150.

Ungjilli i Evionitëve u shkrua nga fundi i shekullit II dhe fillimi i shekullit III. Ky ungjill dëshmohet nga Epifani.

Ungjilli sipas Petros u shkrua në Siri rreth gjysmës së dytë të shekullit II dhe bën fjalë për ngjarjet e pësimeve, të vdekjes dhe të varrimit të Zotit, si dhe të Ngjalljes së Krishtit, të cilën e lidh me shumë mrekulli. Ky ungjill përmendet nga Origjeni.

Ungjilli i Nikodimit u shkrua rreth shekullit II greqisht, latinisht, koptisht, sirisht, armenisht dhe arabisht. Ungjilli bën fjalë për gjyqin, Kryqëzimin dhe Varrosjen e Zotit (Kap.1:11). Dëshmohet nga Justini, Tertuliani dhe Eusebio. Qëllimi i shkruajtjes së Ungjillit ishte ndoshta për të justifikuar veprimet e Pilatit, sepse ai nderohet si shenjtor në Kishën Kopte.

Ungjilli i parë i Jakobit u shkrua para vitit 165 dhe bën fjalë për lindjen, moshën rinore dhe përkushtimin e Shën Marisë në kishë, martesën e saj me Josifin e deri në therjen e foshnjave në Betlehem. Shkruesi i ungjillit është Jakobi i Vogël Episkopi i Jeruzalemit. Shpëtoi si dorëshkrim greqisht dhe i përkthyer sirisht,

armenisht, koptisht. Ky ungjill është përdorur nga Justini, Origjeni dhe Klimi i Aleksandrisë.

Ungjilli i Thomait na jep sqarime rreth moshës feminare të Jesuit. Koha kur u shkrua ka mbetur e panjohur. Ky ungjill përmendet nga Hipoliti, Origjeni dhe Kirili i Jeruzalemit.

Ungjilli i Filipit u shkrua rreth shekullit III dhe bën fjalë për shkruarjen nga ana e Filipit të dogmave të fshehta, të cilat iu dhanë Apostujve nga Zoti, pas Ngjalljes së Tij.

Ungjilli i Bartolomeut u shkrua rreth shekullit III dhe bën fjalë për pyetjet e Bartolomeut mbi Ungjillëzimin e Hyjlindëses. Ky ungjill u shkrua në greqisht por kemi edhe copëza latinisht dhe koptisht.

Ungjilli i Matheut u shkrua rreth shekullit II dhe përmendet nga Klimi i Aleksandrisë, Origjeni dhe Eusebio.

VEPRATAPOKRIFE

Veprat apokrife u shkruan me qëllim që të plotësojnë boshllëqet e jetës, të aktivitetit dhe të vdekjes së Apostujve të Shenjtë. Shkruesit e tyre mbetën të panjohur. Veprat kanë rëndësi të madhe sepse ndriçojnë rreth adhurimit kristian të shekullit të dytë dhe të tretë. Kanë shpëtuar lutje personale si dhe himne të psalltura nga populli të cilat nxitën edhe artin kishtar të mesjetës.

Veprat e Palit u shkruan rreth vitit 190 në Azinë e Vogël dhe përbëhen nga këto copëza:

- A). Përgjigjia e Korinthianëve ndaj letrës së dytë të Apostull Palit si edhe letra e tretë.
- B). Veprat e Palit dhe të Theklës.
- C). Martirizimi i Shën Palit sipas Tertulianit.

Veprat e Petros u shkruajtën në Siri ose në Palestinë rreth viteve 190 dhe ndahen në dy pjesë.

A). Veprat e Petros dhe të Simonit, që sqarojnë mënyrën e shkuarjes së Palit nga Roma drejt Spanjës, aktivitetin e Simon Magjistarit në Romë dhe çuarjen e Petros në Romë.

B). Martirizimi i Petros, që sjell historinë e “Domine quo Vadis”, gjykimin dhe kryqëzimin e apotsull Petros.

Veprat e Petros dhe të Palit u shkruan rreth shekullit III, që të tregojnë marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunimin e Petros me Palin. Në to bëhet fjalë për çuarjen e Palit në Romë dhe martirizimin e tij e të Petros. Në to gjejmë material edhe nga veprat kanonike të Apostujve. Teksti është greqisht dhe latinisht.

Veprat e Joanit u shkruan rreth viteve 150 në Azinë e Vogël dhe sqarojnë përpjekjet misionare të Joanit në Azinë e Vogël, bisedat, mrekullitë dhe vdekjen e tij. Veprat përmbajnë shumë lutje dhe janë të rëndësishme sepse bëhjet fjalë për misterin e Liturgjisë Hyjnore si dhe për ceremoninë e varrimit.

Veprat e Andreas u shkruan rreth viteve 250 dhe kanë shpëtuar vetëm një pjesë, e cila bën fjalë për përpjekjen misionare të Andreas si dhe ngjarje nga jeta e Petros dhe e Andreas, martirizimin e Andreas në Patra etj.

Veprat e Thomait u shkruan rreth shekullit III në gjuhën siriane. Teksti u përkthye greqisht dhe në gjuhë të tjera dhe ka arritur i plotë. Të 14 pjesët e veprave bëjnë fjalë për përpjekjen misionare të Thomait në Indi ku edhe u martirizua.

Veprat e Thadheut u shkruan në Siri. Thadheu ishte Apostull nga të 70. Veprat përbëhen nga:

A). Korrespondenca e mbretit të Edhesës Avgar dhe Jisuit, të cilën Eusebio e përktheu nga sirishtja në greqisht, marrë nga arkivi i

Edhesës. Avgari ishte person historik dhe dinastia e tij mbretëroi nga shekulli IV – VII pas Krishtit.

Veprat e tjera.

A). Veprat e Mateut nga të cilat ka shpëtuar vetëm pjesa e fundit.

B). Veprat e Filipit, Bartholomeut, Barnabës, Markut, dhe Timoteut. Këto u shkruan ndërmjet shekullit IV dhe V.

LETRAT APOKRIFE

Letrat e Apostujve u shkruajtën në Azinë e Vogël ose në Egjipt. Në fillim në greqisht por të plota kanë shpëtuar në etiopisht. Shkruesi i panjohur ka qenë burrë kishtar dhe përdori libra kanonikë të Dhiatës së Re dhe më pas tekste apokrife. Letra fillon me dëshminë e besimit të 12 Aposujve dhe në vazhdim flet për mrekullitë, Ngjalljen, Zbritjen në Ferr dhe Apokalipsin e Zotit. Gjithashtu flet edhe për përpjekjet misionare të Apostujve. Letra flet për tema të rëndësishme teologjike.

A). Krishti është i palindur dhe i lindur, i patrup dhe i trupëzuar. B). Biri është Perëndi ashtu si Ati dhe Kryeengjëlli Gabriel është përfaqësuesi i fjalës. Trupat e njerëzve do të ngjallen me gjykimin e ardhshëm dhe do të gjykohen pas shpirtrave dhe frymës së tyre. Me vlerë në letër është dhe simboli i besës, i cili bën fjalë për personat e Trinisë së Shenjtë, për kishën dhe faljen e mëkateve. Pagëzimi quhet i mjaftueshëm për shpëtim. Liturgjia hyjnore quhet “Pashkë”. Me të drejtë kjo letër u quajt si më e rëndësishmja e letrave apokrife dhe nga tekstet më të rëndësishme të literaturës apokrife.

Letrat e Palit: A) Drejtuar Laodhiqisë u shkrua në fillim greqisht, por ka shpëtuar edhe përkthimi latinisht. Shkruesi i

panjohur mendohet ta ketë shkruar rreth viteve 400. Teksti përbëhet nga fraza origjinale të Palit ndaj Filipianëve.

B) Drejtuar Aleksandrisë. Ky tekst ka humbur. Përmendet në kanunin e Moratorit.

C) Drejtuar Korinthianëve

Bën pjesë në veprat e Palit dhe u shkrua si përgjigje e letrës së Korinthianëve ndaj Apostullit. Letra bën fjalë për tema kryesore dhe për një farë kohe në kishën siriane dhe armene u quajt si letër kanonike e Palit.

Korrespondenca e Palit dhe e Senekës. Koleksioni nga tetë letrat e Senekës drejtuar Palit dhe më pas e gjashtë letrave të Palit drejtuar Senekës. Letrat u shkruan latinisht rreth shekullit III me qëllim përhapjen e ideve të Palit në shoqërinë e lartë romake.

Letra e Titos u shkrua greqisht dhe ka shpëtuar edhe përkthimi latinisht ku bëhet fjalë për bisedat rreth virgjërisë.

APOKALIPSËT APOKRIFË

Apokalipsi i Petros u shkrua rreth shekullit II dhe bën fjalë për bukurinë e qiellit dhe për skëterrën e Ferrit, duke marrë shkas nga tradita Judaikë dhe Orfike. Teksti i plotë ka shpëtuar në etiopisht, por gjenden edhe pjesë të shkëputura në greqisht. Shkruesi mbetet i panjohur. Eusebio dhe Jeronimi e quajtën Apokalipsin e Petros si heretik, ndërsa Klimi i Aleksandrisë dhe Sozomeni e quajtën tekst kanonik. Në Kanunin e Moratorit përmendet si kanonik me shënimin që nuk është pranuar nga të gjithë. Në praktikë u përdor nga kisha e Palestinës deri në shekullin IV. Nga të gjithë apokalipsët apokrifë ky quhet më i rëndësishmi.

Apokalipsi i Palit u shkrua në Egjipt rreth vitit 250 nga një shkrimtar i panjohur. Apokalipsi i Palit ngjan pjesërisht me atë të Petros dhe bën fjalë për vendin e shpirttrave pas vdekjes.

Apokalipsi i Thoma it u shkrua në vitin 400 latinisht, por nga disa burime vërtetohet se më parë ishte shkruar greqisht. Është përkthyer anglisht në shekullin IX. Titulli i plotë i veprës është letra e Zotit tonë Jesu Krisht drejtuar nxënësit Thoma. Bën fjalë për fundin e botës ku shenjat e shkatërrimit do të kryhen brenda shtatë ditëve. Ky libër u cilësua si heretik nga votimi i Gelasianos.

Apokalipsi i Stefanit, ka marrë këtë emër nga shkaku se prifti Lukianos rreth vitit 415 fliste për lipsanin e Shën Stefanit. Asgjë më tepër nuk dimë për këtë, veçse u dënua si heretik nga votimi i Gelasianon.

Apokalipsë të tjerë. Kemi dy Apokalipsë me emrin e Ungjillorit Joan, që bëjnë fjalë për fundin e botës dhe Antikrishtin etj.

SHKOLLAT TEOLOGJIKE TE LINDJES

Literatura teologjike antiheretike e shekullit II solli nevojën e paraqitjes sistematike të mësimdhënies së krishterë. Kjo shpuri në krijimin e shkollave teologjike të kohës. Në luftën për mbrojtjen e doktrinës kristiane u shquan disa qendra të kulturës kishtarë, ku milituan burra të shquar duke hedhur bazat e disa shkollave teologjike. Shkollat teologjike qenë: shkollat e Aleksandrisë, Antiokisë dhe të Qesarisë. Të gjitha këto shkolla teologjike luajtën rol të rëndësishëm në historinë e kishës së periudhës së parë. Terreni për zhvillimin dhe lulëzimin e shkollave teologjike u përgatit nga apologjistët.

SHKOLLA E ALEKSANDRISË

Shkolla e Aleksandrisë ishte më e rëndësishmja dhe më e vjetra nga të gjitha shkollat teologjike të lindjes. Ajo u bë e njohur në vitin 180, kur drejtohej nga Panteni. Më përpara ajo ishte thjesht një shkollë katekizmi e themeluar nga Ungjillor Marku. Dëshmi të tjera thonë se krijuesi i saj qe apologjisti Athinagora. Aleksandria ishte qyteti më ideal për shkollën. Që nga themelimi i qytetit në shekullit IV para Krishtit, ekzistonin gjurmë të qytetërimeve të ndryshme. Aleksandria ishte pika ku takohej kultura lindore me atë perëndimore. Atje ndodhej biblioteka më e madhe e njohur në lashtësi. Ky qytet nuk ishte vetëm qendra e shkencës pagane, por edhe qendra e judaizmit helenistik që kishte tentuar të bashkonte kulturën dhe filozofinë greke me mësimet e Dhiatës së Vjetër. Themeluesi i shkollës ka qenë Panteni, ndërsa Aleksandria me qytetërimin e saj i dha shkollës tri karakteristika dalluese: 1-Kërkimin metafizik të përmbajtjes së besimit, 2-Mbylljen në filozofinë Platonike, 3-Komentimin alegorik të Shkrimit të Shenjtë.

Drejtuesit e shkollës si Panteni, Klimi, Origjeni e shumë të tjerë i dhanë shkollës teologjike impulse të reja në lidhje me paraqitjen sistematike të ideve. Më e veçanta ishte metoda alegorike e komentimit të Shkrimit të Shenjtë. Shumë kohë më parë se teologët e Aleksandrisë, filozofët grekë si Pitagora, Platoni etj e zbatonin alegorinë për komentimin që u bënin miteve të perëndive të Homerit e të Isiodhit.

SHKOLLA E QESARISË

Shkolla e Qesarisë ndryshonte vetëm pak nga shkolla e Aleksandrisë, sepse themeluesi i shkollës, Origjeni, solli në të shpirt të lartë në teorinë filozofike së të vërtetave kristiane me metodën alegorike të komentimit të Shkrimit të Shenjtë. Kjo shkollë nuk mund të krahasohet për nga rëndësia me atë të Aleksandrisë, por ja vlen të paraqitet në qendrën e studimeve teologjike nëpërmjet kontributit të Pamfilit, Grigor Çudibërësit, Eusebios së Qesarisë etj.

SHKOLLA ANTIOKISË

Në një qytet të madh të lindjes, në Antiokinë e Sirisë, u themelua një shkollë e re teologjike, në kundërshtim me shkollat e Aleksandrisë dhe të Qesarisë. Shkolla u themelua rreth vitit 260 nga Lukiano i Samosatës. Më vonë rreth shekullit IV, ajo u bë qendra e studimeve komentuese, kur teologët e mëdhenj Joan Gojarti e Theodhor Mopsoestias i dhanë vulën e një pune shumë serioze. Në kundërshtim me shkollën e Aleksandrisë, të cilët përdornin alegorinë, shkolla e Antiokisë zbatonte metodën gramatiko-historike të komentimit të Shkrimit të Shenjtë. Ajo ishte e interesuar për të dhënat historike, të cilat lidhnin personalitetin e Krishtit nëpërmjet kuptimit të dukshëm të Zbulesës Hyjnore. Kjo metodë ekzistonte si rregull për shkollën dhe alegoria përdorej rrallë. Por antiokët nuk ishin gjithnjë konsekuentë në parimet e tyre të komentimit, sepse në disa raste përdornin tipologjinë ose alegorinë, por me një emër tjetër. Kjo përbënte edhe pikën në të cilën këto dy shkolla takohen.

PANTENI (+200)

Panteni e kishte origjinën nga Sicilia dhe në fillim qe stoik. Pasi u konvertua në krishterim punoi si misionar në Indi dhe me t'u kthyer prej andej, rreth viteve 180, u vendos në Aleksandri ku ekzistonte shkolla e katekizmit, të cilën Panteni e ktheu në shkollë teologjike dhe e drejtoi për 20 vjet rresht, deri me vdekjen e tij në vitin 200. Ndër nxënësit e tij më të njohur janë: Klimi i Aleksandrisë dhe Aleksandri i Jeruzalemit.

Shkrimet: Ndonëse Panteni ka lënë shkrime, asnjë prej tyre nuk ka qenë e mundur të bëhet e njohur. Klimi i Aleksandrisë është përpjekur të zbulojë veprën letrare të Pantenit por orvatjet e tij kanë dështuar. Gjithsesi mendohet se Panteni është autori i *Letrës drejtuar Diognetit*. Shkruesi i Letrës për Diognetin ka qenë apologjistik dhe ka jetuar rreth fundit të shekullit të dytë. Koha e shkruarjes së letrës ka mbetur e panjohur. Thuhet se letra u shkrua gjatë përndjekjes ndaj të krishterëve, por nuk përcaktohet se cilës përndjekjeje. Letra është një shkrim apologjistik që i drejtohet Diognetit. Letra për Diognetin përbëhet prej dymbëdhjetë pjesësh.

Letër për Diognetin

Kreu 5

1. Për të krishterët nuk mund të bëhet dallim nga pjesa tjetër e racave njerëzore duke u nisur nga vendi, nga gjuha ose zakoni. 2. Ata nuk jetojnë në qytete të tyre; ata nuk përdorin formë të përveçme të ligjëratës; ata nuk ndjekin një mënyrë jashtëqendrore (ekscentrike) të jetës. 3. Kjo doktrinë e tyre nuk është zbuluar nga zgjuarsia apo nga mendimet e thella të njerëzve kuriozë, dhe këta

njerëz nuk përdorin një mësim thjesht njerëzor, ashtu siç bëjnë disa njerëz të tjerë. 4. Edhe pse jetojnë në qytete të ngjashme me ato barbare e Greke, siç i ka rënë për short çdo njeriu, dhe ndjekin zakonet e vendit si në veshje, në ushqim dhe në çështje të tjera të jetës së përditshme, ata në të njëjtën kohë japin prova të ndërtimit të shkëlqyeshëm të pasurisë së tyre të përbashkët. 5. Ata jetojnë në vendet e tyre, por vetëm si të huaj. Ata kanë pjesën e tyre në çdo gjë si qytetarë dhe vuajnë çdo gjë si të huaj. Çdo tokë e huaj është atdheu i tyre, dhe madje çdo atdhe është për ta një tokë e huaj. 6. Ata martohen si çdo njeri tjetër dhe lindin fëmijë, por ata nuk braktisin pasardhësit e tyre. 7. Ata e ndajnë vendin e tyre me njëri tjetrin, por jo krevatin e tyre martesor. 8. Është e vërtetë që ata ekzistojnë “në mish” por ata nuk jetojnë “sipas mishit”. 9. Ata merren me punë në tokë, por janë qytetarë të qiellit . 10. Ata i binden ligjeve të krijuara, por në jetën e tyre shkojnë përtej asaj çka kërkojnë ligjet. 11. Ata i duan të gjithë njerëzit dhe nga i gjithë njerëzimi persekutohen. 12. Ata janë të panjohur dhe akoma sulmohen; ata ekzekutohen për vdekje, por prapë sillen në jetë. 13. Ata janë të varfër, por prapë bëhen të pasur; janë plotësisht të varfëruar, por prapë vazhdojnë të gëzojnë bollëk. 14. Ata çnderohen dhe në kulmin e çnderimit të tyre bëhen të lavdishëm; poshtërohen dhe përgëzohen njëkohësisht. 15. Ata përbuzen, por prapë janë të bekuar; kur ata poshtërohen, respektohen akoma më shumë. 16. Kur ata bëjnë të mira, ndëshkohen si keqbërës; kur i nënshtrohen ndëshkimit, ata gëzojnë që janë sjellë në jetë. 17. Ata trajtohen nga judenjtë si të huaj dhe armiq dhe poshtërohen nga grekët; dhe gjatë gjithë kohës të gjithë ata që i urrejnë e kanë të pamundur të justifikojnë armiqësinë e tyre.

Kreu 6

1. Për ta thënë më thjeshtë: çfarë shpirti është në trup, kjo janë të krishterët në botë. 2. Shpirti zhduket përmes gjithë pjesëve të trupit, dhe të krishterët shpërndahen në të gjithë vendet e botës. 3. Shpirti jeton në trup, por nuk i përket trupit dhe të krishterët jetojnë në botë por nuk i përkasin botës. 4. Shpirti, që është i padukshëm, ruhet brenda trupit të dukshëm; në të njëjtën mënyrë, të krishterët njihen kur ekzistojnë në botë, por besimi i tyre qëndron i padukshëm. 5. Mishi e urren shpirtin dhe e trajton atë si armik, edhe pse nuk ka vuajtur prej tij, sepse i është privuar nga gëzimi kënaqësive e tij; kështu që edhe bota i urren të krishterët edhe pse ajo nuk ka vuajtur nga duart e tyre, sepse ata e shtyjnë vetveten kundër kënaqësive të saj. 6. Shpirti dashuron mishin dhe pjesët e tij të cilat e urrejnë atë; në të njëjtën mënyrë të krishterët duan ata të cilët i urrejnë. 7. Shpirti mbyllet në trup dhe prapë e mban trupin të bashkuar; ndërsa të krishterët kufizohen në botë si në një burg dhe prapë ata e mbajnë botën të bashkuar. 8. Shpirti, i cili është i pavdekshëm, vendoset në një banesë të vdekshme; ndërsa të krishterët vendosen midis gjërave të prishshme, për të pritur paprishjen që do të jetë e tyre në qiell. 9. Shpirti, kur mbahet keq me ushqim dhe pije, rritet më mirë; po kështu dhe të krishterët, kur ndëshkohen nga dita në ditë, rriten shumë e më shumë. Është një vend si ky ku Perëndia i ka vendosur ata dhe ata nuk duhet të përpiqen ta shmangin atë. *(Marrë nga Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks, shkrimet e hershme).*

KLIMI I ALEKSANDRISË (150-216)

Klimi Aleksandrisë (Titus Flavius Klemens) ka lindur rreth vitit 150 në Athinë nga prindër paganë. Ku dhe si u kthye në krishterim nuk dihet. Pas konvertimit në kristianizëm, Klimi ndërmori shumë udhëtime në jug të Italisë, në Siri dhe Palestinë me synimin të merrte mësimë feje nga mësuesit më të njohur të krishterimit. Më vonë u dorëzua prift. Udhëtimet e tij e sollën në Aleksandri, ku ndoqi leksionet e Pantenit, të cilat e tërhoqën aq shumë, sa vendosi të rrinte në Aleksandri dhe të bëhej nxënës dhe pasardhës i Pantenit në drejtimin e shkollës së katekizmit. Koha kur ai u bë trashëgimtar i profesorit të tij, mendohet të jetë aty rreth vitit 200 pas Krishtit. Disa vjet më vonë nga përndjekja e Septim Severit u detyrua të largohej nga Egjipti. Klimi gjeti strehë në Kapadoki bashkë me nxënësin e tij, Aleksandrin, i cili më vonë do të bëhej peshkop i Jeruzalemit. Klimi vdiq në vitin 216 pas Krishtit.

Shkrimet: Klimi u përpoq me të gjitha fuqitë e tij, që të shpjegonte dhe të demonstronte nga pozita filozofike doktrinën kristiane, ose të krijonte një të tillë siç thoshte ai vetë, por në shpjegimet e tij shpesh herë gaboi dhe prandaj bën pjesë vetëm në grupin e shkrimtarëve të krishterë. Nga veprat e tij, të cilat kanë arritur deri në ditët tona janë këto: 1) *Thirrja nxitëse drejtuar grekëve*, e cila konsiderohet si një thirrje, që synon kthimin në krishterim. Qëllimi i saj është të bindë adhuruesit për kotësinë e perëndive dhe vlerën e kotë të besimeve pagane. Synimi i veprës është të nxisë ata që të pranojnë të vetmen fe të vërtetë.

“Atëherë, përse po ua dërgoj këtë thirrje? Për t’ju nxitur që të shpëtoheni. Pikërisht këtë do edhe Krishti. Me një fjalë, Ai bujarisht u fal jetë. Po kush është Ai? Mësoni shkurtimisht. Fjala e

së vërtetës, Fjala e mosprishjes, që e rilind njeriun, duke e kthyer sërish tek e vërteta–nxitja që të çon drejt shpëtimit–Ai, që dëbon shkatërrimin dhe gjurmon vdekjen–Ai, që ndërton me njerëz tempullin e Perëndisë, duke bërë që Perëndia t’i bëjë njerëzit banesën e tij”. *Thirrja drejtuar grekëve* është e lidhur ngushtë me apologjitë e hershme të krishtera, të cilat kundërshtonin mitologjinë e lashtë. Klimi synon të entuziazmojë lexuesit e tij që t’i përkushtohen fesë së krishterë si të vetmes filozofi të vërtetë.

2) *Pedagogu* ose *Kujdestari*, vepër e cila përmban tri libra dhe është vazhdimësia e *Thirrjes*. Me anën e Kujdestarit Klimi u drejtohet atyre që ndoqën këshillën e tij duke pranuar besimin e krishterë. Pedagogu i udhëzon këta të kthyer dhe i mëson se si duhet të jetojnë. Klimi paraqitet si bariu i deleve dhe kujdestari i fëmijëve. “Ushqena në fëmijët ashtu si dhe delet. Po, o Mjeshtër, na mbush me drejtësi. Kullotën Tënde, po o Kujdestar, ushqena në Malin Tënd të Shenjtë, në Kishën Tënde, që lartësohet mbi gjithçka, që është mbi retë, që prekin qiejt”.

Në fillim të librit të dytë, trajtesa u kthehet dertëve të jetës së përditshme: të ngrënët, pija, shtëpitë dhe mobiljet, muzika dhe kërcimi, koha e lirë dhe argëtimet, larja dhe lyerja, sjellja dhe jeta martesore. Këta kapituj na japin një përshkrim të jetës së përditshme në qytetin e Aleksandrisë, të zhytur në degjenerim dhe mëkat. Klimi i paralajmëron të krishterët që të mos bëjnë jetë të tillë dhe paraqet kodin moral të sjelljes së krishterë. *Kujdestari* mbyllet me himnin drejtuar Krishtit Shpëtimtar.

3) *Stromata*, vepër e cila përbëhet nga tetë libra. Në këtë libër trajtohet lidhja mes besimit të krishterë dhe filozofisë greke. Klimi thotë se filozofia është dhënë prej Perëndisë dhe iu fal grekëve prej vetë përkujdesjes Hyjnore, ashtu sikundër Ligji iu dha

Hebrenjve. Filozofia mund të kryejë shërbime të rëndësishme për të krishterët, nëse dëshirojnë të arrijë njohje të plotë të përmbajtjes së besimit. Klimi shkruan se filozofia kurrë nuk mund të zëvendësojë zbulesën hyjnore, por vetëm mund të përgatisë dikë për të pranuar besimin. Njohja e Perëndisë mund të arrihet vetëm përmes besimit dhe besimi është themeli i gjithë dijes. “Besimi, të cilin grekët e trajtojnë me përbuzje si diçka të kotë dhe barbare, është një parakonceptim i vullnetshëm, pohim i shpresëtarisë—”tema e të gjithë shpresave, dëshmia e së padukshmes”, sipas apostullit hyjnor. Pa besim është e pamundur të kënaqësh Perëndinë” (*Strom.* 2, 2, 8, 4).

ORIGJENI (185-254)

Origjeni ka lindur në vitin 185 në Aleksandri nga prindër kristianë. Babai i tij Leonidha kishte vdekur si martir në vitin 202 gjatë persekutimeve të perandorit Septim Severi. Origjeni ishte nxënës dhe pasardhës i Klimit të Aleksandrisë në drejtimin e shkollës së katekizmit. Ai ishte një nga përfaqësuesit më të mëdhenj të shkollës së Aleksandrisë dhe një shkrimtar gjenial. Filozofinë e kishte mësuar nga i famshmi Amonius Saca, themeluesi i rrymës neoplatonike, ndërsa teologjinë nga Klimi i Aleksandrisë. Që në moshë të re shquhej për njohuritë e gjera dhe për jetë të moralshme. Në moshën 18-vjeçare u emërua drejtor i shkollës së katekizmit. Sipas dëshmisë së Eusebit, leksionet e Origjenit tërhiqnin shumë dëgjues, si të krishterë ashtu edhe paganë. Ky fakt ndikoi që nëna e perandorit Aleksandër Severi, Julia Mamaea, ta thërresë në Antioki, që t’i mësonte djalit të saj të vërtetat e kristianizmit. Origjeni udhëtoi në Romë, Greqi dhe Arabi për qëllime studimi dhe debate teologjike. Gjatë këtyre udhëtimeve episkopët e Qesarisë dhe të Jeruzalemit

e dorëzuan prift. Kjo gjë e zemëroi episkopin Dhimitër, i cili thirri dy sinode në Aleksandri ku vendosi përjashtimin e tij nga radhët e klerit. Atëherë Origeni shkoi në Qesari ku themeloi një shkollë katekizmi si ajo e Aleksandrisë. Në kohën e persekutimeve të perandorit Decius, Origenin e futën në burg. Ai vdiq nga shkakut e torturave në Tiro të Finikit në vitin 254.

Shkrimet: Origeni është një nga shkrimtarët kristianë më produktivë. Thuhet se ka shkruar rreth 6000 vepra, sepse kishte shtatë stenografë, që shkruanin atë çfarë u diktonte ai dhe po aq kopjues dhe kaligrafistë. Për veprimtarinë e tij të palodhur pasardhësit e quajtën “Adamintion” i fortë si diamanti. Vetëm një pjesë e vogël e veprave të tij janë ruajtur. Shumica kanë humbur. Origeni është marrë më shumë me interpretimin e shkrimeve të shenjta. Veprat e tij në këtë fushë kanë qenë këto: 1) *Eksapla* një edicion i Shkrimeve të Shenjta në disa gjuhë dhe komentarët pothuajse të të gjitha shkrimeve të Dhiatës së Vjetër dhe të Re. 2) Në fushën apologjitike në vitin 246 ka shkruar një apologji të famshme *Kundër Çelsit*. 3) Në fushën dogmatike shkroi librin e parë dogmatik me titull “De Principis”, një vepër monumentale, por brenda së cilës qenë përfshirë shumë ide heretike. 4) Në fushën e moralit kristian në vitin 233 shkroi një libër *Mbi lutjen* dhe një tjetër *Mbi shtytjen për martir* në vitin 235, si dhe një numër të madh fjalimesh dhe letra. Më vonë, në Sinodin V Ekumenik të vitit 553, Origeni u dënua si heretik sepse në shkrimet e tij ekzistojnë, krahas doktrinës së drejtë dhe të vërtetë kristiane, edhe mësim të gabuara.

Prologu i komentit të Kantikut të Kantikëve Nga Origjeni

Ky libër më duket një *epithalamium*, që do të thotë, një këngë dasme, shkruar nga Salomoni në formën e një pjese teatrale, të cilën ai e recitoi në rolin e një nuseje e cila po martohej dhe që digjej nga dashuria qiellore për dhëndrin, që është Fjala e Perëndisë. Meqenëse ajo ishte shpirti i bërë sipas imazhit të tij apo të Kishës, ajo kishte rënë krejt në dashuri me të. Për më tepër, ky libër i Shkrimeve na mëson në lidhje me fjalët që ky dhëndër i mrekullueshëm dhe i përsosur përdor për Shpirtin apo për Kishën, që është bashkuar me të. Gjithashtu, nga i njëjti libër, i cili titullohet Kantiku i Kantikëve, ne mësojmë se çfarë thanë vajzat e reja që ishin zgjedhur si shoqërueset e nuses, si dhe çfarë thanë miqtë dhe shoqëruesit e dhëndrit. Miqtë e dhëndrit kishin mundësi që aq sa të mundeshin të thoshin ato çfarë kishin dëgjuar nga vetë dhëndri, përderisa ata po gëzonin për bashkimin e tij me nusen. Përveç kësaj, nusja i drejtohet jo vetëm dhëndrit, por edhe vajzave të reja dhe po kështu dhëndri i drejtohet jo vetëm nuses por edhe miqve të tij. Ishte pikërisht kjo që donim të thonim kur këtë e quajtëm pak më lart një këngë dasme të shkruar në formën e një pjese teatrale. Një pjesë teatrale përkufizohet si një histori, zakonisht e luajtur në skenë, në të cilën prezantohen disa personazhe, ku disa personazhe dalin e të tjerë hyjnë dhe struktura e të rrëfyerit plotësohet nga fjalët të ndryshme që u drejtohen personazheve të ndryshme. Secilin nga këto elemente libri i Shkrimeve e përfshin sipas rendit të tij dhe tërësia e tyre është formuar nëpërmjet fjalësh të mrekullueshme dhe misterioze.

Por së pari ne duhet të kuptojmë se ndërsa fëmijët nuk preken nga pasioni i dashurisë si të rriturit, ashtu dhe mosha e brendshme e njeriut nuk mund të kuptojë këto fjalë nëse është një vogëlush ose një foshnjë. Po i referohem atyre që ushqehen në Krishtin me qumësht dhe jo me ushqim të fortë dhe që tani për herë të parë kanë etje për qumështin shpirtëror të pastër. Në fakt në fjalët e Kantikut të Kantikëve mund të shikohet se ushqimi për të cilin apostulli thotë: “Por ushqimi i fortë është për të rritur” dhe u kërkon si dëgjues njerëz të cilët “i kanë të zhvilluara vetitë për të dalluar të mirën nga e keqja”. Kështu, nëse ata që ne kemi quajtur “të vegjël” vendosen përballë librit të Shkrimeve, mund të ndodhë që ata të mos kenë asnjë përfitim nga libri ose që të mund të dëmtohen nga ai duke lexuar atë që është shkruar ose duke studiuar çka është thënë për ta interpretuar atë. Por nëse afrohet dikush i cili sipas mishit është një i rritur, për të nuk ka asnjë rrezik sado të vogël nga ky libër Shkrimesh. Sepse nëse ai nuk di se si të dëgjojë emrat e dashurisë pastërtisht dhe me veshë të qashtë, ai mund të deformojë gjithçka ka dëgjuar nga njeriu i brendshëm të njeriu i jashtëm dhe tokësor dhe të largohet nga Shpirti të mishit. Më pas ai do t’i ushqejë vetes dëshira njerëzore dhe për shkak të shkrimeve të Shenjta do të shihet që ai orientohet dhe mbizotërohet prej lakmisë së mishit. Për këtë arsye unë paralajmëroj dhe këshilloj të gjithë ata që ende nuk janë të lirë nga shqetësimet e mishit dhe të gjakut dhe që nuk janë tërhequr ende nga dëshira për një botë materiale të vetëprivohen tërësisht prej leximit të këtij libri dhe gjithçka është thënë rreth tij. Në fakt thuhet se hebrenjtë kanë një rregull sipas të cilit nëse dikush nuk ka arritur moshën e përsosur dhe të pjekur, ai as nuk lejohet që ta mbajë këtë libër në dorë. Për më tepër ne pranojmë gjithashtu ndjekjen e rregullit të mëposhtëm

nga ata – është zakoni i tyre që të gjitha Shkrimet t’u jepen fëmijëve nga mësuesit dhe dijetarët dhe në të njëjtën kohë ato pasazhe që ata i quajnë *deuteroseis* duhet të studiohen të fundit. Këta janë katër: fillimi i Zanafillës në të cilën përshkruhet krijimi i botës, kapitujt e parë të profetit Ezekiel në të cilin përmenden kerubimet, fundi i Ezekielit i cili përfshin ndërtimin e Tempullit dhe ky libër, Kantiku i Kantikëve.

Duke pasur parasysh këtë, mua më duket e nevojshme që përpara se të fillojmë diskutimin tonë për atë çka është shkruar në këtë libër, të diskutojmë shkurtimisht së pari vetë dashurinë, e cila është dhe tema kryesore e librit dhe më pas serinë e librave të Salomonit ndër të cilët natyrisht ky libër zë vendin e tretë. Më pas do të diskutojmë gjithashtu dhe për vetë titullin e librit dhe pse ai titullohet “Kantiku i Kantikëve”. Së fundi do të diskutojmë gjithashtu dhe për mënyrën e kompozimit në formën e një pjese teatrale dhe si një histori që zakonisht luhet në skenë me shkëmbimin e personazheve.

Ndërmjet grekëve, shumë njerëz të ditur, të cilët dëshironin të kërkonin të vërtetën, kanë publikuar shumë libra të ndryshëm për natyrën e dashurisë, disa prej të cilëve janë shkruar dhe në formën e dialogëve. Ata janë përpjekur që të tregojnë që forca e dashurisë nuk është gjë tjetër veçse forca që ngre shpirtin nga toka në lartësitë e madhërishtme qiellore dhe që ne nuk mund të arrijmë bekimin qiellor nëse nuk na pushton dëshira e madhe e dashurisë. Përveç kësaj, paraqiten gjithashtu për diskutim çështje që lidhen me dashurinë; është një lloj sikur të mendonim se jemi në një banket midis atyre që mendonin se po bënë një banket, por jo me ushqim, por me fjalë. Po kështu, të tjerë na kanë lënë disa libra “arti”, në të cilët kjo dashuri është në gjendje që të lindet apo të rritet në shpirt.

Por njerëzit tokësorë i kanë transformuar këto arte në dëshira të dhunshme ose në misteret e dashurisë së gabuar. Prandaj pa dyshim që edhe me ne, ku shumicën e përbëjnë të thjeshtët dhe rrjedhimisht të paditurit, e kemi konsideruar natyrën e dashurisë si të vështirë dhe të rrezikshme. Te grekët, megjithëse kishin një reputacion të mirë si njerëz të zgjuar dhe të ditur, kishte nga ata të cilët nuk i merrnin këto libra me atë kuptim që janë shkruar; por duke nxjerrë si justifikim atë që ishte shkruar për dashurinë, ata ranë në mëkatet e mishit dhe në rrugët e rrezikshme të shthurjes, qoftë duke marrë sugjerime dhe duke u ndikuar nga shkrimet që i kemi përmendur tashmë, ose duke prezantuar shkrimet e tyre si të vjetra dhe si një maskim të humbjes së kontrollit.

Prandaj, aq më pak ne nuk duhet që të ofendojmë në asnjë mënyrë atë që është shkruar mirë dhe me frymë shpirtërore nga mendimtarët e vjetër, duke e shtrembëruar atë në një kuptim imoral ose mishtor, por le të shtrijmë duart e shpirtit dhe të trupit tonë drejt Zotit, kështu që Perëndia, i cili u dha Fjalën e tij predikuesve me një fuqi të madhe, të mund të na japë dhe ne Fjalën me fuqinë e tij, nga e cila ne mund të jemi në gjendje të arrijmë në një kuptim të qartë dhe të përshtatshëm të emrit dhe natyrës së dashurisë për të ndërtuar qashtërinë.....

GRIGORI I NEOQESARISË (210-275)

Grigori lindi rreth vitit 210 pas Krishtit. Prindërit e tij ishin paganë dhe kishin një pozitë të lartë shoqërore në Neoqesari. Grigori së bashku me vëllanë e tij shkuan në Viritto për të studiuar drejtësi, por Perëndia kishte plane të tjera për shenjtin. Duke kaluar në Qesari dëgjoi komentuesin e famshëm të shkrimeve, Origjenin. Kaq shumë u entuziazmua sa që i la studimet dhe u bë nxënës i tij. Më pas shkoi në Aleksandri dhe u kthye në Neoqesari me dije të plota teologjike. Mitropoliti Amasia, duke vlerësuar virtytet e Grigorit, e dorëzoi episkop të Neoqesarisë. Grigori predikoi Ungjillin në gjithë krahinën dhe shumë njerëz përqaftuan besimin kristian dhe filluan të prishnin tempujt e idhujve. Me ndihmën e Perëndisë, Grigori, pas një përpjekjeje të madhe arriti të kthejë në fenë kristiane të gjithë qytetin. Në fund të vitit 270 kishin mbetur në atë krahinë vetëm 17 paganë. Grigori ndërroi jetë në 17 nëntor të vitit 275.

12 Kanonet e Grigorit të Neoqesarisë

1. Në përgjigje të pyetjes për të krishterët që kanë qenë robër dhe u është dhënë ushqim, që u është sakrifikuar idhujve ose që është i ndaluar, Shën Grigori thotë që nuk rezulton asnjë dëm dhe mëkat serioz, duke cituar (1 Kor. 6:13).

2. Për gratë që qenë përdhunuar duke qenë nën robëri, ai thotë që ato që dihehin edhe më parë që kishin një prirje ose joshje drejt marrëdhënieve seksuale jashtë martesës, nuk duhet të marrin kungimin, por ato që kanë bërë një jetë të matur nuk duhen dyshuar, nuk kanë bërë asnjë gabim. Kjo mbështetet nga (Deut. 22:26-27).

3. I pyetur për njerëzit, të cilët gjatë persekutimit do të vidhnin shtëpitë e bashkëqytetarëve të tyre të krishterë që mbaheshin në burg, ai thotë që një hajdut duhet aforizuar (nxjerrë jashtë kungimit), por ai që vjedh në një kohë të tillë trishtimi e vështirësia, duhet dëbuar jashtë kishës, që zemërimi i Perëndisë të mos bjerë mbi të gjithë njerëzit.

4. Duke mbështetur kanonin e mësipërm ai jep një shembull ku një njeri vodhi, mirëpo shumë vuajtën prej veprimeve të tij, derisa zemërimi u ndez kundër gjithë kongregacionit të Izraelit (Josh: 7:1).

5. Duke pasuar kanonet e mësipërme ai thotë: mos lini asnjë të thotë që ata i kanë gjetur këto gjëra të braktitura, sepse në Deut. 22; 1-3 dhe Dalje 23:4, ne na thuhet që të kthejmë çdo gjë të humbur që gjejmë edhe kur ato t'i përkasin armiqve tanë.

6. Disa pretendojnë se derisa gjërat e tyre u vodhën nga barbarët, ata morën gjërat e vëllezërve të tyre për t'i zëvendësuar. Shën Grigori thotë se ata janë duke mashtruar vetveten dhe po bëhen për bashkëqytetarët e tyre të krishterë, ashtu si barbarët u bënë për ta. Kështu, u dërgua dikush që t'i ndihmojë të vendosin se cilat çështje të përjashtojnë nga lutja dhe cilat jo.

7. Disa të krishterë kanë mbajtur me forcë ata që i arratiseshin persekutimit. Shën Grigori e denoncon këtë dhe thotë se duhet shqyrtuar çështja.

8. Si ata që u bashkuan me barbarët dhe vranë vëllezërit e tyre, ashtu edhe ata që u treguan barbarëve shtëpitë e tyre, mbetën jashtë kishës, derisa Sinodi të mblidhet për të diskutuar çfarë do të bëhet me ta.

9. Ata që kanë vjedhur shtëpitë e të krishterëve të skllavëruar dhe provohen fajtorë, gjithashtu duhet të qëndrojnë

jashtë kishës. Por, në qoftë se rrëfejnë dhe kthejnë gjithçka kanë marrë, mund të qëndrojnë me “të gjunjzuarit”.

10. Ata që gjetën diçka që lanë barbarët në shtëpitë e tyre dhe nuk e kthejnë, konsiderohen fajtorë dhe bashkohen gjithashtu me “të gjunjzuarit”. Por, në qoftë se rrëfejnë dhe kthejnë gjithçka, ata konsiderohen të denjë për lutje (por ende jo për kungim).

11. Ata që kanë gjetur diçka që i përket një personi tjetër, nuk duhet të kërkojnë shpërblim prej të zotit kur t’ia kthejnë.

12. Ky kanon përcakton vetëqëndrimet e ndryshme të pendimtarëve: “vajtuesit” qëndrojnë jashtë kishës dhe u lypin besimtarëve të luten për ta; “dëgjuesit” qëndrojnë në narteks dhe largohen me katekumenët, “të gjunjzuarit” qëndrojnë në pjesën e pasme të kishës dhe gjithashtu largohen me katekumenët; “bashkëqendruesit” qëndrojnë me besimtarët deri në fund të shërbesës, por nuk marrin kungim. (*The Rudder (Pedalion), përkthyer nga Aleksandra Koço, Luna Printing Co, Nju Jork 1983, page 33*).

IRINEU I LIONIT (140-202)

Mendohet se Irineu lindi aty rreth vitit 140 dhe shërbeu si prift në vitin 177 në Lion të Francës. Gjatë persekutimit të atëhershëm, montanizmi, një herezi e re, bëri për vete mjaft të burgosur të painformuar, ndër këta edhe Irineun. Por shpejt Irineu u pendua dhe u kthye drejt krishterimit. Besimtarët e bënë kryebari pas ikjes së episkopit të tyre, Pothinit. Martirizimin e tij e përshkroi sipas të gjitha gjasave Irineu. Ai u mundua për përhapjen e krishterimit te grekët, latinët dhe keltët dhe njëkohësisht luftoi herezitë. Irineu ishte atë i shquar e teolog i shkëlqyer, zotërues i retorikës, letërsisë e filozofisë. Në saje të autoritetit të tij ndërhynte paqësisht në problemet themelore mbarëkristiane. Kështu vërtetoi se ishte shumë më e keqe skizma se sa krentimi. U martirizua në vitin 202.

Shkrimet: Irineu ishte tepër produktiv dhe i talentuar, ai kompozoi shumë, por sot ruhen vetëm pak vepra apologjetike, ekleziologjike, didaktike e dogmatike.

Kundër herezive Nga Irineu i Lionit

1. Disa njerëz, duke mohuar të vërtetën, po na dëftojnë ndodhi të paqena dhe gjenealogji të kota, të cilat më tepër nxisin polemika, siç thotë apostulli, sesa ndihmojnë punën e Perëndisë për forcimin e besimit. Me anë të retorikës së tyre dhelpërake, ata ngatërrojnë dhe zënë peng mendjet e paditura, duke prishur orakujt e Zotit dhe duke u bërë shpjegues të ligj të fjalëve të mira. Sepse ata trazojnë shumë mendje, duke i degdisur larg, me pretendimin

se dija e tyre buron nga ai, që bëri dhe rregulloi gjithësinë, thua se zotërojnë diçka më të lartë e më madhështore për t' u dëftuar të tjerëve se vetë Perëndia që bëri qiellin e dheun dhe gjithçka që gjendet në to. Me fjalë të bukura dhe dinake tërheqin mendjet e thjeshta drejt hetimeve të llojit të tyre, dhe më pas i shkatërrojnë mizorisht, duke krijuar idetë e tyre blasfemuese dhe besëliga për Demiurgun. Dëgjuesit e tyre të thjeshtë nuk arrijnë të dallojnë rrenën nga e vërteta.

2. Sepse gabimi i tyre nuk dëftohet i tillë, për sa kohë që nuk paraqitet lakuriq dhe dukshëm para njerëzve; me dhëlpëri mbështillet në veshje tërheqëse dhe paraqitet më i vërtetë se vetë e vërteta, para gjithë të paditurve, sepse është pamja e jashtme ajo që gënjen. Siç mund të thotë dikush që është më i ditur se unë për këto punë, një gur i çmuar si smeraldi, që shumë vetë e çmojnë shumë, mund të ndjehet i turpëruar para një imitimi mjeshtëror prej qelqi, për sa kohë nuk del dikush që ta hetojë e të tregojë se çka arrin të bëjë mashtrimi i artit; ose kur kemi një përzierje tunxhi dhe argjendi, kush është ai jo- specialist që mund të provojë lehtësisht një gjë të tillë? Kështu, që disa të mos bien pre për fajin tim, si delet që gënjehen nga ujqërit, për shkak të veshjeve të tyre prej deleje – prej të cilëve Zoti na paralajmëroi të ruhem – dhe sepse ata flasin si ne, megjithëse mendojnë krejt ndryshe, mendova, miku im i dashur, pasi lexova Komentaret e dishepujve të Valentinit, siç i quajnë ata, pasi takova disa prej tyre dhe u njoha me këndvështrimin e tyre, se ishte e nevojshme të sqaroja ato mistere të thella dhe të jashtëzakonshme, të cilat jo të gjithë i pranojnë, sepse ende nuk e kanë pastruar sa duhet trurin e tyre. Kështu, ti, pasi të jesh njohur me këto gjëra, t'ua bësh të qarta të gjithë njerëzve dhe t' i paralajmërosh që të jenë syhapur karshi kësaj

çmendurie dhe blasfemie të humnertë kundër Krishtit. Aq sa mundem do të përshkruaj shkurtimisht e qartësisht pozicionin e mësuesve të rremë të tanishëm, d.m.th. të pasuesve të Ptolemeut, që është pjellë e shkollës së Valentinit. Më pas do të jap, aq sa më lejojnë aftësitë e mia modeste, rrugët për ta përmbysur këtë dije, duke treguar se sa absurde dhe të huaja për të vërtetën janë mësimet e tyre. Nuk jam shumë i mësuar me gjuhën e shkruar e as shumë i zoti në retorikë, por dashuria për ty dhe për njerëzit e tu më jep zemër që të dëshmoj lidhur me këto mësimet që kanë ndenjtur të fshehta deri më tash, por që tani i ka nxjerrë në dritë hiri i Perëndisë. “Sepse nuk ka asnjë të fshehtë, që nuk do të zbulohet dhe asnjë sekret, që nuk do të bëhet i ditur”.

3. Ti nuk mund të presësh prej meje, banor ndër Keltët dhe kryesisht njohës i një gjuhe barbare, zotësi në retorikë, të cilën nuk e mësova kurrë, e as forcë në shkrim, që nuk e studiova ndonjëherë, aq më pak bukuri gjuhe e stili, për të cilat nuk kam farë njohurie. Por këto që t’i shkruaj nga dashuria, thjesht, qartë dhe vërtetësisht, jam i sigurtë se do t’i presësh me dashuri dhe më pas do t’i plotësosh vetë, duke pasur më shumë aftësi se unë, ato që unë po t’i paraqes thjesht si parime themelore. Me plotësinë e mendjes tënde, do të mundesh t’i bësh shumë herë më frytdhënëse ato që unë po shkruaj shkurtimisht dhe do të jesh në gjendje t’ua paraqesësh njerëzve fuqishëm ato që unë shpjegova dobët. Ashtu si unë u përpoqa, duke iu përgjigjur dëshirës tënde të hershme për të mësuar mbi pozicionin e tyre, jo vetëm të të sqaroj ty, por edhe të jap mjetet e nevojshme për të vërtetuar rrejtshmërinë e tyre, kështu edhe ti bëju të njëjtin shërbim të tjerëve, sipas hirit që Zoti të ka dhënë, me qëllim që njerëzit të mos bien më në grackën e mashtrimeve të tyre, të cilat janë si më poshtë.

Besimi i Kishës

Kisha, edhe pse e shpërndarë në mbarë botën e qytetëruar deri në fund të dheut, e ka marrë prej apostujve dhe dishepujve besimin në një Perëndi, Atin e Gjithëfuqishëm, i cili bëri qiellin e dheun, dhe detet dhe gjithçka që gjendet në to, dhe në një Krisht Jesu, Birin e Perëndisë, i cili mori trup për shpëtimin tonë, dhe në Shpirtin e Shenjtë, i cili nëpërmjet profetëve shpalli rendin e ngjarjeve sipas planeve të Perëndisë – ardhjet, lindjen nga një virgjëreshë, pësimet, ngjalljen prej së vdekurësh, ngritjen trupore në qiell të të dashurit Jesu Krisht, Zotit tonë dhe ardhjen e tij nga qiejt, në lavdinë e Atit për të ndrequr të gjitha gjërat dhe për të ngritur gjithë trupat, d.m.th. gjithë sojin njerëzor, me qëllim që çdo gju të përkulet, i gjithçkaje në qiell e mbi tokë dhe nën tokë, përpara Jesu Krishtit Zotit tonë, Perëndisë, Shpëtimtarit dhe Mbretit tonë, siç i pëlqen Atit të padukshëm dhe që çdo gjuhë ta rrëfejë Krishtin dhe ai të zbatojë gjykimin e tij të drejtë mbi të gjithë. Fuqitë shpirtërore të ligësisë, engjëjt që mëkatuan dhe ranë në apostazi, të paperëndishmit, të ligjtë, të pabindurit dhe blasfemuesit ndër njerëzit, do t'i hedhë në zjarrin e pasosur. Por, të drejtëve, të shenjtëve dhe atyre që kanë mbajtur porositë e tij dhe kanë qëndruar në dashurinë e tij, disa që nga fillimi [i jetës] dhe disa pas pendimit të tyre, me hirin e tij do t'u japë jetë të paprishur dhe do t'i veshë me lavdi të përjetshme.

2. Duke u predikuar dhe duke u dhënë një besim i tillë, siç e thashë edhe më parë, Kisha, edhe pse e përhapur në mbarë botën, e ruan me kujdes këtë besim si të jetonte në një shtëpi të vetme. Ajo i beson këto gjëra [kudo] njësoj, si të kishte një zemër dhe një shpirt të vetëm, dhe i predikon ato harmonishëm, i mëson

dhe ua përcjell të tjerëve si të kishte vetëm një gojë. Sepse gjuhët e botës janë të ndryshme, por kuptimi i traditës [së krishterë] është një dhe i vetëm. Asnjë nga kishat e themeluara në Gjermani nuk beson ndryshe dhe as nuk përçon një traditë tjetër, as ato të Iberisë, as ato të Keltëve, as të Egjiptit a Libisë, e as të tjerat në zonat qendrore të botës. Por si një krijesë e Perëndisë, ashtu si dielli që është një dhe i vetëm në gjithë botën, ashtu edhe predikimi i së vërtetës rrezëllin kudo dhe ndriçon gjithë ata, që duan t' i aviten dijes së vërtetë. Asnjë nga ata që kryesojnë kishat, asnjë gojtar i zoti nuk do të thoshte diçka ndryshe, sepse asnjë nuk është mbi mësuesin [e tij] dhe asnjë folës i dobët nuk do të thoshte më pak se tradita. Sepse meqenëse besimi është një dhe i vetëm, ai që mund të thotë shumë nuk shton asgjë dhe ai që ka pak për të thënë nuk lë asgjë mangët.

3. Të pasurit një kuptim më të thellë a më të cekët nuk do të thotë se njerëzit ndryshojnë idenë themelore dhe përfytyrojnë një tjetër Perëndi mbi Demiurgun dhe Bërësin dhe Mbështetësin e kësaj gjithësie, a thua se ai nuk na mjaftonte, ose një tjetër Krisht a një tjetër të Vetëmlindur. Por ka të bëjë me të kuptuarit e atyre që janë thënë në shëmbëlltyra dhe me ndërthurjen e tyre brenda themelit të besimit: me sqarimin e veprimtarisë dhe planeve të Perëndisë për hir të njerëzimit; me dëftimin e qartë të mëshirës së Perëndisë edhe pas rënies së engjëjve dhe mosbindjes së njerëzve; me sqarimin e asaj se pse i njëjti Perëndi disa gjëra i bëri të vareshin nga koha, ndërsa të tjerat të përjetshme, disa qiellore e disa të dheshme; me të kuptuarin e asaj që pse Perëndia, duke qenë i padukshëm, iu shfaq profetëve, jo në një formë të vetme, por në forma të ndryshme njerëzve të ndryshëm; me shpjegimin e arsyes se përse pati disa besëlidhje me njerëzimin, me shpjegimin e

karakterit të çdonjërës prej këtyre besëlidhjeve; me zbulimin e arsyes se përse Perëndia rrethoi gjithçka me mosbindje, që të mëshironte gjithçka; me falenderimin për mishërimin e Perëndisë Fjalë dhe vuajtjet e tij; me shpalljen e arsyes së ardhjes së Birit të Perëndisë në fund të kohërave, do të thotë se përse Fillimi u shfaq në fund; me shpalljen e asaj që gjejmë te profetët për fundin dhe gjërat që ende nuk kanë ardhur; me mos-heshtjen lidhur me atë se Perëndia i ka bërë paganët e pashpresë bashkëtrashëgimtarë, një trup dhe ortakë me shenjtoret; me shpjegimin e asaj se si ky trup i vdekshëm do të vishet me pavdekësi dhe prishja me mosprishje; dhe me shpalljen e asaj që thotë: “Do ta quaj popullin tim atë që nuk ka qenë populli im dhe të dashur të mosdashurin” dhe: “sepse bijtë e së braktisurës do të jenë më të shumtë se të asaj që kishte burrin”. Duke pasur parasysh këto dhe të tjera, apostulli thërriti: “O thellësi pasurie, urtësie dhe diturie të Hyjit! Sa të pahulumtueshme janë gjykimet e tij dhe të pashtershme janë udhët e tij!” Por [kjo mjeshtëri e rrallë] nuk ka të bëjë me përfytyrime të tjera përtej Krijuesit dhe Demiurgut, Nënës së tij dhe të këtyre gjërave, Dëshirës së një Eoni bredharak dhe të arrish në blasfemi, madje as me përfytyrimin e Pleromës mbi të, herë me tridhjetë e herë me turma të panumërta Eonësh, siç thonë këta mësues, që nuk kanë farë dijenie për gjërat hyjnore. Por, siç të thashë edhe më parë, Kisha e vërtetë ka një besim të vetëm në mbarë botën.

TERTULIANI (155-235)

Tertuliani (Quintus Septimius Florens Tertulianus) ka lindur në vitin 155 në Kalqedoni të Afrikës. Ai rridhte nga një familje e kamur. Tertuliani mësoi filologjinë greke dhe latine, të drejtën romake dhe njohuri të tjera enciklopedike. Ushtronte profesionin e avokatit në Romë. Në vitin 193 u bë i krishterë dhe u kthye në Kalqedoni ku filloi aktivitetin kishtar. Veçse në vitin 207 përqafoi herezinë e montanizmit.

Shkrimet: Tertuliani ka shkruar shumë vepra 1) *Ad Nationes* në vitin 197, 2) *Apologeticum* më 197, 3) *De testimonio animale* në 197, 4) *Adversos Judaeos*, 5) *Ad Scapulam* etj. Libri *Mbi lutjen* (De Oratione) u drejtohet katekumenëve. Në fillim komenton lutjen e së Dielës dhe vijon me tema të tjera të përgjithshme.

Mbi lutjen Nga Tertuliani

Kreu I

Hyrje e përgjithshme

Shpirti i Perëndisë dhe Fjala e Perëndisë dhe Arsyjeja e Perëndisë - Fjala e Arsyjes dhe Arsyjeja dhe Shpirti i Fjalës - Jesu Krishti, Zoti ynë në emër, që është edhe njëri edhe tjetri, - ka caktuar për ne, dishepujt e Dhiatës së Re, një formë të re lutjeje; sepse edhe në këtë rast ishte e nevojshme që vera e re të futej në kacekë të rinj dhe copa e re të qepej në veshje te re . Përveç kësaj, gjithçka që i përkiste ditëve të shkuara ose është ndryshuar tërësisht, si p.sh. rrethprerja, ose është shtuar, si pjesa tjetër e Ligjit; ose është përmbushur, si profecia, ose është përsosur, si vetë besimi.

Sepse hiri i ri i Perëndisë ka rinuar gjithë gjërat, duke i shndërruar nga mishore në shpirtërore, duke u bërë shkaku i parë i Ungjillit, fshirësi i gjithë sistemit të lashtë; në të cilin Zoti ynë Jesu Krishti është pohuar si Shpirti i Perëndisë dhe Fjala e Perëndisë dhe Arsyeya e Perëndisë: Shpirti, me anë të të cilit ishte i fuqishëm; Fjala, me anë të së cilës mësoi; Arsyeya, me anë të së cilës erdhi. Kështu, lutja e krijuar nga Krishti, është krijuar nga tre pjesë. Ligjërimi , me anë të të cilit shpallet lutja, shpirti, me anë të të cilit vetëm mbizotëron, arsyeya me anë të së cilës mësohet, madje dhe Joani i pati mësuar dishepujt e tij të luteshin , por gjithë puna e Joanit parapërgatiti sheshin për Krishtin deri kur “ai u rrit”, - ashtu sikurse po ky Joan parashpallte se: “ ishte e nevojshme” që “Ai të rritej dhe vetë të zvogëlohej” - gjithë vepra e pararendësit, bashkë me vetë shpirtin e tij, kaloi mbi Zotin. Ndaj, mënyra sesi Joani na mësoi të luteshim nuk ka mbijetuar, sepse gjërat tokësore ua kanë lënë vendin atyre qiellore. “Ai që është nga dheu”, - thotë Joani, - “flet për të dheshmet; dhe ai që është nga qiejt flet për gjërat që ka parë” . Dhe, a ka ndonjë gjë në mënyrën e të luturit të Krishtit që nuk është qiellore? Ndaj, vëllezër të lumur, le të shohim urtësinë e tij qiellore: së pari le të prekim rregullin e lutjes së fshehtë, me anë të së cilës Ai ndreqi besimin e njeriut, në mënyrë që ai të ishte plotësisht i bindur se vështrimi dhe dëgjimi i Perëndisë së Gjithëfuqishëm janë të pranishme poshtë çative dhe arrijnë deri në vendet më të fshehta; dhe kërkoi thjeshtësi në besim, në mënyrë që lavdet fetare t’i drejtoheshin vetëm Atij që besojmë se sheh dhe dëgjon kudo. Më tej, meqenëse urtësia është ajo që pason këtë rregull, le ta lejojmë atë që të ndikojë mbi besimin tonë dhe mbi thjeshtësinë e besimit, në mënyrë që të mos mendojmë se Zotit duhet t’i avitemi me një mal me fjalë, i cili jemi të bindur se kujdeset

për të tiftë pa ia kërkuar një gjë të tillë. Megjithatë, pikërisht kjo shkurtshmëri—dhe le ta themi këtë për shkallën e tretë të urtësisë—është e mbështetur në thelbin e një shpjegimi të shkëlqyer dhe të bekuar dhe është aq e gjerë në kuptim, sa ç’është e përmbledhur në fjalë. Sepse arrin të përfshijë jo vetëm pikat kryesore të lutjes, qoftë kjo adhurimi i Perëndisë apo lutje për një njeri, por edhe pothuajse çdo bisedë të Zotit, çdo mbamendje të Disiplinës së Tij; kështu që në Lutje gjejmë të përfshirë një përmbledhje të gjithë Ungjillit.

Kreu II

Fjalja e parë

Lutja fillon me dëshmimin e Perëndisë dhe me shpërblimin e besimit kur themi: “Ati ynë që je në qiej”, sepse (duke thënë kështu) në të njëjtën kohë i lutemi Perëndisë dhe përlëvdojmë besimin, shpërblim për të cilin është ky emërtim. Është shkruar: “Të gjithë atyre që e pranuan, ai u dha pushtetin të bëhen bij të Perëndisë”. Gjithsesi, shumë shpesh Zoti ynë e shpalli Perëndinë si Atin tonë; madje na dha një parim themeltar: “Dhe përmbi tokë mos thirrni askënd a të tuaj, sepse vetëm një është Ati juaj, ai që është në qiej”, pra, duke u lutur kështu zbatojmë edhe parimin e dhënë. Të lumur janë ata që njohin Atin e tyre! Pikërisht ky është edhe qortimi që i bëhet Izraelit, për të cilin Shpirti pohon para qiellit dhe dheut, kur thotë: “Rrita fëmijë, por ata nuk më njohën”. Për më tepër, duke thënë “Atë”, e quajmë edhe “Perëndi”. Ky emërtim është njëherësh një detyrim birësor dhe pushtetar. Sërisht, me Atin i thërrasim edhe Birit, sepse ai thotë: “Unë dhe Ati jemi Një”. Kështu, as nëna jonë Kisha nuk lihet pa përmendur, sepse në Atin dhe Birin njohim edhe nënën, prej së cilës vijnë edhe emrat e Atit dhe të Birit. Me një term të vetëm ose me një fjalë, ne

nderojmë Perëndinë, bashkë me të tujat, por edhe nderojmë rregullin e dhënë dhe u tërheqim vëmendjen atyre që kanë harruar Atin e tyre.

Kreu III

Fjalia e dytë

Emri i “Perëndisë Atë” nuk i ishte shpallur askujt. Edhe Moisiu, i cili e kishte pyetur Perëndinë për emrin, pati dëgjuar një emër tjetër. Ne na u zbulua te Biri, sepse Biri është tashmë emri i ri i Atit. “Unë kam ardhur”, thotë ai, “në emër të Atit” dhe sërish: “O Atë, përlëvdo emrin tënd” dhe ende më hapur: “Unë ia kam dëftuar emrin tënd njerëzve”. Prandaj ne lutemi: “qoftë i përlëvduar” ai emër. Jo sepse u ka hije njerëzve që të urojnë Perëndinë të jetë mirë, ose t’i urohet të jetë më mirë se dikush tjetër që ndoshta ekziston, apo se Perëndia do të vuante nëse nuk do ta uronim. Thjesht, i ka hije mbarë gjithësisë dhe çdo njeriu që ta bekojë Perëndinë, në çdo kohë dhe në çdo vend, në kujtim të mirësive të tij. Por kjo lutje shërben gjithashtu edhe si falenderim për bekimet. Sepse, kur nuk është i “shenjtë” dhe i “lavdëruar” emri i Perëndisë nëpërmjet vetë Atij, duke qenë se përmes vetes Ai shenjtëron gjithçka tjetër – Ai rreth të cilit rreshtat e engjëjve nuk pushojnë së kënduari: “I Shenjtë, i shenjtë, i shenjtë?” Në të njëjtën mënyrë edhe ne, që jemi kandidatë për t’u bërë engjëj, nëse arrijmë ta meritojmë një gjë të tillë, duhet të fillojmë që këtu në tokë të mësojmë përmendësh këtë melodi dhe t’ia drejtojmë vetëm Perëndisë, në pritje të lavdisë së ardhshme. Gjithçka për lavdinë e Perëndisë. Nga ana tjetër edhe për përmbushjen e lutjeve tona, themi këtë kur lutemi: “I shenjtëruar qoftë emri yt”, me qëllim që të shenjtërohet në ne, që jemi në Të, si edhe në gjithçka tjetër, që Perëndia po pret t’i japë hir ; që, gjithashtu, t’i bindemi këtij parimi kur themi “duke

u lutur për të gjithë”, madje edhe për armiqtë tanë. Kështu, lutemi me përmbajtje, por duke mos thënë “u shenjtëroftë ndër ne”, themi “në gjithçka”.

Kreu IV

Fjalja e tretë

Sipas këtij modeli, nënrenditim: “U bëftë vullneti yt në qiej dhe mbi dhë” ; jo sepse gjendet një forcë që mund të pengojë përmbushjen e vullnetit të Perëndisë dhe ne lutemi që Ai të arrijë të përmbushë me sukses vullnetin e tij, por lutemi që vullneti i tij të bëhet në gjithçka. Sepse, sipas një shpjegimi figurativ të “trupit” dhe të “shpirtit”, ne jemi “qielli” dhe “dheu”; megjithatë, edhe nëse do ta kuptonim thjesht, kuptimi i lutjes mbetet i njëjti, që vullneti i Perëndisë të bëhet mbi dhë, ndër ne, dhe të bëjë të mundur që në të njëjtën mënyrë të bëhet edhe në qiej. Çfarë dëshiron Perëndia, përveç të ecim sipas udhëzimeve të Tij? Ne lutemi që Perëndia të na japë thelbin e vullnetit të tij dhe aftësinë për të bërë këtë vullnet, me qëllim që të gjejmë shpëtim si në qiell, ashtu edhe mbi dhë; sepse përmbledhja e vullnetit të tij është shpëtimi i gjithë atyre që Ai ka birësuar. Gjithashtu, kemi edhe vullnetin e Perëndisë, që u përmbush në predikimet e Zotit, në veprën e tij, në pësimet e tij: sepse nëse Ai vetë shpalli se nuk bënte vullnetin e tij, por atë të Atit të tij, atëherë padyshim që gjithë ato që bëri ishin sipas vullnetit të Atit; gjëra të cilat na shërbejnë si shembuj për të predikuar, vepruar dhe duruar pësime, madje deri edhe vdekjen. Ne kemi nevojë për vullnetin e Perëndisë që të mundësohemi për të përmbushur gjithë këto detyra. Sërish, kur themi: “U bëftë vullneti yt” ne jemi duke i uruar mirësi vetes sonë, sepse nuk gjendet kurrfarë ligësie në vullnetin e Perëndisë; as atëherë kur gjatë periudhash të vështira na imponohet diçka tjetër . Kështu, me anën e kësaj shprehjeje i

këshillojmë durim vetes sonë. Vetë Zoti, kur deshi të na zbulonte kufizimet e trupit, kur ishte vetë në trup, me anë të realitetit të vuajtjes tha: “Atë, largoje prej meje këtë kupë”; dhe pastaj duke kujtuar veten shton: “por, u bëftë vullneti yt dhe jo i imi”. Vetja ishte vullneti dhe pushteti i Atit; por megjithatë për të dëftuar durimin që i kishte hije, Ai ia dorëzon Vetën e tij Vullnetit të Atit.

Kreu V

Fjalë e katërt

“Ardhtë mbretëria jote” i referohet gjithçkaje që “u bëftë vullneti yt” – d.m.th. i referohet në ne. Sepse kur Perëndia nuk mbretëron, në duart e kujt mbesin zemrat e gjithë mbretërve? Çfarëdo që i urojmë vetes, e urojmë edhe për Atë dhe Atij i atribuojmë gjithçka që presim prej Tij. Ndaj, nëse shfaqja e mbretërisë së Zotit lidhet me vullnetin e Perëndisë dhe me pritjet tona të ankthshme, si ka mundësi që disa luten për jetëgjatësinë e botës (shtyrjen e fundit), në një kohë që mbretëria e Perëndisë, ardhjen e së cilës e lusim dhe e urojmë, priret të rendë drejt mbarimit të botës? Dëshira jonë është që mbretërimi ynë të përshpejtohet dhe jo të për zgjatet skllavëria jonë. Edhe nëse nuk do të na ishte këshilluar në Lutje që të kërkojmë ardhjen e mbretërisë, ne vullnetarisht duhet të kishim nxjerrë atë thirrje për të përshpejtuar përmbushjen e shpresave tona. Shpirtrat e dëshmorëve poshtë altarit, nga padurimi i thërrasin Perëndisë: “Deri kur do të presësh Perëndi për të marrë hakun e gjakut tonë nga ata që banojnë mbi dhe?” Sepse, padyshim, hakmarrja do të vihet në vend në mbarim të botës. Po, o Zot, sa më parë ardhtë mbretëria jote, - lutja e të krishterëve, turbullimi i paganëve, gëzimi ngadhënjimtar i engjëjve, për të cilën ne vuajmë, ose më mirë të themi për të cilën ne lutemi! . . .

(Marrë nga Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks, shkrimet e hershme).

HIPOLITI I ROMËS (170-235)

Hipoliti ka lindur rreth vitit 170. Në vitin 212 u dorëzua klerik dhe shërbente në Romë. Në vitin 235 gjatë përndjekjes së Maksim Thrakasit, Hipolitin e internojnë në Sardenjë ku gjeti vdekjen. Kisha e perëndimit e kremton më 13 gusht. Në vitin 236 lipsanet e Hipolitit u sollën në Romë.

Shkrimet: Hipoliti ka qenë poligraf. Shkrimet i shkroi greqisht dhe pjesa më e madhe e tyre kanë humbur. Hipoliti na informon rreth problemeve që përballonte Kisha e Romës. Gjithashtu në shkrimet e tij gjendet teksti më i vjetër i lutjes eukaristike, si dhe për misterin e pagëzimit dhe atë të mirosjes.

Pagëzimi dhe Mirosja në Traditën Apostolike të Hipolitit

Dhe kur ai që do të pagëzohet zhytet në ujë, ai që e pagëzon vë dorën mbi atë duke thënë kështu: A beson në Perëndinë Atin e Tërëfuqishëm? Ai që po pagëzohet do të thotë: Besoj. Le ta pagëzojë ai menjëherë, një herë, duke i vënë dorën mbi kokën e tij. Dhe mbas kësaj le të thotë: A beson në Jesu Krishtin, Birin e Perëndisë, Që lindi nga Shpirti i Shenjtë dhe Virgjëresha Mari, Që u kryqëzua në kohën e Pontit Pilat, Dhe vdiq dhe u varros, Dhe u ngrit i gjallë prej së vdekurish ditën e tretë, Dhe u ngjiti në qiell, Dhe rri në të djathtë të Atit, Dhe do të vijë të gjykojë të gjallët dhe të vdekurit? Dhe kur ai thotë: Besoj, le ta pagëzojë herën e dytë. Dhe përsëri le t'i thotë: A beson në Shpirtin e Shenjtë, në Kishën e

Shenjtë dhe në ngjalljen e trupit? Dhe ai që po pagëzohet do të thotë: Besoj. Dhe le ta pagëzojë për herën e tretë. Pastaj, kur ai del nga uji, ai do të lyhet nga presbiteri me Vajin e falënderimit duke thënë: Të lyej me vajin e shenjtë në Emrin e Jesu Krishtit. Dhe kështu duke u fshirë gjithsecili vetë me peshqir, ata vishen dhe mbas kësaj çohen të gjithë në bashkësinë (Kishë). Dhe peshkopi do të vërë dorën e tij mbi ata duke u lutur dhe duke thënë: O Zot Perëndi, që i vlerësove shërbëtorët e tu të denjë për të merituar ndjesën e mëkateve me anë të larjes së rilindjes, bëji ata të denjë të mbushen me Shpirtin Tënd të Shenjtë dhe dërgo mbi ata hirin Tënd, që ata të mund të të shërbejnë ty sipas vullnetit Tënd; sepse Ty të përket lavdia, Atit e Birit dhe Shpirtit të Shenjtë në Kishën e Shenjtë, tani e përherë e në jëtën pa mbarim. Amin. Mbas kësaj, duke derdhur vajin e shenjtëruar prej dorës së tij dhe duke e vënë dorën e tij mbi kokën e atij, ai do të thotë: Të lyej ty me vajin e shenjtë në Perëndinë Atin e Tërëfuqishëm dhe Jesu Krishtin dhe Shpirtin e Shenjtë. Dhe duke e vulosur atë në ballë, ai do t' i japë atij puthjen e paqes dhe do të thotë: Zoti qoftë me ty. Dhe ai që sapo është vulosur do të thotë: Dhe në shpirtin tënd. Dhe kështu do të bëjë me gjithsecilin më vete. Pastaj ata do të luten së bashku me të gjithë popullin. Por ata nuk do të luten më parë me besnikët para se të kenë kaluar në këto gjëra. Dhe mbas lutjeve, le të japin puthjen e paqes.

Falenderimi në Traditën Apostolike të Hipolitit

Zoti qoftë me ty. Dhe me shpirtin tënd. Ngrini lart zemrat. I kemi te Zoti. Le ta falënderojmë Zotin. I ka hije dhe është e drejtë. Të falënderojmë ty Perëndi nëpërmjet shërbëtorit Tënd të

dashur Jesu Krisht, të cilin Ti e ke dërguar kohët e fundit që të jetë Shpëtimtari dhe Çliruesi ynë dhe lajmëtari i këshillës Tënde, Fjala (Logos) që doli prej Teje, me anën e të cilit i ke krijuar të gjitha gjërat, të cilin Ti pëlqeve ta dërgosh prej qiellit në gjirin e Virgjëreshës, dhe në trupin e saj Ai u mishërua dhe u shfaq të ishte Biri Yt i lindur prej Shpirtit të Shenjtë dhe Virgjëreshës. Për të përmbushur vullnetin Tënd dhe për të bërë gati për Ty një popull të shenjtë, Ai shtriu duart e Tij kur Ai pësoi që Ai të mund të çlironte nga vuajtjet ata që kishin arritur besimin në Ty. Dhe kur Ai e dha Vetën në pësimin vetëdashës, që të shkatërronte vdekjen, dhe të thyente prangat e djallit, dhe të shkelte Hadhin, dhe të ndriçonte të drejtët, dhe të ndërtonte gur kufiri, dhe të zbulonte Ngjalljen, Ai mori bukën, falënderoi dhe tha: “Merrni hani, ky është trupi im që thyhet për ju.” Në të njëjtën mënyrë mori potirin dhe tha: “Ky është gjaku im që derdhet për ju. Sa herë që ta bëni këtë mbani kujtimin tim.” Kur ne kujtojmë vdekjen dhe ngjalljen e Tij në këtë mënyrë, ne sjellim tek ty bukën dhe potirin, dhe të falënderojmë Ty, sepse Ti na ke vlerësuar të qëndrojmë para Teje dhe të shërbejmë ty si priftërinj. Dhe të lutemi që të dërgosh Shpirtin Tënd të Shenjtë në blatin e Kishës. Bashkoi ato dhe jepu të gjithë shenjtorëve që të marrin pjesë në blatin, që ata të mund të mbushen me Shpirtin e Shenjtë, që të fuqizohen në besim dhe në të vërtetë, që të mund të të lavdërojnë Ty me zë të lartë me anë të shërbëtorit Tënd, Jesu Krishtin, nëpërmjet të cilit Ty të dërgojmë lavdi e nder në kishën Tënde të shenjtë, tani e përherë. Amin. *(Protopresviter Thomas Hopko, Besimi Orthodhoks, vëllimi III, Shkrimi i Shenjtë dhe Historia e Kishës, përkthyer nga Imzot Joan Pelushi, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2000, faqe 185-189).*

QIPRIANI (210-258)

Qipriani (Thascius Caecilius Cyprianus) ka lindur rreth viteve 210 në një familje të pasur të Kalqedonisë. Pasi kreu studimet ka ushtruar profesionin e oratorit. Në vitin 246 u konvertua në krishterim. Pasi asketoi disa vjet, më 249 u hirotonis episkop i Kalqedonisë. Gjatë përndjekjeve të perandorit Ualianos, në vitin 257 Qiprianin e internojnë. Ndërsa më 258 u dënua me prerje koke. Kisha e shpalli shenjt dhe kujtimin e tij e kremtojmë më dy tetor.

Shkrimet: 1) *Ad Donatium*, e cila u shkrua në vitin 246 dhe i drejtohet mikut të tij Donatit. 2) *De habitu virginum*, u shkrua në vitin 249 dhe flet për veshjet e stolitë e virgjërshave. 3) *De Lapsis*, u shkrua më 251 etj.

Njëshmëria e Kishës Katolike Nga Qipriani

1. "Ju jeni kripa e tokës". Këto fjalë të Zotit mbartin në vetvete një paralajmërim. Përderisa ai na porositi të jemi të thjeshtë dhe të çiltër, madje të mençur në thjeshtësinë tonë, a nuk është, pra, e drejtë, vëllezërit e mi të dashur, që ne duhet të tregojmë largpamësi për të zbuluar kurthet e armikut të egër dhe për të marrë masa ndaj tyre nëpërmjet mendimit tonë të shqetësuar dhe kujdesit vigjilent? Ne që kemi veshur Krishtin dhe urtësinë e Perëndisë Atë, nuk duhet të na mungojë mençuria për të mbrojtur shpëtimin tonë. Nuk është vetëm persekutimi prej të cilit ne duhet të kemi frikë, apo sulmet, të cilat zhvillohen hapur për të përmbysur dhe për të rrëzuar shërbëtorët e Perëndisë. Parandalimi nuk është i vështirë

kur rreziku është i dukshëm. Kur kundërshtari e shfaq vetveten, mendja jonë është e përgatitur për ndeshjen. Më tepër duhet të kemi frikë, më tepër duhet të kemi kujdes prej një armiku i cili zvarritet rreth nesh në një mënyrë të fshehtë, na mashtron me një shenjë paqeje dhe e fsheh afrimin e tij nëpërmjet dredhive gjarpëruese, besnik i emrit të tij prej gjarpëri. Dinakëria e këtij lloji, e mashtruesit të errët të pritave, ka qenë gjithmonë kjo mënyra e tij e përhershme për të na shtënë në grackë. Me anën e kësaj mënyre ai na ka mashtruar dhe na ka gënjyer që prej fillimit të botës, gënjeshtat e tij lajkatuan shpirtin e papërvojë në besueshmërinë e tij të paarsyeshme. Me këtë mënyrë ai u përpoq të tundonte vetë Zotin, duke iu afruar fshehurazi me qëllim që të vidhte përsëri prej tij dhe ta mashtronte. Por ai u kuptua dhe u mund, sepse u njoh dhe iu gris maska.

2. Kështu, ne jemi mësuar prej shembullit t' i largohemi njeriut të vjetër dhe të ecim në gjurmët e fitimtarit Krisht në mënyrë që të mos biem përsëri në kurthin e vdekjes nëpërmjet pakujdesshmërisë sonë, por përkundrazi, të qëndrojmë zgjuar kundrejt rrezikut dhe të zotërojmë pavdekësinë që kemi marrë. Por si mund të zotërojmë pavdekësinë përderisa nuk zbatojmë porositë e Krishtit, me anë të të cilave vdekja është mposhtur dhe është mundur? Ai na paralajmëron duke thënë: “Në qoftë se ti do të hysh në jetë, ruaj porositë” dhe përsëri: “Nëse bëni gjërat që unë ju urdhëroj, unë nuk ju quaj më shërbëtorë, por miq”.

Vini re se cilin njeri ai e quan të fuqishëm dhe të palëkundshëm, të mbështetur në mënyrë të sigurt mbi shkëmb, të ngritur mbi një qëndrueshmëri të palëkundshme dhe të patundshme ndaj çdo stuhie dhe rrebeshi të botës. Krishti thotë: “Prandaj, ai që i dëgjon këto fjalë të mia dhe i vë në praktikë, mund të krahasohet

prej meje me një njeri të zgjuar, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb. Ra shiu, erdhi përmytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi; por ajo nuk u shemb, sepse ishte themeluar mbi shkëmb”.

Është detyra jonë t’u qëndrojmë besnikë fjalëve të tij dhe të zbatojmë të gjitha ato që ai vetë mësoi dhe bëri. Si ka mundësi që njeriu të ushtrojë besimin më Krisht, pa zbatuar çfarë Krishti porositi? Si mund të fitojë shpërblimin e besimit pa e ruajtur këtë besim nëpërmjet porosive? Ai nuk mundet, por përkundrazi, do të lëkundet dhe do të sillet vërdallë, i grabitur nga shpirti i gabimit dhe i rrotulluar përreth si pluhuri i shpërndarë nga era. Ai që e braktis rrugën e vërtetë të shpëtimit, nuk do ta gjejë më kurrë atë.

3. Ne duhet të ruhem ndaj mashtrimeve të fshehta e dinake, jo më pak se ndaj rrezikut të dukshëm. Dhe a ekziston ndonjë gjë më dinake dhe mashtruese që të jetë trilluar më mirë sesa kjo? Me ardhjen e Krishtit, armiku është zbuluar dhe mposhtur, dritë shkëlqeu në kombe, dielli i shpëtimit ndriçoi për të shpëtuar qenien njerëzore dhe kështu të shurdhët morën dëgjimin e hirit shpirtëror, të verbërit hapën sytë drejt Zotit, të dobëtit morën fuqi në shëndetin e përjetshëm, të çalët vrapuan në Kishë, memecët u lutën me zë të lartë. Veçse kur armiku pa idhujt e braktisur dhe tempujt e tij të lënë shkretë nga shumica e besimtarëve, atëherë ai mendoi një mashtrim të ri: të gënjente jovigjilentët duke u fshehur nën emrin kristian. Ai shpiku herezi dhe skizma, me qëllim që të minonte besimin, të shtrembëronte të vërtetën dhe të thyente njëshmërinë. Duke mos qenë në gjendje për të na mbajtur në rrugët e errëta të mëkatit të qëmotshëm, ai na tërhoqi në një labirinth të ri të mashtrimit. Ai i largoi njerëzit nga vetë Kisha, pikërisht në çastin kur ata mendonin se tashmë i ishin afruar dritës dhe i ishin larguar

natës së botës dhe befas i zhyti në një errësirë të re. Megjithëse ata nuk mbështeten te Ungjilli, te disiplina dhe te ligji i Krishtit, ata e quajnë veten të krishterë. Megjithëse ecin në errësirë, ata mendojnë se janë në dritë dhe kjo si rezultat i lajkave mashtruese të kundërshtarit, i cili, siç thotë apostulli: “Shndërrohet në një engjëll drite dhe i shndërron punëtorët e tij në punëtorë të drejtësisë” të cilët e quajnë natën ditë, vdekjen shpëtim, dëshpërimin shpresë, pabesinë besim, antikrishtin Krisht, duke qenë të shkathët për të prishur të vërtetën nëpërmjet një imazhi të gabuar të saj. Ja, pra, çfarë ndodh vëllezër, kur ne nuk kthehemi te burimi i së vërtetës, kur nuk shohim përpara dhe kur nuk ruajmë doktrinën e mësuar prej qiellit.

4. Për shkak të marrjes në konsideratë të këtyre çështjeve, diskutimi bëhet i gjatë dhe debati i panevojshëm. Besimi gjen prova të gatshme kur e vërteta është bërë e ditur në mënyrë të dukshme. Zoti i thotë Pjetrit: “Unë po të them gjithashtu se ti je Pjetër, shkëmb dhe mbi këtë shkëmb unë do të ndërtoj Kishën time dhe dyert e ferrit nuk do ta mundin atë; dhe unë do të të jap çelësat e mbretërisë së qiejve; gjithçka që do të lidhësh mbi tokë do të jetë lidhur në qiej dhe gjithçka që do të zgjidhësh në tokë, do të jetë zgjidhur në qiej”. [Ai e ndërton Kishën mbi një njeri. Me të vërtetë, pas ngjalljes, ai caktoi fuqi të njëjta për të gjithë apostujt, duke thënë: “Sikurse më ka dërguar mua Ati, ashtu unë po ju dërgoj juve. Merrni Frymën e Shenjtë! Kujt do t’ia falni mëkatet, do t’i jenë falur, kujt do t’ia mbani, do t’i jenë mbajtur”. Pavarësisht nga kjo, me qëllim që ta bëjë njëshmërinë të dukshme, ai e përshtat nëpërmjet autoritetit të tij në mënyrë që njëshmëria ta ketë fillimin nga një person. Sigurisht, apostujt e tjerë ishin krejtësisht si Pjetri; ata ishin të pajisur me një ndarje të barabartë të detyrës dhe pushtetit. Veçse njëshmëria ka

ekzistuar që në fillim, përpara çdo zhvillimi, për të treguar se Kisha e Krishtit është një. Kjo Kishë e vetme është parashikuar gjithashtu te Kantiku i Kantikëve, kur Shpirti i Shenjtë thotë në personin e Zotit: “Pëllumbesha ime, e përkryera ime është e vetme; nëna e ka të vetme, e përzgjedhura e saj që e ka pjellë”. A mundet dikush, i cili nuk ruan njëshmërinë e Kishës, të besojë se ruan besën? A mundet dikush, i cili kundërshton dhe lufton Kishën, të jetë i sigurt se është anëtar i Kishës? Apostulli i Shenjtë Pal jep të njëjtin mësim dhe deklaron të njëjtin mister për njëshmërinë, kur thotë: “Është një trup dhe një Frymë, sikurse ju u thirrët në një shpresë të thirrjes suaj. Një Zot, një besim, një pagëzim, një Perëndi”

KREU I DYTË

LULËZIMI I LITERATURËS PATERISTIKE

(325 – 451)

THEMELUESIT E MONAKIZMIT

Jeta monakale në një formë të përcaktuar, u shfaq së pari në Egjipt në fillim të shekullit IV dhe shumë shpejt u përhap në jetën e gjithë krishterëve se Mbretëria e Perëndisë nuk i përket kësaj bote. Monakizmi mori tri forma kryesore, të cilat u shfaqën në Egjipt. Në fillim pati heremitë, që bënë një jetë të izoluar në kolibe ose në shpella madje edhe nëpër varre, mbi degë pemësh ose mbi majën e një shtylle. Prototipi i murgut heremit ka qenë Shën Andoni (251–356), i cili konsiderohet si ati i monakizmit. Më vonë monakizmi, u shfaq në formën e komuniteteve, ku murgjit bënë një jetë kolektive në manastir, mbi bazën e disa rregullave të përgjithshme. Prarendësi i kësaj forme të monakizmit ka qenë Shën Pahomi (286–346), i cili përcaktoi rregullat e para të jetës monakale. Shkrimet asketike të Vasilit të Madh patën një ndikim

të madh mbi monakizmin lindor. Shën Vasili nxiste institucionet fetare të punonin për interesin e përgjithshëm, të merreshin me të varfërit dhe të sëmurët, të organizonin spitale, jetimore etj. Në shekullin V lëvizja monakale u zhvendos në Palestinë, me Shën Efthimin e Madh (377-473).

Detyra e parë e një murgu ortodoks është të luturit dhe pikërisht duke u lutur, ai shpreson t' u shërbejë të tjerëve. Murgu tërhiqet në vetminë e shkretëtirës që të mësojë të vërtetën rreth Perëndisë. Pas një përgatitjeje të gjatë në vetmi, pasi ka fituar dhuntinë e gjykimit të mençur të një igumeni, mund të hapi portën e qelisë së tij dhe të pranojë gjithë njerëzit prej të cilëve qe larguar.

Monakizmi perëndimor i ka fillimet rreth shekullit V, me manastiret e Lerënit dhe të Sen Viktorit të Marsejës. Shën Benedikti rreth vitit 525 përcaktoi rregullat e murgjve perëndimorë. Objekti kryesor i fretërve perëndimorë ishte shërbimi i Zotit (Opus Dei) nëpërmjet lutjes dhe ceremonive liturgjikale. Fretërit janë ushtarë të Zotit, nën autoritetin e kryemurgut.

Një figurë tipike e monakizmit ortodoks është Igumeni, cilësitë e veçanta spirituale të të cilit, forca e logjikës dhe e gjykimit si edhe mënçuria që e karakterizon, bëjnë që atë ta pranojnë të gjithë murgjit e tjerë si udhëheqësin e tyre. Igumeni është ati shpirtëror i manastirit dhe ka detyrën e drejtimit nga ana shpirtërore dhe ekonomike. Igumeni zgjidhet nga radhët e murgjve të vjetër. Kjo përzgjedhje bëhet ndërmjet tri kandidaturave të paraqitura. Igumeni i parë dhe më i famshëm ka qenë Shën Andoni. Ai e kaloi pjesën e parë të jetës së tij, asket në shkretëtirë. Më pas e braktisi këtë lloj jete prej heremiti dhe filloi të pranojë vizitorë.

ANDONI I MADH (251-356)

Andoni i Madh ka lindur rreth vitit 251 pas Krishtit. Origjinën e kishte prej familjeje të pasur nga fshati Koma i Egjiptit të sipërm. Në moshën 18-vjeçare Andoni i humbi të dy prindërit e tij. Nga kjo u hidhërua, por gjeti ngushëllim te mësimit e Kishës. Ai e mblodhi shpejt veten duke iu përkushtuar Perëndisë dhe kujdesit për motrën e vogël. Një të diel dëgjoi në Kishë Ungjillin, në të cilin Krishti, duke iu drejtuar një të riu pasanik, i tha se po të dëshironte të bëhej i përsosur, duhej të shiste pasurinë dhe të hollat t'ua ndante të varfërve e t'i shkonte pas. Ai menjëherë e vuri në zbatim thirrjen hyjnore. Shën Andoni zgjodhi një vend në shkretëtirë midis Menfit dhe Arsionit. Nuk kish bërë asnjë lloj arsimi, sepse në fshatin e tij s'ka pasur shkollë. Andonit i pëlqente veçanërisht të lexonte Shkrimin e Shenjtë duke mësuar përmendësh kapituj të tërë. Pjesën më të madhe të natës ia kushtonte lutjes, mendimeve dhe gjykimeve hyjnore ose vështrimit dhe dëgjimit të natyrës, e cila me lulet e saj, me yjet, me shpendët dhe kafshët, me freskinë dhe gjëhimet, lajmëron mirësinë e Krijuesit. Ai shtrihej mbi një shtresë të thjeshtë e të ashpër, duke pasur parasysh se një murg dhe heremit, që të jetë i zoti i plotë i vetvetes duhet që përveç ushtrimeve shpirtërore, të bëjë edhe një jetë trupore të vështirë.

Në moshën 35-vjeçare, Andoni gëzonte emër të madh për shprestarinë dhe virtytin e tij. Të gjithë donin ta takonin, të shprehnin respektin dhe dashurinë për të. Në këtë kohë, për të evituar këto manifestime, shkoi të banonte më thellë në shkretëtirë. Njerëzit për ta takuar e për t'i marë bekimin, udhëtonin me ditë të tëra. Rreth vitit 305 pas Krishtit nisi të ngrinte qendra banimi të quajtura

hisihastire (vende pushimi) për ata që i vinin pas dhe dëshironin të bënin një jetë si të tijën.

Shën Vasili kur vendosi të heqë dorë nga profesioni i oratorit mendoi të vizitonte Egjiptin; po kështu edhe Athanasi i Madh, i cili pati një lidhje të përzemërt dhe miqësi me Andonin e Madh në shkretëtirë. Shën Andoni nuk qëndronte gjithnjë nëpër hapësirat e shkretëtirave. Fama e tij arriti gjer në vesh të perandorit Konstandini i Madh, i cili i ka shkruar letra, duke i kërkuar bekimet dhe uratat. Andoni i Madh vdiq në vitin 356, kur ishte në moshën 105 vjeçare. Shën Andoni përkujtohet më 17 Janar.

PAHOMI (290-346)

Shën Pahomi ka lindur në vitin 290 në Thivahiva të Egjiptit nga prindër paganë. Në moshën 20-vjeçare u fut në radhët e ushtrisë. Qenë vitet e mbretërimit të Kostandinit të Madh, i cili për të luftuar tiranët kishte nevojë për ushtarë. Ushtarët e rinj ishin nën mbikqyrje të rreptë, me qëllim që të mos arratiseshin. Gjatë natës, disa të krishterë, shkonin në vendin ku ruheshin ushtarët e huaj dhe u jepnin ushqime. Pahomi, pasi mësoi që këta bamirës ishin të krishterë, i pyeti se pse ishin kaq të prirur për t'u bërë lëmosha. Pasi u njoh me besimin e tyre, Pahomi filloi t'i lutej Perëndisë, të cilin akoma nuk e njihnte. "O Zot, dua të bëhem shërbëtori yt dhe të zbatoj urdhërimet e tua deri në fund të jetës". Perëndia e dëgjoi lutjen e tij. Pas fitores së Kostandinit të Madh ushtarët u liruan.

Pahomi shkoi në Kinovoskia, ku gjendej një kishë e krishterë dhe u pagëzua. Më pas u njoh me asketin Palamon, të cilit iu lut ta bënte murg. Kur shenjtji ishte duke u lutur në një vend të shkretë, të quajtur Tavenë, dëgjoi zërin e Perëndisë, që i thoshte

të ndërtonte një manastir aty, pasi të shumtë do të ishin ata që do të shpëtonin nëpërmjet tij. Për këtë e ndihmoi dhe Palamoni, i cili pas pak kohe vdiq. (*Atë Justini, Pahomi i Madh, Ngjallja, maj 2002, faqe 9*).

Shumë të rinj vinin te Pahomi për t'u bërë murgjër. Sipas udhëzimeve që engjëlli i Zotit i jepte Pahomit, ata që vinin për t'u bërë murgjër kalonin një periudhë prove trevjeçare, duke mësuar të përbuznin lavdinë e botës, pasurinë, dëshirat trupore etj. Në vijim ata merrnin sqimën e shenjtë. Vite më vonë, shenjti ndërtoi edhe manastire të tjera, ku numri i përgjithshëm i murgjive arrinte në 7000. Gjithashtu Pahomi ndërtoi edhe një manastir për gra, ku igumene u bë motra e tij. Pahomi nuk pushonte së punuari për shpëtimin e shpirtit të tij duke u bërë shembull virtyti. Ndonëse i sëmurë rëndë nga një epidemi, shenjti nuk pranonte të rrinte në shtrat nga frika se mos mëkatonte në momentet e fundit. Ai fjeti më 15 maj të vitit 346, pasi i bekoi dhe i këshilloi murgjit, që të ruajnë deri në fund të jetës porositë e Perëndisë.

ISIDOR PILUSIOTI (360-440)

Isidor Pilusioti ishte nga Egjipti dhe lindi rreth vitit 360. Shquhej për formimin e tij teologjik dhe kishte studiuar në mënyrë të shkëlqyer filozofinë greke. Fillimisht punoi si mësues dhe predikues në kishën e Aleksandrisë. Dashuria e tij për Perëndinë ishte kaq e madhe sa që ai braktisi pasurinë dhe famën që kishte dhe u bë murg në manastirin pranë Pilusios, prej dhe nga u quajt Isidor Pilusioti. Më pas u hirotonis prift dhe u bë igumen në manastirin e tij. Perëndia duke vlerësuar devotshmërinë e tij e

denjësoi shenjtin që të japë shpjegim dhe të komentojë pjesë të vështira të shkrimeve. Shën Isidor Pilusioti ishte me të vërtetë një model i vetëpërbajtjes asketike si dhe i guximit ndaj prijësve qoftë kishtarë, qoftë politikë sa herë që bëhej fjalë për devijime nga ortodoksia ose për gjëra të paligjshme. Ndërroi jetë në paqe në moshë të thyer rreth vitit 440.

Shkrimet: Ruhen akoma rreth 2012 letra të tij që dëshmojnë për dituritë dhe aftësitë e shenjtit. Këto letra përmbajnë këshilla dhe komente rreth temave dogmatike.

EFTIMI I MADH (377-473)

Eftimi i Madh ka lindur në vitin 377 në Melitini të Armenisë. Prindërit e tij Pali dhe Vjonisia qenë besimtarë. Kur Eftimi ishte në moshën 3-vjeçare i vdiq i ati. E ëma e rriti me mundime. Episkop Eftroi, duke vlerësuar dhuntinë e Eftimit, e përkrahte. Pasi mbaroi me sukses studimet u hirotonis dhjak. Pak kohë më vonë u hirotonis prift dhe u mendua si më i përshtatshmi për të drejtuar manastirin e Melitinisë. Në vitin 406 shkoi në Jerusalem, ku u shqua për virtytet morale e shpirtërore. Pranë qelisë së tij u përqëndruan shumë murgjër të zellshëm, të cilët e zgjodhën Eftimin igumen të tyre.

Këtë detyrë, Eftimi e kreu me përkushtimin më të madh. Nëpërmjet punës së tij misionare për ndriçimin e arabëve, mjaft prej tyre përqaftuan besimin e krishterë. Gjithashtu kontribuoi në kthimin e mjaft heretikëve në gjirin e otodoksisë. Fjalët e tij qenë aq bindëse, sa edhe mbretëresha Evdhoksia, e cila kishte rënë në rrjetën e herezisë së monofizitëve, duke parë diturinë dhe vitytin e Eftimit u rikthye në dogmën ortodokse. Në vitin 473 ai dorëzoi

shpirtin te Perëndia. Aktivitetin dhe kontributin e tij kisha e vlerësoi duke i dhënë titullin “I Madh”.

ETËRIT E MËDHENJ DHE MËSUESIT EKUMENIKË

Me termin Etër quheshin edhe episkopët, meqenëse predikuan dhe mësuan popullin. Disa prej tyre u quajtën “Etër të mëdhenj” ose “Mësues Ekumenikë” në shenjë të ofertës së madhe. Këta janë Athanasi i Madh, Vasili i Madh, Grigor Teologu, Joan Gojarti për Lindjen dhe Leoni i Madh, Ambrozi, Jeronimi e Agustini për Perëndimin. Etërit shqueshin nga kultura dhe arsimi i tyre, por edhe nga dhuntitë dhe hilet. Disa Etër dalloheshin për ngritjen e tyre teologjike, të tjerët për shenjtëri dhe mrekullibërje dhe disa për plagët e martirizimit. Etërit u kanë ofruar besimtarëve mësimdhënien ortodokse, tema të adhurimit të Perëndisë, të jetës shpirtërore etj. Disa prej tyre quhen Hierarkë sepse ishin episkopë. Etërit e Kishës kundërshtuan herezitë, duke ruajtur anëtarët e Kishës nga mashtrimi. Ata komentuan drejt jetën e Krishterë duke e udhëhequr grigjën jo vetëm me anën e shkrimeve, por edhe me shembullin personal.

ATHANASI I MADH (295-373)

Athanasi i Madh ka lindur në vitin 295 prej prindërisht të pasur nga Aleksandria. Ai u dorëzua dhjak në vitin 318. Në Sinodin e Parë Ekumenik të Nikesë të vitit 325, Athanasi shoqëronte Patrikun e Aleksandrisë Aleksandrin, ku u shqua për mendime të pjekura në luftën kundër arianizmit. Ndonëse i ri në moshë Athanasi në diskutimet e tij tregoi kulturë të lartë teologjike dhe qëndrueshmëri në besimin ortodoks. Më 28 prill të vitit 328 fjeti Aleksandri i Aleksandrisë dhe vendin e tij e zuri Athanasi.

Skizmatikët meletianë vazhduan një luftë të ashpër shpifjesh kundër Athanasit, duke e akuzuar se kishte thyer potirin e shenjtë, me të cilin prifti Iskiras kryente Liturgjinë Hyjnore, se kishte paguar tradhëtarin Filumeno etj. Atëherë Kostandini në vigjilje të Pashkës të vitit 332, e thirri Athanasin në Kostandinopojë për të dëshmuar. Perandori i shprehu simpati dhe besim Athanasit. Kështu Athanasi u kthye i pafajshëm në Aleksandri. Në fillimet e vitit 334 filluan sërish shpifjet e meletianëve kundër Athanasit, duke e akuzuar sikur kishte vrarë episkopin skizmatik Arsenin, por ky i fundit u gjet i gjallë, pasi qe fshehur në një manastir. Nga 46 vjetët që ka qenë episkop, Athanasi 16 vjet i kaloi në internim. Athanasi fjeti në vitin 373. Kisha e ka shpallur shenjt dhe kujtimin e tij e kremtojmë më 18 janar dhe 2 maj.

Shkrimet: a) Apologjetike. 1) *Fjala ndaj grekëve*, e cila u shkrua në vitin 318. 2) *Tri fjalime kundër arianistëve*, të cilat i shkroi më 358, gjatë internimit të tretë të tij në shkretëtirë (356-362). b) Asketike. *Jeta e Oshënarit Andon*, që u shkrua në vitin 357.

Andoni i Madh **Nga Athanasi i Madh**

Filozofët përballë të diturit

Andoni ishte një njeri i urtë. Edhe pse nuk kishte mësuar në shkolla, ishte një njeri i ditur dhe i zgjuar. Njëherë dy vizitorë, të cilët ishin filozofë, erdhën në mal për ta takuar dhe donin që ta ngacmonin. Ai ndodhej në atë moment larg shtëpisë së tij, sipër në mal. Ai i lexoi përbrenda ata të dy dhe u tha me anën e një përkthyesi: - Përse u lodhët kaq shumë, o filozofë, të vini këtu dhe të shihni një njeri të pamend? Ata u përgjigjën se nuk ishte aspak i pamend, por ishte shumë i zgjuar dhe i ditur. - Në qoftë se erdhët për të parë një të pamend, mundi që ju bëtë është i kotë. Por, në qoftë se besoni se jam i ditur, duhet pra të bëheni si unë, sepse duhet të imitoni gjithmonë të mirën.

Nëse unë do të vija te ju, sigurisht që do të bëhesha i ngjashëm me ju. Por përderisa ju erdhët tek unë, më imitoni, sepse jam i krishterë. Filozofët u larguan shumë të habitur kur panë se edhe demonët e kishin frikë Andonin. Njëherë tjetër erdhën përsëri disa filozofë në të njëjtin vend, vetëm sa për t'u tallur me atë, për faktin se nuk kishte shkollë, dhe ai i pyeti: - Me të vërtetë çfarë thoni? Cila prej të dyjave ka ekzistuar më parë mendja apo shkrimi? Mendja është shkaku i shkronjave apo shkronjat janë shkaku i mendjes? Kur ata i thanë se mendja ekziston përpara të tjerave dhe se është ajo që gjen shkronjat, Andoni u përgjigj: - Njeriu që ka mendje të fortë nuk ka nevojë për shumë. Këto fjalë i çuditën shumë filozofët dhe ata që ndodheshin aty.

Ata u larguan duke ndjerë admirimin për atë burrë të thjeshtë, tek i cili shikonin aq shumë urtësi. Filozofët habiteshin, se Andoni nuk ishte kthyer në njeri të egër edhe pse jetonte nëpër male. Përkundrazi ai ishte shumë i hapur dhe shumë i dashur me të gjithë. Fjala e tij ishte plot urtësi. Asnjë nuk e urrente dhe të gjithë që vinin për ta parë, mbusheshin me gëzim. Njëherë erdhën disa veta, që i konsideronin idhujtarët si njerëz të ditur dhe e pyetën për Krishtin dhe për besimin në Atë.

Por ata filluan të nxirrnin argumente rreth predikimit të Kryqit të Nderuar, duke dashur të talleshin. Andoni, duke vajtuar për paditurinë e tyre, u tha me anën e një përkthyesi: - Çfarë gjëje është më e mirë të rrëfejë njeriu, Kryqin apo t'u ofrojë të ashtuquajturve perëndi që ju adhuron, kurvëria dhe zhvirgjërime fëmijësh? Sepse ajo që themi ne është provë burrërie dhe fisnikërie dhe një vetëdije se e kemi përbuzur vdekjen, ndërsa tuajat janë pasione kurvërie. Pastaj a ka gjë tjetër më të lartë se sa të pohosh se Fjala e Perëndisë nuk ndryshoi, por i njëjti person për shpëtimin e njerëzve mori trup njerëzor që të hyjnizojë njerëzit me trupëzimin e tij për njeriun?

Apo vallë mendoni se është urtësi ta krahasosh Perëndinë me kafshë dhe copa druri? Këto janë hyjnitë tuaja. Ju e ndani shpirtin prej qiellit dhe thoni se, meqë gjoja shpirti u mashtrua, ai ra nga harku qiellor brenda në një trup njerëzor. Por do të ishte mirë të binte vetëm në trupa njerëzorë dhe jo në katërkëmbështa dhe zvarranikë...

Besimi ynë thotë se Krishti u shfaq në tokë për shpëtimin e njerëzve. Kurse ju mashtroheni, sepse flisni për një shpirt të palindur. Ne besojmë në fuqinë dhe njeridashjen e Përkujdesjes Hyjnore, si rrjedhim kjo gjë nuk është e pamundur për Perëndinë. Ju, duke

thënë se shpirti është ikonë e mendjes, përsëri gaboheni dhe tregoni përralla kur thoni se gjoja shpirti ndryshon. Dilni në përfundimin se meqë ndryshon ai, të njëjtën gjë pëson edhe mendja.

Çfarë është ikona, i tillë duhet të jetë edhe ai të cilit i përket ikona. Kur besoni gjëra të tilla për mendjen, ta dini se blasfemoni Atin e mendjes. Për sa i përket kryqit, a keni ndonjë gjë më me vlerë për të treguar. Është më mirë që një njeri të durojë kryqin që i përgatitën njerëzit e pabesë apo të rrëfejë përralla të gënjeshtërtat për Osiridin dhe Isidën, për marifetet dinake të Tifonit dhe ikjen e Kronosit, për vëllavrasjen dhe atëvrasjet e panumërta. Flas kështu, sepse këto gjëra themelojnë diturinë tuaj. Por, si është e mundur që nuk admironi Ngjalljen përderisa talleni me kryqin.

Përse nuk flisni, përderisa zini në gojë kryqin, për të vdekurit që u ngjallën, për ulokët që ecën, për të verbrit që morën dritën e syve. Përse nuk flisni për lebrozët që u shëruan prej lebrës, për ecjen mbi det dhe për shenjat e tjera të cilat na tregojnë se Krishti nuk ishte vetëm njeri, por është edhe Perëndi. Më duket se ju duke mos lexuar me kujdes Shkrimet e Shenjta që ne kemi, i bëni një padrejtësi të madhe vetes suaj. Lexoni edhe shikoni se të gjitha ato që bëri Krishti janë prova të qarta se Ai është Perëndia që erdhi në botë për shpëtimin e njerëzve. Na flisni edhe ju për gjërat tuaja. Çarë do të na thoni për kafshët e palogjikshme dhe për egërsinë e tyre? Në qoftë se dëshironi të thoni se i tregoni këto gjëra si përralla dhe e shpjegoni krijimin e botës me rrëmbimin e Persefonit, zjarrin me invaliditetin e Efesit, ajrin me Herën, diellin me Apollonin, Hënën me Artemisën dhe detin me Poseidonin, nuk e nderoni aspak Perëndinë. Ju adhuron krijesën në vend të Krijuesit. Nëse me këto kuptoni bukurinë e natyrës, atëherë ju adhuron krijesat duke u dhënë atyre nderimin që i takon Perëndisë, Krijuesit.

Sepse ju nderimin që i përket arkitektit që ndërtoi shtëpinë ia jepni shtëpisë që ai ndërtoi. Apo është njëlloj sikur ushtarit t' i japësh nderimin e gjeneralit. A mund të gjeni argumente bindëse për të tallur predikimin e lartë të Kryqit dhe fuqinë e tij?

Ata kthyen kokën andej-këtej të çuditur jashtë mase. Andoni buzëqeshi dhe vazhdoi t' u thotë nëpërmjet përkthyesit: - Këto gjëra bëhen të njohura kur i sheh vetëm një herë. Por, meqë ju përdorni vetëm argumente provë dhe përdorni artin e arsytimit, dëshironi që edhe ne ta adhurojmë Perëndinë duke u mbështetur vetëm në logjikën e thatë. Prandaj më mirë të na flisni ju të parët. Më thoni si mundet një njeri ta njohë Perëndinë? Çfarë nevojitet, prova logjike apo energji besimi? Cili është më i vjetër brenda shpirtit të njeriut, besimi apo argumentet e logjikës? Kur ata u përgjigjën se më i vjetër ishte besimi dhe se brenda tij gjendet dija e vërtetë, Andoni tha: - Mirë e thatë, sepse besimi buron prej dëshirës dhe thellësisë së shpirtit, ndërsa dialektika vjen nga arsytimet teknike. Kështu provat dhe argumentet logjike janë të tepërta tek ata ku ekziston energjia e besimit. Atë që ne e mendojmë me ndihmën e besimit, ju përpiqeni ta lidhni me logjikën. Shumë herë nuk mundni dot ta shprehni atë që ne mendojmë. Kështu energjia e besimit është më e mirë dhe më e sigurt sesa arsytimet tuaja prej sofisti.

Ne të krishterët, misterin e jetës dhe të shpëtimit tonë e mbështesim jo në fjalë filozofësh, por në fuqinë e besimit që na fal Perëndia nëpërmjet Jesu Krishtit. Për t' ju vërtetuar këtë po ju tregoj një fakt më se të vërtetë: Ja ne nuk kemi mësuar në shkolla dhe nuk dimë të lexojmë, megjithatë besojmë në Perëndinë dhe në Përkujdesjen e Tij Hyjnore për gjithë krijesën. Besimi ynë është shumë aktiv. Shikoni!

Ne e mbështesim besimin tonë në Krishtin, kurse ju në arsyetimet e sofistëve. Fantazmave të idhujve tuaj u bie vlera çdo ditë, kurse besimi ynë po shtrihet kudo. Ju nuk mundeni të bindni njerëzit me anën e sofizmave tuaja që të kthehen prej Krishterimit në idhujtari. Ne, duke predikuar kudo besimin e krishterë, zbulojmë mashtrimin tuaj dhe njerëzit mësojnë të gjithë se Krishti është Perëndi dhe Biri i Perëndisë.

Ju me anën e retorikës suaj nuk mundeni ta pengoni besimin në Krishtin. Kurse ne me anën e besimit, mundim demonët që ju i nderoni si perëndi. Kudo ku bëhet shenja e Kryqit, arti juaj magjik nuk ka vlerë dhe ligësia djallëzore nuk gjen vend për të vepruar. Thoni, ku janë shortaret dhe faltoret tuaja? Ku kanë humbur këngët magjike të Egjiptit? Ku janë fantazmat e magjistarëve? Kur u zhdukën këto gjëra dhe sa kohë ka që nuk po gjenden. A nuk ka ndodhur kjo prej kohës që u shfaq Krishti në botë? Mos vallë duhet të përqeshim kryqin apo ato gjëra që u shkatërruan prej Atij? Sepse edhe kjo është një gjë e denjë për t' u lavdëruar. Idhujt tuaj nuk u përdoqën asnjëherë, megjithatë kishat tona lulëzojnë dhe shumohen më tepër sesa tuajat. Të gjitha festat dhe panairot që bëni ju po zbehen për nga rëndësia çdo ditë e më shumë. Kurse besimi në Krishtin dhe doktrina jonë edhe pse tallen prej jush dhe persekutohen shumë herë edhe prej mbretërve, u përhapën në të gjithë botën. Kur shkëlqeu dituria e vërtetë e Perëndisë? Kur është shfaqur më parë një shkallë kaq e lartë virtyti dhe urtësie? Apo kur është përbuzur më shumë se sa kur u ngrit Kryqi i Krishtit? Prandaj askush nuk ka dyshim për këtë gjë. Duke parë martirët, ne e përçmojmë vdekjen për hir të Krishtit, duke parë të virgjërit e Kishës sonë që ruajnë trupat e tyre të pastër dhe të panjollë për dashurinë e Krishtit, ne përbuzim kurvërinë. Këto gjëra besoj se

janë mjaft për të pohuar se besimi i krishterë është i vetmi i vërtetë, me të cilin një njeri mundet të adhurojë Perëndinë.

Megjithë këto ju nuk besoni, por doni që t'ua shfaqim besimin tonë me anën e arsytimit. Ashtu si na porositi mësuesi ynë “të lëçiturit tonë nuk u bë me fjalë diturie, njeriu që mbush mendjen” dhe ne e shfaqim të vërtetën duke i bindur njerëzit me besimin që tejkalon çdo lloj argumenti logjik. Ja tani kanë ardhur disa të demonizuar. Ata kishin ardhur për t'u shëruar nga Andoni, sepse mundoheshin prej demonëve. Andoni i vuri të rrinin në mes dhe u tha filozofëve: - Pastrojini ju me argumentet e logjikës suaj apo në çfarëdolloj arti ose magjie që doni, duke thirrur demonët në ndihmë. Në qoftë se nuk mundeni, pohoni se jeni mundur dhe do të shihni fuqinë e kryqit të Zotit. Sapo mbaroi së thëni këto fjalë, bëri shenjën e kryqit mbi të demonizuarit dy - tri herë.

Njerëzit u shëruan dhe lavdëruan Perëndinë me lot. Ata u çuan menjëherë të urtësuar dhe lavdëruan Perëndinë. Të ashtuquajturit filozofë mbetën jashtë mase të habitur para asaj mrekullie që panë me sytë e tyre. Atëherë Andoni u tha: - Përse habiteni? Nuk i bëjmë ne këto mrekulli, por është Krishti që i kryen, duke na përdorur ne si instrumente të tij. Besoni edhe ju dhe do ta shikoni se nuk ka art fjalësh te ne, por besim që shfaqet me dashuri. Në qoftë se keni edhe ju besim te Krishti, nuk do të keni nevojë më për argumente, por do të mendoni se mjafton vetëm besimi. Kështu foli Andoni dhe filozofët, duke ndjerë admirim për atë që u tha, ikën, pasi e puthën duke pohuar se kishin përfituar shumë prej tij. (*Athanas i Madh, Andoni i Madh, përktheu Teodor Bendo, botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë 2006, faqe 75-82*).

Tri letrat e Athanasit të Madh

1. Letra e parë deklaron se nuk ka asgjë të papastër në një qenie njerëzore që e ka krijuar Perëndia. Kështu, nuk ka asgjë të papastër në derdhjet e pavullnetshme nocturne (të spermës). Ai gjithashtu, deklaron që s'ka asgjë të gabuar në martesën, por ata që zgjedhin virgjërinë do të marrin 100 në vend të 30 shpërblimeve.

2. Përsa u përket atyre që iu bashkuan arianizmit dhe pastaj u kthyen dhe u penduan, klerikët që u bashkuan, që rrëfyen se kishin mbajtur besimet e arianizmit dhe që u bënë shkak që të tjerët të bashkoheshin, duhet të pranohen, por duhet të çirotonisen. Ata që u bashkuan me forcë u lejohet të mbeten klerikë. Laikët që u mashtruan ose u detyruan, duhet të pranohen pasi të pendohen. Gjithashtu, të gjithëve u kërkohet që të denoncojnë Euzoiusin dhe Eudoksiusin, mbrojtës së herezisë ariane, si dhe të rrëfejnë besoren.

3. Kjo letër jep një kanon për librat e Biblës. Numri total i librave të Dhiatës së Vjetër është 22: Zanafilla, Dalja, Levitiku, Numrat, Ligji i përtërirë, Jozuehu, Gjykatësit, Ruthi, 4 librat e Mbretërve, Kronikat, Esdra, Psalmet, Fjalët e urta, Kishtarët, Kënga e këngëve, Jobi, Profetët, 12 prej të cilëve numërohen si një libër, Isaia, Jeremia, Baruku, Vajtimet, Letra, Ezekili dhe Danieli. Librat e Dhiatës së Re janë: 4 Ungjijtë (Matheu, Marku, Lluka, Joani), Veprat e Apostujve, Jakovi-1, Petri-2, Joani-3, Juda, 14 letrat e Palit, Romakëve, Korintasve-2, Galatianëve, Efesianëve, Fulipianëve, Kolosianëve, Selanikasve-2, Hebrenjve, Timoteut-2, Titit, Filimonit dhe Zbulesa e Joanit. Gjithashtu ka edhe libra të tjerë që duhen përdorur për katekizëm dhe këto janë: Mençuria e Solomonit, mençuria e Sirakut, Esteri, Judita, Tobias, Didakia

(mësimet e Apostujve) dhe Bariu. (*The Rudder (Pedalion)*, përkthyer nga Aleksandra Koço, Luna Printing Co, Nju Jork 1983, page 34).

Mishërimi i Fjalës së Perëndisë Nga Athanasi i Madh

Në shkrimet e mëparshme kemi trajtuar në mënyrë të plotë disa nga pikat kryesore, që kanë të bëjnë me adhurimin e idhujve paganë dhe me mënyrën se si lindën fillimisht këto besime të rreme. Gjithashtu me anë të hirit të Perëndisë kemi treguar se vetë Fjala e Atit është Hyjni, se gjithçka ekziston falë vullnetit dhe fuqisë së Tij, se pikërisht nëpërmjet Fjalës Ati urdhëron krijesën, se gjithçka vihet në lëvizje nga Ai dhe se gjithçka buron nga Ai.

Tani, Makar, pasues i vërtetë i Krishtit le të vazhdojmë në besën e fesë sonë të shenjtë dhe të shohim edhe një herë se si Fjala u bë njeri dhe se si hyjërisht Ati u paraqit në mesin tonë. Këtë mister judenjtë e përflasin, grekët e përqeshin, kurse ne e adhurojmë. Dashuria dhe përkushtimi juaj për Fjalën do të rritet edhe më, pikërisht për faktin se në jobesimtarët, aq më tepër e bën të qartë Hyjninë e Tij. Gjërat që njerëzit i klasifikojnë si të pamundura, krejt qartësisht Ai i tregon si të mundura; atë që njerëzit e përqeshin dhe e quajnë të pahijshme, Mirësia e Tij e bën të hirshme, gjërat që njerëzit në urtësinë e tyre të gënjeshtërt, i quajnë thjesht njerëzore, Ai me fuqinë e tij i shpall hyjnore.

Kështu me anë të varfërisë dhe dobësisë në dukje, Ai përmbys pretendimet dhe paradën e idhujve, qetësisht dhe padukurisht fiton mbi tallësit dhe jobesimtarët duke u njohur si ZOT!

Për të trajtuar këto çështje, duhet së pari të rikujtojmë çfarë është thënë deri më tani. Duhet të kuptoni se përse Fjala e Atit, kaq e madhërishtme dhe e lartë, u shfaq në formë trupore. Ai nuk e mori formën trupore, sepse kjo ishte në natyrën e tij. Aspak! Përkundrazi, u shfaq në një trup njerëzor, për një arsye të vetme: për hir të dashurisë dhe mirësisë së Atit të Tij, për shpëtimin e tërë njerëzve.

Do të fillojmë kështu, me Krijimin e botës dhe me Perëndinë si Krijuesi i saj, sepse i pari fakt që duhet të kuptoni është se përtëritja e krijesës u krye nga e njëjta Fjalë që krijoi tërë krijesën, që nga fillimi. Kështu kemi vazhdimësi mes krijimit dhe shpëtimit, sepse i njëjti Atë ka vënë në punë të njëjtin Autoritet, për të dyja veprat dhe ndikon në shpëtimin e botës, nëpërmjet po asaj Fjale që e krijoi atë.

2

Përsa i përket krijimit të Gjithësisë dhe tërë krijesave të tjera, ka pasur mendime të ndryshme dhe gjithsekush ka nxjerrë teori sipas shijes së tij. Disa thonë se gjithçka vjen nga vetvetja, d.m.th. është e rastësishme. Të tillë janë Epikurianët, të cilët mohojnë ekzistencën e ndonjë Mendjeje përtej Gjithësisë. Por, kjo pikëpamje bie ndesh me tërë faktet e përvojës njerëzore, duke përfshirë edhe vetë qenien e tyre. Sepse nëse tërë gjërat janë krijuar në këtë mënyrë, d.m.th. automatikisht dhe jo si rrjedhojë e veprimtarisë së ndonjë Mendjeje, atëherë gjithë gjërat që ekzistojnë do të ishin njësoj dhe jo të ndryshme nga njëra-tjetra. Në Gjithësi çdo gjë do të ishte diell ose hënë ose diçka tjetër, në trupin njerëzor gjithçka do të ishte dorë ose sy ose këmbë. Por faktikisht dielli, hëna dhe

toka janë të tria të ndryshme, edhe trupi njerëzor përmban gjymtyrë të ndryshme si këmba, dora dhe koka. Ky dallim mes gjërave nuk flet për një krijim të rastësishëm, por për një Shkak të Parë dhe nga ky shkak ne kuptojmë Perëndinë, Krijuesin dhe Rregullatorin e gjithçkaje.

GRIGOR TEOLOGU (328-390)

Grigor Teologu ka lindur në vitin 328 në Arianzo të Kapadokisë. Prindërit e tij qenë Grigori dhe Nona. Mësimet e para i mori në Çezare, ku u njoh me Vasilin e Madh. Në vijim studioi në Aleksandri dhe vite më vonë e gjejmë në Athinë, ku studioi për retorikë, mjekësi dhe fizikë. Gjatë viteve të studimeve në Athinë (352-357) Grigori zuri miqësi të ngushtë me Vasilin e Madh. Pasi u kthye në vendlindje u pagëzua dhe jepte mësimet retorike. Në vitin 360 asketoi në Pont, ndërsa më 361 u dorëzua në gradën priftërore. Në vitin 372 Grigori u hirotonis Episkop i Sasimos, ndërsa më 380 u fronëzua Kryepiskop i Kostandinopojës. Në vitin 381, pas vdekjes së Meletit të Antiokisë, Grigori kryesoi punimet e Sinodit II Ekumenik. Shumë shpejt Grigori dha dorëheqjen, përshëndeti popullin e Kostandinopojës dhe vitet e fendit të jetës i kaloi në vendlindje. Grigori fjeti në vitin 390. Kisha e shpalli shenjt dhe kujtimin e tij e kremtojmë më 25 janar.

Shkrimet: 1) *Fjalimet*, përbëhen nga 45 predikime, të cilat u shkruan në vitet 379-381. Grigori ka qenë orator i shquar, prandaj fjalimet dhe predikimet zënë pjesën kryesore të trashëgimisë së tij letrare. Shumë prej *Fjalimeve* janë shkruar gjatë qëndrimit në Kostandinopojë. *Fjalimet* e Grigorit ndahen: a) Dogmatike. *Pesë Ligjërata Teologjike* të cilat bëjnë fjalë për hyjninë e Fjalës

(*Fjalimet 3 dhe 4*), doktrinën e Trinitetit (*Fjalimi 2*) dhe Mbi Shpirtin e Shenjtë (*Fjalimi 5*). *Pesë Ligjëratat Teologjike* janë shembujt më të shquar të gojtarisë së krishterë. Ato janë fjalimet më të rëndësishme të Grigorit, të cilat i dhanë titullin Teolog. b) *Festive*. Qenë fjalimet e Grigorit, të cilat janë mbajtur gjatë ditëve të festave. Ndër to mund të përmendim *Ditëlindja e Shpëtimtarit*. Kjo ligjëratë u shkrua rreth vitit 379 ose 380. Grigori gjithashtu ka shkruar për Pendikostinë, mbi Pashkët etj.

2. *Poezitë*, të cilat Grigori i shkroi nga fundi i jetës. Kanë shpëtuar 408 epose me rreth 18.000 vargje. Grigori ishte një mjeshër i stilit poetik. Autobiografia e tij në vargje *Mbi Jetën e Tij*, e cila përbëhej nga 1949 vargje na jep shumë të dhëna të rëndësishme rreth problemeve të kohës. Grigor Teologu ka qenë më letrari ndër etërit.

3. *Letrat* përbëhen nga 245 letra, si dhe fjalimi i përmortshëm para kufomës së të atit, në prani të Vasilit të Madh. Grigor Teologu predikoi për Trininë e Shenjtë dhe ndikoi mbi himnshkruesit e kohës. *Letrat* u mblodhën nga vetë Grigori, me kërkesën e nipit të tij, Nikobulit.

Mbi Birin Nga Grigor Teologu

1. Sa thamë më lart janë ata që do të mund të thonë ndonjëgjë që të ndalojë gadishmërinë dhe shpejtësinë që kanë kundërshtarët në të folur dhe të tregojnë se arroganca është e rrezikshme në të gjitha gjërat në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë kur ndonjë flet rreth Perëndisë. Madje qortimi nuk është gjë e rëndësishme, por shumë e lehtë dhe mund ta bëjë kush të dëshirojë,

ndërsa të paraqesë ndonjë mendim të tij kundër mashtrimit tregon besim të fortë dhe urtësi; prandaj edhe ne të inkurajuar nga shpirti i shenjtë, të cilin ata e përbuzin, ndërsa ne i falemi, le të shprehim cilat janë kuptimet tona mbi hyjninë, si një pasardhës i një prejardhjeje fisnike që vjen në orën e tij. Sigurisht atëherë në të shkuarën nuk heshtëm, sepse vetëm ne ekzistonim si të guximshëm dhe trima në këtë, po tani me më tepër liri predikojmë të vërtetën, që të mos gjykohe mi për frikën, në të cilën ashtu si thotë shkrimi, Perëndia nuk pushon. Ngaqë çdo ligjëratë ka dy pamje; në njërën folësi paraqet pikëpamjet e veta, ndërsa në tjetrën përmbys kundërshtarët, fillimisht do të paraqesim edhe ne mësimin tonë dhe pastaj do të përpiqemi të rrezojmë kundërshtimet e kundërshtarëve. Që të dyja pjesët do të jenë sa më shkurt të jetë e mundur, që ligjëratat të mbahet lehtë në kujtesë, ashtu si ligjëratat hyrëse për fillestarët, - që ata e shpikën për të shtypur të thjeshtët dhe tashmë të marrët, - dhe që të mos shpërndahen kuptimet për shkak të madhësisë së ligjëratës, pikërisht ashtu si shpërndahet dhe humbet uji në fushë kur nuk kufizohet brenda tubave.

2. Konceptet më kryesore mbi Perëndinë janë tre; anarkia, poliarkia, monarkia. Dy të parat i përdorën idhujtarët dhe le të vazhdojnë t' i përdorin. Sepse dhe anarkia është gjendje çrregullimi dhe poliarkia është gjendje rebelimi; pra anarki do të thotë çrregullsi. Që të dyja të çojnë në të njëjtin përfundim, domethënë në çrregullsinë, dhe krijojnë prishje, sepse çrregullsia është parapërgatitje e prishjes. Por ne nderojmë monarkinë, madje dhe monarkinë që nuk kufizohet në një person; sepse ndodh që edhe njëri të ngrihet kundër vetes së tij dhe të bëhet shumë; por monarkinë të cilën na e realizon barazia e natyrës, uniteti i mendimit, identifikimi i lëvizjes dhe marrëveshja me një person, gjë që nuk arrihet në natyrën e krijuar. Edhe pse ekziston ndryshim në numër, esenca

nuk ndahet. Prandaj ndërsa është i vetëm në esencën fillestare, vazhdoi në dhiadhë (domethënë 2) dhe qëndroi në triadhë. Kështu kemi Atin, Birin dhe Shpirtin e shenjtë. Ati është ai që lind dhe buron pa pësim, pa kohë dhe pa trup; Biri lind dhe shpirti buron, ose nuk e di si do të mundej ndonjë ta karakterizojë, pa përdorur fare diçka nga gjërat e dukshme. Një filozof grek në filozofinë e tij për shkakun e parë dhe të dytë, guxoi të thotë këto fjalë: “vërshon si krater”. Ne sigurisht nuk do të guxojmë të flasim për vërshim të mirësisë, që të mos futim lindjen e vullnetshme sikur të jetë një tepricë natyrore dhe e papërmbajtshme, gjë që nuk shkon aspak ta mendojmë për hyjninë. Prandaj mbetemi në termat tona dhe përdorim ‘i palindur’ dhe ‘i lindur’ dhe “buron prej Atit” ashtu si thotë diku vetë Perëndia dhe fjala.

3. Kur pra, ndodhën këto? Këto janë më tej kur-it. Dhe nëse duhet të themi diçka të guximshme, ato ndodhën kur ekzistonte dhe Ati.

Kur ekzistonte ati? - nuk ekzistonte kohë që të mos ekzistonte. E njëjta gjë dhe për Birin dhe Shpirtin e shenjtë. Pyetmë përsëri dhe përsëri do të të përgjigjem.

Kur ka lindur Biri? - kur Ati ishte i palindur.

Dhe kur ka buruar Shpirti? - kur Biri nuk kishte buruar por kishte lindur jashtë kohës dhe me mënyrë që nuk mund të shprehet; edhe pse nuk mund të përshkruajmë kuptimin e jashtëkohës (pa kohë) kur duam të shmangim tregimin e kohës. Sepse “kur-i”, “para tij”, “pas këtyre” dhe “nga fillimi” nuk kuptohen jashtë kohës, sado që të mundohemi t’i kuptojmë. Veçse nëse marrim përjetësinë si një interval që shtrihet pa fillim dhe fund dhe nuk ndahet as matet me ndonjë lëvizje, as me rrotullimin e diellit, gjë që është pikërisht koha.

Si pra nuk janë njësoj pa fillim kur janë njësoj të përjetshëm? Sepse vjen nga Ati, ndërsa nuk është pas atij. Ajo që nuk ka fillim, është dhe e përjetshme. Madje ajo që është e përjetshme, nuk është patjetër dhe pa fillim, me kuptimin që të mos referohet në ndonjë burim, domethënë në Atin.

Pra, përsa i përket shkakut nuk janë pa fillim. Por është e qartë që shkakun nuk është më parë se ato për të cilat është shkak, sepse as dielli nuk është më i vjetër se drita.

Pra, dhe Biri dhe Shpirti janë pa fillim përsa i përket kohës, edhe nëse ti akoma i tremb më të thjeshtë, sepse nuk janë nën pushtetin e kohës ato nga të cilat u krijua koha.

4. Atëherë si lind Biri nga Ati pa pësim? - ngaqë është pa trup. Sepse nëse lindja trupore ka pësime, ajo jotrupore është pa pësime. Dhe unë do të të pyes – si Biri është Perëndi nëse është krijesë? Sigurisht çdo gjë që bëhet, nuk është Perëndi. Nuk është e nevojshme të sqaroj se për qeniet trupore janë pësim koha, dëshira, kujtimet, përkujdesja, shpresa, hidhërimi, rreziku, fatkeqësia, ndreqja. Të gjitha këto dhe të tjera më tepër se këto, ashtu si e kuptojmë të gjithë ne, kanë lidhje me krijimin. Habitem se si nuk guxon të imagjinosh edhe këtë, një lloj bashkëqenieje, dhe interval shtatzanie, dhe rrezik dështimi, sepse as të lindë nuk është e mundur, nëse nuk lind sipas kësaj mënyre. Përsëri duke numëruar llojet e lindjeve, të shpendëve, të kafshëve të tokës dhe të detit, të inkuadrosh brenda në ndonjë nga këto lindje dhe lindjen hyjnore, e cila nuk mund të shprehet, apo ndryshe të kundërshtosh lindjen e Birit me teorinë tënde të çuditshme. Dhe nuk mund të kuptosh as këtë; se Biri, që kishte lindje mbinjerëzore në mish, (sepse midis njerëzve ku dëgjove Hyjlindëse Virgjëreshë?), ka dhe

lindjen e tij hyjnore krejtësisht të jashtëzakonshme, ose më mirë, Perëndia që nuk ka të njëjtën natyrë me njerëzit, sigurisht ka dhe mënyrë të ndryshme lindjeje.

5. Atëherë cili është Atë pa fillim?- ai që ekzistenca e tij nuk ka fillim. Që kur filloi të ekzistojë, që atëherë ishte dhe Atë. Pra, nuk është bërë më vonë Atë, sepse ekzistenca e tij nuk ka fillim. Dhe është kryesisht Atë sepse nuk është dhe Bir. Njëlloj dhe Biri është kryesisht Bir, sepse nuk është edhe Atë. Te ne nuk ekzistojnë këto si cilësi të veçanta sepse ne jemi dhe etër dhe bij dhe vetëm për këtë arsye nuk na ndodh ose njëra ose tjetra. Veç të tjerash ne rrijmë nga dy, jo nga një; kështu ndahemi dhe bëhemi gradualisht njerëz dhe ndoshta as njerëz sepse këto ndodhin pavarësisht nga dëshira jonë, pastaj i braktisim dhe na braktisin, kështu mbeten vetëm lidhjet etër dhe bij, pa gjërat. Disa pretendojnë se “lindi” dhe “u lind” çfarë nënkupton tjetër, veç asaj që lindja ka fillim? Pse pra të mos themi as këtë, se që nga fillimi ishte i lindur? Kështu lehtë do të shmangim kundërshtimet e tua të kota që pëlqejnë të përcaktojnë kohën. A do të kthesh vallë kundër nesh shkrimin sepse gjoja ne shtrembërojmë diçka nga shkrimi dhe e vërteta? Apo ndoshta të gjithë e dinë se shumë përcaktime kohore përcaktohen me kohë të ndryshme e madje sipas zakonisht të shkrimit, jo vetëm për ngjarjet e së shkuarës ose të së tashmes, por dhe për ato të së ardhmes? P.sh thotë: “përse turbullohen kombet”, ndërsa akoma nuk ishin turbulluar. Gjithashtu “populli kaloi lumin me këmbë të thata” që do të thotë se e kishin kaluar. Do të harxhonim shumë kohë të numëronim të gjitha citimet e njëjta të cilat të zellshmit i kujtojnë....*(Marrë nga Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks, shkrimet e hershme).*

Ligjëratat e Pashkës

Nga Grigor Teologu

Rreth Vdekjes dhe Ngjalljes së Krishtit. Dje unë isha kryqëzuar me Atë; sot unë jam lavdëruar me Atë. Dje unë vdiqa me Atë; sot unë jam bërë i gjallë me Atë. Dje unë u varrosa me Atë; sot unë jam ngritur me Atë. Le t' i blatojmë Atij që pësoi dhe u ngjall për ne... vetvetet, pasuria më e çmueshme dhe më e përshtatshme të Perëndia. Le të bëhemi si Krishti, meqenëse Krishti u bë si ne. Le të bëhemi Hyjnorë për hir të Atij, meqenëse Ai u bë për ne njeri. Ai mori mbi vete më të keqen që të na japë ne më të mirën. Ai u bë i varfër që nëpërmjet varfërisë së Tij ne të mundim të bëhemi të pasur. Ai pranoi formën e një shërbëtori që ne të mundim të fitojmë përsëri lirinë tonë. Ai zbriti poshtë që ne të mundemi të ngjitemi lart. Ai u tundua që nëpërmjet Tij ne të fitojmë. Ai u turpërua që të na lavdërojë ne. Ai vdiq që të na shpëtojë ne. Ai u ngjit që të mund të na marrë te vetvetja, neve që ishim hedhur poshtë nga rënia në mëkat. Le të japim gjithçka, le të blatojmë gjithçka tek Ai që dha Vetveten si Shpërblim e Pajtim për ne. Ne kishim nevojë për një Perëndi të mishëruar, një Perëndi të dënuar me vdekje, që të mundim të rrojmë. Ne u dënuam me vdekje së bashku me Atë që të mundim të pastrohemi. Ne u ngjallëm me Atë sepse u dënuam me vdekje me Atë. Ne u lavdëruam me Atë sepse u ngjallëm me Atë. Pak pika Gjaku dhe rikrijuan tërë krijimin. (*Protoprezviter Thomas Hopko, Besimi Orthodhoks, Vëllimi I, Doktrina, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1997, faqe 149-150*).

Kundër eunomianëve **Nga Grigor Teologu**

1. Ligjërata ime u drejtohet oratorëve që duan të duken të hijshëm. Le të filloj nga shkrimi: “vështroni, unë jam kundër jush, o njerëz krenarë”, në formim, në fjalë, në mendje. Sepse janë, janë disa që acarohen në dëgjim, në gjuhë dhe sikundër shoh edhe në dorë, nga fjalët e mia dhe gëzohen me fjalë të kota profane, “nga kundërshtimet e asaj që rrejshëm quhet dije” dhe me grindjet me fjalë që nuk të çojnë në asgjë të dobishme. Kështu e karakterizon çdo fjalë të tepërt dhe të çuditshme Pali, predikuesi dhe pohuesi i “fjalës së shkurtër dhe të prerë”, nxënësi dhe mësuesi i peshkatarëve. Ata për të cilët flet ligjërata, ashtu si kanë gjuhë të paqëndrueshme dhe të frikshme në paraqitjen me fjalë të zgjedhura dhe të përshtatshme, qofshin kështu skolastikë dhe në jetën e tyre praktike, qoftë edhe për pak; dhe atëherë do të ishin, ndoshta, më pak sofistë dhe oportunistë në fjalë dinake dhe të çuditshme, që të jap dhe një përcaktim qesharak për diçka qesharake.

2. Ngaqë shkatërruan çdo udhë të drejtësisë dhe synojnë vetëm te kjo pikë, ç’farë probleme do të lidhin ose zgjidhin (si në teatër të shkathëtit e mjeshtërive të mundjes, që tregojnë jo ato mjeshtëri të cilat, sipas rregullave të atletizmit, sigurojnë fitoren, por ato që bëjnë përshtypje tek ata që nuk e kanë idenë për këto dhe e mahnitin admiruesin) dhe duan që çdo treg të gumëzhijë nga komentet e fjalëve të tyre, çdo banket të humbasë kohën kot nga llomotitjet dhe neveria, çdo festë të zotërohet nga trishtimi, i cili është i papërshtatshëm për festën dhe, çdo vajtim të ngushëllohet nga një katastrofë më e madhe: diskutimet, çdo banesë gruaje që

ka shoqërues thjeshtësinë të shqetësohet dhe me rrjedhën e shpejtë të fjalës të grabitet lulja e respektit.

Ngaqë këto bëhen kështu dhe e liga është e papërmbajtshme dhe e padurueshme dhe misteri ynë i madh rrezikohet të bëhet si zanat, u lutem spiunëve, përderisa nxitem nga ndjenjat atërore dhe, siç thotë Jeremia i shenjtë, jam prekur thellë në ndjenjat e mia, të më durojnë aq sa të mos presin me ashpërsi ligjëratën time e cila ka lidhje me këto çështje dhe duke përmbajtur pak gjuhën e tyre - natyrisht nëse kanë mundësi - të vënë veshin e të më dëgjojnë. Në asnjë rast nuk do të dëmtoni asgjë, sepse, nëse flas në veshët e njerëzve që dëgjojnë, atëherë ligjëratat ka ndonjë fryt: përfitimin tuaj (ngaqë mbjellësi mbjell fjalën në çdo mendje, por jep fruta ajo e mira dhe pjellorja), ose ma përbuzni edhe këtë ligjëratë dhe largohuni duke pasur të mbledhur më tepër material për kundërshtim dhe përgojime kundër meje, në mënyrë që të ngopeni edhe më shumë. Dhe, nëse them fjalë në kundërshtim me lavdërimin dhe zakonin tuaj, mos u çuditni, ju të cilët me shumë vrull rinor dhe me egoizëm demonstrativ, që të mos them me padituri dhe paturpërsi dhe kështu ju shqetësoj, thoni se i dini dhe i mësoni të gjitha.

3. Jo çdo njeriu, të dashurit e mi, i takon të filozofojë rreth Perëndisë, jo çdo njeriu. Kjo çështje nuk është kaq e lirë dhe e ulët dhe, do të shtoj, nuk është e mundur gjithmonë, as tek të gjithë, as në të gjitha pikat; por vetëm disa herë te disa persona, brenda kufijve të caktuar. Pra, nuk është për çdo njeri, veçse për ata që janë të provuar dhe gjithsa kanë përparuar në teori dhe para këtyre janë pastruar në shpirt dhe trup, ose, të paktën, pastrohen tani. Sepse është dhe e rrezikshme për të papastrën të prekë të pastrën, pikërisht ashtu si rrezja e diellit në syrin e sëmurë.

Dhe kur? Kur jemi të liruar nga ndotjet dhe shqetësimet e jashtme dhe drejtimi ynë nuk ngatërrohet me demonstrime keqdashjeje dhe të gabuara, në mënyrë që të ngatërrojmë shkronjat e shkruara mirë me të këqijat, ose aromën e mirove me papastërtinë. Sepse, me të vërtetë, duhet të qëndrojmë dikush pa u marrë me ndonjë gjë tjetër që të njohë Perëndinë dhe, vetëm kur gjejmë rast, të merremi me bukurinë e teologjisë. Dhe te cilët persona? Tek ata që e studiojnë çështjen seriozisht dhe nuk e kanë si një nga të tjerat, objekt llogotitjeje me kënaqësi pas garave, teatrove, këngëve, grykësisë dhe seksit. Për këta njerëz, një sektor kënaqësie janë edhe fjalët e shumta rreth këtyre çështjeve dhe vërtetimi i hijeshisë me format e fjalëve.

Cilat gjëra duhet të ketë dikush objekte të mendimit të tij filozofik dhe deri në çfarë pike mund të ecë përpara? Aq sa janë të mundshme për ne dhe deri atje ku arrin mundësia dhe aftësia natyrore e dëgjuesit, në mënyrë që të mos ndodhë si me tingujt shumë të fortë që shkatërrojnë dëgjimin dhe ushqimet e tepërta që shkatërrojnë trupat, barrat shumë të rënda që shkatërrojnë të ngarkuarit apo shirat e shumta dhe të shpejtë që shkatërrojnë arën. Them kështu që këta të mos ndodhë të mposhten dhe të përthyhen me fjalë të fuqishme, le ta them kështu, dhe shkatërrohet edhe fuqia e tyre fillestare.

4. Duke thënë këto nuk nënkuptoj se nuk duhet të kemi Perëndinë gjithmonë në mendje. Mos të hidhen para meje përsëri mendjemëdhenjtë dhe mendjelehtët e përhershëm. Sepse është më mirë të mendojmë dikush Perëndinë, sesa të marrë frymë dhe, nëse është e mundur të them dhe këtë: nuk duhet të bëjmë dikush asgjë tjetër veç kësaj. Jam dhe unë nga ata që lavdërojnë fjalën e cila nxit të studiojmë ditë e natë dhe të rrëfejme në mbrëmje, në mëngjes

dhe në mesditë dhe të bekojmë zotin “në çdo kohë” dhe, nëse duhet të them edhe fjalën e Moisiut, kur dikush të jetë shtrirë, kur çohet, kur ecën, kur bën çfarëdolloj gjëje tjetër, ta ketë në mendjen e tij, që të pastrohet.

Pra, nuk pengoj që ta ketë dikush vazhdimisht në mendjen e tij, por që të teologjizojë. Nuk pengoj teologjinë, sepse pengesa e saj është vepër e pafé, por pengoj të marrët e pavend me të, as mësimin, por padallueshmërinë. Ndoshta dikush mund të hajë shumë mjaltë dhe kjo i shkakton të vjella edhe pse është mjaltë. Dhe çdo gjë në kohën e vet. Mendoj ashtu siç mendonte dhe Solomoni. E mira nuk është e mirë kur nuk bëhet mirë, si lulja, gjatë dimrit, në kohë krejtësisht të papërshtatshme, veshjet e burrave te gratë, apo të grave te burrat, gjeometria në vajtim dhe lotët në banket. Vetëm këtu në teologji do të lëmë mënjane kohën e përshtatshme, një fushë ku duhet të nderohet në mënyrë të veçantë kjo përshtatshmëri?

5. Aspak, o miq dhe vëllezër, sigurisht, ju quaj ende vëllezër edhe pse nuk silleni me vëllazëri, të mos mendojmë kështu, as të mos hedhim poshtë mendimin shpirtëzues, si kuajt gjakxehtë dhe të harbuar, dhe të mos përbuzim adhurimin i cili na përmban më së miri që të mos vrapojmë më tutje kufirit, por të filozofojmë brenda kufijve tanë dhe të mos e ndërrojmë drejtimin as për nga Egjipti, as të tërhiqemi drejt asirianëve, as të psalltim këngën e zotit në dhé të huaj, nënkuptoj çdo dëgjues dhe të huaj, tonin, mik dhe armik, mirënjohës dhe mosmirënjohës i cili me interesim të madh gjurmon çështjet tona dhe do të dëshironte të bëhej flakë shkëndija e ligësive tona. Prandaj, dinakërisht e ndez dhe i fryn me të fryrët e tij duke e ngritur Atë deri në qiell dhe e bën flakën më të lartë se flaka e furrës së Babilonisë që digjte gjithçka rreth saj.

Ngaqë nuk kanë fuqi në dogmat e tyre përpiqen të gjuajnë rastin në dobësitë tona, prandaj bien mbi dobësitë tona, duhet t'i emërtoj fatkeqësi ose mëkate, ashtu si mizat mbi plagë. Por, ne të mos e lëmë veten tonë më tepër në padituri, as të mos e lëmë mënjane korrigjimin e mëkateve tona, por nëse nuk është e mundur ta prishim armiqësinë, të paktën le të biem dakord midis nesh në këtë: të flasim në mënyrë mistike për mistiket dhe në mënyrë të shenjtë për të shenjtat, të mos hedhim në veshët e pafe të mistershmet, as të bëhemi shkak që të duken më të hijshëm se ne ata që u falen demonëve, adhuruesit e miteve dhe të gjërave të neveritshme, ata që pëlqejnë të japin gjakun e tyre, sesa të mistershmet tek ata që nuk janë në dijeni të këtyre gjërave. Por, le të dimë se ashtu si ekziston një lloj estetike në veshje, në ushqim, në të qeshur dhe në të ecur, në të njëjtën mënyrë ekziston edhe në fjalë dhe në heshtje, mbasi veç emërtimeve të tjera dhe fuqive të Perëndisë, besojmë dhe në Atë të fjalës. Atëherë le të jetë dhe konflikti ynë brenda ligjit.....

VASIL I MADH (329-379)

Vasili i Madh ka lindur në vitin 320 në Çezare të Kapadokisë, në një familje të shquar. Prindërit e tij, Vasili dhe Emelia, qenë fisnikë dhe shprestarë. Vëlla kishte Grigorin e Nisës dhe motër Oshënare Makrinën. Vasili studimet e para i kreu në vendlindje dhe më pas në Nikomedi. Në vitin 351 vajti në Athinë ku studioi filozofi, retorikë, filologji, astronomi dhe mjekësi. Gjatë viteve të studimeve zuri miqësi të ngushtë me Grigor Teologun. Në vitin 356 Vasili u kthye në Çezare, ku punoi si mësues retorike. Një ndikim vendimtar në formimin e tij shpirtëror pati vizita që bëri nëpër manastiret e Sirisë, Palestinës dhe Egjiptit. Vasili u dorëzua dhjak dhe asketoi në shkretëtirën e Pontit rreth viteve 360–365. Pasi u hirotonis prift, Vasili u vendos në Çezare, ku u përball me herezinë arianiste. Në vitin 370 u dorëzua episkop. Vasili u shqua si udhëheqës i grigjës, por duke qenë prej kohësh i sëmurë, u thye herët në moshën 49-vjeçare. Kisha ortodokse e kremton më 1 janar.

Shkrimet: Mësuesi ekumenik shkroi vepra të rëndësishme: apologjitike, komentuese, dogmatike etj. Më e rëndësishmja prej tyre është *Liturgjia Hyjnore*, e cila mban emrin e tij. a) Dogmatike. *Mbi Shpirtin e Shenjtë*, u shkrua në vitin 375, *Kundër Eunomit* në vitin 363. b) Pedagogjike. *Drejtuartë rinjve*, e cila është edhe nga më të rëndësishmet prej veprave të tij. Deri në vitin 1500 është ribotuar 20 herë. c) Komentarë. *Rreth gjashtë ditëve*, që përbëhet prej nëntë ligjëratash.

Mbi Shpirtin e Shenjtë
Letër drejtuar Amfilokut, peshkopit të Ikoniumit
Kapitulli I.

1. I dashur dhe i nderuar vëlla Amfilok. E çmoj shumë dëshirën tënde për dije dhe për punë. Me të vërtetë, është një gëzim i madh për mua, kur shoh kthjelltësinë e diturisë tënde, e cila të shtyn që të mos lësh pa shqyrtuar me kujdes asnjë nga fjalët që kanë të bëjnë me Perëndinë. Ti ke përfituar me të vërtetë nga porosia e Zotit. “Kushdo që lyp, merr dhe kush kërkon, gjen. “Mua më duket, se dëshira jote e zjarrtë për të mësuar, prek edhe më të ndrojturin dhe e bën të tregojë çfarë ai njeh. Por, ajo që çmoj më shumë tek ty, është, sepse ti pyet për të mësuar të vërtetën dhe jo për të ngritur kurthe, siç bën pjesa më e madhe e bashkëkohësve tanë. Sepse, në ditët tona ka njerëz të shumtë që pyesin pa pushim, vetëm sa për të folur, por është shumë vështirë të gjesh një njeri që e kërkon të vërtetën, si një ilaç, për të shëruar paditurinë e tij. Ashtu siç gjahtari i fsheh kurthet e tij dhe ushtarët pusitë, kështu bëjnë edhe disa njerëz me pyetjet e tyre. Ata nuk pyesin me qëllim që të përfitojnë ndonjë gjë, por që të kenë, nëse përgjigjja nuk iu vjen sipas dëshirës, një shkak për debat.

2. Por, nëse “Dituria do t’i jepet një të marri që e kërkon atë”, sa më tepër duhet çmuar nxënësi i zellshëm, të cilin profeti e quan “këshilltar të nderuar”. Së pari, ai meriton një mirëseardhje të ngrohtë; pastaj, ai duhet të pranohet në shoqërinë e atyre që kanë të njëjtin zell si ai dhe si ai përpiqen që të shkojnë përpara drejt përsosmërisë. Ata që nuk janë seriozë në rrugën e drejtësisë, e quajnë terminologjinë teologjike, si edhe përpjekjet për të hulumtuar kuptimet e thella në çdo fjalë dhe në çdo rrokje, si sekondare; por,

ata që janë të ndërgjegjshëm në qëllimin e thirrjes sonë, e kuptojnë se ne jemi thirrur të bëhemi të ngjashëm me Perëndinë, përse kjo është e mundur për natyrën njerëzore. Por, ne nuk mund të bëhemi të ngjashëm me Perëndinë, nëse nuk kemi njohuri për Të, pasi njohuria vjen nga të mësuarit. Mësimi fillon me përdorimin e drejtë të të folurit dhe të folurit përbëhet nga fjalët dhe parafjalët. Prandaj, të shqyrtosh parafjalët nuk është pa kuptim. Nëse disa çështje duken të parëndësishme, nuk ka ndonjë arsye që t'i lemë pas dore. Përkundrazi, të gjuash të vërtetën nuk është e lehtë; duhet të kërkosh kudo për gjurmët e saj. Të mësosh të vërtetën, është njësoj si të mësosh një profesion; përparimi bëhet pak e nga pak. Ata që kanë hyrë në dituri, nuk duhet të neglizhojnë asgjë, sepse, kush përbuz elementët bazë, kurrë nuk do të arrijë në plotësinë e diturisë. “Po” dhe “Jo” janë vetëm dy rrokje. Fjalë të vogla, por që shpesh shprehin ose gjënë më të mirë: të vërtetën, ose mbulojnë gjënë më të keqe: gënjeshtren. Përse e them këtë? Sepse, në kohët e shkuara, dikush, vetëm me një të tundur koke, u bë martir i Krishtit, se kjo tregonte përkushtimin e plotë në besën e vërtetë. Nëse është kështu, cili term teologjik është aq i parëndësishëm, sa që të mos e prishë balancën, nëse është kështu, cili term teologjik është aq i parëndësishëm, sa që të mos e prishë balancën, nëse nuk përdoret drejtë? Dhe nëse as edhe “një jotë a një pikë nuk do të shkojë nga ligji”, atëherë, si mund ne të lemë pas dore edhe gjërat më të vogla? Çështjet që ti do të qartësosh, janë njëkohësisht të vogla e të mëdha: të vogla, sepse kërkojnë pak kohë për t'u shqiptuar – dhe të mëdha për nga rëndësia e kuptimit të tyre. Ato mund të krahasohen me farën e sinapit, e cila është më e vogla nga të gjitha farërat, por kur mbin dhe rritet në mënyrë të përshtatshme, i kalon të gjitha shkurret, e bëhet pothuaj pemë. Kushdo që qesh e tallet me hollësitë e

përdorimit tonë të parafjalëve, ta dijë mirë se ai do të vjelë për të qeshurën e tij, siç thotë edhe Palmisti, një frut të papjekur. Ndërsa ne, le të mos i përulemi qortimit të njerëzve dhe as të mos mundemi nga përbuzja e tyre, por, le ta vazhdojmë kërkimin pa ndërprerje. Le të mos turpërohemi ngaqë ato janë gjëra të vogla; por, nëse unë mund të arrij një përqind të vleftës së tyre, do të gëzohem si për një nder të madh dhe do t'u them vëllezërve se është një arritje me përfitim jo të vogël. Unë e kam të qartë, se, për këto fjalë të vogla, po bëhet një debat i madh me shpresën e shpërblimit, unë nuk do të hezitoj që të punoj. Jam i bindur, se për mua kjo punë do të jetë e frytshme, por edhe për dëgjuesit do të jetë e dobishme. Prandaj, po e filloj këtë shpjegim, duke i lypur Shpirtit të Shenjtë që të më ndriçojë. Dhe me pëlqimin tënd, me qëllim që të qartësohet drejtimi që do të marrë debate, unë do kthehem për një çast pak mbrapa, në origjinën e problemit tonë.

3. Tani vonë, kur unë lutem me popullin, ne e mbarojmë ndonjëherë lavdërimin (doksologjinë) ndaj Perëndisë Atë me formen: “Lavdi Atit me Birin, bashkë me Shpirtin e Shenjtë”; dhe ndonjëherë tjetër: “Lavdi Atit me anë (ose nëpërmjet) të Birit, në Shpirtin e Shenjtë”. Disa nga të pranishmit na kanë akuzuar për përdorim fjalësh të çuditshme dhe kontradiktore. Sigurisht, pra, nga dëshira për t'i ndihmuar këta njerëz- dhe nëse sëmundja e tyre nuk ka shërim – të paktën për të mbrojtur ata që shoqërohen me ta; ti mendo se një qartësim i lerës së këtyre parafjalëve do të jetë i dobishëm. Unë do të shkruaj sa më shkurt që të jetë e mundur, duke shpresuar të paraqes një fillim të palqyeshëm të këtij diskutimi. (*Shën Vasili i Madh, Mbi Shpirtin e Shenjtë, përkthyer nga At Joan Pelushi, Tiranë 1996, faqe 19-22*).

**Eksorcizmi për ata që vuajnë nga demonët
dhe nga çdo lloj sëmundje
Nga Vasili i Madh**

Le t'i lutemi Zotit.

Perëndi i perëndive, dhe Zot i zotërinjve, Krijuesi i rreshtave të zjarrtë, dhe bërës i fuqive pa trup, Mjeshtër i qielloreve dhe të dhemshmeve, të cilin nuk e ka parë asnjë njeri, dhe që nuk mund ta shohë, prej të cilit frikësohet dhe dridhet e gjithë krijesa, ai që rrëzoi për tokë dikur Kryegjeneralin, që devijoi dhe shkeli nga mosbindja shërbimin e tij, dhe engjëjt bashkëkryengritës me të, që u bënë demonë, i hodhi në errësirën e nëntokes së thellë, jep edhe këtë aforkizëm, i cili kryhet në emrin tënd të frikshëm, dhe bëje të ketë frikë kryetarin e djallëzisë, dhe të gjitha kolonat e tij që ranë bashkë me të prej dritës së lartë dhe shpartalloi, kthei dhe urdhëroi atë dhe demonët e tij të ikin plotësisht, që të mos bëjë ndonjë dëm kundër ikonës së vulosur por le të marrin fuqinë e forcës, këta të vulosur, të shkelin përmbi gjarpërinj dhe gaforre, si dhe mbi çdo fuqi të armikut. Se himnohet dhe madhërohet, dhe lavdërohet me frikë nga çdo frymë, emri yt i tërëshenjtë i Atit, i Birit, dhe i Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin. (*Uratore e Vogël, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2004, faqe 298-299*).

**Fjalimi drejtuar të rinjve
Nga Vasili i Madh**

Ne të krishterët e quajmë krejtësisht gjë pa rëndësi jetën njerëzore këtu në tokë. Nuk llogarisim dhe nuk themi mirë, se na shërben vetëm për këtë jetë. Origjinën e lavdishme, gjallërinë e

shtatit, ndjenjën e bukur, çmimet që japin njerëzit akoma dhe ofiqet mbretërore dhe çfarëdolloji tjetër që na ofron bota e huaj, nuk guxojmë për gjërat e mëdha dhe që i kanë zili të tjerët. Nuk na bëjnë përshtypje ata që kanë. Shpresat tona shkojnë shumë lart. Veprat tona janë një përgatitje për një jetë tjetër. Pikërisht, pra sa nevojiten në këtë botë dhe në tjetrën, këto të duam, këto dëshirojmë duke përçmuar çdo gjë që nuk na shpie atje. Cila është kjo bota tjetër? Ku dhe si do të rrojmë? Kjo temë është gjëja më e lartë e shkakut të sotëm, për tua përshkruar. Dhe ju, veç të tjerash, nuk keni akoma gjithë pjekurinë për të kuptuar përshkrimin e tij. Do t' u jap veçse një përshkrim të shkurtër të tij, që do t' ju mjaftojë. Le të marrim nga një anë gjithë lumturinë që është grumbulluar në këtë botë që nga dita e parë. Nga gjithë kjo lumturi tokësore nuk mbërrin as më e vogla nga të mirat e jetës tjetër. Të gjitha të këqijat e kësaj bote janë kaq të ulëta nga më e pakta ndërmjet atyre të mirave, aq poshtë është hija dhe ëndrra nga realiteti. Ose të përdorim një nga shembujt më të zakonshëm, ndryshimi ndërmjet dy jetëve, për të cilat flasim është aq dhe e natyrshme vlera ndërmjet shpirtit dhe trupit.

92 Kanonet e Vasilit të Madh

1. Kanoni ka të bëjë me mënyrën se si të pranohen heretikë dhe skizmatikë të caktuar. Ai përkufizon heretikët si ata që u bënë armiq (të huaj) për besimin, skizmatikët si ata që u ndanë për shkak të grindjeve me njëri-tjetrin dhe parasinagoguesit si ata që mbajtën shërbesa pasi qenë aforizuar (nxjerrë jashtë kungimit) ose çhirotonisur. Përsa i përket Pepuzenisë, është një herezi kundër Shpirtit të Shenjtë dhe pagëzimi i tyre nuk është pranuar. Katharitet

klasifikohen si skizmatikë. Enkratitët duhet të ripagëzohen. Të gjithë personat që kthehen duhen mirosur gjithashtu, me Miro.

2. Një grua që ka bërë abort konsiderohet vrasëse. Jo vetëm që vë në rrezik jetën e saj (shumë gra që u përpoqën ta bëjnë këtë do të vdisnin), por ajo shkatërron embrionin. Në vend të aforizmit për jetë, pendesa do të jetë dhjetë vjet.

3. Një dhjak që kryen marrëdhënie seksuale jashtë martesë do të çhirotoniset, por nuk do të aforizohet (nxirret jashtë kungimit). Kjo sepse një kanun i vjetër (Ap. 85) thotë që, ata që duhet të humbasin shkallën e tyre nuk do të marrin dënim tjetër. Arsye për këtë janë shkrimet :Ti nuk do të marrësh shpagë për herë të dytë për të njëjtën fyerje” (Nahum 1,9). Një arsye tjetër është që laikët të cilët janë dëbuar të pranohen prapë, ndërsa një dhjak i çhirotonisur nuk mund të bëhet përsëri dhjak.

4. Ky kanon i përket martesave të dyta dhe të treta. Thotë që pendesa për një martesë të dytë (bigami) është një ose dy vjet; një martesë e tretë nuk është martesë e vërtetë dhe pendesa për të është pesë vjet aforizim (nxjerrë jashtë kungimit).

5. Ata heretikë që pendohen vërtet në fund të jetës së tyre mund të pranohen.

6. Në qoftë se një klerik kryen marrëdhënie seksuale të paligjshme, ai nuk falet dhe nuk lejohet të martohet, por i thuhet t’i japë fund kësaj marrëdhënieje.

7. Homoseksualët, bestialistët (që kryejnë marrëdhënie seksuale me kafshët), vrasësit, magjistarët, shkelësit e kurorës dhe idhujtarët meritojnë të njëjtin dënim. Kështu, çfarëdo rregulli të keni për një prej tyre ruajeni edhe për të tjerët. Në qoftë se ata janë penduar për 30 vjet, s’ka dyshim që duhen pranuar.

8. Ky kanon flet për shembuj të vrasjeve të vullnetshme dhe të pavullnetshme. Disa nga shembujt janë: qëllon me gur një qen dhe vret një njeri, kjo është e pavullnetshme kurse të godasësh gruan me sopatë, kjo është e vullnetshme.

9. Vendimi i zotit do të ishte që, burri dhe gruaja janë njësoj të detyruar të mos ndahen nga njëri-tjetri, përveç rastit të marrëdhënieve seksuale jashtë martese ose shkeljes së kurorën nga secila palë. Por, tradita lejon që një burrë të ndajë gruan në qoftë se ajo shkel kurorën, por gruaja nuk mund të ndajë burrin në qoftë se ai vepron kështu. Në qoftë se një grua martohet me një burrë të cilin e ka lënë gruaja për shkak të shkeljes së kurorës, ajo nuk është shkelëse e kurorës dhe burri mund të falet; por një grua që lë burrin për çfarëdo arsye, ajo është shkelëse kurore. Në qoftë se një burrë lë gruan jo për arsye të shkeljes së kurorës dhe martohet, ai është shkelës kurore.

10. Ata që janë betuar të mos hirotonisen nuk duhen inkurajuar ose detyruar të hirotonisen (pjesa që mbetet e këtij kanuni ka të bëjë me një rast specifik të kësaj).....(*The Rudder (Pedalion)*, *dispensë e përkthyer nga Aleksandra Koço, Luna Printing Co, Nju Jork 1983, page 34-35*).

Kreshma **Nga Vasili i Madh**

Kreshma është një dhuratë e çmueshme e Perëndisë. Kjo traditë e lashtë u ruajt si trashëgimi atërore deri në ditët e sotme. Pranojeni me gëzim. Ju të varfërit pranoni çlodhjen tuaj. Ju të pasurit pranoni atë që ju shpëton nga rreziku i ngopjes së tepërt dhe që bën të shijshme të gjitha ato që kënaqësia e vazhdueshme i bën të

pahijshme. Ju të sëmuret pranoni nënën e shëndetit. Të shëndetshmit i siguron shëndetin e mirë. Pyesni mjekët dhe ata do t' u thonë se asgjë nuk është kaq e dyshimtë dhe e pasigurtë sa shëndeti. Ata që kreshmojnë rregullisht përpiqen të ruajnë shëndetin e tyre dhe të shpëtojnë nga ngarkesa e dhjamosjes së madhe.

Mos thuaj se nuk mund të mbash keshmë, duke sjellë si justifikim sëmundje ose dobësi trupore, sepse nga ana tjetër, në të gjithë jetën tënde e rëndon trupin me të ngrënë të shumtë. E di shumë mirë se mjekët u japin të sëmureve dietë të rreptë dhe keshmë dhe jo shumëllojshmëri dhe sasi të madhe ushqimesh. Më e lehtë për trupin është të kalojë një natë duke ngrënë darkë të lehtë, apo të bie në shtrat i rënduar nga të ngrënë? A mund të qetësohet trupi, apo do të rrotullohet nga ngarkesa?

Një kapiten mund ta komandojë më lehtë dhe ta shpëtojë në rast furtune anijen që ka mbingarkesë, apo atë që ka ngarkesë normale? Anijen që ka mbingarkesë mund ta fundosë edhe një furtunë e vogël. Kështu ndodh edhe me ato trupa, që nga mbingarkesa sëmuren shpesh, ndërsa kur konsumojnë ushqime të lehta gëzojnë shëndet të mirë.

Le të ndjekim historikisht çështjen e keshmës dhe do të shohim sa u vlerësua nga shenjtorët dhe dobitë që na solli. Moisiu i perëndishëm, pasi keshmoi dyzetë ditë guxoi të ngjitet në malin Sina për të marrë rasat me dhjetë porositë. Nuk do ta kishte marrë guximin të ngjitej në majë të malit, i cili ishte i zjarrtë nga providenca hyjnore, nëse nuk do të kishte keshmuar. Keshmoi dhe kështu mundi të komunikonte me Perëndinë.

Profeti Samuil ishte fryt i keshmës. Nëna e tij, Ana, pasi keshmoi iu lut Perëndisë: “Zot i fuqive, nëse do të më përdëllesh dhe të më dhurosh një fëmijë do ta kushtoj Ty”.

JOAN GOJARTI (344-407)

Joan Gojarti ka lindur në vitin 344 në Antioki. Babai i tij quhej Sekundo, ndërsa e ëma Anthusa. Sekundo ishte gjeneral dhe vdiq herët. Për edukimin e Joanit u kujdes e ëma. Në vitin 365 Joani u regjistrua në shkollën idhujtare të Livanit. Ky i fundit mendonte ta linte si trashëgimtarin e tij, por Joani e braktisi atë dhe studioi teologji. Në vitin 370 Joani u pagëzua nga Meleti i Antiokisë. Joani asketoi për tre vjet dhe në vitin 380 u kthye në Antioki. Më 381 u dorëzua dhjak nga Meleti i Antiokisë dhe më 386 u bë prift. Pas vdekjes së Nektarit, më 15 dhjetor të vitit 397, Joani u fronëzua Kryeepiskop i Kostandinopojës. Joan Gojarti udhëhoqi grigjën gjatë viteve 398-404. Pas një konflikti që pati me perandoreshën Evdhoksi, Joanin e internojnë. Joani vdiq në internim në vitin 407. Kujtimin e tij e kremtojmë më 13 nëntor. (*Jovan Joco, Të dhëna mbi mbretin e Shenjtorëve dhe disa shenjtorë, Korçë, faqe 54-55*).

Shkrimet: 1) *Për Gjenezën*, e përbërë nga nëntë fjalime të shkruara në vitin 386. 2) *Përshkrime të psallmeve* të shkruara rreth viteve 395. 3) *Për Isaian* përbëhet nga gjashtë biseda. 4) *Rreth Davidit dhe Saulit* që përbëhet nga tri fjalime. 5) *Rreth Matheut* 90 fjalime të cilat u shkruan në Antioki në vitin 390. 6) *Rreth Joanit* 88 fjalime të cilat u shkruan në vitin 391. 7) *Rreth Veprave të Apostujve* 55 fjalime të shkruara në Kostandinopojë në vitin 400. 8) *Rreth Romakëve* 32 fjalime të shkruara në Antioki në vitin 391.

Shenjtji ka shkruar shumë vepra dhe ka kompozuar shumë vargje të Liturgjisë që mban emrin e tij. Gjithashtu ka lënë shumë letra dhe sidomos omeli. 9) *Për Eutropion* që përbëhet prej dy fjalimesh dhe tregon për aftësinë retorike të hierarkut të madh. Por

cili ishte Eutropi, të cilit Joani i drejtoi dy predikimet nga amvoni i kishës së Apostujve të Shenjtë në Kostandinopojë. Eutropi ishte një obortar i pallatit perandorak, i cili ndërmjetësoi për t' i dhënë grua perandorit Arkad (395-408) vajzën e bukur Evdhoksi. Prej kësaj martese pozita e Eutropit u forcua shumë. Perandori Arkad e zgjodhi atë kryeministër. Në këtë kohë Eutropi u ngrit kundër kishës duke u bërë armik i kryepiskopit të Kostandinopojës, Joanit.

10) *Mbi Priftërinë* u shkrua në vitin 383. Kjo vepër e shkruar në formë dialogu është nga më të përkryerat e Joan Gojartit.

Mbi priftërinë Nga Joan Gojarti

Kam pasur shumë miq të sinqertë e të vërtetë, të cilët i njihnin rregullat e shoqërisë dhe i ruanin ato me përpikmëri. Por ishte njëri në këtë grup i cili ua kalonte të gjithëve për miqësinë e tij ndaj meje dhe vuri në zemrën tij t' i kalonte gjithë të tjerët, po aq sa edhe ata i kishin lënë pas njerëzit të cilët mua më shihnin me indiferentizëm. Ai ishte një nga shokët e mi të përhershëm. Ne shkuam për të njëjtat studime dhe ndoqëm të njëjtët mësues. Kishim të njëjtin zell e entuziazëm në studimet me të cilat punonim si dhe të njëjtat ide të larta që buronin nga interesa të përbashkëta. Dhe jo vetëm gjatë kohës që ishim në shkollë, por edhe kur u larguam prej saj dhe duhej të vendosnim se cila karrierë do të ishte më mirë për t' u zgjedhur, ne ishim qartësisht të një mendjeje. Dhe përveç gjithë kësaj, kishte shumë lidhje që qëndronin të pazgjidhura dhe të sigurt. Asnjëri nga ne nuk do të mburrej më shumë se tjetri për madhësitë e vendit të tij. As nuk kisha unë më tepër para, ndërkohë që ai jetonte në varfëri të skajshme; por përkundrazi, e përbashkëta

jonë ishte po aq e njëjtë sa edhe pikëpamjet tona. Familjet tona ishin nga e njëjta klasë dhe kështu gjithçka shkonte në përputhje me gjendjen tonë.

Por, kur erdhi koha për të hyrë në jetën e bekuar të murgjëve dhe të filozofisë së vërtetë, peshorja nuk qëndroi më në ekuilibër. Krahu i tij u ngrit me të drejtë lart, ndërkohë që unë, i prangosur ende nga dëshirat e botës, tërhoqa poshtë krahun tim, duke rënduar mbi të kotësitë rinore dhe duke e detyruar të qëndrojë në nivel më të ulët. Që prej asaj kohe miqësia jonë qëndroi e paepur si më parë, por intimiteti ynë u thye. Sepse nuk mund të vepronim më së bashku gjersa interesat tona ndryshonin.

Por kur edhe unë u largova paksa nga furia e jetës, ai më priti me krahë hapur. Megjithatë, as në atë kohë nuk mund të kishim barazinë e mëparshme; pasi ai ma mori që në nisje dhe duke treguar një zell të vazhdueshëm, ngrihej shumë lart meje dhe arrinte një lartësi shumë të madhe. Megjithatë, duke qenë një njeri kaq i mirë dhe duke vlerësuar së tepërmi miqësinë time, u tërhoq nga të gjithë shokët dhe kalonte tërë kohën me mua. Ai i shqetësuar kërkonte ta bënte këtë më parë, por, siç edhe e shpjegova, ish frenuar prej indiferencës sime. Pasi për dikë që e kalonte kohën nëpër gjyqe dhe fërgëllonte nga kënaqësitë e skenave, ishte e pamundur që të shoqërohej shpesh me një njeri që ishte i ngjitur pas librave të tij dhe nuk doli kurrë as gjer në pazar. Për këtë arsye ai u nda prej meje. Por menjëherë, sapo më futi të ndjek të njëjtin plan jete si të tijin, hartoi skemën të cilën e kishte përpunuar që kohë më parë. Nuk do më linte vetëm as edhe për një moment, por këmbëngulte në mbrojtje të idesë se secili nga ne duhej të braktiste shtëpinë e tij dhe të rrinim në një vend së bashku. Ai arriti të më bindte dhe gjërat ishin gati.

Por ndërhyrjet e pandërprera të nënës sime më penguan të bëja ndaj tij këtë mirësi – ose më mirë, të pranoja mirësinë e tij. Menjëherë, sapo ajo e pa se ky ishte synimi im, ajo më zuri për dore dhe më shpuri në dhomën e saj vetjake. Ulur pranë meje, mbi shtrat, në të cilin më kishte lindur, ajo u mbush në të qara dhe më pas foli fjalë më prekëse se lotët. Dhe ky ishte ankimi i saj i pikëlluar: “Biri im, - tha ajo, - mua nuk m’u lejua të gëzoja për një kohë të gjatë virtytet e babait tënd, pasi kështu i pëlqeu Perëndisë. Vdekja e tij pasoi menjëherë pas përpjekjeve të mia me ty dhe të la ty jetim e mua një të ve përpara kohe, bashkë me gjithë mundimet e vejenisë, të cilat vetëm ato që i kanë kaluar mund që t’i kuptojnë si duhet. Asnjë fjalë nuk mund të përshkruajë furtunën e detit që përballon një vajzë e re, kur ajo sapo ka lënë shtëpinë e atit të saj, pa pasur as edhe një përvojë për botën, menjëherë goditet me pikëllim të pamundshëm, shtrëngohet të ngrejë halle tepër të mëdha për moshën dhe gjininë e saj. Sepse, siç e di shumë mirë, asaj i duhet të korrigjojë pakujdesinë e shërbëtorëve, të mbikqyrë sjelljet e tyre të këqija, të prishë planet e fqinjve dhe të mbajë me dinjitet fyerjet e zyrtarëve publikë dhe vrazhdësinë e tyre për pagesën e taksave. Dhe nëse burri i saj i vdekur do t’i ketë lënë një fëmijë, dhe nëse fëmija është vajzë, ajo do t’i shkaktojë shumë shqetësime nënës së saj, dhe pse jo shpenzime dhe frikë. Por një djalë e mbush me një mori dyshimesh çdo ditë që pason, dhe madje me më shumë shqetësime. Nuk po flas pastaj për shpenzimet e mëdha që duhet të heqë nëse kërkon që ta rrisë si zotëri. Megjithë këto, asnjë nga këto mendime nuk më bindi që të ndërmarr një martesë të dytë dhe të fusja një burrë tjetër në shtëpinë e babait tënd. Jo, qëndrova e durueshme, ndërkohë që turbullira më qarkonin, por nuk u sprapsa prej furrës së hekurt të vejushërisë. Ndihma kryesore ishte nga

lart. Dhe gjeja shumë ngushëllim ndër ato prova, gjersa vështroja vazhdimisht mbi fytyrën tënde dhe ruaja në ty imazhin e gjallë e të njëjtë të burrit tim të vdekur. Kështu pra, gjersa ti ishe ende fëmijë e ende nuk kishe mësuar të flisje, në kohën kur fëmijët i dhurojnë kënaqësinë më të madhe prindërve të tyre, ti më ofroje një ngushëllim shumë të madh. As nuk mund të më qortosh nëse e mbajta virgjërinë time me dinjitet, por vetëm për koston e zvogëlimit të trashëgimisë, për hir të nevojave të një vejushe – një fat të cilin, unë e di, vuajtën shumë që patën fatin e keq të ishin pa baba. Jo, me të vërtetë; e ruajta të gjithën të pacënuar – dhe nuk lë mangët asnjë shpenzim që kërkon reputacioni yt, por e paguaj nga kuleta ime dhe nga prika ime, të cilën e solla nga shtëpia ime.

Të lutem, mos mendo se po t’i them këto tani si vërejtje për ty. Por si shpërblim për të gjitha këto, të kërkoj vetëm një nder: të mos më shkaktosh një fatkeqësi të dytë dhe të zgjosh përsëri pikëllimin e fjetur. Ki durim deri në fjetjen time. Mund që ndarja të mos jetë shumë e largët. Ata që janë të rinj e shohin nga larg moshën e vjetër, por ne që jemi tashmë të rritur nuk kemi se çfarë të presim veçse vdekjes. Kur të më kesh dorëzuar në dhé dhe të më kesh bashkuar me eshtrat e babait tënd, atëherë nisur për në udhëtimet e tua të gjata dhe lundro çfarëdo lloj deti që të duash. Atëherë nuk do të ketë më njeri që të të pengojë. Por deri sa të kem frymën e fundit, ji i kënaqur që të jetosh me mua. Mos i shkakto ofendime të panevojshme Perëndisë duke më mbytur me këtë fatkeqësi, pasi unë kurrë nuk të kam lënduar.

Sigurisht, nëse ke arsye për t’u ankuar se të kam shqetësuar me kujdesjet e botës dhe të kam vënë të drejtosh pasurinë time, atëherë as mos i kushto fare vëmendje ligjeve të natyrës, edukimit, zakoneve ose diçkaje tjetër, por shmangiu atyre si të ishin tradhëtarë

e armiq. Por, nëse në të kundërt, unë bëj gjithçka për të mundësuar që të kesh plot kohë të lirë për të ndjekur një jetë të tillë, atëherë le të jetë kjo lidhje, nëse s'ka tjetër, që të të mbajë pranë meje. Edhe nëse argumenton se ke njëqind shokë, as edhe një prej tyre nuk do të lejonte që të gëzoje një liri të tillë, pasi nuk ka as edhe një që të kujdeset për reputacionin tënd si unë”.....

Urata e Pashkës **Nga Joan Gojarti**

Cilido besëmirë dhe hyjdashës, le ta gëzojë këtë panair të mirë dhe gazmor. Cilido shërbëtor mirënjohës, le të hyjë i gëzuar në gazin e të Zotit. Ai, që u mundua me kreshmë, le ta marrë tani shpagimin. Ai, që punoi prej orës së parë, le ta marrë sot rrogën e plotë. Ai, që erdhi pas së tretës, le të kremtojë me gjithë zemër. Ai, që arriti pas së gjashtës, le të mos dyshojë fare, se nuk pëson dëm. Ai, që vonoi gjer më të nëntën, le të afrohet pa hezituari fare. Dhe ai që arriti vetëm në të njëmbëdhjetën, le të mos trembet nga vonimi. Se Zoti zemërdhemshur e pret të fundit, si edhe të parin, dhe e çlodh atë të orës së njëmbëdhjetë, si atë që punoi që prej orës së parë. Edhe të fundin e mëshiron, edhe të parin e shëron; edhe këtij i jep, edhe atij i fal; edhe punët i pret, edhe mendimin e pëlqen; edhe veprën e nderon, edhe qëllimin e lëvdon.

Hyni, pra, të gjithë në gazin e Zotit tonë; edhe të parë edhe të dytë, merreni rrogën. Të pasur e të varfër, vallëzoni me njëri-tjetrin; të përkorë e të ngathët, kremtojeni këtë ditë; sa kreshmuat dhe sa nuk kreshmuat, dëfreni sot. Tryeza është plot, hani që të gjithë. Gjella është e shumtë, asnjë le të mos dalë i uritur. Të gjithë gëzojeni dasmën e besës; të gjithë, gëzojeni pasurinë e mirësisë.

Asnjë le të mos vajtojë për varfërinë, se u shfaq mbretëria e përbashkët. Asnjë le të mos qajë për faje, se ndjesa lindi nga varri. Asnjë le të mos ketë frikë nga vdekja, se na ndriçoi vdekja e Shpëtimtarit. E shuajti kur përmbahej prej asaj. E plaçkiti ferrin ai, që zbriti në ferr. E hidhëroi, kur ngjeroi mishin e tij. Dhe këtë e parashikoi Isaia, dhe thirri: ferri u hidhërua, kur të hasi poshtë. U hidhërua, se u burgos. Priste një njeri, dhe gjeti Perëndinë. Priste dhenë, dhe hasi qiellin. Ku është mburrja jote, o vdekje? Ku është mburrja jote o ferr?

U Ngjall Krishti, dhe ti u hodhe poshtë. U Ngjall Krishti dhe u përmbysën demonët. U Ngjall Krishti, dhe gëzohen engjëjt. U Ngjall Krishti, dhe jeta qytetërohet. U Ngjall Krishti, dhe asnjë i vdekur s'mbeti në varr. Se pas Krishtit u ngjallën të gjithë të vdekurit. E Atij është lavdia dhe fuqia, në jetë të jetëve. Amin.

Ndikimi i gruas mbi burrin Nga Joan Gojarti

Një grua e mirë dhe e urtë mund të ushtrojë influencë shumë të madhe mbi burrin e saj; ka aq fuqi mbi burrin, sa nuk mund të ketë as më i miri mësonjës dhe as më i zoti predikonjës. Le t'i japin këshilla të mira miqtë e tij të ngushtë; le ta mësojnë mësonjës të ditur; le ta këshillojnë njerëz me fuqi e me pozita të larta; nuk do të dëgjojë as një nga këta, aq sa do të dëgjojë këshillat e gruas së tij. Shumë herë bile këshillat e të tjerëve i sjellin dhe një farë mërzitjeje; kurse ato që dalin nga goja e gruas, kanë një ëmbëlsi të veçantë dhe i sjellin një kënaqësi të patreguar. Sa burra kanë qenë zemërligj, brutalë, kryeneçë e plot me vese të tjera, e megjithë këtë urtësia dhe zotësia e gruas ka mundur t'i zbutë këta dhe t'i bëjë krejt të

ndryshëm? Sepse gruaja të gjitha gjërat i ka të përbashkëta me burrin, e prandaj dhe lidhja mes tyre është aq e ngushtë, sa është ajo e trupit me kokën; nëse do të rastisë të jetë e urtë dhe e ëmbël, nuk ka dyshim se do ta pushtojë burrin e saj dhe do ta udhëheqë gjithnjë e do ta shpjerë në udhën e drejtë.

Prandaj i këshilloj gratë që këtë detyrë (detyrën e këshillimit të burrit) ta quajnë si më të lartë nga çdo punë tjetër që kanë bërë në botë. Le të kenë parasysh se më të shumtën e herës nga dora e tyre varet që burrat të bëhen të mirë ose të ligj, të lumtur ose të mjerë. Kemi një tok shembëllash që na e provojnë këtë: grua ka qenë ajo që shkatërroi Avesallomin, grua ishte ajo që e shtynte Jovin në katastrofë e në greminë, grua ishte ajo që shpëtoi navalin nga prishja, grua ka qenë ajo që shpëtoi një popull të tërë... Prandaj edhe Pali thotë: “ku di ti, o grua, se nuk do të mundësh të shpëtosh burrin tënd?”.

Po “si duhet të sillet e të veprojë gruaja, që të mund të influencojë burrin e ta këshillojë ashtu si duhet?” mund të pyesë ndonjë grua. Kësaj pyetjeje po i përgjigjem: kur shikon burri se ti nuk je e keqe, se nuk e ke mendjen gjithnjë në luks dhe në stolitë, se nuk ke pretendime të larta, se nuk kërkon të shpenzosh shuma të mëdha, për t’u stolisur me sende të tepërta e të shtrenjta, kur shikon se ti në punën e shpenzimeve shkon me rregull e me hesap; kur i shikon tërë këto, atëherë të jesh e sigurt se e ke bërë për vete burrin dhe se ky do të durojë me gjithë zemër, që t’u udhëzosh e ta këshillosh. Përkundrazi; kur ti i jep mësimë dhe këshilla të mira, po bën vepra krejt të kundërta, atëherë mos kij asnjë pikë dyshimi se burri do të të quajë për njeri, i cili të tjera flet e të tjera bën, një njeri që nuk ka seriozitet, e si të tillë nuk do të durojë të dëgjojë për asnjë minutë. Jep këshilla të mira? Bukur. Po vetëm kjo nuk

mjafton; është e nevojshme të japësh mësimë dhe me vepra e me punë. Po cilat janë këto punë? Të mos kërkosh xhevahire, sende të arta e të shtrenjta; të mos vishesh me një mënyrë luksoze dhe me rroba që kushtojnë; por përkundrazi të jesh e kursyer në një masë të arësyeshme; të stolisesh në një mënyrë modeste; të vishesh me rroba të mira e të pastra, por jo të shtrenjta dhe jashtë mundësive financiare të burrit; të tregosh interes të veçantë për gjendjen ekonomike të shtëpisë, për buxhetin e saj, për të ardhurat e shpenzimet; të marrësh pjesë në mundimet që heq burri për të siguruar mjetet financiare të familjes dhe ta ndihmosh për këtë qëllim me anën e qeverimit të mirë të shtëpisë; të përkujdesesh pastaj që të zbukurosh jo vetëm trupin, por edhe shpirtin, sidomos këtë të fundit. Sepse burrit i pëlqen më tepër bukuria e shpirtit dhe e zemrës dhe jo ajo trupore. *(Nga kryeveprat e Gojartit, copë të zgjedhura, shqipëruar nga Prof. S. Papahristo, Kryepiskopata Orthodhokse e Shqipërisë, dega e botimeve Nr. 3, Tiranë 1944, faqe 12-14).*

Për Eutropion

Nga Joan Gojarti

Kurdoherë dhe në mënyrë të veçantë tani është koha të themi: “Kotësi e kotësive, çdo gjë është kotësi” (Ekleziasti 1,2). Ku është tashmë shkëlqimi i ofiqit që jepte uniforma? Ku janë krismat dhe vallet, shoqëritë dhe dëfrimet nëpër hipodrome dhe lajkat e spektatorëve? Të gjitha ikën. Papritmas iku ajri, fletët ranë dhe pema mbeti e zhveshur duke rrezikuar të kalbet dhe të thahet.

Ku janë tashmë miqtë hipokritë? Ku janë qejfet? Ku është banda e parazitëve dhe verërat më të mira që derdheshin gjithë ditën dhe gjellët e ndryshme? Ku janë shërbyesit fjalëmbël e servilë?

Çdo gjë ishte natë dhe ëndërr dhe sapo gdhiu u zhdukën, u vryshkën lulet pranverore, u zhduk hija, u zhduk tymi, plasi flluska e sapunit, rrjeta e merimangës u gris. Për këtë arrijmë në konkluzionin: “Kotësi e kotësive, çdo gjë është kotësi”.

Nuk të thoja shpesh se zhduket pasuria? Ti veçse nuk më honepsje. Nuk të thoja se je skllav i pavlerë? Ja ku u katandisën gjërat. Kur ti më bëje vërejtje pafund sepse të thoja të vërtetën, unë nuk e jepja veten se të doja më tepër se servilët? Nëse do të duroje plagët e mia nuk do të gënjeheshe nga puthjet e shtirura shkatërrimtare të tyre. Plagët e mia të japin shëndet, ndërsa puthjet intriguose qenë sëmundje e pashërueshme.

Ku janë vallë shërbyesit që mbushnin gotat me verë? Ku janë ata që të thurnin lëvdata të panumërta? Humbën, mohuan miqësinë dhe shihnin vetëm veten e tyre. Por ne nuk sillemi si ata. Nuk u larguam prej teje kur revoltoheshe dhe tashmë që re të gjendemi dhe të ndihmojmë. Kisha që ti luftove hapi krahët dhe të pranoi. Në të kundërt teatrot që ndiqje dhe prej tyre revoltoheshe kundër nesh të tradhëtuan dhe të shkatërruan. Ne kurrë nuk pushojmë të tërheqim vëmendjen: “Çfarë bën? Lufton kishën dhe shkon drejt shkatërrimit”! Nuk u jep rëndësi.

Hipodromet bënë rrush e kumbulla pasurinë tënde dhe mprehën tehun e shpatës kundër teje, ndërsa kisha që vuajti nga përndjekja jote e padrejtë, të vendos në gjinj të saj për të të shkëputur prej rrjetave të vdekjes. I them këto jo për të hedhur mbi të rënët, por për të të vendosur tek të drejtët. Jo për të gërvishur plagët e të plagosurit, por për të ruajtur nga të tjerët.

Krishti lindet Nga Joan Gojarti

Mister i çuditshëm dhe krejtësisht paradoksal. Zërat e barinjve arijnë deri në veshët e mi. Nuk luajnë sot me fyejt e tyre, por buzët e tyre psalltin himne qiellore. Engjëjt himnizojnë, kryeengjëjt lavdërojnë, psalltin kerubimet dhe lavdërojnë serafimet. Festojnë të gjithë duke parë Perëndinë të zbresi në tokë dhe njeriun të ngjitet në qiell.

Sot Betlehemi zëvendësoi qiellin; në vend të yjeve pranoi engjëjt, në vend të diellit pranoi diellin e drejtësisë. Mos kërko të mësosh si: “Aty ku është vullneti i Perëndisë, fiton mbi çdo gjë natyrale”. Ai pra e dëshironte dhe e bëri. Zbriti në tokë dhe shpëtoi njeriun. Të gjithë bashkëpunuan me të për këtë qëllim. Sot lindet ai që ekziston në përjetësi dhe u bë ai që kurrë nuk ekzistonte. Është Perëndi dhe bëhet njeri. Bëhet njeri dhe përsëri mbetet Perëndi.

Kur lindi, judenjtë nuk e pranuan lindjen e tij të mbinatyrshme. Nga njëra anë farisenjtë komentnin librat e shenjtë dhe nga ana tjetër shkronjësit mësonin gjëra të tjera. Irodi përsëri kërkonte të gjente foshnjën e sapolindur, jo që t’i falet, por për ta vararë. Të gjithë këta fërkojnë sytë duke parë mbretin e qiejve të zbresi në tokë me trup njerëzor të lindur nga mitra e virgjër.

Erdhën mbretërit t’i falen mbretit të lavdisë qiellore. Erdhën ushtarët t’i shërbejnë gjeneralit të fuqive qiellore. Erdhën gratë t’i falen atij që shndërroi psherëtimat e gruas në gëzim. Erdhën virgjëreshat t’i falen atij që krijoi gjinjtë dhe qumështin dhe tashmë pi nga nëna virgjëreshë. Erdhën foshnjat t’i falen atij që u bë foshnjë, për të lidhur himnin lavdërues “nga gojët e foshnjave që pijnë”.

Erdhën fëmijët t’i falen atij. Erdhën burrat t’i falen atij që u bë njeri për shpagimin nga fatkeqësitë. Erdhën barinjët t’i falen bariut të mirë, që sakrifikoi jetën e tij për hir të grigjës. Erdhën priftërinjtë t’i falen atij që u bë kryepriфт “sipas regullit të Melisedekut”. Erdhën skllëvërit t’i falen atij që mori formë skllavi për të shndërruar skllavërinë në liri. Erdhën peshkatarët t’i falen atij që i bëri “peshkatarë njerëzish”. Erdhën doganierët t’i falen atij që nga doganierë i ngriti në ungjillorë. Erdhën gratë e përdala t’i falen atij që lau këmbët e tij me lotët e një gruaje të përdalë. Me pak fjalë erdhën të gjithë mëkatarët të shohin Qengjin e Perëndisë, që ngre mbi supe mëkatin e botës:

Triumfi i kishës **Nga Joan Gojarti**

Siç vërtetohet Krishti është Perëndi. Te kjo pyetje themelore le të mos përpiqemi t’i përgjigjemi me metodën e krijimit të qiellit dhe të dheut, sepse jobsimtari nuk do ta pranojë. Le të themi se ngjalli të vdekur, shëroi të verbër, përzuri demonë, atëherë do të besojë. Nëse themi se premtoi ngjalljen e të vdekurve, mbretërinë e qiejve dhe të mirat e papërskrueshme, atëherë jo vetëm nuk do të besojë, por edhe do të qeshë.

Si do ta drejtojmë në besim dhe më saktë kur nuk është i kultivuar shpirtërisht? Sigurisht do të mbështetemi tek të vërtetat, që ne dhe ai pranojmë pa dyshimin më të vogël. Në cilën pikë biem dakort me të plotësisht? Aty ku themi se Krishti mbolli Kishën. Prej kësaj do të tregojmë fuqinë dhe do të pranojmë hyjninë e Krishtit. Do të shohim se është e pamundur të jetë punë njerëzore përhapja e krishterimit në gjithë botën brenda një kohe shumë të

shkurtër. Dhe më saktë kur morali kristian fton në jetë të lartë njerëz me zakone të këqija, sklevër të mëkatit. Dhe veçse Zoti arriti të çlirojë nga të gjitha këto jo vetëm ne, por gjithë gjininë njerëzore.

Këtë e arriti pa përdorur armë, pa shpenzuar para, pa rrezikuar ushtarë, pa shkaktuar luftëra. E arriti duke filluar me dhjetë dishepuj, që qenë të pastër, të paditur, të varfër, të zhveshur, të paarmatosur....

Me të tillë njerëz arriti të bindë kombet të mendohen drejt, jo vetëm për jetën e tashme, por edhe për atë të ardhme. Mundi të çvleftësojë ligjet e vjetra, të çrrënjosi zakone të lashta dhe të mbjellë të reja. Mundi të shkëpusë njeriun nga mënyra e thjeshtë e jetesës dhe ta drejtojë në të vështirën. Të gjitha këto i arriti, ndërsa të gjithë e luftonin, ndërsa ai duroi kryqëzim poshtërues dhe vdekje të përulur!

JERONIMI (331-420)

Jeronimi (Sophronius Eusebios Hieronymus) ka lindur në vitin 331, në Stridon të Dalmacisë nga prindër të krishterë. Studimet për retorikë, filologji dhe filozofi greke dhe latine i kreu në Romë. Në vitin 356 u pagëzua nga papa Liberi (352-361). Vite më vonë filloi të merrej me studime teologjike. Në vitin 373 udhëtoi duke kaluar nga Greqia dhe Azia e Vogël për në Antioki të Sirisë ku mësoi interpretimin e shkrimit. Pasi u shërua nga një sëmundje e rëndë mësoi hebraishten, ndërsa paralelisht punonte për të jetuar. Në vitin 377 u dorëzua pa dëshirën e tij presviter dhe shërbeu në Antioki. Ai preferoi të bënte jetë asketike. Në vitin 380 shkoi në Kostandinopojë për të mësuar pranë Grigor Teologut. Për shkak të problemeve kishtarë më 382 shkoi në Romë. Jeronimi udhëhoqi shpirtërisht një shoqëri virgjëreshat fisnike, të cilat dëgjonin me zell këshillat e tij. Prej tyre mund të përmendim Aselën, Markelën, Pavlën, Eustikian etj. Në këtë kohë duke parë aftësitë e tij, Papa Damasi e caktoi të përkthente Shkrimin e Shenjtë në gjuhën latine. Në vitin 384, priftërinjtë e Romës e akuzojnë duke shpifur për të. Kështu Jeronimi la Romën dhe u vendos në Betlehem të Palestinës ku krijoi dy manastire. Manastirin e burrave e drejtonte vetë, ndërsa atë të grave ia besoi patricias romake Paolës. Jeronimi fjeti më 30 shtator të vitit 420, në moshën 90-vjeçare. (*Moikom Zeqo, Mes laokontit dhe Krishtit, Onufri II, Medaur, Tiranë 2000, faqe 189*).

Shkrimet: a) Përkthimet. 1) *Itala*, i cili është përkthimi i Shkrimit të Shenjtë në gjuhën latine. Përkthimi i tij do të bëhej më vonë versioni zyrtar i Kishës Latine. 2) Nga hebraishtja ka përkthyer *Vulgatën*, të cilën e shkroi në Betlehem, ndërmjet viteve 391-404. 3) Nga Origjeni ka përkthyer *14 biseda mbi Jeremian* dhe *14*

biseda mbi Ezekelin. Këto i ka shkruar në Betlehem në vitin 381. Ka përkthyer 39 *biseda mbi Llukën*, 2 për *Kantikun e Kantikëve* dhe 8 *biseda për Isaian*. Këto i shkroi në Romë ndërmjet viteve 385-387.

b) Tekste historike. *Libri i Burrave të Shquar të Kishës* (De viris illustribus Ecclesiae), në të cilin flet për jetën dhe veprën e 135 personaliteteve kishtarë. Ky libër u shkrua në vitin 392, në Betlehem. Jeronimi është gramatologu i parë i perëndimit. 2) *Plotësimi i Kronikave të Eusebit*, të cilin e shkroi në Kostandinopojë në vitin 382.

c) Letra. *Për Eustikian* (As Eustochium) u shkrua në vitin 384 dhe i drejtohet një vajze të re, e cila ishte përkushtuar te Krishti dhe dëshironte ta jetonte gjithë jetën në virgjëri. Eustikia ishte e bija e Shën Paolës, njërës prej nxënësve të përkushtuara të Jeronimit. Ajo bënte një jetë të rreptë duke mohuar krejtësisht veten e saj. Duke pasur këshillues Jeronimin, ajo kishte përparuar në jetën shpirtërore. Në letrën *Për Eustikian*, Jeronimi përshkruan hapat që kaloi ajo për t'u bërë skllave e vërtetë e Perëndisë. Jeronimi flet me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.

Për Eustikian Nga Jeronimi

Dhoma jote.

a) Çfarë të bësh. Si të mendosh. Kujdesu që të ruash në çdo moment shenjtërinë e dhomës tënde. Dhëndri duhet të jetë aty brenda teje dhe të luajë me ty në çdo çast. Lutesh, flet me dhëndrin. Studion, të flet ai. Kur fillon të të zëri gjumi ai do të vijë pas murit, do të zgjasë dorën e tij nga dritarja, do të të përkëdhelë dhe ti do

të hidhesh e mbushur gjithë gëzim e do të thuash: “në e gjetshi të shtrenjtin tim, i thoni se po digjem nga dashuria” (Kënga e Solomonit 5,8). Ai do të të thotë: “Një kopësht i mbyllur me shul është motra ime, nusja ime, një kopësht i mbyllur me shul, një krua i vulosur” (Kënga e Solomonit 4,12).

b) Mos dil nga shtëpia për të shuar kureshtjen! Të mos takosh vajza nga lagje të panjohura, nëse ke vëllezër patriarkët dhe baba Izraelin. E bija e Jakovit, Dina, doli dhe e përdhuan. Nuk dua të kërkosh nëpër sheshe për dhëndër! Nuk dua që të bredhësh nëpër sokakë! Ndoshta do të më thuash: “Të lutem, lërmë të çohem e të shkoj rrotull nëpër qytet, lërmë ta kërktoj nëpër rrugë e nëpër sheshe, Atë që shpirti im ka dashur” (Kënga e Solomonit 2,3).

Nuk do të pranoj të përgjigjem. Këtë dhëndër nuk është e mundur që ta gesh nëpër sheshe. “Por e ngushtë është porta dhe e kufizuar udha që të shpie në jetë (Matheu 7,14). Në lidhje me këtë Shkrimi i Shenjtë vazhdon: “E kërkova, por nuk gjeta, e thirra, por nuk m’u përgjigj” (Kënga e Solomonit 5,6). Makar të ishe boll që atje do të gjeje atë. Atje do të marrësh plagë! Do të zhvishesh! Më pas do të të pushtojnë lotët dhe dëshpërimi. “Më gjetën atje ushtarët që patrollojnë në qytet. Më goditën. Më plagosën. Më morën rrobat dhe më lanë zhveshur” (Kënga e Solomonit 5,7).

c) Në moshën rinore. Nëse pëson diçka të tillë (kur del) ai më tha! “Unë fle, por zemra ime rri zgjuar” (Kënga e Solomonit 5,2) dhe “Vëllai im është për mua si buqetë me miro dhe do ta vë të mbijë në gjirin tim” (Kënga e Solomonit 1,13). Çfarë do të bëhet me ne, që jemi akoma në moshë të re dhe kemi detyrime që presim të hyjë dhëndri me nusen dhe ne të mbetemi jashtë (Matheu 25,12). Krishti është xheloz. Nuk do që ta shohin të tjerët fytyrën tënde.

Kujdesu të kërkosh të falur dhe në justifikimin tënd: Tërhoqa më poshtë shaminë e kokës, mbulova fytyrën dhe e pyeta. Të thashë: “Tregomë, ti që shpirti im ka dashur, se ku e kullot dhe ku e le të pushojë kopenë në kohën e drekës. Pse të bëhem si një grua e mbështjellë me të zeza ndër kopetë e shokëve të tu?” (Kënga e Solomonit 1,7).

d) A ke vetëdije? Duke dëgjuar këto fjalë do të zemrohet do të hidhërohet dhe do të thotë: “Nëse ti nuk kujdesesh të kesh vetëdije, të njohësh veten tënde, ti më e bukura e grave atëherë kërko ku është “grigja” dhe kullot pasionet e tua në tendat, aty ku presin barinj të (Kënga e Solomonit 1,7).

Domethënë thotë! “Aq e bukur sa je, kaq sa fytyra jote dëshiron Dhëndrin më tepër nga të gjitha gratë.

–Nëse nuk kujdesesh të njohësh veten tënde.

–Nëse nuk kujdesesh të ruhesh nga “çdo burg” në zemrën tënde.

–Nëse nuk u shmangesh syve të të rinjve, nga ngasjet djallëzore, do të ikësh! Do të fillosh të merresh me kecat, “delet do t’i vendosë në të djathtë, kurse cjeptë në të majtë” (Matheu 25, 33).

e) Porta. Për këtë, Eustikia ime, bija ime, zonjusha ime, bashkësklavja ime, motra ime dëgjo çfarë thotë Isaia: “Eja, populli im në arkën tënde, mbylle portën tënde, fshihu për pak, deri sa të kalojë zemërimi i Zotit” (Isaia 26,20).

Virgjëreshat e marra vrapojnë nëpër rugë (Matheu 25, 10-12). Ti mbyllu brenda me dhëndrin tënd. Përse nuk kujtohesh që të mbyllësh derën tënde dhe të lutesh sipas porosisë së ungjillit – tek Ati yt në fshehtësi (Matheu 6,6) do të vijë të trokasë në portën tënde dhe do të thotë: -Ja erdha. Kisha ndër mend portën tënde

dhe trokita. “Nëse dikush do të ma hapë derën, do të hyj brenda dhe do të darkoj bashkë me të dhe ai me mua” (Apokalipsi 3,20). Sigurisht që ti do të përgjigjesh menjëherë. “Ai është zëri i vëllait që troket: hape motra ime, e afërmja ime, pëllumbesha ime, e zgjedhura ime” (Kënga e Solomonit 5,2). Ndryshe do të jesh e detyruar t’i thuash: “Kam hequr hitonin! Si do të mund të hysh!

Çohu dhe hape menjëherë? Pa u vonuar aspak, sepse do të largohet dhe atëherë ti da ta kërkosh duke thënë: “Unë ia hapa derën vëllait tim, por vëllai kish ikur” (Kënga e Solomonit 5,6).

Për çfarë arsye e kishe mbyllur portën e zemrës së Dhëndrit? Ta hapësh për Krishtin dhe ta mbyllësh për djallin! Thotë Shkrimi i Shenjtë: “Nëse dikush nga frymërat, ai që ka pushtetin e botës përpiqet të hyjë brenda teje, mos i lër vend” (Jezekil 10,4).

ë) Dritaret. Danieli në anakoret e tij, nuk mund të rrinte në shtëpi të thjeshtë, sepse mbante hapur gjithnjë dritaret me pamje nga Jerusalemi (Denieli 6,10). Kështu të bësh edhe ti, t’i mbash vazhdimisht të hapura dritaret e tua, por vetëm nga ajo anë nga e cila vjen drita, prej ku sheh qytetin e Perëndisë. Por të mos i hapësh kurrë ato dritare për të cilat Shkrimi i Shenjtë thotë: “Vdekja erdhi nëpërmjet dyerve....(Jeremia 9,21).

Me këto fjalë Shkrimi i Shenjtë na thotë: “Vdekja shpirtërore kalon brenda jush prej dritareve tuaja nëpërmjet organeve shqisore ose prej disa pjesëve të trupit tuaj.

AMBROZI I MILANOS (339-397)

Ambrozi ka lindur në vitin 339 në Trevira të Italisë. Pas vdekjes së të atit familja e tij u vendos në Romë, ku studioi retorikë, filozofi dhe drejtësi. Në vitin 370 vajti në Milano, ku ushtroi profesionin e gjykatësit. Ai vendosi që të pagëzohet i krishterë, të bëhet anagnost dhe më pas, brenda një kohe të shkurtër, të marrë të gjitha gradat kishtarë. Më vonë u hirotonis episkop i Milanos. Ambrozi udhëhoqi grigjën e Milanos nga dhjetori i vitit 374 deri më 4 prill 397. Gjatë 23 vjetëve si episkop nuk mbajti asgjë për vete, pasi thoshte se të gjithë duhet të ndjekin rrugën që ndoqi Krishti. Ambrozi vdiq në paqe në vitin 397 në moshën 57 vjeçare. Kujtimi i tij kremtohet më 7 dhjetor.

Shkrimet: a) *Komentarë. Rreth gjashtë ditëve* (Exameron), që përbëhet nga nëntë fjalime, të cilat janë shkruar në vitin 388. ku përshkruhet në mënyrë fantastike natyra. 2) *Ekspoze e Ungjillit sipas Lukës* (Expositio Evangelii secundum Lucam), vepër në dhjetë libra. Për të shkruar këtë vepër është frymëzuar nga Origjeni. 3) *E vërteta komentuese rreth parajsës, Kainit dhe Abelit, Noes, Abrahamit, Isakut, Jakovit, Jozefit, Patriarkëve* (De paradise, de Cain et Abel, de Noe, de Abraham, de Isaac, de Iacob, de Ioseph, de Patriarchis) etj.

b) *Asketike.* 1) *Mbi detyrat e meshtarëve* (De officiis Ministrorum), me anën e kësaj vepre Ambrozi u drejtohet klerikëve të Milanos. Kjo vepër u shkrua në vitin 386. 2) *Për pendimin* (De paenitentia), e cila përbëhet nga dy libra dhe u shkrua ndërmjet viteve 387-390.

Për pendimin

Nga Ambrozi i Milanos

52. Atëherë, le të vajtojmë për pak kohë që të kemi lumturi të përhershme. Le të kemi frikë Zotin, le ta paraprijmë Atë me rrëfimin e mëkateve tona, le të korrigjojmë rebelimet dhe gabimet tona që të mos thuhet dhe për ne: “Sa i mjerë që jam, o shpirti im, sepse njeriu i perëndishëm është zhdukur nga dheu dhe midis njerëzve nuk ka njeri t’i korrigjojë ata”.

53. Përse keni frikë t’ia rrëfeni mëkatet tuaja Zotit tonë të mirë? “Fol ti vetë, - thotë Ai, - për t’u justifikuar”. Shpërblimet e drejtësisë vihen përpara atij që ende është fajtor i mëkatit, sepse është i justifikuar ai që vullnetarisht rrëfen mëkatin e tij; dhe më pas: “I drejti gjykon vetveten në fillimin e të folurit të tij”. Zoti di gjithçka, por Ai pret fjalët e tua, jo që të ndëshkojë, por të falë. Nuk është dëshira e Tij që djalli të triumfojë mbi ty dhe të të akuzojë kur i fsheh mëkatet e tua. Bëhu gjyqtar i vetvetes: nëse gjykon vetveten, nuk do të kesh frikë asnjë gjyqtar; nëse e kallëzon vetveten, edhe sikur të kesh vdekur, përsëri jeton.

54. Krishti do të vijë në varrin tënd dhe nëse atje gjen duke qarë për ty Martën, gruan e shërbesës së mirë, dhe Marien që dëgjoji fjalën e Zotit si Kisha e shenjtë që ka zgjedhur pjesën më të mirë, Ai do të ketë dhembshuri kur në varrimin tënd do të shohë lotët e shumë njerëzve dhe do të pyesë: “Ku e keni vënë?” që do të thotë në cilën gjendje të fajit është ai? Në cilin rang të pendestarëve gjendet? Dua ta shoh atë për të cilin po qani, që ai vetë të më bëjë me lotët e tij të kem dhembshuri. Do të shoh nëse ai ka vdekur për mëkatin, për të cilin kërkohet falje.

55. Njerëzit do t'i thonë Atij: "Eja dhe shih". Çfarë do të thotë "eja"? Nënkupton ardhhtë falja e mëkateve, ardhhtë jeta e të ikurit, ringjallja e të vdekurit, ardhhtë mbretëria jote te ky mëkatar gjithashtu.

56. Ai do të vijë dhe do të urdhërojë të hiqet guri që zuri rrënjë mbi shpatullat e mëkatarit. Ai mund ta hiqte gurin me një fjalë, sepse edhe natyra e pajetë i bindet urdhrin të Krishtit. Me anën e fuqisë së Tij të heshtur Ai mund ta hiqte gurin nga varri, me Pasionin e të cilit gurët papritur u hoqën dhe shumë varre të vdekurish u hapën, por Ai urdhëroi njerëzit që të hiqnin gurin që me të vërtetë të pabesët t'i besojnë atij që panë dhe të shohin të vdekurin të ngrihet përsëri, por në një mënyrë që Ai mund të na japë fuqinë e lehtësimit të barrës së mëkateve, domethënë peshës së rëndë që është mbi fajtorët. Puna jonë është ta ngremë peshën e Tij është të ngrejë përsëri e t'i nxjerë nga varret ata që janë çliruar nga prangat e tyre.

57. Kështu Zoti Jesu qan, duke parë barrën e madhe të mëkatarit. Ai ka dhembshuri për të dashurin e Tij dhe i thotë atij që ka vdekur "dil!", domethënë ti që shtrihesh në errësirën e ndërgjegjes dhe në papastërtinë e mëkateve të tua si në burgun e fajtorëve, dil, rrëfe mëkatet e tua për t'u justifikuar. "Sepse me gojë bëhet rrëfimi për shpëtim".

58. Nëse rrëfeni në thirrjen e Krishtit, hekurat do të thyhen dhe çdo zinxhir do të zgjidhet, madje dhe era e keqe e prishjes trupore do të zhduket. Sepse ishte i vdekur për katër ditë dhe mishi i tij qelbej në varr; por Ai, mishi i të cilit nuk u prish, ishte tre ditë në varr, pasi Ai nuk i njihte të këqijat e mishit që përbëhet nga substancat e katër elementeve. Sado e fortë të jetë era e keqe e trupit të vdekur, ajo largohet sapo vaji i shenjtë të lëshojë erën e tij

të mirë; dhe i vdekuri do të ngrihet përsëri, dhe jepet urdhëri për të liruar duart e atij që deri tani ishte në mëkat; hiqet mbulesa nga fytyra e tij e cila fshihte të vërtetën e hirit që ai kishte marrë. Dhe përderisa ai ka marrë faljen, jepet urdhëri për të zbuluar fytyrën e tij. Sepse ai, mëkatet e të cilët janë falur, nuk ka asgjë për t'i ardhur turp.

59. Por në praninë e një hiri të tillë të dhënë nga Zoti, të kësaj mrekullie të mirësisë hyjnore, kur të gjithë duhej të lumturoheshin, të këqinjët u ngacmuan dhe mblodhën një këshill kundër Krishtit dhe për më tepër dëshironin të vrisnin edhe Lllazarin. A nuk e kuptoni se ju jeni pasardhësit e tyre, ashpërsia e të cilëve trashëgohet te ju? Sepse edhe ju jeni të inatosur dhe mblidhni një këshill kundër Kishës, për shkak se shikoni që të vdekurit ngjallen përsëri në Kishë dhe ngrihen prapë nëpërmjet faljes së mëkateve të tyre. Dhe kështu, prej zilisë, dëshironi t'i vrisni prapë ata që u ringjallën.

60. Por Jesui nuk i tërheq dhuratat e tij, për më tepër, i rrit. Ai me padurim i bën vizitë përsëri atij që u ringjall dhe gëzohet me dhuratën e rifitimit të jetës, Ai vjen në festën që Kisha ka përgatitur për të, ku gjendet ai që ishte i vdekur si një ndër ata që ulen me Krishtin.

61. Të gjithë ata që e shikojnë me vështrimin e qartë të mendjes habiten, ata të cilët janë të çliruar nga zilia, sepse të tillë bij ka Kisha. Habitën, siç thashë, se si ai që dje dhe pardje shtrihej në varr është një nga ata që ulen me Zotin Jesu.

62. Maria vetë derdhi vaj të parfumuar te këmbët e Zotit Jesu. Ndoshta te këmbët e Tij sepse një nga më të ulëtut u rrëmbye prej vdekjes, sepse jemi të gjithë trupi i Krishtit, por të tjerë ndoshta janë gjymtyrë më të nderuara. Apostulli ishte goja e Krishtit sepse

ai tha: “Ju kërkoni provën e Krishtit që flet në mua”. Profetët me anën e të cilëve Ai foli për gjërat që do të vinin ishin goja e Tij. Qofsha i denjë të jem këmba e Tij dhe Maria të derdhë mbi mua vajin e saj të çmuar dhe të heqë mëkatin tim.

63. Çka lexojmë për Llazarin duhet ta besojmë për çdo mëkatar që ka ndryshuar, i cili megjithëse qelbej, pastrohet nga parfumi i çmuar i besimit. Sepse besimi ka një hir të tillë që atje ku i vdekuri qelbej një ditë më parë, tani e gjithë shtëpia është mbushur me një aromë të mirë.

64. Shtëpia e Korintit qelbej kur për të u shkrua: “Kudo po dëgjohet se ndër ju ka imoralitet, madje një imoralitet të tillë që as nuk zihet në gojë ndër paganë”. Kishte erë të rëndë, sepse pak maja kishte korruptuar gjithë brumin. Erdhi një erë e mirë kur u tha: “Por atij që ju do t’i falni diçka, e fal dhe unë, sepse edhe unë, nëse kam falur gjë, kujtdo që t’ia kem falur, e bëra për ju përpara Krishtit”. Dhe kështu kur mëkatarin u çlirua, në atë vend kishte një gëzim të madh dhe e gjithë shtëpia ishte mbushur me një aromë të ëmbëlsisë së hirit. Prandaj apostulli, duke e ditur shumë mirë që ai kishte derdhur mbi të gjithë vajin e çmuar të faljes apostolike, thotë: “Sepse ne jemi për Perëndinë era e këndshme e Krishtit ndër ata që shpëtohen”.

65. Pra me derdhjen e këtij vaji të çmuar të gjithë gëzohen; vetëm Juda flet kundër kësaj. Edhe tani, ai që është mëkatar flet kundër, ai që është tradhëtar ia vë fajin kësaj, por ai vetë është fajësuar nga Krishti sepse ai nuk e njeh mjetin e shërimit të vdekjes dhe nuk e kupton misterin e atij varrimi madhështor. Sepse Zoti vuajti dhe vdiq që ai të mund të na shpëtonte nga vdekja. Kjo tregohet nga vlera e shkëlqyer e vdekjes së tij e cila mjafton për faljen e mëkatarit dhe rikthimin e tij me hirin e ri; kështu që të gjithë

vijnë, habiten nga ulja e tij në tavolinë me Krishtin dhe lavdërojnë Zotin duke thënë: “Le të hamë dhe të gëzohemi sepse ky biri im kishte vdekur dhe u kthye në jetë, kishte humbur dhe u gjet përsëri”. Por njeriu i pabesë kundërshton: “Pse Mësuesi ha bukë me tagrambledhësit dhe me mëkatarët?” Kjo është përgjigja e Tij: “Nuk janë të shëndoshët ata që kanë nevojë për mjekun, por të sëmurët”.

AUGUSTINI (354-430)

Augustini (Aurelius Augustinus) ka lindur më 13 nëntor të vitit 354, në Tagasi të Numibisë. I ati quhej Patrikios dhe ishte idhujtar, por andej nga fundi i jetës së tij u pagëzua. Nëna e tij quhej Monika. Studimet i kreu më 371 në Karqidonë. Më pas në vitin 383 vajti në Romë dhe Milano, ku punoi si mësimsdhënës i retorikës. Përshtypje të madhe i bënë predikimet e Ambrozit, prej të cilit u pagëzua në vitin 387. Në vitin 391 vajti në Iponë ku u dorëzua në gradën priftërore prej episkopit të qytetit, Valerit, dhe më 396 me vdekjen e këtij të fundit u dorëzua episkop. Augustini u dallua për jetën asketike, dashurinë ndaj klerit dhe popullit, në ndeshjet me heretikët etj. Augustini konsiderohet si më i madhi nga etërit e Perëndimit prandaj është shpallur Mësues Ekumenik (Doctor Ecclesiae). Ai ndërroi jetë më 28 gusht të vitit 430, kur ishte në moshën 76 vjeçare. Kujtimi i tij kremtohet më 15 qershor.

Shkrimet: 1) *Rrëfimet* (Confessiones) në 13 libra, ku gjëja më e rëndësishme e kësaj vepre është autobiografia, e cila u shkrua rreth viteve 397-401. Në librat nga 1-9 Augustini rrëfen për jetën e tij, ndërsa në të dhjetin bën krahasimin e jetës në mëkat dhe të asaj me Krishtin. Në librat 11-13 përshruan krijimin e botës dhe të njeriut. 2) *Rishqyrtimi* (Retractationes) në 2 libra. Kjo veper u

shkrua rreth viteve 286-472 dhe përmban predikimet dhe letrat e Agustinit.

2) *Rreth Trinisë* (Di Trinitate), në 15 libra, të cilat i shkroi ndërmjet viteve 399-419. Për të shkruar këtë vepër Augustini iu deshën 20 vjet. Në kap. 1-7 Augustini flet për dogmën e Trinisë sipas Shkrimit të Shenjtë. Në kap. 8-15 flet për filozofinë sipas mendimit të etërve. Vetë Augustini ka deklaruar se të paktë janë lexuesit që mund ta kuptojnë këtë vepër.

3) *Mbi herezitë* (De Haeresibus), të cilën e shkroi në vitin 482. Në këtë vepër trajtohet lufta kundër 88 herezive duke filluar nga Simon Magjistari e deri te Pelagji.

4) *Qyteti i Zotit* (De civitate Dei), në 22 libra, të cilët i shkroi ndërmjet viteve 313-426, për të treguar se plaçkitja që iu bë Romës në vitin 410 nga Alariku ishte hakmarrja e Perëndisë ndaj shtetit që përndiqte të krishterët. Në pjesën e parë (librat 11-12) paraqitet mësimdhënia e krishterimit dhe përhapja e tij. Kjo vepër ka vlera të mëdha teologjike dhe filozofike se Augustini paraqet lakuriqësinë e qytetit të atëhershëm (civitas terrena). Kjo është vepra më e përkryer e Augustinit, prej së cilës është frymëzuar Dante kur shkroi *Komedinë Hyjnore*. (Moikom Zeqo, *Rrëfimet e Augustinit në shqip, sfida e një kryevepre mbijetuese, Ballkan, 4 mars 2007, faqe 16-17*).

Rrëfimet

Nga Augustini

Si t'i lutesh Zotit

1. Ti, o Zot, nuk je i madh e i denjë për lavdërimet më të mëdha, por më i madh është virtyti yt dhe e pafund dituria jote. Njeriu, kjo grimcë e krijimit tënd, ka dëshirë të të mburrë; ky njeri vepron përreth vdekjes së tij, vepron pas dëshmisë së mëkatit të tij dhe dëshmisë së qëndresës tënde përpara kryelartëve: Megjithatë, njeriu, kjo grimcë e krijimit tënd, ka dëshirë të të mburrë. Ti e zgjon me kënaqësinë për të kënduar lavdërimet e tua, sepse ti na ke krijuar për të, dhe zemra jonë nuk është e qetë derisa nuk prehet tek ti. Për këtë gjë, o Zoti im, më jep zgjuarsi dhe dije. A duhet të të drejtohem ty përpara se të të takoj? Si mund të të drejtohem ty pa të njohur? A ekziston rreziku, që nga padija t'i drejtohesh një gjëje, në vend të një tjetre e të keqkuptohesh? Apo mos është më mirë të drejtohem tek ty për të të takuar? Por si do t'i drejtohem atij, tek i cili nuk kanë besuar ende? Dhe si mund të besojnë, në qoftë se askush nuk e bën të njohur? Zoti do ta lavdërojë atë që ndien mungesën e tij, sepse kush e kërkon ka për ta gjetur, dhe kush e gjen do t'i bëjë lavdërimet. Unë dua të të kërkoj ty, o Zoti im, duke t'u drejtuar, si dhe drejtohem tek ti, sepse lajmërimi për ty na është dhënë. Ty, o Zot, të drejtohet besimi im, ai besim që ti më ke dhënë, ai që ndjenja njerëzore e birit tënd dhe detyra e atij që lajmëron për ty, më frymëzon.

Përse t'i lutem Zotit?

2. Si do t'i drejtohem Zotit tim, Zotit tim dhe Perëndisë, veçse duke iu drejtuar dhe duke e thirrur brenda meje? Por a ka

brenda meje një hapësirë për të pritur Zotin tim, ku të hyjë brenda ai Zot që ka bërë qiellin dhe tokën? Si? A ka tek unë një vend të përshtatshëm për të të mbajtur ty, Zoti im dhe Perëndi? Qielli dhe toka, të cilat ti i ke bërë dhe ku më ke bërë edhe mua, a të mbajnë dot? Meqenëse pa ty nuk do të kishte asgjë, mos vallë ndodh që çdo gjë të ka ty brenda vetes? Po në qoftë se edhe unë prej saj jetoj, përse vallë të kërkoj të vish brenda meje? Unë që nuk do të isha unë, në qoftë se ti nuk do të ishe tek unë. Epo, unë nuk jam ende në ferr, ndërsa ti je edhe atje. Por kur unë do të kem zbritur në ferr, ti do të jesh atje. Pra, unë nuk do të ekzistoj, Zoti im, nuk do të isha hiç asgjë, sikur ti të mos ishe tek unë. Ose më saktë, nuk do të ekzistoj sikur të mos isha tek ti, sepse çdo gjë ekziston prej teje, për ty dhe tek ti. Po, kështu është, Zoti im, kështu është! Ku të kërkoj për t' u drejtuar tek ty, nëse prej kohësh jam brenda teje, ndërsa ti, nga do të vije vallë brenda meje? Në cilat vende të fshehta përtej tokës dhe qiellit të tërhiqem, që prej tyre të vijë tek unë Zoti im që ka thënë: unë plotësoj tokën dhe qiellin?

Prania e Zotit në Univers

3. A të mbajnë dot brenda tyre qielli dhe Toka, meqenëse ti i plotëson ato, apo ti i plotëson dhe përsëri ngelet diçka nga ti, sepse ato nuk të mbajnë dot? Po ku e derdh gjithë atë që mbetet prej teje, kur ke mbushur qiell e tokë? Apo ndoshta nuk ke nevojë të jesh në asnjë mënyrë i përmbledhur, ti që përmban çdo gjë, sepse për ty, të plotësosh është të përmbledhësh? Patjetër që enët nuk janë plot me ty për të të bërë të përhershëm, sepse, edhe sikur t' i thyeje, nuk do të derdheshe. Dhe kur derdresh mbi ne, ti nuk përhapesh në tokë, por përkundrazi, na ngre ne; dhe nuk humbet ti, por bën që ne të mblidhemi tek ti. Gjithashtu, çdo gjë që plotëson,

e plotëson me të gjithë veten tënde. Mos vallë atëherë, ngaqë secila gjë nuk mund të të përmbajë të tërin, të gjitha gjërat përmbajnë prej teje vetëm një pjesë, si dhe veten e tyre? Apo secila përmban prej teje një pjesë më të madhe ose më të vogël, sipas madhësisë së saj? Atëherë a do të kishte prej teje pjesë më të mëdha apo pjesë më të vogla? Apo je i gjithi në çdo pikë, dhe asgjë nuk të përmbledh të gjithë?

Cilësi të pashprehura të Zotit

4. Çfarë je, pra, Zoti im? Çfarë, veç një Zoti që është Perëndi? E po, kush është Perëndi përveç Perëndisë? Është zot përveç Zotit tonë? Ti, më i larti, më i miri, më i fuqishmi; po, po, i plotfuqishmi, më i bukuri e më i forti, i palëvizshëm e i pakapshëm, i pandryshueshëm që ndryshon gjithçka, kurrë ndonjëherë i ri dhe kurrë ndonjëherë i vjetër; çdo gjë e rinon, si dhe i mplant kryelartët që nuk e vënë re. Ti je gjithmonë në veprim, gjithmonë në qetësi, pa qenë nevoja mbledh, mbështet, plotëson, mbron, krijon, ushqen dhe përfundon; ti kërkues, që nuk të mungon asgjë. Ti dashuron e nuk turbullohesh, je xheloz e i patundur, ti pendohesh dhe nuk të vret ndërgjegjja, ti tërbohesh dhe qëndron i qetë, ndryshon veprat, por jo mendimin; e merr atë që gjen pa e humbur kurrë, nuk do t'ia dish nga mjerimi dhe gëzohesh nga fitimi, nuk e njeh kopracinë dhe të shkon mendja te fajdeja. Ti bën çmos për të na bërë borxhlinj tek ti. Megjithatë, kush është ai që ka një gjë të vetme e që nuk të takon ty? Ti paguan borxhe, pa i pasur kujt borxh, si dhe i fal ato, pa humbur asgjë. Po ne, Zoti im, jeta ime, ëmbëlsia ime hyjnore, çfarë kemi thënë? Çfarë mund të thotë vallë ai që flet për ty? Megjithatë, mjerë ai që nuk flet për ty, sepse flet dhe është i heshtur.

Synimi i shpirtit për të fituar Zotin

5. Kush do të më bëjë të gjej qetësi tek ti, kush do të të bëjë ty që të vish në zemrën time për ta dehur? Që unë të harroj të këqijat e mia dhe ta përfaqësoj të mirën time të vetme, Ty. Çfarë je për mua? Ki mëshirë për mua, më lër të flas. Çfarë jam unë për ty, përse ti më urdhëron të të dua dhe nxehesh me inat kundër meje, në qoftë se nuk e bëj këtë gjë derisa të lëshosh mbi mua kërcënimin me goditje shumë të rënda? Sikur është pak ajo që nuk të dua! Pak mëshirë, të lutem e të përgjërohem! Zoti im, më thuaj se çfarë je për mua. Thuaji këtij shpirti se unë jam shpëtimi yt. Thuaje në mënyrë të tillë që unë ta dëgjoj. Ja, përpara gojës tënde janë veshët e zemrës simë; hapi dhe thuaji shpirtit: unë jam shpëtimi yt. Unë do të vrapoj pas për të mos vdekur, dhe do ta shoh fytyrën tënde.

E gushtë është shtëpia e shpirtit tim që ti të vish tek ajo. Bëje më të gjerë! Ajo është duke u shkatërruar. Ngrije ti përsëri në këmbë! Ajo ka me se t'i fyejë sytë e tu, unë e di këtë dhe e pranoj. Por kush do ta pastrojë përsëri? Cilit, përveç teje, mund t'i bërtas: më çliro Perëndi, ti e di: Përballë teje a nuk e ke falur mosbesimin e shpirtit tim te feja? Unë nuk diskutoj me ty, që je e vërteta. Nuk dua të gënjem, sepse paudhësia ime nuk gënjen veç veten e vet. Jo, nuk diskutoj me ty, sepse, në qoftë se do të marrësh parasysht gabimet, Perëndi, o Perëndi, kush do të mundte të duronte? (*Shën Augustini, Rrëfimet, Gjurmët e shpëtimit në dramën e jetës, përktheu Çlirim Mukli, Plejad, Tiranë 2006, faqe 15-18*).

GRIGORI I MADH (540-604)

Grigori i Madh ka lindur në vitin 540 dhe e kishte origjinën nga Roma. Në vitet 572-573 në saj të aftësive të tij, u ngrit në rang të lartë politik, të cilin e braktisi me vdekjen e të atit në vitin 575. Pasi ua shpërndau pasurinë njerëzve në nevojë, iu përkushtua jetës monakale dhe themeloi shumë manastire. Në vitin 590 u zgjodh Papë i Romës, ku aktiviteti i tij qe shumë i madh. Grigori i Madh dërgoi murgun Augustin të Kantërburit dhe një grup misionarësh për të ungjillëzuar Anglinë. U shqua si organizator i mirë dhe luftëtar i vendosur ndaj herezive, kryesisht të “Tre kapitujve”. Grigori themeloi shkollën e psalltëve, e cila u quajt *Schola cantorum*. Në vitin 587 mori titullin “Universalis Papis”. Fjeti më 604 i nderuar nga të gjithë. Kisha e shpalli shenjt dhe kremtohet më 12 mars.

Shkrimet: 1) *Libri i Dialogjeve* (Liber Dialogorum) u shkrua në vitet 593-594. Ky libër është në formë dialogu ndërmjet tij dhe kryedhjakut Petro, prandaj quhet ndryshe Grigor Dialogu. Libri përbëhen prej katër pjesësh dhe përmban *Dialog rreth jetës dhe çudive të etërve italianë*, të cilat u përkthyen greqisht prej papa Zaharias (741-752).

2) *Doracaku pastoral* (Liber Regulae Pastoralis) që u shkrua në vitin 591 dhe është vepra kryesore e tij. Libri ka ngjallur interes në qarqet kishtare të kishës romanokatolike. Kjo vepër u pëlqye në lindje. Vetë Grigori në një letër pastorale të tij, të shkruar në vitin 602, përmend se libri është përkthyer greqisht prej patrikut të Antiokisë Anastasit II (599-609). Ky përkthim fatkeqësisht ka humbur.

3) *Marali i Iobit* (Moralia in Job), në 35 libra, vepër që u shkrua në vitin 595. Këtë libër Grigori ia kushtoi mikut të tij Leandro

Sevilit. 4) Fjalime. Kanë shpëtuar 40 fjalime rreth Ungjijve. Këto u shkruan rreth viteve 591-592. 5), 6) Liturgjike. *Sacramentarium Gregorianum*. 7) Himne, të cilat quhen *Cantus Gregorianus*. 8) Letrat. Kanë shpëtuar 854 letra të Grigorit, të cilat flasin për çështje të organizimit kishtar. (*Jacques Le Goff, Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar, Toena, Tiranë 1998, faqe 484*).

Mesha e Dhuratave të Parashenjtëruara Nga Grigori i Madh

Kjo meshë bëhet në periudhën e kreshmëve të mëdha në mes të javës, veçanërisht të mërkurave dhe të Premteve, si dhe të Hënën e Madhe, të Martën e Madhe dhe të Mërkurën e Madhe. Dhuratat quhen të parashenjtëruara, se janë të përgatitura dhe të bekuara që të Dielën e mëparshme. Për këtë arësye në këtë meshë nuk bëhet Shërbesa e Blatës.....

Dhjaku: Le të vëmë re.

Prifti: Të Shenjtat e parashenjtëruara të Shenjtëve.

Kori: Një është Shenjt, një është Zot, Jesu Krishti, për lavdi të Perëndisë Atit. Amin. Ngjeroni dhe shikoni sa i mirë është Zoti. Alilluja, alilluja, alilluja.

Në këtë mes Prifti e zbulon Dhiskun dhe Dhjaku thotë: “Copëto, o Atë Bukën e Shenjtë”. Prifti e copëton në katër pjesë dhe thotë: “Copëtohet e pjesëtohet Qengji i Perëndisë, i cili copëtohet, po nuk përçahet, i cili hahet gjithnjë, po nuk mbarohet kurrë dhe i cili i shenjtëron ata që e hanë”. Prifti rregullon të katër pjesët mbi Diskun kryqthi:

Pastaj Prifti e hedh copën e markuar JS, brenda në kupë pa thënë gjë, gjithashtu shtie ujë të nxehtë.

Prifti: besoj dhe rrëfej, o Zot se ti je me të vërtetë Krishti, i Bir i Perëndisë, që erdhe në këtë botë për të shpëtuar mëkatarët,

nga të cilët unë jam i pari. Edhe besoj se ky është me të vërtetë trupi yt i kulluar dhe ky është gjaku yt i çmuar. Të lutem, pra ki mëshirë për mua dhe ndjeji mëkatet e mia me dashje a padashje, me fjalë a me punë, me dije a padije dhe vlerësomë të kungoj faqebardhë misteret e tua të shenjta për ndjesën e mëkateve dhe për jetën e amshuar.

Dhjaku: në darkën tënde mistike, o i Bir i Perëndisë, merrmë sot pjesëtar se nuk do t'u tregoj armiqve misterin, as nuk do të jap një puthje si Juda, po si kusari të thërres: Kujtomë o Zot, kur të vish në Mbretërinë tënde.

Prifti: Mos më gjykoftë dhe mos më dënoftë kungata jote, o Krisht, po ma shëroftë shpirtin edhe trupin.

Pastaj prifti thotë: “Dhjak, afrohu”. Dhjaku afrohet duke thënë: ja ku i afrohem Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë të pavdekshëm. Kungomë, o Atë me trupin dhe gjakun e çmuar të Zotit dhe Perëndisë e Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht”. Prifti i jep një copë të bukës së Shenjtë nga pjesa, e markuar KS, duke thënë: “Kungohet shërbëtori i Perëndisë (aksh) me trupin dhe me gjakun e çmuar të Zotit dhe Perëndisë e Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht për ndjesën e mëkateve dhe për jetën e amshuar. Amin”. Pastaj Prifti merr një copë të bukës së shenjtë nga pjesa e markuar KS, duke thënë: “Ja ku i afrohem Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë të pavdekshëm. Me trupin dhe me gjakun e çmuar të Zotit dhe Perëndisë e Shpëtimtarit tonë Jesu Krisht kungohem unë, Prifti i pavyer (aksh), për ndjesën e mëkateve dhe për jetën e amshuar. Amin”. Pastaj Prifti thotë me zë të ulët uratën e përhirimit.

Prifti: Të përhirojmë, o Perëndi, o Shpëtimtari i botës, për të gjitha të mirat që na ke falur, si dhe për kungatën e trupit dhe të

gjakut të Krishtit dhe të lutemi, o Kryezot njeridashës ruajna nënë hijen e fletëve të tua dhe vlerësona të kungohemi faqebardhë gjer në ditën e fundme të jetës sonë për ndriçim të shpirtit e të trupit dhe për trashëgim të Mbretërisë qiellore.

Me verën Prifti kungon pa thënë gjë, Dhjaku nuk e kungon me verën këtë herë, po në fund të meshës, gjithashtu bën edhe Prifti, nëqoftëse meshon pa Dhjak. Pastaj Dhjaku i shtie të gjitha copat e bukës në kupë, e merr kupën nga dora e Priftit dhe thotë duke shikuar popullin:

Dhjaku: Me frikë Perëndie, besë dhe dashuri afrohuni. . . .

Pastaj thotë troparin e Shën Grigorit të Romës. T. IV:

Kanon i besës dhe kor e butësisë, mësonjës i përkorës ndrite përpara besnikëve, me të vërtetën e punëve; prandaj i fitove me përunjësinë të lartat, me varfërinë të pasurat. Atë Shën Grigor, Kryeprift i madh, lutju Zotit Krisht Perëndi, të shpëtohen shpirtërat tona.

Mëshiro o Zot (12 herë). Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani e përherë dhe në jetët e jetëve. Amin. Ti je e nderuar mbi kerubim dhe e lavdëruar pa përqsasje mbi Serafim; ti me të vërtetë linde Fjalë Perëndinë. Pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

Pastaj Prifti bën Përleshimin e Shkurtër:

Prifti: Krisht, Perëndia ynë i vërtetë, me ndërmjetimet e Shën Marisë, të Shën Apostujve të lavdëruar dhe emërshkëlqyer; të Shën Grigor Homiliastit; të Shenjtit të Kishës sonë (aksh); të Shenjtit të ditës (aksh), të cilin po lusim sot; dhe të gjithë shenjtorëve; na mëshiroftë dhe na shpëtoftë si i mirë dhe njeridashës. (*Uratore e Kishës Orthodoxe, e përktheu Imzot Fan S. Noli, e botoj Peshkopata e Amerikës, Boston, Mass. 1941, faqe 149-178*).

ETËR TË LINDJES

EFREM SIRIANI (306-373)

Efremi ka lindur në vitin 306 në Siri. Prindërit e tij ishin të krishterë besimtarë. Kur Siria u pushtua prej persëve, Efremi u largua për në Edesa. Pasi u largua nga Edesa jetoi e asketoi për disa vite. Më vonë shkoi në Çezare për të takuar Vasilin e Madh. Ky i fundit e hirotonisi dhjak në vitin 338. Oshënari i mbushur me hir Perëndie ishte kaq i arsyeshëm sa që fjalët e tij mund të zbutnin çdo shpirt, të ngushëllonin të trishtuarit dhe të qetësonin nevojtarët. Efremi dorëzoi shpirtin e tij te Perëndia në vitin 373. Kisha e shpalli shenjt dhe kujtimin e tij e kremtojmë më 28 janar.

Shkrimet: 1) Nga komentaret ka shpëtuar *Për Gjenezën* dhe *Për Eksodin*. 2) Ka shpëtuar një *Testament i Efremit* ku flitet për këshillat e mësuesit të madh ndaj dishepujve të tij. 3) *Jonai dhe nevitët* ku tregohet se Jonai u porosit nga Perëndia që të shkonte në kryeqytetin e shtetit asirian, ku do të predikonte pendimin e banorëve të Nievit. Jonai nuk iu bind porosisë, por dëshironte të shkonte me anije në qytetin spanjoll Tartiso. Në udhëtim e sipër deti u egërsua në saj të vullnetit hyjnor dhe marinarët e ndëshkuan fajtorin duke e hedhur në det. Jonain e gëlltiti një peshk i madh. Brenda në barkun e peshkut, profeti i lutet Perëndisë për tri ditë e tri netë dhe ky i fundit urdhëron që dallgët ta nxjerrin peshkun në bregun e detit. Pas kësaj ngjarjeje, Jonai shkon në qytetin e Nievit për të predikuar shkatërrimin e tij. Rreth kësaj ndodhie bën fjalë fjalimi i Efremit *Jonai dhe nevitët*.

Jonai dhe nevitët

Nga Efrem Siriani

Profeti Jona pasi shpëtoi nga dhëmbët e balenës dhe doli nga deti, filloi të predikojë te banorët e Nievit, që qenë idhujtarë. Filloi t' u predikojë pendimin, ashtu siç e kishte porositur Perëndia. I këshillonte të pendoheshin, sepse në rast të kundërt qyteti i tyre Nievi brenda tri ditësh do të rrënohej.

Predikimi profetik i befasoi nevitët, të cilët u frikësuan dhe u mallëngjyen nga cepi në cep të qytetit. Zemrat e popullit dhe të udhëheqësve u copëtuan, sepse qyteti i tyre i shpresave rrezikohej të shkatërrohej. Pasi dëgjuan zërin e profetit, mbretërit u trembën. Ata u përlën deri në atë masë sa flakën kurorat mbretërore dhe u gjuhëzuan në pendim. E dëgjuan udhëheqësit dhe u shqetësuan, hoqën rrobat e shkëlqyeshme dhe veshën tesha me qime në shenjë përlësie. E dëgjuan pleqtë dhe futën kokat në hi. E dëgjuan të pasurit dhe menjëherë ua shpërndanë pasurinë të varfërve. E dëgjuan fajdexhinjtë dhe i grisën menjëherë defterët e tyre. E dëgjuan borxhlinjtë dhe rendën të shlyenin borxhet. E dëgjuan vjedhësit dhe kthyen menjëherë sendet e grabitura. E dëgjuan viktimat dhe thanë se sendet e grabitura nuk qenë të tyre duke ua lënë përsëri në duart e vjedhësve. E dëgjuan vrasësit dhe rrëfyer krimet e tyre duke mos llogaritur frikën e gjykatësve. E dëgjuan gjykatësit dhe i falën, sepse brenda atij mallëngjimi të papërshkrueshëm askush nuk kishte kurajo të gjykonte. E dëgjuan mëkatarët dhe rrëfyer për veprat e tyre të këqija. E dëgjuan skllëverit dhe u përlën ndaj zotërve të tyre. E dëgjuan të pasurit dhe flakën fodullëkun e tyre.

Me pak fjalë, filloi çdonjëri të kujdesej për shpëtimin e tij dhe t’i lutej Perëndisë. Nuk ekzistonte më askush që të donte të keqen e tjetrit. Të gjithë tashmë kishin vetëm një qëllim: Të fitonin shpirtin e tyre. Të gjithë filluan të bënin bamirësi dhe të kërkonin ndjesë! Profeti Jona, në Nievi qëndronte si mjek, i cili hapte plagët dhe i pastronte me barna shëruese. Për bisturi përdorte zërin e tij të frikshëm. Nuk i ftonte që të pendoheshin. I mbyllte portën e shpresës për t’u frikësuar dhe të ndalonin të keqen, që e lindnin shpirtat e sëmurë. Hiri i Perëndisë nuk e dërgoi në atë qytet për ta shkatërruar, por për ta shpërfytyruar. Dëgjoji Nievi paralajmërimin e tij dhe me keshmë dhe lutje u kthye në udhën e drejtë duke treguar se ishte ndrequr dhe kërkonte strehë të Perëndia. Përse e ndryshoi vendimin e tij?

Ndaluuan darkat e bollshme të arhondëve. Pasi foshnjat e tyre pushuan së piri, cili do të ishte ai që do të kërkonte kënaqësinë e ushqimeve të shijshme? Pasi kafshëve nuk u jepnin as ujë, cili prej tyre do të pinte verë? Pasi mbreti veshi rroba me qime, cili do të vishej me rroba të kushtueshme? Pasi panë të ndreqeshin gratë e rrugës, cili do të bënte dasmë që të martonte fëmijët e tij me to? Pasi të çrregulltit u mblodhën nga frika, nga cila gojë do të dilte e qeshura? Pasi të gjithë qanin dhe mbanin zi, cili do të argëtonte? Pasi vjedhësit u vetëgjykuan për bëmat e tyre, cili do të abuzonte? Pasi qyteti do të humbiste, cili do të ruante shtëpinë e tij?

Floriri ishte hedhur përtokë dhe të gjithë e përçmonin. Arkat e thesarit qenë të hapura dhe askush nuk afrohej të merrte. Njerëzit e dhënë pas epsheve mbyllën sytë që të mos shihnin gratë e bukura. Dhe gratë fshiheshin për të mos skandalizuar burrat. Çdonjëri shikonte t’i bënte mirë fqinjët me qëllim që të shpëtonin të gjithë. Çdonjëri nxiste tjetrin me lutje dhe rrëfim. Çdonjëri kujdesej të

mos mëkatonte. Kështu i gjithë qyteti u bë një trup. Çdonjëri lutej jo vetëm të shpëtonte veten, por edhe për shpëtimin e të gjithëve, sepse të gjithë rrezikoheshin nga shkatërrimi. Të drejtët luteshin për mëkatarët dhe mëkatarët i luteshin Perëndisë të dëgjonte të drejtët.

Shfaqja e dytë **Nga Efrem Siriani**

Të dashur vëllezër, dëgjoni për shfaqjen e dytë të tmerrshme të Zotit tonë Jesu Krisht. Në këtë moment solla në mendjen time atë moment dhe u tremba kur mendoj për sa pritet të ndodhin kush mund t' i tregojë? Cila gjuhë mund t' i përshkruaj? Cili vesh do të mund t' i dëgjojë? Atëherë kur mbreti i gjithësisë do të ngrihet nga fronti i lavdisë dhe do të vijë për të gjykuar gjithë banorët e tokës dhe do të llogarisë ndërmjet tyre duke shpërblyer të drejtët dhe duke dënuar mëkatarët në ferrin e përjetshëm.

Kur përmend këto, në mendjen time më sundon frika dhe paralizohem i gjithë. Sytë e mi lotojnë, zëri më ndërpritet, buzët më ngrijnë, gjuha më dridhet dhe pasionet ndalojnë. Nëse frika më shtyn të hesht detyrohem të flas për hir të dobësisë suaj. Do të ndodhin ngjarje të mëdha dhe të frikshme, që nuk kanë ndodhur që nga krijimi i botës, as do të ndodhin në gjithë brezat.

Nëse një rrufe e fuqishme na tromaks shpesh herë dhe na pret këmbët, pa të dëgjojmë zërin e trumpetës që do të buçasë nga qielli me forcë nga çdo bubullimë, për të zgjuar të gjithë të vdekurit, të drejtët dhe të padrejtët?

Atëherë gjithë eshtrat e të vdekurve do të shpejtojnë të bashkohen. Do të urdhërojë mbreti i madh, i cili sundon mbi gjithë

krijesën dhe menjëherë me dridhje toka dhe deti do të japin të vdekurit e tyre. Akoma dhe gjithë ata që u shqyen nga egërsirat ose i hëngrën peshqit, ose shpendët grabitqarë, të gjithë sa hap e mbyll sytë do të paraqiten përpara syrit të gjykuesit të paanshëm. Atëherë lumenjtë dhe burimet do të zhduken, yjet do të bien, dielli do të shuhet, hëna do të humbasë.

Engjëjt e dërguar nga Perëndia do të çajnë rruzullin dhe do të grumbullojnë gjithë të zgjedhurit nga çdo anë e tokës. Atëherë do të shohim “qiej të rinj dhe tokë të re” (Letra II e Petros 3,13) sipas premtimit të Zotit. Si do të durojmë kur të shohim të përgatitet froni i tmerrshëm dhe të dalë kryqi mbi të cilin u sakrifikua Krishti me dëshirën e tij për ne! Kur të shohim në qiell skeptrin e shenjtë të Vasilit të Madh dhe do të kujtojmë dhe do të kuptojmë fjalët e Zotit “rreth shenjës së Birit të Njeriut” (Matheu 24,30) dhe do të njoftohemi të gjithë se bëhet fjalë të shfaqet Mbreti i tmerrshëm. Atë moment çdokush nga ne do të dëshmojë dhe do të mendojë gjithë veprat e tij, kur të dëgjojë zërin kumbues nga lartësitë e qiellit: “Ja Dhëndri vjen”, “Ja Gjykuesi mbërriti për të gjykuar të gjallët e të vdekurit”, atëherë nga kjo e thirrur do të tunden themelet dhe në skajet e tokës nga një anë deri në tjetrën. Atëherë, vëllezërit e mi, mërzia dhe frika do të pushtojë çdo njeri për ato që do të ndodhin në gjithësi.

Fuqitë e qiejve do të tunden, do të hapen qiejtë dhe do të paraqitet Mbreti i mbretërve, Perëndia i shenjtë dhe i lavdishëm si një vetëtimë e tmerrshme me pushtet dhe lavdi të papërshtuar.

KIRILI I JERUSALEMIT (313-386)

Kirili i Jerusalemit ka lindur në vitin 313 në Jerusalem. Në vitin 343 u dorëzua presviter dhe më 348 Kryeepiskop i Jerusalemit. Kirili iu kundërvu me forcë arianëve. Mitropoliti arian i Çezaresë së Palestinës, Akaci, i ndihmuar dhe nga perandori Konstand më 357, arriti ta shkarkonte dhe ta internonte Kirilin në Sinodin e Jerusalemit. Akuza ndaj tij ishte sikur gjatë një periudhe urie kishte shitur disa enë të shenjta për të ushqyer të varfërit. Kirili shkoi në Kiliki të Azisë së Vogël. Sinodi i vitit 359 mbajtur në Selfekia, e rehabilitoi, por një sinod tjetër i Akacit në Kostandinopojë e dënoi përsëri. Me ardhjen në fron të Julian Paravatit, Kirili u kthye në selinë e tij, ku e prisnin përpjekje dhe ankthe të reja. Në kohën e mbretërimit të Ualit (364-378) u internua përsëri. U kthye pas vdekjes së këtij të fundit, në vitin 378, dhe udhëhoqi grigjën për 8 vjet. Kirili ndërroi jetë në vitin 386.

Shkrimet: 1) 24 *Katekizmat* të cilat i mbajti në mënyrë të improvizuar në vitin 350 në Kishën e Ngjalljes para të katekizuarve, që u ndriçuan pas pagëzimit të tyre ditën e Pashkës. *Katekizmat* u realizuan në saje të dëgjuesit stenograf. 2) *Për Kostandinin* bën fjalë për shenjën e ndritshme të Kryqit. Kjo letër u shkrua në Jerusalem, më 351, gjatë festës së Pesëdhjetores. (*Arkimandrit Justini, Nga thesari i Shenjtorëve, Tiranë 2004, faqe 106-107*).

Katekizmi i parë

Nga Kirili i Jerusalemit

I cili u bë në Jerusalem, si hyrje për ata që do të pagëzohen dhe leximi nga Isaia në pjesën “Lyhuni dhe bëhuni njerëz të pastër, largoni të ligat nga shpirtat tuaj që të jeni të pastër përpara meje” si dhe në vazhdim...

1- Nxënës të Dhiatës së Re dhe kungues të mistereve të Krishtit, tani, sigurisht me ftesën por më vonë me hirin, “rimëkëmbni zemrën tuaj dhe shpirtin tuaj” që të bëhet shkak kënaqësie në forcat qiellore. Sepse, në qoftë se, sipas Ungjillit, për një mëkatar që pendohet bëhet gëzim, aq më tepër do t’i shkaktojë gëzim ose shpëtimin aq shpirtave në forcat qiellore. Përderisa nisët rrugën e mirë dhe të pëlqyeshme përshkoni rrugën e devotshmërisë me shprestari. Sepse Biri i Vetëmlindur i Perëndisë që qëndron në krahun tuaj është gati t’ju dhurojë shpëtimin duke thënë: “Ejani afër meje sa jeni të lodhur dhe të ngarkuar dhe unë do t’ju shplodh”. “Sa nga ju keni veshur rrobën e rëndë të mëkateve dhe jeni lidhur me zinxhirët e mëkateve tuaja dëgjoni zërin profetik që thotë : “Lahuni, pastrohuni, largoni nga prania ime ligësinë e veprimeve tuaja, mos bëni më keq”, që të thërrasin për ju kori i engjëjve : “Lum ai të cilit i kanë falur shkeljen, ai të cilit i kanë mbuluar mëkatin”. Pikërisht tani, sa nga ju ndezët lambadhat e besimit, i mbani në duart tuaja të ndezura, që Ai që hapi dikur, këtu, në këtë Golgotha Parajsën për kusarin, për shkak të besimit të tij, t’ju denjësojë të psallni himnin nusëror.

2- Në qoftë se ka këtu ndonjë skllav të mëkatit le të përgatitet me besimin të pranojë rilindjen e lirë të adaptimit dhe mbasi të braktisë skllavërinë aq të keqe të mëkateve dhe të përfitojë

skllavërinë e lumtur të Zotit, të denjësohet të trashëgojë mbretërinë e qiejve. Hiqni nga ju me rrëfimin si një rrobë tjetër veten tuaj të vjetër që prishet nga dëshira e mëkatit mashtrues që të vishni njeriun e ri, i cili rimëkëmbet gjatë njohjes së Atij që e krijoi. Përfitoni me besimin, fejesën e Shpirtit të Shenjtë që të mundeni të bëheni të pranueshëm në mbulesën qiellore. Ejani të merrni vulën mistike që të njiheni lehtë nga Zoti. Numërohuni nga e djathta duke trashëguar jetën e përgatitur për ju. Sepse sa mbajnë akoma rrobën e rëndë të mëkateve ata gjenden në të majtën e Perëndisë sepse nuk erdhën në hirin e Perëndisë që u dha nëpërmjet Krishtit me rilindjen e pagëzimit. Dhe rilindje nuk kuptoj të trupit por rilindjen shpirtërore të shpirtit. Sepse vërtet trupat linden nga prindër të dukshëm ndërsa shpirtrat rilinden me besimin “sepse Shpirti që do merr frymë”. Dhe kur bëhesh i denjë atëherë do të dëgjosh “Të lumtë shërbëtor i mirë dhe besimtar” përderisa sigurisht do të gjendesh që të mos kesh në ndërgjegjen tënde asnjë nga papastërtitë e hipokrizisë.

3-Në qoftë se dikush nga ju që gjendeni këtu mendon se mundet të provojë hirin, gënjen vetë veten dhe mohon fuqinë e tij. Njeriu im kije shpirtin tënd të sinqertë pa hipokrizi përpara Atij që kontrollon thellësitë e zemrave tona. Sepse ashtu si ata që thërrasin për ushtarë, kontrollojnë nga mosha dhe nga trupat ata që shkojnë ushtarë, ashtu edhe Zoti duke i rreshtuar në ushtri shpirtrat, kontrollon mendimet dhe në qoftë se gjen brenda në shpirt të fshihet hipokrizia ndjek njeriun si të papërshtatshëm për mobilizimin e vërtetë. Por në qoftë se kupton se është i denjë jep menjëherë tek ai hirin. “Nuk jep të shenjtat te qentë” por ku sheh të ketë mendim të mirë atje jep shpëtimin dhe vulën e mrekullueshme, së cilës i tremben demonët dhe njohin engjëjt me qëllim që demonët të ikin duke nxituar ndërsa engjëjt ta mbrojnë si mikun e tyre. Pra tek ata

që marrin këtë vulë shpirtërore dhe shpëtimtare është e domosdoshme dhe mendimi i përshtatshëm. Sepse ashtu si pena që shkruajmë ose gjilpëra nevojiten ata që do t'i venë në veprim, ashtu dhe për hirin që të veprojnë nevojitet dëshira e besimtarëve.

4- Pra nuk merr armë që prishen por shpirtërore. Mbillesh tashmë në Parajsën e kuptueshme. Merr emër të ri që nuk e kishe më parë. Para kësaj ishe katikumen ndërsa tani do të quhesh besimtar. Mbillesh pra në ulla të prodhues nga ulla të egër shartoresh në ulli të butë, nga mëkatet në drejtësi, nga infeksionet në pastërti. Bëhesh hardhi në vreshtin e shenjtë. Dhe në qoftë se qëndron në vresht do të rritesh dhe do të bëhesh hardhi frutdhënëse, ndërsa në qoftë se nuk qëndron do të digjesh nga zjarri. Le të paraqesim pra fruta të denja. Mos na ndodhtë neve ajo që ndodhi me fikun e pafrutshëm dhe të vij në një moment Krishti dhe të na mallkojë për pafrutshmërinë tonë. Por të gjithë të themi “unë jam si ulliri mbushur plot me fruta brenda në shtëpinë e Perëndisë”(sepse mbështes përgjithmonë shpresat e mia në mëshirën e Perëndisë). Sigurisht ulli jo i dukshëm por me kuptim që jep dritë. Pra vepër e Perëndisë është mbjellja dhe ujitja ndërsa jotja frutdhënia. Vepër e Perëndisë është të japë hirin ndërsa jotja ta pranosh dhe ta mbash. Të mos përbuzësh hirin sepse të jepet falas por mbasi ta marrësh ruaje me devotshmëri.

5-Tani është koha për rrëfim. Rrëfe të gjitha sa bërë me fjalë, me vepra, natën ose ditën. Rrëfeu tani që është koha e përshtatshme dhe prano thesarin qiellor tani që është dita për shpëtimin tënd. Merr pjesë në eksorkizmat, të ndjekësh katekizmat dhe të kujtosh aq sa do të thonë. Sepse thuhet jo vetën që t'i dëgjosh por dhe t'i vulosësh me besimin ato që mëson. Largo nga ti çdo kujdes njerëzor, sepse nxiton për shpirtin tënd. Braktis

patjetër gjërat e botës. Ato që braktis janë të parëndësishme, ndërsa ato që dhuron Zoti janë me vlerë të madhe. Braktis të tashmet dhe beso tek e ardhmja. Kalove kaq vite duke u marrë kot me botën dhe nuk mundesh të përkushtosh dyzet ditë për shpëtimin e shpirtit tënd: “Merruni dhe mësoni se unë jam Perëndia” thotë Shkrimi. Lërnini bisedimet e kota. Të mos akuzosh as të dëgjosh me gëzim atë që akuzon, por të jesh gjithmonë gati për lutje. Trego me stërvitjen tënde forcën e zemrës tënde. Pastro enën e shpirtit tënd që të pranosh sa më shumë hir. Sepse falja e mëkateve u jepet njësoj të gjithëve, ndërsa kungimi i Shpirtit të Shenjtë dhurohet në përputhje me besimin e çdonjërit. Në qoftë se mundohesh pak do të marrësh pak , në qoftë se do të punosh shumë do të jetë e shumtë edhe paga jote. Për veten tënde nxito, mendo interesin tënd.

6-Në qoftë se brenda teje ke diçka kundër dikujt, fale. Vjen që të marrësh faljen e mëkateve të tua, është e domosdoshme të falësh dhe ti atë që mëkatoi. Sepse me ç’fytirë do t’i thuash Zotit “falmë mëkatet e mia të shumta” ndërsa ti nuk fale as të paktat e bashkëshërbëtorit tënd? Nëpër mbledhjet të jesh i kujdesësh. Jo vetëm tani që klerikët kërkojnë të kujdesesh, por edhe pas pagëzimit. Sepse në qoftë se atë që bën përpara se të marrësh hirin është e mirë, nuk është e mirë edhe mbasi të marrësh hirin. Në qoftë se vaditja dhe kultivimi janë të nevojshme përpara shartimit, atëherë nuk janë më shumë të nevojshme mbas mbjelljes? Përpiqu për shpirtin tënd veçanërisht këto ditë. Ushqe shpirtin tënd me lexime të shenjta. Sepse Zoti të përgatiti tryezë shpirtërore. Thuaj dhe ti si dhe Psallmuesi “Zoti është bariu im, asgjë nuk do të më mungojë, Ai më çon në kullota me bar të njomë, më drejton pranë ujërave që të çlodhin. Ai ma përtërin shpirtin” që të ngazëllohen bashkë me

mua dhe engjëjt. Dhe vetë Krishti, Kryepriifti i madh mbasi pranon dëshirën tuaj të mirë, duke ju ofruar juve të gjithëve do t' i thotë Atit të tij: “Ja unë dhe djemtë që mi dha Perëndia”. Pra ky Perëndi t'ju ruaj të gjithëve ju kështu që ta falënderoni. Sepse Atij i përket lavdia në shekuj të pafund. AMIN. *(Përktheu nga anglishtja, Kristo Kume).*

Ngjallja e të vdekurve Nga Kirili i Jerusalemit

Rrënja e çdo vepre të mirë është shpresa e ngjalljes. Pritja e shpagimit nxit shpirtin në mirësi. Punëtori që shpreson në shpërblimin e mundit të tij është i gatshëm të durojë çdo vështirësi. Ndërsa ata që lodhen të pashpresë për shpërblim, shumë shpejt do ta braktisin punën. Ushtari që pret të marrë medaljen është gati për luftë. Veçse askush nuk tregohet i gatshëm të rrezikojë për hirin e mbretit mendjelehtë, që nuk shpërblen bëmat e ushtarëve të tij.

Me të njëjtën mënyrë çdo shpirt, kur beson në ngjalljen dhe në shpërblimin e ardhshëm, kujdeset për veten e tij. Ndërsa kur nuk beson në ngjalljen dhe gjykimin e ardhshëm, jepet në mëkat dhe në katastrofë. Ai që beson se trupi i tij do të ngjallet, kujdeset për të dhe nuk e njollos me jetë të shturur. Ndërsa cili nuk beson në ngjalljen, bie në mëkat dhe keqpërdor si të huaj trupin e tij.

Është e rëndësishme dogma e kishës sonë të shenjtë, e cila bën fjalë për ngjalljen e të vdekurve. Mësimdhënia e Ortodoksisë është e rëndësishme. Ndërsa nga shumë dyshohet, nga e vërteta vërtetohet. Idhujtarët thonë të kundërtën, samaritanët nuk besojnë, heretikët e shtrembërojnë dogmën. Shumë kundërshtime, veçse e vërteta është një.

Na thonë kundërshtarët: Vdiq njeriu dhe u varros. U kalb në tokë dhe zuri krimba. Por edhe krimbat ngordhën. Pra trupi u shkatërrua dhe u zhduk. Si do të ngjallet? Na thonë akoma: “Sa njerëz u mbytën, u bënë ushqim për peshqit, por edhe këta u hëngrën nga peshq të tjerë më të mëdhënj. “Sa u ndeshën me egërsirat, u bënë ushqim për arinj të dhe luanët, të cilët hëngrën kockat e tyre. Skifterët dhe korbat, pasi hëngrën kufomat e braktisura të të vdekurve në dhe, fluturuan dhe u shpërndanë larg. Si do të grumbullohen përsëri pjesët e trupit? Ndodh me shpendët grabitqarë që hëngrën të vdesin larg, dikush në Indi, dikush në Persi dhe tjetri në Evropë. Si do të montohen trupat e atyre që u dogjën dhe rëra ose shiu ka shpërndarë edhe hirin e tyre?

Për të gjitha këto do të përgjigjemi: Për ty gjëja më e vogël dhe e pamundur për njeriun sigurisht është shumë larg India nga Gjermania dhe Spanja nga Persia. Për Perëndinë veçse, që mban në dorë gjithë tokën janë të gjitha të afërta. Pra mos akuzo Perëndinë, duke filluar nga dobësia jote, por të shohësh gjithëfuqinë e Tij.

Dielli, një krijesë e vogël brenda krijesës së pafund, mundet që me rrezet e tij të shërojë gjithë tokën; dhe ajri si krijesë e Perëndisë e mbështjell. Perëndia që krijoi edhe diellin edhe ajrin, gjendet larg nga ne? Supozo nëse përziën farëra të llojeve të ndryshme dhe i merr në grushtin tënd. Është e vështirë ose e lehtë për ty, si njeri të dallosh llojet e ndryshme dhe t’i grumbullosh sipas llojit? Pra ti mundesh të veçosh gjithë sa ndodhen në dorën tënde, Perëndia vallë nuk mund të dallojë dhe të ndajë sa gjenden në dorën e Tij?

Pendimi

Nga Kirili i Jerusalemit

A. Mëkati është e keqe e tmerrshme dhe sëmundje e shpirtit. E pret me dinakëri dhe paralizon duke e hedhur në zjarrin shekullor. Është e keqe që varet nga dëshira jonë. Është fryt i vullnetit tonë. Mëkati është e keqe e madhe, por jo e pashërueshme. Atë e shëron vetëm pendimi. Për sa kohë e mban dorën tënde në zjarr, patjetër që do të digjet. Veçse sapo e tërheqim, pushon së djeguri. E njëjta gjë ndodh me mëkatin, që është një zjarr, i cili djeg njeriun. Për ata që nuk e ndjejnë këtë djegie thotë Shkrimi i Shenjtë: “Do të hidhet dikush në zjarr dhe nuk do të djegë rrobat e tij”.

B. Mëkati nuk është ndonjë armik që të lufton nga jashtë, por mbin dhe kultivohet brenda teje. “Shihe me mençuri” (Proverbat 4, 25) dhe nuk do të ndiesh dëshirë të turpshme. Të mendosh për gjykimin e ardhshëm dhe jo për kurvërinë, tradhëtinë, vrasjen, as të qenët që do të të pushtojë “kur harron Perëndinë nuk do të fillosh të mendosh dinakërisht dhe të veprosh në mënyrë të ngjashme.

C. Në mëkat të shtyn djalli i keq. Të shtyn, por nuk mundet të bëjë që të mëkatosh nëse ti nuk e kundërshton. Nuk mundet të të dëmtojë, akoma dhe për vite të të skandalizojë nëse ke zemrën e mbyllur. Nëse pa dashje pranon ndonjë dëshirë të keqe që të shtyn, do të të skllavërojë dhe do të të hedhë në gropën e mëkateve. Por ndoshta do të thuash: “A është e mundur në besim dhe nuk do të më sundojë dëshira e neveritshme sa shpesh nëse e pranoj”. Duket se nuk ke njohuri se edhe gurin shpesh herë e copëton një rrënjë që mbetet. Pra mos prano farën e mëkatit sepse do të të shkatërrojë besimin. Çrënjose të keqen, përpara se të mbijë, ndoshta duke përzënë në fillim plogështinë më vonë do të dënohesh

dhe do të provosh sqeparin dhe zjarrin. Përpiqu të shërohesh në kohë, kur gjendet në fillim defekti i syrit, për të mos bredhur kot nëpër doktorë kur je verbuar.

D. Djalli mëkatoi i pari dhe shkakton gjithë të këqijat. Këtë nuk e them unë, por Zoti: “Nga fillimi djalli mëkatoi” (Let. I e Joanit 3,8). Askush nuk kishte mëkatuar përpara tij. Mëkatoi djalli pa e detyruar askush. Sepse atëherë përgjegjës për mëkatin do të ishte Perëndia. Ai u gatua i mirë prej Tij. Mëkatoi veçse me dëshirën e tij dhe prej kësaj u quajt djall. Ndërsa ishte kryeengjell u katandis të shpifë d.m.th. të shpifë ndaj Perëndisë protoplastëve dhe prandaj u quajt djall. Ai ishte shërbëtor besnik i Perëndisë, por u bë satana, d.m.th. armik dhe kundërshtar i Perëndisë. Sepse fjala satana komentohet ai që gjendet në të kundërt d.m.th. kundërshtar.

Djalli pas rënies së tij çoi shumë në apostazi. Ai mbjell dëshirat mëkatore tek ata që e ndjekin. Prej tij vjen tradhtia, kurvëria dhe çdo e keqe tjetër. Ai e çoi Adamin në mosbindje dhe në dënim. Nga shkakut e tij Adami në vend të parajsës që lulëzonte nga frytet e shumta trashëgoi tokën që lëshonte gjemba.

GRIGORI I NISËS (335-395)

Grigori i Nisës ka lindur në vitin 332. Ai ishte vëllai i vogël i Vasilit të Madh dhe mësimet e para i mori nga vëllai i tij, Vasili prandaj Grigori e quan atë mësues. Pasi përfundoi shkollën e mesme në Neoçezare vajti për studime në Çezare me qëllim që të bëhet mësues retorike. Grigori u martua me Theosevinë, por martesja e tyre nuk zgjati shumë dhe mbeti i ve. Në moshën 40-vjeçare, i shtyrë nga vëllai i tij Vasili që atëherë ishte Kryepiskop i Çezaresë, vendosi të pranonte Episkopatën e Nisës. Në vitin 379 Grigori mori pjesë në Sinodin e Antiokisë ku u dënua herezia e Apolarit. Grigori fjeti në vitin 395. Kujtimin e tij e kremtojmë në 10 janar.

Shkrimet: 1) Dogmatike. *Fjala drejtuar Anomion* e cila u shkrua gjatë viteve 380-383, dhe përbëhet nga katër fjalime nën titullin: Rreth apologjisë gjatë së cilës Anomion kundërshton padrejtësisht Vasilin e Madh. Kjo veper është nga më të mirat e Grigorit dhe bën pjesë në literaturën kundërrarianiste. 2) *Rreth jetës së Moisiut* ose *mbi virtytin e përkryer* që u shkrua në vitet 390-392. Në pjesën e parë të veprës, Grigori përdor metodën historikogramatike të komentimit, ndërsa në pjesën e dytë hedh idetë e tij alegorike.

Mbi virtytin Nga Grigori i Nisës

1. Ajo që ndodh me ata të cilëve u pëlqen të ndjekin garat me kuaj dhe që, nga dëshira që fitimtar të jetë kalorësi për të cilin brohorasin, megjithëse këtij të fundit nuk i mungon prirja për të rendur, që lart ndjekin me vështrime garën dhe si të munden nxisin

kalorësin të vrapojë më shpejt, ndërsa, në të njëjtën kohë u thërrasin kuajve e në vend të kamxhikut tendosin e tundin duart drejt kuajve, jo se gjestet e tyre luajnë ndonjë rol në rezultatin përfundimtar, por, të shtyrë prej simpatisë për ata që ndeshen, nëpërmjet zërave dhe gjesteve duan të tregojnë dëshirat dhe interesin e tyre, kështu, pra, diçka të ngjashme po bëj dhe unë, o më i shtrenjti im ndër miqtë dhe vëllezërit. Teksa ti ndeshesh me maturi në garën e virtytit, në udhën hyjnore dhe me më shumë forcë vrapon drejt medaljes së thirrjes hyjnore me hapa të shpejtë e të lehtë, unë, me të thirrurat e mia të nxis të ngutësh edhe më, të shtosh më shumë shpejtësinë dhe seriozitetin. Këto nuk i bëj i shtyrë nga ndonjë mani e palogjikshme, por që të ofroj gjithçka që mund të të kënaqë, si biri im i dashur që je.

2. Meqë letra që më dërgove para pak kohësh më shtronte këtë kërkesë, pra, të të shkruaj një letër me këshilla për jetën e përsosur, mendova, meqë në fjalët e mia mund të mos ketë asgjë të dobishme, të të shkruaj për bindjen, gjë që do të jetë e dobishme për ty. Nëse unë, që jam në vendin e atit të kaq shpirtave, mendoj se me gjithë flokët e bardhë që kam, duhet të pranoj kërkesën e rinisë së matur, është më e natyrshme që një i ri të bindet vullnetarisht, që të pasqyrohet tek ti veprimi i drejtë i bindjes së gatshme, sikundër të kam mësuar.

3. Kaq sa për këtë. Le të vijojmë drejt qëllimit që vura, duke pasur Perëndinë udhëheqës në fjalët e mia. Më kërkove, i dashuri im, të të përvijoj se cila është jeta e përsosur. Është e dukshme se ky është qëllimi yt; nëse atë që kërkon e gjen në fjalët e mia, merre dhe vëre në jetë hirin që do të shohësh në fjalët e mia. Në të dyja rastet unë jam i pazot: se, që fjalët e mia të përmbajnë përsosmërinë dhe, atë që do të them me fjalë ta dëshmoj në jetë,

them se edhe njëra edhe tjetra janë tej fuqive të mia. Dhe, ndoshta, nuk jam i vetëm, pasi shumë prej të mëdhenjve të virtytit dhe prej atyre që janë të shkëlqyer në virtyt do të pohojnë se e kanë të vështirë.

4. Por, duke përdorur fjalët e psallmistit, që të mos dukem se trembem edhe atje ku s'ka gjë për t'u trembur, do të të paraqes qartë atë që dua të të them.

5. Përsosmëria e gjithçkaje që mund të matet nëpërmjet shqisave është e shenjuar me kufij të përcaktuar. Masa e çdo sasive i përmbahet caqeve të saj. Ai që ka para sysh pashin apo dhjetëshen e numrit, di se nga të fillojë e ku të përfundojë për të pasur të përsosurën. Për virtytin mësuam nga apostulli përkufizimin se për të nuk ka përkufizim. Apostulli i madh, i shenjtë e mendjethellë, duke vrapuar gjithmonë në garën e virtytit, asnjëherë nuk reshti së shkuari gjithnjë e më përpara. Për të vendi në garë nuk ishte i sigurtë. Pse? Pasi çdo e mirë nuk ka kufi në natyrën e saj, por kufizohet nga prania e së kundërtës së saj. Ashtu sikundër jeta kufizohet me vdekjen, drita me errësirën dhe, përgjithësisht, çdo e mirë përfundon me gjithçka që konsiderohet si e kundërta e saj.

6. Ashtu sikundër fundi i jetës është fillimi i vdekjes, ashtu dhe fundi i udhës të së mirës është fillimi i rrugës të së keqes. Fjalët e mia nuk dolën të gënjeshtërtë, kur thoja se virtyti është e pamundur të kufizohet në përsosmëri. Sepse u vërtetua se çka kufizohet brenda caqesh nuk është virtyt. Thashë se ata të cilët ecin në udhën e virtytit e kanë të pamundur të arrijnë në përsosmëri. Edhe kjo do të qartësohet.

7. E mira e parë dhe kryesore, natyra e së cilës është mirësi, është vetë hyjnorja. Ky është emri i saj dhe njihet prej natyrës. Meqë u provua se virtyti nuk ka kufizim tjetër veç së keqes dhe

hyjnorja nuk e pranon të kundërtën e saj, përfundojmë se natyra hyjnore kuptohet si e pacak dhe e pafund. Por, ai i cili ushtrohet në virtytin e vërtetë, nuk merr pjesë në asgjë tjetër, veç në Perëndinë, sepse ai është virtyti i përkryer. Përderisa ata të cilët e dinë se cila është natyra e së mirës dëshirojnë të marrin pjesë në të dhe përderisa kjo e mirë nuk njih kufij, dëshira e pjesëmarrësit nuk ndalet askund, por shtrihet bashkë me të pakufishmin.

8. Përfundimisht, është kryekëput e pamundur për dikë të arrijë përsosmërinë, pasi përsosmëria, sikundër thamë, nuk kufizohet brenda caqesh dhe përkufizimi për virtytin është vetëm një: e pakufishmja. Atëherë, si mund të arrish në cakun që kërkon, përderisa nuk ka asnjë cak?

9. Ndërkaq, meqë deri këtu provuam se përsosmëria është tërësisht e pakapshme, kjo nuk do të thotë se duhet të lëmë mënjanë porosinë e Zotit që thotë: “Të bëheni të përsosur si Ati juaj qiellor”. Për sa u përket të mirave nga natyra e tyre, megjithëse nuk është e mundur t’i arrish të gjitha, për të mençurit do të ishte fitim i madh të mos humbnin qoftë edhe një pjesë të tyre.

10. Duhet, pra, të tregojmë zell të madh se mos shmangemi përfundimisht prej përsosmërisë që synojmë të arrijmë, por, duke ecur drejt së mirës, le ta bëjmë tonën aq sa është e mundur. Kjo prirje, pra, të duash gjithmonë të kesh më shumë të mira, kjo është përsosmëria e natyrës njerëzore.

11. Për këtë rast mendoj se është e udhës të marr për shembull Shkrimin. Sepse diku Perëndia, nëpërmjet profecisë së Isaisë, thotë: “Ktheni vështrimin nga Abrahami, ati juaj dhe nga Sara që ju ka lindur”. Këtë porosi u jep Shkrimi gjithë atyre që enden jashtë virtytit. Ashtu sikundër ata, të cilët deti u ndryshoi kursin për në port, duke parë një zjarr që lartohet nga një vend i

lartë, apo duke parë një kreshtë mali, me të njëjtën mënyrë Shkrimi kërkon të kthejë pas në limanin e vullnetit hyjnor ata që enden mendjehumbur në detin e jetës duke u dhënë shembullin e Sarës dhe të Abrahamit.

12. Por, meqë natyra njerëzore ndahet në mashkullore dhe femërore dhe, zgjedhja e virtytit apo së keqes është lënë njëlloj në dëshirën dhe pushtetin e cilësdo palë, për këtë, që më parë Shkrimi na dha shembullin e duhur të virtytit. Kështu, secili duke kthyer sytë nga korrespondentja e tij, pra, burrat duke parë Abrahamin dhe gratë Sarën, të dyja palët, nëpërmjet këtyre shembujve, udhëhiqen te virtyti.

13. Ndoshta do të na mjaftonte të përmendej ndonjëri nga ata që u treguan të suksesshëm në jetë, për të zëvendësuar shenjën e zjarrit dhe të na tregojë si arrihet të drejtohet shpirti në limanin e qetë të virtytit, pa u lëkundur aspak nga tronditjet e jetës dhe të mos fundoset në fund të së keqes nga tallazet e njëpasnjëshme të pasionit. Ndoshta për këtë arsye kemi një përshkrim kaq të hollësishëm të jetës së atyre burrave të lartë, në mënyrë që nëpërmjet imitimit të shembujve të tyre të drejtojmë jetën tonë drejt së mirës.

14. Por, do të thotë ndonjëri, ç' do të ndodhë nëse unë nuk jam kaldeas, siç ishte Abrahami, as jam ushqyer nga bija e Egjiptit, siç ishte Moisiu? Asgjë në jetën time nuk ngjan me ndonjë nga këta burra të lashtë. Atëherë, si të vendos veten time në një radhë me njërin prej tyre, përderisa nuk mund të imitohet me veprat e mia atë që është kaq larg prej meje? Dhe ne do të përgjigjemi. Të jesh kaldeas nuk e konsiderojmë as të keqe, as virtyt, as do të lëmë njeri jashtë prej jetës së virtytit për shkak se ka jetuar në

Babiloni apo në Egjipt. Nuk themi se “Perëndia u bëhet i ditur të denjëve vetëm në Jude”, as se Sioni, siç mendohet zakonisht, është banesa e Perëndisë. Duhet të mendojmë më hollë e të vështrojmë më thellë që të shohim prej historisë se prej cilëve kaldeas a egjiptas, prej cilës robëri babilonase duhet të çlirohemi që të shkelim në tokën e jetës së lumur.

15. Le të marrim si shembull Moisiun. Le të tregojmë shkurtimisht jetën e tij, ashtu siç na e mëson Shkrimi hyjnor dhe, kështu, të kërkojmë kuptimin e duhur të historisë, që të kemi një imazh të virtytit, nëpërmjet të cilit do të kuptojmë se cila është jeta e përsosur e arritshme prej njerëzve.

16. Thuhet, pra, se Moisiu lindi atëherë kur ligji i sunduesit u ndalonte jetën fëmijëve meshkuj dhe se nëpërmjet hirit mori me bollëk gjithçka që mund të merrte atëkohë. Madje, që në shpërgëj, meqë ishte fëmijë i hijshëm, i bëri prindërit të mos e vrisnin e të mos e zhduknin.....(*Marrë nga Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks*).

8 Kanonet e Grigorit të Nisës

1. Ky kanon është për trajtimin e sëmundjeve shpirtërore. Ai thotë që shpirti mund të vështrohet në tre pjesë dhe ne duhet të njohim se cila pjesë është e sëmurë me qëllim që ta shërojmë atë. Tre pjesët janë: a) arsyeja, që ka si virtyte, respektin dhe besimin për Perëndinë dhe urtësinë për të zgjedhur ndërmjet së mirës dhe së keqes. Si vese, dëshirën e ambicjes, bukurinë e trupit, dashurinë për kënaqësi. b) dëshiruese, që ka si virtyte, dëshirën për atë çka është e mirë dhe përdorimin e gjithë fuqisë për të dashur atë objekt, që është Perëndia dhe si vese, dëshirën e ambicjes, bukurinë e trupit, dashurinë për kënaqësi. c) afektive, që ka virtyte, urrejtjen

e mëkatit, luftën kundër pasioneve dhe trimërinë e shpirtit, dhe si vese, urrejtjen për të afërmin, grindjen, smirën dhe prirjen hakmarrëse.

2. Etërit i kanë çmuar mëkatet e arsyes si më të rënda dhe që kanë nevojë për një pendesë më të madhe. Për shembull, ai që mohon Krishtin, do të marrë një pendesë për gjithë jetën, që i mbetet deri në shtrat të vdekjes.

3. Për ata që kanë shkuar te magjistarët duhet caktuar arsyeja. Në qoftë se kanë shkuar sepse ata braktisën besimin e tyre në Krishtin, ata konsiderohen njëlloj si ata që e mohuan Atë, në qoftë se vajtën për arsye nevojë, dhunë, torture, sëmundjeje ose ndonjë shprese të prerë prej humbjes, por përsëri besojnë në Krishtin, ata duhen gjykuar me butësi, njëlloj si ata që e mohuan Atë nën torturë.

4. Ky kanon i referohet mëkatit të marrëdhënieve seksuale dhe bën dallimin ndërmjet marrëdhënieve seksuale para martesë, shkeljes së kurores, homoseksualizmit dhe marrëdhënieve seksuale me kafshët. Ata që kryejnë marrëdhënie seksuale para martesë, duhet të marrin një pendesë prej 3 vjetësh, kurse ata që kryejnë aktet e tjera, marrin një pendesë prej 6 vjetësh. Në qoftë se një peson rrëfen vetë mëkatin, pendesa mund të ulet sepse kjo është “provë që shërimi i sëmundjes tashmë ka filluar”.

5. Ndryshimet ndërmjet vrasjes së vullnetshme dhe të pavullnetshme janë shpjeguar (e vullnetshme duke qenë e paramenduar ose që ndodh gjatë një përleshjeje). Pendesa për vrasje të vullnetshme është 27 vjet dhe për të pavullnetshme 9 vjet. Ati shpirtëror mund ta reduktojë atë, në qoftë se personi tregon pendim.

6. Ky kanon merr në konsideratë gjendjen e tretë të shpirtit dhe disa mëkate të lidhura me të. Ai përmend sakrilegjin, vjedhjen dhe grabitjen e varreve. Vjedhja ndahet në dy kategori: e hapur dhe e fshehur. Vjedhja e hapur vihet nën pendesë si vrasja, përderisa ai që bën këtë është thujse gati të vrasë. Vjedhja e fshehtë vihet nën pendesën që, personi që ka vjedhur t’u japë të varfërve gjithë

ç’i përkasin atij; në qoftë se nuk ka asgjë, le të punojë e t’u japë të varfërve.

7. Grabitja e varreve ndahet në dy klasa: e falshme (ku kockat nuk janë trazuar dhe zbukurimet janë marrë për përdorim pozitiv dhe të dobishëm); e pafalshme (ku kockat janë trazuar dhe gjërat janë marrë për përfitime personale).

8. Ndëshkimi për sakrilegjin (vjedhja e gjërave kushtuar Perëndisë) në Dhiatën e Vjetër konsiderohej i barabartë me vrasje, por Etërit e kanë ulur këtë në më pak se pendesa e shkeljes së kurorës. Ati shpirtëror duhet t’i kushtojë më shumë vëmendje pritjes së personit që është nën pendesë, sepse vetëm kohëzgjatja e pendesës nuk është e mjaftueshme për shërim. Më shumë është vullneti i lirë dhe zelli i mëkatit që po vetëtrajtohet me pendim. (*The Rudder (Pedalion)*, përkthyer nga Aleksandra Koço, Luna Printing Co, Nju Jork 1983, page 39).

Rreth lutjes “Ati ynë”

Nga Grigori i Nisës

3. Mos i shumfisho shkaqet e dhimbjes.

Kur i lutemi Perëndisë: “Bukën tonë të përditshme, epna neve sot”, nuk kërkojmë as kënaqësi, as pasuri, as veshje të stolisura me lule, as stoli të florinjta, as gurë të çmuar, as veshje të argjendta, as prijësin luftarak dhe qeveritarin e kombeve. Nuk kërkojmë tufa me kuaj dhe buaj, kope me bagëti, as pafajësinë e skllëvërve, as radhë të shkruara me mozaikë, as fotografi, as basma të mëndafshhta, as programe muzikore dhe asgjë tjetër të ngjashme. Të gjitha këto e shkëpusin shpirtin prej kujdesit të shenjtë dhe të rëndësishëm.

Por kërkohet nga Perëndia vetëm bukën tonë të përditshme. Shihni sa e gjerë është kjo procedurë? Sa të vërteta përmbledhen me këtë frazë të shkurtër? Me këtë fjalë thërret zemra e atyre që kuptojnë: Qëndroni o njerëz dhe mos shpërndahemi në gjëra të kota me dëshirat tona. Pushoni të mos shtoni shkaqet e rënda të dhimbjeve. Detyrimi yt ndaj natyrës është i vogël. Në torbën ku mban bukën gjëja që është e matshme dhe e lehtë të porositësh, nëse natyrisht sheh plotësimin e nevojës.

Përse e shton peshën e taksës tënde? Për çfarë arsye e solle veten dhe skllavërohesh me sa e sa detyrime? Kërkon për argjend te metalet dhe nxjerr flori, kërkon materialin e tejdukshëm; vetëm e vetëm që të hajë mirë stomaku yt, ai faktorino, i cili pandërprerë mbledh tatimet? Për stomakun është e rëndësishme buka që do të plotësojë nevojën për trupin.

Ti veçse bën udhëtime tregtare në Indi dhe duke hasur rreziqe në detet e barbarëve dhe mundon veten tënde në udhëtime detare që zgjasin me vite, për të shijuar ushqimin me sa mundesh të sjellësh prej andej. Dhe nuk mendon se ato ndjenja që shkaktojnë kënaqësinë përfundojnë në qiell. Akoma dhe ai që ka pamje të mirë dhe në aromë është i shijshëm të sjell ndjenjën dhe kënaqësinë e çastit. Tutje nga qielloret nuk dallon asnjë ndryshim në atë që e sjell, pasi natyra ndryshon gjithçka në pjesë të barabarta drejt erës së keqe.

Fara e mirë e nikoqirit është gruri. Dhe prej grurit bëhet buka. Ndërsa kënaqësia është thekra, të cilën e mbolli armiku bashkë me grurin. Veç kur njerëzit mbeten t’i shërbejnë natyrës me sa është e domosdoshme, atëherë me të vërtetë “mbyten” nga kujdesi i kotë dhe mbesin të pazhvilluar shpirtërisht, pasi shpirti merret vazhdimisht me ato.

KIRILI I ALEKSANDRISË (375-444)

Kirili ka lindur në vitin 370 në Aleksandri. Nikodhim Agjioti në sinaksarin e tij thotë se Kirili ka jetuar në vitet e mbretërisë së Teodosit. Prindërit e tij ishin shumë shprestarë. Në kujdesin e xhaxhait të tij, Teofilin të Aleksandrisë, Kirili studioi teologji dhe filozofi. Gjatë periudhës së ushtrimit të tij në shkretëtirë u lidh me asketin e famshëm Isidor Pilusiotin, të cilin e nderonte shumë. Rreth vitit 400 u hirotonis dhjak e më pas prift nga Teofili i Aleksandrisë. Në vitin 412 u fronëzua Patriark i Aleksandrisë. Sapo hipi në fron përzuri nga perandoria heretikët dhe skizmatikët novatianë. Kur u bë Sinodi III Ekumenik në Efes, në vitin 431, Kirili ishte kryetar dhe kontribuoi në kundërshtimin e herezive të Nestorit. Kirili u shqua si teolog i madh dhe mbrojtës i ortodoksisë kundër nestorianizmit. Kirili vdiq në vitin 444. Kisha e shpalli shenjt dhe kujtimin e tij e kremton më 9 qershor. (*Atë Justini, Kirili i Aleksandrisë, Ngjallja, janar 2005, faqe 10*).

Shkrimet: a) Dogmatike. 1) *Libri i thesareve rreth Trinisë së Shenjtë dhe të njëqenëshme* e cila përbëhet prej 35 kapitujsh dhe është shkruar rreth viteve 420-425. 2) *12 anatemat kundër Nestorit* që u shkruan në vitin 430. b) Fjalime. Kanë shpëtuar 22 fjalime të Kirilit të Aleksandrisë, të cilat i ka mbajtur në Efes dhe Aleksandri. c) Letrat. Kanë shpëtuar 29 letra paskale, të cilat janë shkruar ndërmjet viteve 414-442. Letrat flasin për tema praktike dhe morale.

Mbi njëshmërinë e Krishtit Nga Kirili i Aleksandrisë

A. Njerëzit me arsye të drejtë e të shëndoshë, që kanë mbledhur në mënyrë intelektuale gjithë atë njohuri që jep jetë, kurrë nuk janë lodhur së studiuar shkencat e shenjta. Dhe me të vërtetë është shkruar: “Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë”.

B. Sa drejt që e ke.

A. Të urtët dhe gojtarët në mes të paganëve janë të mbushur nga admirimi për fraza të përpunuara bukur. Njëri nga shqetësimet e tyre kryesore ka të bëjë me elegancën e të shprehurit. Ata janë të mbushur nga entuziazmi i tepërt për stil të mirë dhe krenohen shumë nga përdorimi mjeshtëror i fjalës. Materiali bazë për poetët e tyre mbështetet kryesisht te ritmi dhe metri i gënjeshtërt për hir të hijeshisë dhe të harmonisë, e sa për të vërtetën, ata kanë fare pak ose aspak kujdes. Mund të themi se ata janë të sëmurë nga mungesa e një nocioni të vërtetë apo të saktë të natyrës së Perëndisë. Ose, ashtu siç e thotë edhe i shumë shenjti Pal: “U bënë të pamend në arsyetimet e tyre dhe zemra e tyre pa gjykim u errësua. Duke e deklaruar veten të urtë, u bënë të marrë, dhe e shndërruan lavdinë e Perëndisë së pakalbshëm në një shëmbëllim të ngjashëm me atë të një njeriu të kalbshëm, të shpendëve, të kafshëve, katërkëmborëve dhe të rrëshqanorëve”.

B. Pikërisht kështu. Dhe Perëndia foli për ta nëpërmjet zërit të Isaias: “Një person i tillë ushqehet me hi, zemra e tij e mashtron, e çon në rrugë të keqe”.

A. Por mjaft me kaq për ta. Sa për shpikësit e herezive të përlyera, të profanëve dhe apostatëve, që kanë hapur gojën vesh

më vesh kundër lavdisë hyjnore, “njerëz që do të flasin gjëra të çoroditura”, ne mund t’i akuzojmë se shkanë me marrinë e tyre aq poshtë sa edhe vetë paganët e pamend, ndoshta dhe më poshtë, pasi do kishte qenë më mirë të mos e kishin njohur kurrë rrugën e së vërtetës, sesa, pasi ta kishin njohur, t’i kthenin shpinën urdhërimit të shenjtë që u është dhënë. Për çfarë flet mjaft qartë libri i proverbave, ajo në të vërtetë ka ndodhur: “Qeni u kthye në të vjellat e veta dhe dosa e larë u kthye të zhgërryhet në llucë”. Ata kanë qarkulluar mes tyre akuza blasfemie kundër Krishtit dhe si ujqër të egër shkretojnë grigjën për të cilën Krishti vdiq. Ata plaçkisin atë që është e vetë Atij “duke grumbulluar gjëra që nuk janë të tijat”, siç është shkruar, dhe “duke mbushur barqet plot”. Sa me vend u shkon kjo thënie atyre që “mes nesh dolën, por nuk ishin nga tanët”.

B. Me të vërtetë që nuk ishin.

A. Pra, kjo është një mundësi për ne që të marrim parasysh doktrinën e njerëzve të tillë. Disa janë aq të marrë sa të zbresin Fjalën dhe Birin e Vetëmlindur të Perëndisë nga vendi i tij suprem. Ata e zvogëlojnë atë nga barazia me Perëndinë Atë, duke mohuar bashkëqenshmërinë e tij dhe duke refuzuar që ta kurorëzojnë atë me të njëjtin identitet në natyrë. Të tjerët, pak a shumë, ndjekin të njëjtën rrugë si atë që sapo përmendëm. Ata bien në kurthet e vdekjes dhe “në thellësinë e Sheolit”, ndërkohë që shtrembërojnë misterin e ekonomisë së mishërimit të Vetëmlindurit duke predikuar një marrëzi, që në një farë mënyre është binjake me atë të pararendësve të tyre. Në fakt, grupi i parë, aq sa ç’ mund të përmblihet brenda fuqisë së tyre, tërheq poshtë nga lartësitë e hyjshmërisë Fjalën e lindur nga Perëndia Atë që përpara mishërimit; ndërkohë që grupi i dytë ka vendosur t’i shpallë luftë Fjalës edhe

në mishërimin e tij. Këta të pacipë, kanë guxuar të kritikojnë edhe hirin e tij të dashurisë ndaj racës njerëzore, nga fakti që duroi mish mbi vete dhe mori kufizimet e kësaj vetë-zbrazeje, pra, u bë njeri dhe “kështu ajo edhe u shfaq mbi tokë dhe banoi mes njerëzve”, megjithëse ishte Perëndi nga natyra dhe qëndroi me Atin, gjithë kjo tregon mungesën e arsyes së shëndoshë.

B. Sa drejt që e thua.

A. Megjithatë, Shkrimi i frymëzuar nga Perëndia do të buçasë kundër që të dy këtyre formave të çmendurisë. Ai vepron si ambasador i së vërtetës dhe tregon sistemin e dobët dhe të turpshëm të këtyre njerëzve. Ai vendos në rrugën e Perëndishmërisë të gjithë ata që janë mësuar t’i mbajnë sytë e mendjes plot kujdes dhe vëmendje mbi këtë mister. Por përsëri do të doja të pyesja për këta njerëz, që kanë poshtëruar ekonominë e respektuar dhe të papërshkrueshme me fjalë të Perëndisë. Sigurisht që në një farë mënyre kjo çështje të shqetëson.

B. E ke vënë re shumë drejt, “më nxiti një zell i madh për Zotin”, kjo gjë na ka goditur aq fort, sa që tani jam shumë i shqetësuar. Dhe kam frikë kur shoh se deri ku do të shkojë ky mësim i tyre, pasi kanë përdhosur besimin që na u dha, nga shpikjet e atij gjarprit që ka nxjerrë kokë kohët e fundit, duke injektuar mendimet e tyre të vakëta, të çoroditura dhe idiote, si helm në shpirtrat e njerëzve të thjeshtë.

A. Por më thuaj të lutem, kush është ky gjarpër që ka nxjerrë kokën kohët e fundit? Dhe cilat janë këto idiotësi që nxjerr kundër mësimave të së vërtetës?

B. Gjarpri që ka dalë kohët e fundit ishte një i pandershëm me gjuhën plot helm. Ai jo vetëm që nuk mirëpret traditën e gjallë të të parëve në mbarë botën (apo të gjithë shkrimeve të frymëzuara

nga Perëndia), por ai madje paraqet gjëra të tjera si t'i vijë për mbarë, mohon se Virgjëresha e shenjtë është Nëna e Perëndisë dhe përkundrazi, e quan Nëna e Krishtit ose Nëna e Njeriut, për të mos përmendur idetë e tjera tronditëse dhe të pakuptimta që u paraqet mësimëve të pastra ortodokse të Kishës katolike.

A. Më duket se po flet për Nestorin. Tashmë kam njëfarë njohurie për mendimin e tij, por sa për natyrën e saktë të këtij mendimi, miku im, nuk jam edhe aq i sigurt. Si mund të thotë se Virgjëresha e shenjtë nuk është Nëna e Perëndisë?

B. Ai këmbëngul se ajo nuk ka lindur Perëndinë, pasi Fjala ishte para saj, ose ka ekzistuar para çdo kohe, duke qenë i bashkëqenshëm me Perëndinë.

A. Në këtë rast është e qartë se ata duhet që gjithashtu të mohojnë se Emanueli është Perëndi dhe kështu do të duket se Ungjilli e ka interpretuar termin pa vend kur ka thënë që e kthyer do të thotë «Perëndia me ne». Dhe përsëri, meqenëse ai është Perëndi i bërë njeri, kjo është pikërisht mënyra se si duhet ta quajmë atë që është lindur nga Virgjëresha e shenjtë sipas mishit, ashtu si Perëndia Atë na e mëson qartë nëpërmjet zërit të Profetit.

B. Por nuk është e njëjta gjë me këta njerëz. Ata thonë se Perëndia, apo më mirë Fjala e Perëndisë, ka qenë me ne në formën e një ndihmësi. Pasi ai shpëtoi gjithçka nën qiell nëpërmjet atij që u lind nga gruaja

A. Por më thuaj, a nuk ishte ai me Moisiun kur nxori izraelitët nga toka e Egjiptit dhe nga tirania, siç edhe është shkruar: “me dorë të fuqishme dhe krahë të shtrirë”? Dhe pas kësaj, a nuk e gjejmë t'i thotë Jozeut fare qartë: “Ashtu siç kam qenë me Moisiun, kështu do të jem edhe me ty”?

B. Kjo është e vërtetë.

A. Atëherë, përse asnjëri prej tyre nuk quhet Emanuel? Përse ky emër përdoret vetëm për atë që në mënyrë kaq të habitshme u lind nga një grua sipas mishit, në këtë kohë të fundit?

B. Atëherë si duhet ta kuptojmë se Perëndia lindi nga një grua? Mos kjo do të thotë se Fjala e mori qenien në të dhe prej saj?

A. Larg prej këtij opinioni të tmerrshëm e të poshtër! Këto janë mendimet e një heretiku, të një mendjeje të sëmurë që ka marrë atë rrugë në të cilën nuk duhet të shkonte për të menduar se qenia e pashprehshme e të Vetëmlindurit të mund të jetë fryt i mishit. Përkundrazi, si Perëndi Ai ishte pashprehshmërisht i lindur prej natyre nga Ati dhe ishte i bashkëpërjetshëm me të. Për ata që duan të dinë qartësisht se si dhe në çfarë mënyre ai u shfaq në një formë si e jona dhe u bë njeri, ungjillori hyjnor Joan na e shpjegon kur thotë: “Dhe Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; dhe ne soditëm lavdinë e tij si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë”.

B. Por ata mbahen te kjo se, nëse Fjala u bë mish, ai nuk mbeti më Fjalë, por pushoi së qeni ai që ishte.

A. Kjo s’është gjë tjetër veçse budallallëk dhe çmenduri, tërbimi i një mendjeje të rrjedhur. Duket se ata janë të mendimit se termi “u bë” në mënyrë të paevitueshme dhe domosdoshmërisht nënkupton ndryshim ose këmbim.

B. Ata thonë se këtu qëndron çështja dhe e mbështesin mësimin e tyre edhe ata mbi bazat e shkrimeve të frymëzuara nga Perëndia. Pasi ai i qëndron asaj që është thënë diku për gruan e Lotit se “ajo u bë një statujë prej kripe” dhe përsëri për bastunin e Moisiut: “Ai e hodhi për tokë, dhe ai u bë një gjarpër”, dhe se në të gjitha këto raste ka ndodhur një ndryshim prej natyre.

A. Po atëherë, kur këndohet në psallmet “Perëndia im është streha në të cilën gjej mbrojtje”, dhe përsëri “O Zot, u bëre streha ime, brez pas brezi”; çfarë do të thonë ata për këtë? Ai të cilin ne i këndojmë mos ka lënë mënjane të qenit si Perëndi dhe nëpërmjet ndonjë transformimi ka ndryshuar dhe është shndërruar në strehë? Është shndërruar prej natyre në diçka tjetër, në të cilën nuk ka qenë në fillim?

B. Sigurisht që ky përngjasim është i pavend dhe i papërshtatshëm për atë që është Perëndi prej natyre. I pandryshueshëm prej natyre, ai mbetet ai që ishte dhe që është përgjithmonë, megjithëse dikush mund të thotë “u bë strehë” për njerëz të ndryshëm.

A. Ajo që the është e përsosur dhe plotësisht e vërtetë. Kështu, kur flasim për Perëndinë, në qoftë se dikush përdor fjalën “u bë”, a nuk është jobesimtare dhe e pakuptim për dikë që të marrë me mend se ajo nënkupton ndryshim, sesa të përipiqet ta kuptojë atë në një mënyrë tjetër, duke përdorur pak urtësi dhe duke iu kthyer asaj që është shumë më e përshtatshme dhe e zbatueshme për të pandryshueshmin Perëndi?

B. Në qoftë se na duhet të ruajmë pashumueshmërinë dhe pandryshueshmërinë si parësore dhe esenciale për Perëndinë, në çfarë kuptimi atëherë duhet të themi se Fjala u bë mish?

A. I gjithëdituri Pal, administratori i mistereve të Tij dhe i ngarkuari i shenjtë i shpalljeve të Ungjillit, na e shpjegon kur thotë: “Kini në ju po atë ndjenjë që ishte në Jesu Krishtin, i cili, edhe pse ishte në trajtë Perëndie, nuk e çmoi si një gjë ku të mbahej fort për të qenë barabar me Perëndinë, por e zbrazti veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit; dhe duke u gjetur nga pamja e jashtme posi njeri, e përuli vetveten duke u bërë i

bindur deri në vdekje, madje deri në vdekje kryqi”. Dhe me të vërtetë, Fjala e Vetëmlindur, megjithëse ishte Perëndi dhe i lindur prej natyre nga Perëndia “shkëlqimi i lavdisë së tij dhe vula e qenies” së atij që e lindi atë, ishte ai që u bë njeri. Ai nuk e ndryshoi vetveten në mish, ai nuk përjetoi ndonjë përzierje apo shkrirje ose diçka tjetër të këtij lloji. Por ai e nënshtroi veten në të zbrazurit dhe “për gëzimin që ishte përpara tij, duroi kryqin duke përçmuar turpin” dhe nuk e përbuzi varfërinë e natyrës njerëzore. Si Perëndi ai deshi ta bënte këtë mish, i cili ishte nën kthetrat e mëkatit dhe të vdekjes, me të vërtetë më të lartë se mëkati dhe vdekja. Ai e bëri atë të vetin dhe jo pa shpirt, siç kanë thënë disa, por e gjallëroi me një shpirt racional, dhe kështu e riktheu mishin në atë që ishte në fillim. Ai nuk e konsideroi si diçka të ulët të ecte sipas këtij plani dhe kështu pra thuhet se ai ka pësuar një lindje si e jona, ndërkohë që mbeti ai që ishte. Ai lindi nga një grua sipas mishit në një mënyrë të çuditshme, pasi ai është Perëndi nga natyra, i padukshëm dhe jotrupor, dhe vetëm në këtë mënyrë, në formë si e jona, ai mund t’u paraqitej krijesave tokësore. Ai e mendoi se ishte mirë të bëhej njeri dhe në personin e tij të shfaqte natyrën tonë të lavdëruar me madhësinë e hyjnisë. Po ky ishte në të njëjtën kohë Perëndi dhe njeri dhe ishte “i ngjashëm me njerëzit” dhe megjithëse ishte Perëndi ai ishte “në pamje pors i njeri”. Ai ishte Perëndi, me pamje si e jona, Zoti në formën e shërbëtorit. Këtë duam të themi kur flasim se u bë mish dhe për të njëjtat arsye e pranojmë virgjëreshën se është Nëna e Perëndisë....(*Përktheu nga anglishtja, Kristo Kume*).

5 Kanonet e Kirilit të Aleksandrisë

1. Një episkop i quajtur Pjetri ankohej që ishte çhirotonisur padrejtësisht, pa një proces gjyqësor. Shën Kirili shkruan që t'i bëhet një proces gjyqësor që ai të rimarrë detyrën e tij ose të gjykohet zyrtarisht, në mënyrë që të mos ankohet.

2. Përsa i përket parave, që ai pretendon se i janë marrë padrejtësisht, i duhen kthyer, përderisa kjo nuk është e drejtë. Përsa u përket arturinave të shenjtëruara dhe pasurive të patundshme të kishave, ato duhet të ruhen e të mos shiten. Financat i duhen besuar Mitropolitëve dhe Prelatëve, megjithëse, duhet të jetë dhe një kujdestar që t'i drejtojë shpenzimet e Kishës dhe të mënjanojë çdo dyshim.

3. Përsa i përket dorëheqjes së klerikëve (veçanërisht episkop Pjetrit) ai deklaron që kjo që si pasojë e kërcënimeve të individëve të caktuar. Prej një këndvështrimi tjetër, nuk është kanonike për një episkop që të japë dorëheqjen, në qoftë se ai është i denjë duhet të mbetet episkop, në qoftë se jo duhet gjykuar.

4. Meqë shumë njerëz janë bërë klerikë duke mos qenë të denjë, ata kanë krijuar skandale në Kishë. Ky kanon këshillon që të gjithë ata që janë për t'u hirotonisur, duhet të shqyrtohen imtësisht.

5. Në qoftë se një katekumen ka marrë një pendesë, por është për të vdekur, le të pagëzohet. (*The Rudder (Pedalion)*, përkthyer nga Aleksandra Koço, Luna Printing Co, Nju Jork 1983, page 42).

ISAK SIRIANI (375-460)

Isak Siriani ka lindur rreth vitit 375 në Nievi të Sirisë. Studimet i kreu në Edhesa të Sirisë. Në vitin 404 vajti në Romë. Me t'u kthyer u dorëzua prift dhe filloi jetën asketike në shkretëtirë. Vite më vonë e braktisi qelinë e tij, sepse u dorëzua episkop i Nievit. Në këtë post nuk qëndroi për shumë kohë, sepse preferonte jetën asketike. Isak Siriani vdiq rreth vitit 460.

Shkrimet: Isak Siriani ka shkruar *Fjalë Ásketike*, të cilat janë thesare të vërteta të ortodoksisë.

Pastërtia e shpirtit

Nga Isak Siriani

Njeriu për të ruajtur pastërtinë e shpirtit të tij duhet t'u shmanget gjithë ngasjeve që ushqejnë pasionet, domethënë të presë shkaqet për tu shtënë në ngasje. Duhet që me lutjen dhe studimin e Shkrimeve Hyjnore të flakë pasionet e liga, të cilat e njollosin. E keqja sigurisht nuk do të përparojë, por edhe ne nuk duhet të tërhiqemi sepse kemi pranë Perëndinë e Tërëfuqishëm. Çfarë fuqie ka djalli përpara fuqisë së Perëndisë? Dhe atë që ka e lejon vetë Perëndia, vetëm që të na provojë. Kur përpiqet dikush për pastërtinë e shpirtit të tij, nuk duhet të mendojë se çfarë do të thonë njerëzit, por çfarë do të thotë Perëndia. Njerëzit kanë kritere të ndryshme nga kriteret e Perëndisë. Atë që bëjmë për kultivimin e shpirtit tonë, nuk e bëjmë për njerëzit, për të na lavdëruar dhe himnuar në ndërgegjen e tyre, por e bëjmë për Perëndinë, i cili një ditë do të na gjykojë për veprat tona. Atëherë kur do të japim llogari si jemi sjellur në jetën tonë.

Përpjekja për pastërtinë e shpirtit duhet të bëhet sipas porosive të Zotit, apostujve dhe Etërve të Kishës. Apostull Pali thotë: “Asnjë kurorë nuk vlen nëse s’është me përpjekje”. Nuk mundet dikush të përparojë në virtyt, nëse nuk ndjek udhën e kreshmës, të lutjes dhe të studimit të Shkrimeve të Shenjta, që ecën Etërit e Kishës sonë. Ne nuk mundemi të përcaktojmë udhën tonë. Ligjvënësi është Krishti dhe jo ne. Ne jemi të zgjedhurit e ligjit të tij. Vetëm Perëndia i përkryer mund të japë ligj të përkryer për shpëtimin tonë.

Ligjin dhe të vërtetën e Krishtit duhet ta shquajmë kudo, pa u frikësuar prej askujt. Apostull Pali e quante mburrje të tijën Kryqin e Krishtit. Për judenjtë kryqi përbënte skandal, ndërsa për grekët marrëzi. Veçse për ne të krishterët ishte dhe është fuqi e pamposhtur. Në jetën tëndë pra të mos frikësohesh prej askujt, veçse nga Perëndia, sepse vetëm Ai mund të të frikësojë në luftën tëndë ndaj mëkatit. “Nëse Perëndia nuk e dërgon hirin e tij, më kot lodhesh. Shkrimet e Shenjta na kujtojnë: “Nëse Zoti nuk e ndërton shtëpinë, më kot lodhen ndërtuesi: “Kur bujku gërmon dhe nëse Perëndia nuk dërgon shi, i gjithë munda do të shkojë dëm. Mund të duam dhe të përpiqemi për pastërtinë e shpirtit tonë. “Nëse nuk na ndihmon Perëndia, nuk mund të bëjmë asgjë”. Për këtë njerëzit besimtarë gjithmonë thonë: “Nëse do Perëndia”.

Perëndia patjetër do të dëshirojë përsa i kërkojmë me përulësi shpesh herë. Në një vend e thotë Shkrimi i Shenjtë: “për ata që nuk vrapojnë, për Perëndinë përdëllimtar”. Sepse pastërtia e shpirtit ka si parakusht përulësinë. Një virtyt është i lidhur ngushtë me tjetrin. Te Lumërimet, Perëndia thotë se të lumtur janë të përlurit për urtësi dhe me zemër të pastër”. Akoma pastërtia e shpirtit lidhet dhe me mbështetjen e tyre te njerëzit tanë, të cilët janë ikona të

Perëndisë. Ndërkaq nuk flasim për pastërtinë në momentin që njollosim shpirtin me mosinteresimin tonë për njerëzit e tjerë. Këtë virtyt nuk e pranon Krishti. Tradita e asketizmit përmend se kur lutet asketi dhe godet dikush në portën e qelisë, duhet të lërë lutjen dhe të ndihmojë vëllanë e tij. Nevojitet që përveç përlësisë dhe dashurisë në shpirtin tonë nevojitet edhe hiri i Shpirtit të Shenjtë.

Durimi **Nga Isak Siriani**

Aq sa njeriu e përçmon botën dhe vetëpërmbahet me frikën e Perëndisë, kaq më tepër zgjat hiri hyjnor dhe ndihet ndihma e Perëndisë. Ky njeri bekohet nga Perëndia, i cili i dërgon me bollëk përdëllimin e tij dhe e mbulon në të gjithë jetën.

Perëndia lejon dëshpërimet dhe provat për të na afruar më tepër. Nëpër dëshpërimet nuk duhet të shmangemi, por t' i pranojmë ato, sepse kështu do të provohet dashuria jonë ndaj Perëndisë. Llazari i varfër, të cilin e përmend Ungjilli, duroi me burrëri mungesën e të mirave materiale të kësaj bote dhe kështu u lavdërua nga Perëndia duke u vënë në gjirin e Abrahamit. Perëndia është kurdoherë pranë nesh dhe mbi të gjitha mbi dëshpërimet dhe mërzitjet tona. Provat na thërresin fuqishëm dhe na ftojnë te Perëndia. Ai si mjek i mirë që dëshiron shërimin tonë vjen dhe heq pjesët e kalbura, domethënë pasionet, të cilat torturojnë shpirtin tonë. Njeridashja pranohet prej shpirtit. Sado e egër dhe e keqe të jetë sjellja e fëmijës ndaj atit të tij, ky i fundit do ta dojë dhe do të kujdeset me çdo mjet për ta risjellë në udhën e drejtë.

Mund që ta plagosë sjellja e fëmijës, por ai si një atë i dhimbshëm kujdeset për shërimin e tij. E njejta gjë, por në shkallë

të pakrahasueshme bën edhe Ati ynë qiellor, i cili pranon gabimet tona dhe kujdeset me çdo mjet për ta risjellë në udhën e tij. Kur nuk i duron dëshpërimet, njih se nuk e do me të vërtetë Perëndinë dhe brenda teje jeton më tepër bota se sa Ai. Sëmundja dhe varfëria të të mos frikësojnë, sepse ke ndihmës Krishtin. Ai është shpresa dhe gëzimi yt. Mbi dashurinë për trupin tënd duhet të kesh dashurinë ndaj Perëndisë. Kur shpirti yt është i zhveshur nga virtytet, njihe mirë se nuk bëhet fjalë që t'i afrosh Zotit. Nëse dëshiron të bashkohesh me të duhet të ndjekësh udhën e Etërve të Shenjtë, që sakrifikuan gjithçka për dashurinë e tij. I lanë të gjitha për të gjetur margaritarin e çmuar, Krishtin.

Kur mendon se mbytesh nga ngasjet ose nga dëshpërimet, atëherë Krishti është pranë teje dhe të mbështet. Mos harro martirët e shenjtë, të cilët duruan torturat nga dashuria për Krishtin. Mundimet tona nuk janë asgjë përpara torturave të tmerrshme të martirizimit të shenjtoreve, të cilët duruan me gëzim, për të marrë kurorën e pavyskur të fitores. Duruan! Nuk i flakën armët, por luftuan. Me sytë e shpirtit të tyre panë Krishtin, që u kishte përgatitur kurorat e fitores. Me durimin e tyre, nga kudhra e provave arritën madhësinë e lavdisë! Me durimin e tyre u mbyllën gojën mbretërve. Me durimin e tyre bënë shumë heroizma, që i torturuan të besojnë te Krishti. Shumë martirëve iu dha rasti që në shkëmbim të lavdisë njerëzore të mos martirizoheshin, por ata preferuan vdekjen, e cila i solli një herë e përgjithmonë pranë Krishtit. Brenda në zemrën e tyre digjej flaka e dashurisë për Perëndinë. Gjithë gjërat materiale dhe gëzimet e gënjeshtër të botës i mohuan për të jetuar përjetësisht të lumtur, pranë Perëndisë.

Ja përse tek të gjithë dëshpërimet dhe provat treguan durim, durim të madh! Nëse martirët duruan tortura për dashurinë e

Perëndisë, kaq edhe ne duhet të durojmë provat e ndryshme që na i lejon Perëndia për ecurinë tonë shpirtërore. Na ftoi Zoti të bëhemi pjesëmarrës së pësimeve të Tij. Vetë duroi dhe ngriti kryqin e mëkateve tona. Dhe ne le të këmbëngulim me mund dhe dhimbje që mundimet dhe gjithçka, për t’u bërë të denjë të lavdisë së Perëndisë “me ndërmjetimet e së Terëshenjtës sonë Hyjllindëse dhe të virgjëreshës Mari si dhe të gjithë shenjtorëve” që me shumë mund dhe djersë kënaqën Krishtin.

ETËR TË PERËNDIMIT

SILVESTRI (+335)

Silvestri ishte Papë i Romës në vitin 314. Me kishën e perëndimit kemi shumë shenjtorë të përbashkët, të cilët i përkasin epokës përpara ndarjes së kishave. Një nga këta është edhe Shën Silvestri. Ky i fundit ishte i biri i Rufinit dhe kishte lindur në Romë. Në moshën 30-vjeçare u hirotonis nga Papa Markeli, duke i ngjitur shkallët e karrierës kishtare arriti që në vitin 314 të bëhej Papë i Romës. Papa Silvestri u shqua në luftën kundër arianizmit. Në Sinodin e parë Ekumenik të Nikeas në vitin 325 u përfaqësua me anën e dy priftërinjve. Ky papë dekretoi kanonet liturgjike për krezmimin. Ka lënë shumë vepra derisa ndërroi jetë në vitin 335.

LEONI I MADH (+461)

Papë Leoni kishte lindur në Toskana dhe ka qenë papë i Romës në kohën e Perandorëve Marcian dhe Pulqeria. Gjatë punimeve të Sinodit IV Ekumenik që u zhvillua në Kalqedoni ai mbrojti besimin e drejtë. Papë Leoni u shqua në luftën kundër herezive të monofizitizmit dhe monotelitizmit. Papë Leoni fjeti në vitin 461. U shpall shenjt dhe kremtohet në 11 prill për perëndimin dhe më 18 shkurt për lindjen. Në vitin 1754 u quajt mësues Ekumenik (Doctor Ecclesiae).

Shkrimet: 1) *Fjalime*, Leoni i Madh ka shkruar 96 fjalime, karakteristikë e të cilave është ritmi dhe fuqia e mendimit. 2) *Letra*. Koleksioni i tij përbëhet nga 193 letra. Me vlerë teologjike është ajo që titullohet *Sacramentarium Leonianum*. Kjo letër dallohet për kthjelltësinë e mendimit.

PAPË MARTINI (+655)

Papë Martini ka lindur në Todi të Italisë. Hipi në fronin papal në kohën që kisha tronditej nga herezia e monofizitëve. Kisha e Kostandinopojës në atë kohë ishte ngatërruar në rrjetën e kësaj herezie. Patriku Pali II, ishte përkrahës i monofizitëve dhe të njëjtat bindje me të kishte dhe perandori Kosta II. Papa Martini, me anë të letrave u përpoq që të bindte Patriarkun Pal të rikthehej në dritën e ortodoksisë, por më kot. Perandori së bashku me patrikun vazhduan të mbështetnin herezinë dhe arritën deri aty sa internuan të dërguarit e Papa Martinut. Atëherë ky i fundit mbledhi në Romë një sinod me pjesëmarrjen e 150 episkopëve dhe dënoi herezinë.

Pali II vdiq dhe në fron hipi Piri i cili ishte heretik. Hipja e njëpasnjëshme në fron e patriarkëve heretikë shpjegohet me influencën që ushtrohej atëherë nga perandorët e Bizantit në mënyrë despotike mbi kishën e Kostandinopojës. Kosta II u revoltua dhe urdhëroi eksarkun Olimp që të shkonte në Itali dhe të sillte rob në Kostandinopojë Papa Martinin. E internuan në Qersona ku dhe ndërroi jetë në datën 16 shtator të vitit 655. Lipsani i tij më pas u transferua nga Qersona në Romë dhe u vendos në kishën e Shën Silvestrit dhe Shën Martinit.

KREU I TRETË

RËNIA E LITERATURËS PATERISTIKE

(451–749)

ROMAN MELODIOZI (490-560)

Roman Melodiozi ka lindur në Emesa të Sirisë në vitin 490. Ai ishte hebre i konvertuar në krishterim. Melodiozi ka qenë një nga himnografët më të shquar të kishës duke kompozuar rreth 1000 tropare. Në kompozimet e tij shquhej për ëmbëlsinë e tingullit, ndjenjë dhe thellësi teologjike. Roman Melodiozi ka fjetur në vitin 560. Kisha e kanonizoi shenjtor dhe kujtimi i tij kremtohet më 1 tetor. Pas fjetjes së Romanit, himnografi Theofan (778-845) hartoi kanonin kushtuar shenjtit duke e përjetësuar atë në shekuj.

Shkrimet: Romani ka kompozuar himnet e Lindjes së Krishtit, Himnin Akathist, Shkurtoren e Shërbesës së Përshëndoshjeve të Hyjlindëses etj. Ai ka kompozuar himnet e Lindjes së Krishtit. Emrin e Roman Melodiozit mban Shkurtorja e Krishtlindjeve:

Virgjëresha lindi sot, të përmbiqenshmen Fjalë
Edhe dheu i blaton të paftuarit shpellën,

Engjëjt me barinj të po lavdërojnë,
Magët pra, bashkë me yllin po udhëtojnë,
Se për ne ka lindur Krishti,
Si djalë foshnjë, i parëjetshmi Zot.

Ky himn interpretohej në banketin që shtrohej në pallatin perandorak bizantin deri në fund të shekullit të 12. Himnet e krijuara nga Roman Melodiozi bazohen te theksi dhe numri i rrokjeve. (*Kristaq Balli, Himni i Himneve, Tempulli Nr. 12, Korçë 2007, faqe 60*).

JOANI I SHKALLËS (525-600)

Të dhënat biografike që na kanë mbërritur për oshënar Joanin, shkrimtarin e Shkallës, për fat të keq janë të pakta. Biografia e shkurtër që na la Daniel Refina është më tepër një fjalë solemne se sa një tekst biografik. Atdheu i tij është i panjohur. Disa thonë se prejardhja e tij është nga një vend bregdetar ose nga një ishull. Nga ana kronologjike jeta e tij caktohet nga viti 525-600. Familja e tij me siguri duhet të ishte e pasur, sepse i lejoi të vazhdonte shkollimin në një shkollë të lartë. Në moshën 16-vjeçare Joani asketoi në shkretëtirën e Sinaït. Ai kishte shumë dituri dhe për këtë mori emrin skolastik. Joani u drejtua për ngritjen e tij shpirtërore tek Ava Martini. Pas vdekjes së jerondit u tërhoq në një shpellë asketike për 40-vjet. Jeta e shkretëtirës ia ngriti në një shkollë shumë të lartë ineligjencën dhe mençurinë. Për të gjithë murgjit u bë mësuesi i shkretëtirës që shuante çdo etje shpirtërore. Joani fjeti më 30 mars të vitit 600 në moshën 75-vjeçare. Kisha jonë e

vendosi në grupin e oshënarëve dhe e përkujton më 30 mars dhe të dielën e katërt të Kreshmëve të Mëdha.

Shkrimet: *Shkalla e Parajsës*, e cila përbëhet prej 30 kapitujsh. Ky është një libër me përmbajtje të thellë shpirtërore dhe asketike. Në kap. 1-23 bën fjalë për ato gjëra, të cilave murgjit duhet t’u shmangen, ndërsa në kap. 24-30 flet për virtytet që duhet të kenë murgjit.

Mbi lutjen Nga Joani i Shkallës

Lutja për nga cilësia është bashkimi i njeriut me Perëndinë, dhe si energji e saj porosi dhe ruajtës i botës, paqtim me Perëndinë, nënën e botës, gjithashtu dhe bijën e faljes së mëkateve, urën që shpëton nga ngasjet muri që na mbron nga dëshpërimet, shkatërrimet e luftërave, punë e engjëjve, ushqim i të patrupëve, ngazëllim i ardhshëm, punë që nuk përfundon, burim i virtyteve, konsull i karizmatikëve, përparim i padukshëm, ushqim i shpirtit, ndriçim i mendjes, sëpatë që godet paditurinë, faturë e shpresës, fuqi e hidhërimit, pasuri e murgjve, thesar i hisiastëve, zbutje e inatit, pasqyrë e përpatimit shpirtëror, zbulesë e fenomeneve të ardhme, shenjë e lavdisë shpirtërore që ka dikush.

Lutja është për atë që lutet me të vërtetë, gjyq dhe kriter dhe hap i Zotit, përpara hapit të ardhshëm. Është qëndrimi i jashtëm në lutje, por paraqitet në forma të ndryshme. Disa bashkëbisedojnë me të si me mikun dhe zotin e tyre dhe i ofrojnë gjumin dhe hirin e lutjes së të tjerëve dhe jo të vetes së tyre. Të tjerë kërkojnë pasuri dhe lavdi dhe më tepër paraqitje. Të tjerë i luten të lajë hesapet përfundimisht me armikun e tyre. Disa kërkojnë t’u japë një çmim

dhe disa për çlyerjen e borxhit që kanë. Të tjerë kërkojnë që t’i çlirojë nga prangat e pasioneve dhe të tjerë t’u fali mëkatet.

Përpara së gjithash le të vëmë në listën e lutjeve falenderimin e sinqertë. Së dyti rrëfimin e mëkateve tona dhe shtrëngimin e shpirtit me ndjenjë. Në vijim le të drejtojmë kërkesat tona drejt Mbretit të gjithçkaje. Kjo mënyrë lutjeje është e shkëlqyer. Mos i vështirëso fjalët e lutjes tënde, sepse shumë herë belbëzimet e thjeshta të fëmijëve të vegjël kanë kënaqur dhe falenderuar Atin Qiellor.

Mos kërko të thuash shumë në lutjen tënde, që të mos shpërqendrohet mendja duke kërkuar fjalët. Me një fjalë të vetme mund t’i lutesh Perëndisë, sepse vetëm një fjalë besimi e shpëtoi kusarin. Fjalët e shumta gjatë lutjes shpesh krijojnë në mendje fantazi dhe difuzion, ndërsa fjalët e pakta përqendrojnë mendjen.

Për përgojimin Nga Joani i Shkallës

1. Askush nga ata që arsyetojnë drejt nuk do të ketë kundërshtim të thotë se përgojimi lind nga urrejtja dhe ligësia. Përgojimi është sëmundje shpirtërore e hollë, por trashet. Ngjan me një shushunjë të trashë, të fshehur që të mos duket, por që thith dhe zhduk gjakun e dashurisë.

2. Dëgjova disa që përgojnin dhe i kritikova. Këta punëtorë të së keqes, që të justifikohen, m’u përgjigjën se e bënin nga dashuria dhe interesi për ata që kritikonin. Atëherë u thashë që ta linin këtë lloj dashurie që të mos përgënjeshtrohej ai që tha: “Do të shfaros atë që shpif tinës kundër të afërmit.” (Psallmi 101:5). Nëse pretendon se e do tjetrin, të lutesh fshehur për të dhe të mos e përgojosh, sepse kjo lloj dashurie është e pranueshme nga Zoti.

3. Gjithashtu, mos harro edhe këtë dhe kështu sigurisht që do të përmendesh dhe do të pushosh së kritikuari atë që gaboi: Juda i takonte rrethit të nxënësve, ndërsa kusari rrethit të kriminelëve. Është e denjë për t'u admiruar se si brenda disa çasteve njëri mori vendin e tjetrit!

4. Pashë një njeri që mëkatoi hapur, por fshehur u pendua. Atë që unë e kritikova si imoral, Perëndia e konsideroi të pastër, sepse me pendimin e tij ishte mëshiruar.

5. Atë që kritikon të afërmin, kurrë mos e respekto, por edhe t'i thuash: “Pusho, vëlla. Unë çdo ditë gaboj edhe më keq dhe si mund të kritikoj të tjerët?” Kështu do të kesh dy përfitime dhe me një ilaç do të shërosh edhe veten edhe të afërmin.

6. Një rrugë dhe madje më e shpejta që të çon në faljen e mëkateve, është që të mos kritikojmë deri sa është e vërtetë fjala e Perëndisë: “Mos gjykoni, e nuk do të gjykoheni” (Lluk. 6 : 37). Ashtu si zjarri që nuk përshtatet me ujin ashtu edhe kritika me atë që do pendimin.

7. Edhe nëse sheh njeri të mëkatojë në çastet e vdekjes së tij, mos e kritiko, sepse vendimi i Perëndisë është i panjohur për njerëzit. Disa ranë hapur në mëkate të mëdha, por fshehur bënë të mira akoma më të mëdha. Kështu u mashtruan kritikuesit dhe ajo që mbanin në duar ishte tym dhe jo diell.

8. Le të më dëgjoni të gjithë ju kritikuesit e ligj të mëkateve të të tjerëve. Nëse është e vërtetë dhe e vërtetë është se “me gjykimin me të cilin gjykoni, do të gjykoheni” (Mat. 7:2), atëherë le të jeni të sigurt se për ato mëkate që kritikua të tjerët, qoftë shpirtërore ose trupore, do të biem vetë në to dhe nuk është e mundur të ndodhë ndryshe.

9. Sa janë kritikues të ashpër dhe skolastikë të gabimeve të tjerëve, mund të mposhten nga kjo dëshirë, sepse nuk krijuan akoma për vete një përkujdesje të plotë. Kush heq “mbulesën e egoizmit” dhe sheh me përpikmëri të këqijat e tij, për asgjë tjetër nuk do të përkujdeset në jetën e tij duke menduar se jeta e tij nuk i del për të shlyer mëkatet dhe nëse do të rronte njëqind vjet edhe nëse do të shihte gjithë lumin Jordan të dilte nga sytë e tij si lot.

10. Demonët na shtyjnë me forcë ose të mëkatojmë, ose të kritikojmë ata që mëkatojnë që me këtë të infektojmë të parët. Predikimet, veprat dhe veprimtarinë e të tjerëve i kritikojnë dhe i përhapin me kënaqësi dhe lehtë të mundurit e të shtypurit mizorisht nga shpirti i urrejtjes.

11. Gjykimi është rrëmbim brutal i së drejtës së Perëndisë, ndërsa shpifja është katastrofë e shpirtit të atij që shpif.

12. Ashtu si ai zogu që ha vetëm kokrrat e pjekura të rrushit dhe lë të paprekura kokrrat e pabëra, ashtu dhe njeriu i mirë dhe i ndërgjegjshëm ato virtyte që sheh tek të tjerët i shënon me korrektësi, ndërsa njeriu i keq i kërkon të metat dhe i kritikon.

13. Ashtu si fodullëku që edhe pa pasur pasion tjetër mund të shkatërrojë njeriun, kështu edhe kritika, ndonëse ekziston brenda nesh mund të na dëmtojë plotësisht, pasi veç të tjerave edhe fariseu i paravolisë u dënua për shkak të saj.

14. Mos kritiko edhe nëse diçka e sheh me sytë e tu, sepse ato shumë herë të mashtrojnë. *(Marrë nga Forumi Shqiptar, portali bota shpirtërore, komuniteti orthodhoks).*

SOFRONI I JERUSALEMIT (580-637)

Sofroni ka lindur në vitin 580 në Damask të Sirisë. Të atin e quanin Plintha dhe të ëmën Miru. Kishte shumë aftësi mendore dhe arriti të merrte një arsim të lakmueshëm, ndaj dhe u quajt Sofisti “i Urtë”. Kur ishte në moshë të re bëri një vizitë në Vendet e Shenjta dhe atje hyri në manastirin e Oshënar Theodhosit, ku u lidh me murgun e urtë Joan Mosku. Bashkë me të udhëtoi në Egjipt, ku u njoh me Shën Joan Përdëllyesin. Atje e zuri një sëmundje e pashërueshme e syve, por u shërua nga anargjendët e shenjtë Kir dhe Joan me anë të mrekullisë, të cilën ai vetë e përshkroi në një fjalim për nder të tyre.

Së bashku me Moskun vizituan Malin Sina, Qipron dhe Romën. Në Romë Mosku vdiq dhe oshënari e solli lipsanin e tij në Jerusalemin e pushtuar nga persët, ku e varrosi në manastirin e Oshënarit Theodhos. Më vonë shkoi në Aleksandri dhe Kostandinopojë, duke u munduar të luftojë herezinë e monofizitëve, por nuk pati rezultat dhe u rikthye në Jerusalem. Në 16 dhjetor të vitit 634 u zgjodh Patrik i Jerusalemit, duke zëvendësuar Modestin. Përveç heretizmit të mëparshëm tashmë u paraqitej edhe një rrezik tjetër i madh, arabët. Në një sinod, Hierarku dënoi herezinë dhe njëkohësisht u mundua të organizonte mbrojtjen e Qytetit të Shenjtë, por me gjithë rezistencën e madhe, në fund u detyrua të dorëzojë qytetin të Kalifi, me kushte të favorshme. Hierarku fjeti në vitin 637.

Shkrimet: 1) Dogmatike. *Kundër Monotelitizmit* 2) *Fjalime* panagjirike rreth Gjenezës, Ungjillëzimit, Ipapandisë etj. 3) *Jetë shenjtore*sh. Sofroni mendohet të ketë shkruar jetën e Oshënares Maria nga Egjipti.

Jeta e Oshënares Maria Nga Sofroni i Jerusalemit

Njëherë asketi Zosima, po ecte përmes shkretëtirës me shpresën se aty do të gjente ndonjë atë nga i cili mund të dëgjonte fjalën e Perëndisë. Në kohën që psallte, pa në të djathtë të tij një hije njeriu. Në fillim u trondit. Trupin e kishte të nxirë nga dielli dhe në kokë flokë të bardha si pambuk. Asketi Zosima donte që t'i afrohej, por njeriu i panjohur i largohej duke vrapuar nëpër shkretëtirë. Atëherë Zosima filloi ta thërrasë duke qarë: - Pse më largohesh mua plakut? Njeriu i panjohur iu përgjigj: “Ava Zosima, më fal për Zotin Jesu Krisht, por nuk mund të kthehem dhe të të shoh në fytyrë, sepse jam një grua lakuriq.”

Asketi Zosima u habit se gruaja i foli në emër dhe ai e kuptoi se i panjohuri kishte hir të mbinatyrshëm. Ava Zosima i kërkoi gruas që t'i tregonte se kush ishte dhe nga vinte: Gruaja e panjohur, në rininë e saj kishte qenë prostitutë dhe dëshira e saj e vetme ishte të shkonte pas kënaqësive trupore duke bërë një jetë të zhytur në mëkat. Në moshën 12-vjeçare ishte larguar nga shtëpia dhe kishte vajtur në Aleksandri, ku jetonte duke shitur nderin. Një ditë ajo pa shumë njerëz që drejtoheshin për nga deti dhe pyeti se ku shkonin. Ata po shkonin për pelegrinazh në Jerusalem sepse pas pak ditësh do të festohej Ngritja e Kryqit të Nderuar. Bashkë me ta vajti edhe gruaja mëkatore jo nga dëshira për të parë Tokën e Shenjtë, por thjesht për të shuar kuriozitetin dhe për të gjetur klientë në anije. Kur erdhi dita e ngritjes së Kryqit të Shenjtë duke rendur pas pelegrinëve edhe Maria shkeli në pragun e derës, për të hyrë në kishë, por një fuqi hyjnore e pengonte dhe nuk e linte të hynte brenda. Papritur e pushtoi një ndjenjë trishtimi dhe filloi të qajë me

lotët e pendesës. Në kohën që qante, iu shfaq Shën Maria dhe ajo iu lut: “O Zonjë e virgjër, unë nuk jam e denjë të shikoj ikonën tënde të Shenjtë, më ndihmo që të hyj në kishë e të shoh drurin e shenjtë, sepse kur erdha te dera, një fuqi e mbinatyrshme pengonte hyrjen time në kishë.

Të nesërmen mundi që të futej në kishë dhe pasi nderoi drurin e shenjtë u pendua duke vendosur që të ndryshonte mënyrën e jetesës. Ajo u largua nga Jerusalemi dhe shkoi në shkretëtirën përtej lumit Jordan, ku për 47 vjet asketoi duke u lutur dhe kreshmuar. Shën Maria e Egjiptit u bë shenjtore pas një jete mëkatore. Ajo të gjithë dashurinë që kishte për njerëzit e ktheu në dashuri për Krishtin, i cili u sakrifikua për mëkatet e mbarë njerëzimit.

Asket Zosima kur dëgjoi për jetën e saj ra në metani. Por shenjtorja iu afrua plakut, duke mos e lënë të mbaronte metaninë, i tha atij: “Të enjten e Madhe merr Potirin e Shenjtë dhe hajde në atë vend të Jordanit që të kungohem me dhuratat jetëdhënëse.” Zosima ia plotësoi dëshirën. Kur erdhi dita, ai vajti përsëri në shkretëtirën e Jordanit dhe e gjeti Oshënaren të vdekur me duar të kryqëzuara dhe të kthyera për nga Lindja. Tutje pa një copë dru dhe pasi e mori filloi të gërmojë me të për ta varrosur. Për një moment mori frymë thellë dhe pasi ngriti fytyrën, pa një luan të madh që qëndronte pranë lipsanit të Oshënares. Bëri shenjën e kryqit dhe besoi se fuqia e Oshënares do ta ruante nga çdo rrezik. Luani gërmoi me këmbët e përparme gropën aq sa duhej për varrosjen e trupit të saj. Atëherë Zosima u kthye prapë në manastir duke bekuar dhe lavdëruar Perëndinë.

MAKSIM KONFESORI (580-662)

Maksim Konfessori ka lindur në vitin 580 në një familje aristokrate të Kostandonopojës. Duke qenë dijetar e filozof, hoqi shpejt dorë nga puna si kryesekretar i perandorit Irakli. U bë murg dhe më pas igumen në manastirin e Hyjlindëses në Kostandinopojë. Invazionet persiane kundër Kostandinopojës e detyruan të zhvendosej për dy vjet në Kizikë të Proponditës dhe më vonë në Afrikë ku shkoi nëpërmjet Kretës. Veprori në sinode dhe kumtoi në një gamë shumë të gjerë me një mendim mjaft të thellë. Në vitin 645 shkoi në Romë, në sinodin që e bëri protagonist kryesor. Atje Maksimi dënoi dy urdhra të perandorit Kostandini III, çka bënë që të arrestohej dhe të dërgohej në Bizant ku u akuzua si komplotist së bashku me dy vëllezërit e tij shpirtërorë. U internua tri herë. Iu bë anatema, i nxorën nëpër rrugë dhe u prenë gjuhën dhe dorën e djathtë. Oshënar Maksimi fjeti më 21 janar të vitit 662, ndërsa gjendej i burgosur në një kështjellë të Kaukazit. Kisha e shpalli shenjt dhe e kremton më 21 janar.

Shkrimet: 1) *Rreth çudive të ndryshme të Shkrimit Hyjnor*, të cilën e shkroi në vitin 632. Vepra iu dërgua Thalasis dhe përmban 65 pyetje-përgjigje rreth vargjeve të vështira të Shkrimit të Shenjtë. 2) *Rreth çudive të Dionis Aeropagitis dhe Grigor Teologut*. 3) *Fjalë asketike*. 4) *Letrat*. Me emrin e Maksimit kanë shpëtuar 47 letra, të cilat flasin për tema dogmatike dhe filozofike. 5) *400 Thënie rreth dashurisë*, të cilat u shkruan rreth viteve 628-630. Këtë vepër Maksimi e shkroi pas kërkesës së priftit Elpidio. Teksti dhe frazat e dashurisë kanë ndarje të barabartë me katër ungjijtë. Maksimi deklaroi së thëniet nuk janë produkt i

mendjes së tij, por urtësia e mendimit të Etërve të Kishës. (*Maksim Çuko, Përmes Shkrimeve, Tekno Paper, Tiranë 2005, faqe 203-219*).

400 thënie rreth dashurisë

Nga Maksim Konfessori

Ashtu si kujtimi i zjarrit kur ngroh trupin, edhe besimi pa dashuri nuk sjell në shpirt ndriçimin e njohjes.

Ashtu si drita e diellit tërheq syrin e shëndetshëm, kështu edhe njohja e Perëndisë tërheq natyrshëm mendjen e pastër te vetja e saj me dashurinë.

Mendje e pastër është ajo mendje që u largua nga padituria dhe ndriçohet nga drita hyjnore.

Shpirt i pastër është ai shpirt, i cili u çlirua nga pasionet dhe ngazëllehët papushim me dashurinë hyjnore.

Pasion i pahijshëm është lëvizja e shpirtit jashtë natyrës.

Papasionshmëria është një gjendje e paqme e shpirtit, gjatë së cilës vetë shpirti vështirë se tërhiqet nga e keqja.

Ai që me zellin e tij përfitoi frytet e dashurisë, nuk ndahet nga ajo, edhe nëse vuan mijëra të këqija. Le të të bindë për këtë Stefani, nxënës i Krishtit dhe të ngjashmit me të: "...i cili lutej për ata që e qëllonin dhe kërkonte që t'i falte Perëndia, sepse vepronin nga padija" (Vep. Ap. 7,60).

Nëse veçori e dashurisë është zemërgjerësia dhe mirësia, atëherë ai që inatoset dhe vepron në mënyrë dinake, është e qartë se është i huaj për dashurinë, është i huaj për Perëndinë, sepse "Perëndia është dashuri" (Letra I Joan. 4,8).

Mos thuaj që "besimi te Zoti ynë Jesu Krisht, i zhveshur nga veprat mund të më shpëtojë". Kjo është e pamundur, nëse nuk përfiton dhe dashurinë ndaj Tij me vepra. Besimi pa vepra nuk sjell dobi, sepse "edhe demonët besojnë dhe dridhen" (Jak. 2,19).

Bamirësia është vepër dashurie me gjithë shpirt ndaj të afërmit, zemërgjerësia dhe përdorimi i gjërave me arsytim të drejtë.

Ai që do Perëndinë nuk hidhëron asnjë dhe nuk hidhërohet nga asnjë për gjërat e përkohshme. Vetëm një hidhërim shkakton shpëtimin e shpirtit, të cilin i lumuri Pal e provoi, duke e treguar te Korinthianët (Letra II Kor. 7, 8-11).

Ai që do Perëndinë jeton jetën engjëjlore këtu në tokë, kreshmon dhe bën agripni, psall, lutet dhe mendon gjithmonë mirë për çdo njeri.

Secili përpiqet që të përfitojë. Nga të gjitha të mirat dhe të dëshirueshmet, gjëja më e mirë dhe më e dëshirueshme është Perëndia. Sa përpjekje duhet të bëjmë për të arritur këtë të mirë të dëshirueshme?

Mos infekto trupin me vepra të këqija dhe mos infekto shpirtin tënd me mendime të liga. Paqja e Perëndisë do të vijë tek ti dhe do të të sjellë dashurinë.

Ai që u bë i denjë të marrë njohjen hyjnore dhe që përfitoi nëpërmjet dashurisë ndriçimin e saj, nuk do të tërhiqet kurrë nga fryma e lavdidashjes. Por, lehtësisht tërhiqet kush që nuk u bë i denjë të marrë njohjen hyjnore. Por, nëse ky njeri, në çdo gjë që bën kthen vështrimin e tij te Perëndia me ndjenjën që të gjitha i bën për Atë, lehtësisht me ndihmën e Perëndisë do të çlirohet nga lavdidashja.

Ai që nuk përfitoi akoma njohjen hyjnore që shfaqet me dashurinë, ka ide të madhe për të gjitha veprat që bën sipas dëshirës së Perëndisë. Por, ai që u bë i denjë, i përfitoi me ndjenjë të thellë fjalët që tha Patriarku Abraham kur pa Perëndinë: “Unë jam pluhur e hi” (Zan. 18,27).

Ai që ka frikë Zotin, ka gjithmonë shoqërues të tij përlësinë dhe me kujtimet që i shkakton, arrin në falenderim dhe dashuri hyjnore. Sjell në mendjen e tij jetën që bëri më parë, mëkatet e ndryshme dhe tundimet që përballoi që nga koha e rinisë së tij dhe se si e shpëtoi Zoti nga të gjitha dhe e transformoi nga jeta e pasioneve në jetën sipas Perëndisë dhe bashkë me frikën përfiton edhe dashurinë, duke falenderuar gjithmonë me dashuri dhe përlësi Bamirësin dhe Kryetarin e jetës sonë.

Mos e infekto mendjen tënde, duke pranuar mendimet e dëshirës dhe të inatit, që të mos biesh nga lutja e pastër te fryma e plogështisë.

Mendja humb komunikimin që ka me Perëndinë, kur pranon mendime të liga ose të papastra. (*Thënie për dashurinë e krishterë, përkthyer nga Rozeta Baba dhe Elena Krakulli, Kambanat, dhjetor 2006, faqe 37*).

Lufta e demonëve Nga Maksim Konfessori

Perëndia na lejon të luftojmë me demonët për pesë arsye. E para thonë se është: të luftojmë demonët duke kundërvënë ndaj tyre luftën tonë, mbërrijmë aty ku mund të dallojmë virtytin nga e keqja. Shkaku i dytë është: pasi me luftë dhe mundim të arrijmë virtytin, ta mbajmë të qëndrueshëm. E treta është: duke përparuar në virtyt të mos vetëkënaqemi. E katërta është: pasi ta njohim të keqen ta urrejmë me gjithë fuqinë tonë. E pesta arsye bashkë me të tjerat është: pasi të bëhemi indiferentë, të mos harrojmë dobësinë tonë, si dhe fuqitë e atij që na ndihmoi.

Ashtu si mendja e të uriturit ëndërron bukën dhe ai që ka etje ujin, kështu dhe mendja e llupësit ëndërron ushqimin, e qefliut fantazon gra të bukura, e argjenddashësit fantazon fitime, e keqdashësit t' i bëjë keq atij që e dëshpëroi, e vrasësit të dëmtojnë viktimën dhe e njejta gjë ndodh me pasionet e tjera. Sepse mendja është e shqetësuar nga pasionet e rrëmbyeshme edhe kur trupi është zgjuar edhe gjatë kohës së gjumit.

Kur shtohet një dëshirë trupore mendja fantazon gjatë gjumit kënaqësitë trupore që shkaktojnë epshet, kur shtohet inati, atëherë sheh gjërat që shkaktojnë frikë. Domethënë fuqitë e papastra shtojnë pasionet duke u ndihmuar nga pakujdesia jonë dhe i eksitojnë ato. Nga ana tjetër engjëjt e shenjtë ndërmjetojnë që ne të ushtrohemi në virtyte. Kur dëshira e shpirtit pranon ngacmime, krijon brenda shpirtit një zakon të qëndrueshëm kënaqësie, ndërsa kur tronditet vazhdimisht pjesa e inatit atëherë ngrihet mendja frikacake dhe burracake. Këto i kurojnë së pari ushtrimi i gjatë kreshmor, pagjumësia dhe lutja, ndërsa së dyti mirësia, njerëzillëku dashuria dhe dhënia e lëmoshës.

ANDREA I KRETËS (660-740)

Andrea i Kretës ka lindur në vitin 660 në Damask prej prindësh shprestarë. Në moshën 15-vjeçare vajti në manastirin e Shën Savës në afërsi të Jerusalemit. Aty u arsimua në teologji, muzikë, retorikë dhe filozofi. Më pas u qeth murg dhe kryente detyrën e sekretarit patriarkal. Në vitin 685 ishte në Kostandinopojë, ku u dorëzua dhjak në Kishën e Shën Sofisë, ndërsa në vitin 712 u dorëzua Episkop i Kretës dhe kishte nën juridiksion 12 episkopata. Andrea i Kretës luftoi për mbrojtjen e ikonave. Ndërroi jetë në vitin 740 gjatë një udhëtimi për në ishullin Mitilini.

Shkrimet: Vepra e tij më e madhe është *Kanoni i Madh* me 261 tropare. *Kanoni i Madh* pasalltet të Enjten në mëngjes gjatë javës së pestë të Kreshmëve të Mëdha dhe është vepër e Andreas së Kretës. Quhet *Kanoni i Madh* sepse përbëhet nga 261 tropare. Por ka edhe një arrësye tjetër përse quhet *Kanoni i Madh* sepse është një vepër unikale me frymë të lartë poetike, në të cilën përmenden ngjarje që nga fillimi i Shkrimit të Shenjtë dhe deri në fund me qëllim që të na ftojë drejt pendimit.

“O shpirt i dremitur, o shpirt, mos fli po zgjohu,
se vdekja afrohet dhe keq do të dënohesh.

Po ngrihu me vrap edhe lupi ndjesë Jesuit Perëndi,
Që ndodhet kudo dhe i mbush të gjitha”.

Troparet ndahen në 9 nëngrupe, të cilat quhen “ode”, ku çdonjëra prej tyre mbështetet në ngjarje të Dhiatës së Vjetër ose Dhiatës të Re.

1-Odja e parë i kushtohet Himnit të Moisiut pas kalimit të Detit të Kuq (Eksodi kap.15).

- 2-Odja e dytë i kushtohet një himni tjetër të Moisiut (Ligji i përtërirë. Kap. 32).
- 3-Odja e tretë i kushtohet profeteshës Ana, nënës së profetit Samuil (I e Samuilit 2, 1-10)
- 4-Odja e katërt i kushtohet profetit Habakuk (Kap. 3).
- 5- Odja e pestë i kushtohet profetit Isaia (26, 9-20).
- 6- Odja e gjashtë i kushtohet profetit Jona (2,2).
- 7- Odja e shtatë i kushtohet himnit të Tre Djemve (Daniel 3, 26-88).
- 8- Odja e tetë i kushtohet himnit të Tre Djemve (Daniel 3, 26-88).
- 9- Odja e nëntë i kushtohet Hyjlindëses Mari dhe profetit Zaharia (Luka 1, 47-55) dhe 1,68).

Në shumicën e rasteve mungon Odja e dytë, kurse në periudhën e Pashkëve të Mëdha kanonet kanë vetëm tri ode, prandaj edhe libri liturgjik që përmban himnet e kësaj periudhe quhet Triod.

KOZMA MELODIOZI (+750)

Kozma Melodiozi ka lindur në Damask. Që në moshë të re mbeti jetim dhe u birësua prej Serxhit, të atit të Joan Damaskinit. Në fillim të shekullit X vajti në Vendet e Shenjta dhe u qeth murg në manastirin e Shën Savës. Rreth vitit 743 Kozmai u dorëzua Episkop i Gazës. Fjetja e tij mendohet të jetë në vitin 750. Kisha e shpalli shenjt dhe e kremton më 14 tetor. (*Kostandinos Fuskas, "Tema të Patrologjisë", Athinë 1994, faqe 209-210*).

Shkrimet: Kozma Melodiozi ka shkruar Kanonin e Krishtlindjeve si dhe Kanonin e Javës së Madhe. Famën e mori me Kanonin e Krishtlindjeve.

Ja Krishti lind lavdërojeni;
Ja Krishti i qiellit vjen, dilni priteni;
Ja Krishti mbi dhenë, ngrehuni;
Zotin pra e këndonit lart e mbi dhe
Dhe me ngazëllime
Përhimnojeni me mall,
Popuj dhe me lavdi.

Gjithashtu emrin e Kozmait mbajnë edhe shtatë kanone të festave të ndryshme.

JOSIF HIMNOGRAFI (+842)

Josifi e kishte origjinën nga Sicilia dhe që në moshë të re u shqua në studimin e Shkrimeve të Shenjta. Vajti në Selanik ku u dorëzua murg e më pas u bë prift. Pas një farë kohe shkon në Kostandinopojë ku u njoh me Grigor Dekapolitin. Ky i fundit duke parë cilësitë e Josifit e pranoi në qelinë e tij që ndodhej pranë Kishës së Ieromartirit Antipa. Në vitet e mbretërimit të perandorit Leoni V, Josifi u radhit përkrah atyre që kundërshtuan ikonoklazmën duke kundërshtuar dekretin perandorak të luftës ndaj ikonave. Perandori filloi përndjekjet dhe Josifi u detyrua të largohej drejt Romës. Pasi u qetësua ikonoklazma, Josifi u kthye në Kostandinopojë. Kësaj radhe iu përkushtua shkrimit të himneve kishtarë. Josif Himnografi fjeti në vitin 842.

Shkrimet: Josif Himnografi krijoi kanone kushtuar Hyjlindëses, Joan Teologut, Shën Gjergjit, Shën Pandejlimonit etj.

Kanoni i Akathistit
Krijim i Josif Himmografit

Tingull IV.

ODJA I. Anikso To Stoma Mu

Imosi

Ja gojën e çel tani, i frymëzuar prej Shpirtit të Shenjtë, dhe këngë do t' i këndoj, Nënës së Madhe mbi fron, dhe do ta kremtoj, me valle buzëqeshur, me zë do t' i shpall kudo, gjithë çudit' e saj. (2 herë)

Troparet

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Si libër të Zotit Krisht, të hirësuar prej Shpirtit të Shenjtë, të pa Kryeengjëlli, Mari Hyjlindëse, dhe të tha kështu: Lum ti që sjell gëzimin; mallkimin stërgjyshëror ti do ta zhdukësh krejt.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Adamini e ngrite lart, o Virgjëreshë Hyjlindëse, dhe Ferrin e shtrin përdhe, o Zonj' e Shenjtë Mari, lum' ti o pallat, i Zotit edhe Mbretit, lum ti o i zjarrti fron, i perandorit Krisht.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Gëzohu o lindëse e të pafishkurit trëndafil, gëzohu se ti porrit mollën e hershme, lule e qillshme, e Zotit edhe Mbretit, lum' ti o Hyjlindëse, zonjë shpëtonjëse.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Thesar i virtyteve, që na ke ngritur prej varreve, edhe prej kufomave, Zonjë Hyjlindëse, lule dhe zambak, aromë për besnikët, temjan i mirershëm, miro e paçmuershme.

ODJA III. **Tus Sus Imnologus**

Irmosi

O Zonjë dhe Nën' e Perëndisë, burim i pasosur jetësor, ti siguroi gjith' ata, që të këndojnë plot me zell, dhe lart në qiell ku mbretëron, kurorëzoi me çdo lavdi. (2 herë)

Troparet

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Kallinë qiellor ti na ke mbirë, si arë pa buj' dhe pa lërim, lum ti altar i shpirtshëm, ku buk' e jetës na u vu, lum ti burim i ujërave, që japin jetë Hyjlindëse.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Mëshqerrë që demin na ke lindur, qiellor për besnikët pa cënim, lum ti o del' e hyjshme, se qengjin Perëndi na dhe, mëkatin botëror që ngre, gëzohu Zonjë ndërmjetëse.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Gëzohu mëngjes i ditës sonë, që Diellin solle Jesu Krisht, për botën dritë dhe për ne, dhe errësirë s'le mbi dhe, dhe Ferrin e demonëve e shkatërrove për gjithënjë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Gëzohu o derë shpëtimtare ku Fjala dhe Bir i vetëm shkoi, Ferrit ia theve dyert, me lindjen e çlironjësit, gëzohu port' e hyjshme dhe shpëtimtare e ndritshme.

ODJA IV. O Kathimenos En Dhoksi.

Irmosi.

Ti që rri midis lavdisë, përmbi fronin e hyjshëm, nga një re e lehtë, erdhe o Jesu i përjetshëm, dhe na shpëtove me dorën jetëdhënëse, të thërresim pra: Nder dhe lavdi gjithnjë mbi ty.

Troparet

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Me këndime dhe me besë, të thërresim Hyjlindëse, lum ti mal i Shenjtë, që u hijesove prej Shpirtit Shenjt, lum ti kandil edhe shtamë manapurëse, që i ëmbëlson ndjenjat e gjithë besnikëve.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Mëshironjësë e botës, Virgjëreshë Hyjlindëse, lum ti shkall e shenjtë, që nga dheu shpie në qiell me hir, lum ti o urë që prier lavdëronjësit, që prej varreve lart në Parajsën e engjëjve.

Troparet

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Më e lartë prej çdo qielli, Shpëtimtarin e njerëzve ti në gjin' e shenjtë e ke mbajtur Zonjë Hyjlindëse, lum ti që ngjeve me gjakun rrobën ndritëse dhe shkëlqenjësë të Komandantit të Forcave.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Ligjvënësin ke lindur, Virgjëreshë Hyjlindëse, që paligjësitë ua fal të gjithëve darovisht; o lartësi pa kufi o thellësi pa fund, ndërmjetonjësë ti na ke ngritur në qiellin.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ty që mplekse për njerinë një kurorë të qiellshme, ty të përhimnojmë, lum ti Virgjëreshë Hyjlindëse, lum ti fortesë dhe mbrojtje e të gjithëve, o përkrahëse, streh' e përikj' e besnikëve.

ODJA V. Eksesti Ta Simbanta

Irmosi.

Të gjith' i habite ti, me një çudi dhe një lavdi: Ti o Virgjëresh' e pamartuar, Zotin e botës që mbretëron lart në qiell, si një bir e mbajte në pëqi, dhe shpëtim që lartazi u dhurove besnikëve.

Troparet

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

O Zonjë Hyjlindëse, që linde udhëheqësin, ti na ke shpëtuar nga përmbytja, ne mëkatarët dhe të pavyerit, Nus' e Perëndisë Shën Mari, lum ti o Hyjpritëse, Nën' e Zotit të gjithave.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Kështjella e njerëzve, gëzohu o Hyjlindëse, vend' i shenjtërimit dhe lavdisë, vdekja e Ferrit o Nus' e ndritshme, o gëzim i engjëjve në qell, lum' ti o përkrahëse, e të gjithë besnikëve.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

O fron që shkëlqen dhe ndrit, me Fjalën e përjetshme, lum ti o Parajsë shpirtërore, që ke në qendër Zotin e jetëve, që i ëmbëlson edhe i ngjall gjithë të gëzuarit, me kungatën e qiellshme.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Prej teje forcohemi, thërresim pra me zë të madh: Lum ti o qytet i Mbretit tonë, e lavdëruar prej gjithë brezave, dhe prej gjithë kishave kudo, mal i lartë gjer në qiell, det pa fund edhe pa kufi.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Pallat i diamanteve të çmuar o Hyjlindëse, ti që na dhuron margaritarin, Fjalën e Atit dhe Shpëtimtarin ton' Krisht, ti me Perëndinë i pajton, gjithë lumëronjësit, që të lusin besnikërisht.

ODJA VI. Tin Thian Taftin.

Irmosi.

Këtë të kremte e lusim sot, për Zonjën edhe Nënëen Hyjlindëse, gjithë hymëndësit; ejani trokisni pra duart, dhe lavdëroni Zotin që lindi prej asaj. (2 herë)

Troparet

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Banes' e Fjalës e ndritshme, gëzohu shenjtërim i të gjithëve, Zonjë Hyjlindëse, mburrur prej gjithë Profetëve dhe prej të gjith' Apostujve dhe Shenjtorëve.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Na prure vesën e qiellshme, që shojtë tërë zjarrin pagan të keq: Ty të thërresim pra: Lum ti o leshi i vesëve, që Gjedeoni e pa, Zonjë Hyjlindëse.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Gëzohu Zonjë Hyjlindëse, liman u bëj për ne lundronjësit, ku të përmbliidhemi brenda në detin e helmeve, dhe të përballim sulmet e të paudhëve.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Gëzona Zonjë gëzonjëse, mendimet që të themi me zë të madh: Lum ti Hyjlindëse, re edhe ferrë e ndritshme, që ne besnikët na mbron dhe na mbulon gjithnjë.

ODJA VII. Uk Elatrefsan.

Irmosi.

Nuk u faleshin krijesave hyjmëndësit, po Kryetarit lart,
dhe kërcënimin me zjarr, e shkelën me trimëri, psallnin me brohori:
Zot lavdi më ty, o Perëndi i Etërve, ti je vetëm i bekuar.

Troparet

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

O Hyjlindëse, gëzohu fron i shpirtshëm, o vreshtë plot
hardhi, ngarkuar me rrush të kuq, zambak i pafishkur krejt, që
lulëzon o Zonj', pra gëzohu ti, që shpirtrat e besnikëve, i gëzon me
gjak të Krishtit.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Ti që linde mjek, shëronjës të besnikëve, Mari Hyjlindëse,
o shkop i shenjtë mistik, që lulen e qiellshme, ti lulëzon tani, Zonj'
e ndritshme, me gaz prej teje mbushemi, edhe jetë trashëgojmë.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Asnjë gjuhë s' mund të lavdërojë vlerësisht, ty o Hyjlindëse;
nga Serafimet më lart, u ngrite kur linde ti, Mbretin Jesu Shpëtimtar;
pra ati iu lut, të na shpëtojë gjithnjë, sa të lusim plot me besë.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Prej gjith' anëve, të lumërojm' Hyjlindëse, me thirrje
gjithnjë. Gëzohu o Shën Mari, që mban në pëqirin tënd, Fjalën dhe
Zotin Krisht; pra ati iu lut, në librin e të gjallëve, të na shkruajë o
Zonjë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ty të lutemi, të gjithë dhe përgjunjemi, me gjithë zemër e
shpirt; dëgjona pra Shën Mari, shpëtona prej helmeve, se po

përmbysesmi, edhe ruaje, qytetin tënd Hyjlindëse, prej armiqve të pabesë.

ODJA VIII. Pedhas Evagjis En Ti Kamino.

Irmosi.

Djemtë e dënuar për të djegur, prej zjarrit i ka shpëtuar lindj' e Zotit Krisht, si simbol në vjetëri, dhe si një veprim tani, dhe tërë botën po e mbledh për këng' e lavdërim: Himnojni ju veprat e Zotit, dhe i lartësoni përmbi të gjithë jetët.

Troparet

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Fjalën Jesu Krisht në krah' e prite, atë që mban gjithësinë ti e mban në gji, ti me qumësht e ushqen, Zotin dhe ushqenjësin, e dheut dhe të qiellit dhe të këndonjësve: Himnojini ju veprat e Zotit, dhe i lartësoni përmbi të gjithë jetët.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Ferrën e nxori Moisiu, dhe lindjen e Virgjëreshës na e mori vesh. Shëmbëlla e djemve, na e shfaqti qartazi: Në mes të zjarrit hidheshin edhe nuk digjeshin, Hyjlindëse Mari Virgjëreshë; ty pra të himnojmë përherë dhe për jetë.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Grackat e demonëve na zhveshën, po ti përsëri stolin' e re na veshe ne, kur na linde Zotin Krisht, edhe të verbuarit, nga hija e mëkateve e panë Diellin, Hyjlindëse banesa e dritës, ty pra të himnojmë përherë dhe për jetë.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Ngjallen dhe të vdekurit prej teje, se jetën dhe jetëdhënësin e linde ti, flasin gjuhëlidhurit, shohin të verbuarit, shërohen të lebrozurit dhe të lënguarit, dhe zhduken krejt nga drita demonët, Zonjë Virgjëreshë shpëtim i njerëzisë.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Ti që na dhurove Shpëtimtarin, dhe ti që na lartësove gjer në qiellin, lum ti o Hyjlindëse, rojtëse shpëtonjëse, se ti i mbron dhe i bekon gjithë këndonjësit: Himnojini ju veprat e Zotit, dhe i lartësoni përherë dhe për jetë.

ODJA IX. Apas Gjigjenis

Irmosi.

Gjithë njerëzit, kërcenin me ngazëllim, te drit' e Shpirtit Shenjt, ejani lavdërojeni, engjëj në qiell ejani kremtojeni, këtë të shenjtë panair të Kryezonjës Mari, dhe thërrisni: Ti je më e lumura, Virgjëresh' e kulluar Hyjlindëse.

Troparet.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Çdo besnik thërret: Gëzohu Hyjlindëse, se gjithnjë na jep, gaz që fare nuk mbaron, ti pra shpëtona prej gjithë ngasjeve, nga sulmet e barbarëve dhe gjithë plagëve, që na vijnë, nga shumic' e fajeve, dhe mëkateve tona të tmerrshme.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Erdhe për ndriçim, për mbrojtje dhe për shpëtim, pra të thërresim sot: Lum o yll pa perëndim, që sjell në botë Jesunë diellin; lum o hapëse e mbretërisë, kollon' e zjarrt' shum' e fort', që u shpie njerëzve një jet' të re, qiellore e që kurrë nuk ka mbarim.

E përmbishenjtë Hyjlindëse shpëtona.

Ejani besërisht, në Kishën e Zotit Krisht, dhe përshëndosheni, Nënë dhe Hyjlindësen: O Virgjëreshë Zonj' e të gjithëve, lum' ti më e bekuara në mes të grave mbi dhe, lum ti lule, myrrën e përbotshme, ti e prite në gjirin dhe na e dhe.

Lavdi Atit e Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Lum' ti o pëllumb, se ti mëshironjësini, na prure përmbi dhe, mburrj' e Oshënarëve, edhe kurora e Athloforëve, dhe e Dëshmorëve dhe e Shenjtorëve, zbukurimi i gjith' të krishterëve, dhe shpëtimi i gjithë besnikëve.

Tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin.

Zot dhe Perëndi, kurse trashëgimin tënd, falu besnikëve, ndjesën e mëkateve, dëgjoja lutjet Nënës Hyjlindëse, dhe ndërmjetimet pa pushim për gjithë njerëzit, dhe shpëtoji, sipas përdëllimit tënd, edhe falna Parajsën e qiellit. *12-Himni Akathist, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2003, 10-18.*

JOAN DAMASKINI (680-750)

Joani ka lindur në Damask rreth viteve 680. Babai i tij quhej Serxhio dhe ishte në shkallë ministri në oborin e Ambel Malekut. Pas vdekjes së të atit më 715, Joani u bë kryekëshilltar i Sarakinëve. Pasi e braktisi këtë post të rëndësishëm u dorëzua murg në manastirin e Shën Savës në Jerusalem në vitin 718, ndërsa më 730 u dorëzua në gradën priftërore prej Episkopit të Jerusalemit Joan IV. Në vitin 754 u dënua në sinodin ikonomak sepse mbrojtë kultin e ikonave. Në Sinodin VII Ekumenik të Kalqedonisë mësimdhënia e tij rreth ikonave mori përmasa ekumenike. Fjeti në vitet 750 në manastirin e Shën Savës. (*Protoprezviter Thomas Hopko, Besimi Orthodhoks, Vëllimi III, Shkrimi i Shenjtë dhe Historia e Kishës, (përkthyer nga Imzot Joan Pelushi), Tiranë 2000, faqe 216-217*).

Shkrimet: 1) *Burimi i Njohjes*, vepër që u shkrua në vitin 742 dhe cilësohet si më e rëndësishmja e Joan Damaskinit. Kjo vepër ndahet në tri pjesë: a) *Kapitujt Filozofikë*, b) *Historia e 103 herezive* dhe c) *Botimi i besimit të drejtë orthodhoks*. 2) *Mbi ikonat e shenjtë* që përbëhet nga tri fjalime, të cilat u shkruan ndërmjet viteve 726-730.

Joan Damaskini është krijuesi i muzikës bizantine në shekullin VIII. Joani është nga himnografët më të shquar të kishës sonë duke shkruar 1200 himne. Damaskini ka shkruar Tipikonë, Kanonin e Mëngjesores, Kanonin e së Dielës së Pashkës dhe disa himne të shërbesës së varrimit. Gjithashtu Joan Damaskini ka kompozuar librin e Oktaikut.

Mbi ikonat

Nga Joan Damaskini

1. Edhe pse është më mirë për ne që të jemi përherë të vëmendshëm për padenjësinë tonë dhe të rrëfejme mëkatet tona përpara Perëndisë, megjithatë është mirë dhe e domosdoshme të flasësh kur koha e kërkon një gjë të tillë, sepse shoh Kishën që Perëndia themeloi mbi apostujt dhe profetët, gurin e qoshes së saj Krishtin Birin e Atij, të lëkundet në një det të trazuar, goditur nga valë të furishme, tundur e shkundur nga fyerjet e shpirtrave të ligj. Njerëz të pabesë përpiqen të shqyejnë rrobën e pa qepur të Krishtit dhe të copëtojnë Trupin e tij në pjesë: Trupin e tij, që është Fjala e Perëndisë dhe traditën e lashtë të Kishës. Prandaj e konsideroj të paarsyeshme të hesht dhe të mbaj gjuhën, gjersa kujtoj paralajmërimin e Shkrimit: “Nëse tërhiqet, shpirti im nuk gjen kënaqësi në atë,” dhe “Nëse sheh se shpata po afrohet dhe nuk paralajmëron vëllanë tënd, Unë do ta kërkoj prej dorës sate gjakun e tij.” Frika më shtyn të flas; e vërteta është më e fortë se fuqia e mbretërve. Dëgjova Davidin, pasardhësin e Perëndisë duke kënduar: “Do të flas për porositë e tua përpara mbretërve dhe nuk do të turpërohem.” Prandaj, jam i shtrënguar të flas me pasion, sepse urdhërimet e mbretit janë të frikshme për vasalët e tij. Megjithatë, vetëm pak njerëz mund të gjenden që të dinë aq sa për të shpërfillur ligjet e liga të mbretërve, edhe pse autoriteti i monarkëve të tokës vjen që nga lart.

2. Së pari, unë marr mësimin e Kishës, përmes të cilit shpëtimi është mbjellur te ne, si themel dhe shtyllë. Do ta bëj më të qartë kuptimin e këtij mësimi, sepse është si pika e fillimit dhe e mbarimit për garën; është freri i një kali. Është një fatkeqësi e madhe

që Kisha, duke përparuar në një superioritet marramendës dhe zbukuruar me shembujt më të arrirë të shenjtorëve të kohërave të vjetra, të bjerë në nivelin e shpirtave të dobët e lapangjozë, dhe të jenë kaq të frikësuar kur s'ka asgjë për t'u pasur frikë. Është rrënuese të mendosh se Kisha nuk e njeh Perëndinë ashtu si ai është në të vërtetë; dhe që ajo rrëshqiti në idhujtari, sepse nëse ajo dështon qoftë edhe një presje nga përsosmëria, kjo do të ishte një njollë mbi fytyrën e saj të pafajshme, duke shkatërruar me ndyrësinë e saj gjithë bukurinë. Një gjë e vogël nuk është e vogël nëse ajo të shpie në diçka të madhe; dhe nuk është aspak çështje e vogël të harrosh traditën e vjetër të Kishës e cila u mbajt nga ata të cilët u thirrën përpara nesh, shëmbullin e të cilëve duhet ta ruajmë dhe besimin e të cilëve duhet ta imitojmë.

3. Në radhë të parë, përpara se t'ju flas juve, i lutem Perëndisë së Gjithfuqishëm, përpara të cilit të gjitha gjërat janë të hapura, të bekojë fjalët e gjuhës sime, sepse Ai e njeh qëllimin tim të përlulur dhe të sinqertë. Ai të frenojë gojën time dhe ta drejtojë tek Vetja e Tij dhe të ecë në rrugën e Tij të drejtë, jo të kthehet në të djathtë, sado e arsyeshme që të duket, ose të dijë diçka rreth së majtës. Së dyti i kërkoj të gjithë popullit të Perëndisë, kombit të shenjtë, priftërinjve mbretërorë, së bashku me atë që është thirrur për të ruajtur grigjën piftërore të Krishtit në personin e tij, ta pranojë fjalimin tim me dashamirësi. Ata nuk duhet të mbeten në padenjësinë time, ose të presin elokuencë, sepse unë jam shumë i ndërgjegjshëm për mangësitë e mia. Por më tepër, ata duhet të marrin në konsideratë vetë fuqinë e mendimeve. Mbretëria e qiellit nuk përbëhet nga fjalë, por nga vepra. Qëllimi im nuk është për të konkuruar, por të ngre një dorë e cila lufton për të vërtetën – një dorë që ndihmohet nga drejtimi i Tij që është i gjithfuqishëm. Duke

u mbështetur në të vërtetën e pakundërshtueshme si ndihmësen time do ta filloj fjalimin tim.

4. Në të vërtetë, fjalët e atij që nuk mund të mashtrojë: “Zoti Perëndia ynë, Zoti është një,” dhe “Ju do të adhuronit Zotin Perëndinë tuaj dhe vetëm atij do t’i faleni,” dhe “Ju nuk duhet të keni perëndira të huaja.” “Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëllturyrë të asnjë gjëje që ndodhet aty në qiejt ose këtu poshtë në tokë ose në ujërat nën tokë,” dhe “Të gjithë adhuruesit e imazheve janë turpëruar, që mburren me idhujt e pavlerë.” Dhe përsëri, “perënditë që nuk bënë qiejt dhe dheun do të zhduken nga faqja e dheut dhe nga poshtë qiellit.” Në këtë mënyrë dhe në një formë të ngjashme Perëndia ju foli në kohët e shkuara etërve me anë të profetëve, por tani së fundi në këto ditë Ai na ka folur përmes Birit të Vetëmlindur, me anë të të cilit bëri kohërat. Ai thotë: “Kjo është jeta e përjetshme, që të të njohin Ty, Perëndinë e vetëm të vërtetë, dhe Jesu Krishtin, të cilin e ke dërguar.” Unë besoj në një Perëndi, burimin e të gjitha gjërave, pa fillim, i pakrijuar, i pavdekshëm dhe i pakapshëm, i përjetshëm, i përgjithmonë, i paperceptueshëm, i patrup, i padukshëm, i papërshkrueshëm, pa formë. Besoj në një Qenie të mbiqenshme, një Perëndi më i madh se koncepti ynë mbi hyjninë, në tre persona: Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë, dhe adhuroj vetëm atë. Adhuroj një Perëndi, një Zot, por i falem tre personave: Perëndisë Atë, Perëndisë Bir të bërë njeri dhe Perëndisë Shpirti i Shenjtë, një Perëndi. Unë nuk adhuroj krijesën në vend të Krijuesit, por adhuroj atë që u bë një krijesë, që u formua ashtu si unë, që veshi Vetveten në krijim pa u dobësuar ose ndarë nga hyjnimëria e Tij, në mënyrë që të mund të ngrerë natyrën tonë në lavdi dhe të na bëjë pjesmarrës të natyrës së Tij hyjnore. Së bashku me Mbretin tim, Perëndinë tim dhe Atë, adhuroj

atë që veshi Veteveten në purpure mbretërore të mishit tim, jo si veshje që shkon tutje, ose sikur Zoti i mishëruar themeloi një person të katërt të Trinisë, Perëndia mos e lejoftë! Mishi që u mor nga Ai është hyjnizuar dhe qëndron i tillë edhe pas ngjitjes së tij. Natyra mishore nuk humbi kur u bë pjesë e natyrës Hyjnore, por ashtu si Fjala e bërë mish mbeti Fjalë, kështu edhe mishi u bë Fjalë, megjithatë mbeti mish, duke mbetur i bashkuar me personin e Fjalës. Prandaj unë me guxim vizatoj një imazh të Perëndisë së padukshëm, jo si të padukshëm, por si të bërë të dukshëm për hirin tonë, duke marrë mish dhe gjak. Unë nuk vizatoj një imazh të Perëndisë së padukshëm, por unë pikturoj imazhin e Perëndisë që u bë i dukshëm në mish, sepse është e pamundur të bësh një paraqitje të frymës, sa më tepër e pamundur është të pasqyrosh Perëndinë që i jep jetë shpirtit?

5. Tani, disa thonë se Perëndia urdhëroi Moisi ligdhënësin: “Adhuro Zotin Perëndinë tënd dhe vetëm atij do t’i falesh” dhe “Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëlltyrë të asnjë gjëje që ndodhet aty në qiejt ose këtu poshtë në tokë ose në ujërat nën tokë.”

Ata me të vërtetë janë në gabim vëllezër, sepse ata nuk i njohin Shkrimet, sepse germa vret, por Shpirti jep jetë. Ata nuk gjejnë në fjalën e shkruar të fshehurën e saj, kuptimin shpirtëror. Unë me të drejtë mund t’u drejtohem këtyre njerëzve: Ai që ju mëson juve këtë duhet gjithashtu t’ju mësojë dhe atë që vijon. Dëgjo interpretimin e ligdhënësit, të cilin e lexoni në Ligjin e Përtërirë: “Dhe Zoti ju foli ju nga mesi i zjarrit; ju dëgjuat tingëllimin e fjalëve, por nuk patë asnjë figurë; dëgjuat vetëm një zë.” Dhe menjëherë pas kësaj: “Me qenë, pra se nuk patë asnjë figurë ditën që Zoti ju foli në Horeb nga mesi i zjarrit, tregoni kujdes të veçantë për

shpirtërat tuaja, me qëllim që të mos shtureni dhe të mos gdhendni ndonjë shëmbëlltyrë, në trajtën e ndonjë figure: paraqitjen e një burri apo të një gruaje, paraqitjen e një kafshe që është mbi tokë, paraqitjen e një zogu që fluturon në qiell.” Dhe përsëri, “Sepse duke ngritur sytë në qiell dhe duke parë diellin, hënën, yjet, të tëra, domethënë tërë ushtrinë qiellore, ti të mos nxitesh të biesh përmbys përpara këtyre gjërave dhe t’u shërbesh.”

6. Ju e shikoni se e vetmja gjë që kërkon të thuhet këtu është që asgjë e krijuar të mos nderohet në vend të Krijuesit, askujt nuk mund t’i jipet adhurimi përveç se vetëm atij. Prandaj të adhurosh atë gjithmonë do të thotë që t’i ofrosh atij nderim. Sepse përsëri ai thotë: “Nuk do të kesh perëndi të tjera përpara meje. Nuk duhet të bësh për veten tënde imazhe, ose ndonjë gjë të gjërave që janë lart në qiell, ose të gjërave poshtë në tokë. Ti nuk do t’i adhurosh ato as t’i nderosh ato, sepse unë jam Zoti Perëndia yt.” Dhe përsëri, “Do të rrënoni altarët e tyre, do të copëtoni kolonat e tyre të shenjta, do t’u vini flakën Asherimëve të tyre, do të rrëzoni shëmbëlltyrat e gdhendura të perëndive të tyre, sepse ju nuk do të adhuroni perëndi të tjera.” Dhe përsëri, “Nuk do të bësh për vete perëndi të derdhura.”

Rreth kënaqësive Nga Joan Damaskini

Nga kënaqësitë të tjera janë ato shpirtërore dhe të tjera ato trupore. Shpirtërore janë ato që i përkasin vetëm shpirtit, siç janë kënaqësitë që kanë të bëjnë me njohuritë dhe teoritë. Trupore janë ato që kanë të bëjnë me komunikimin e shpirtit dhe të trupit dhe për këtë quhen trupore siç janë kënaqësitë që kanë të bëjnë me

ushqimet, kënaqësitë trupore dhe të tjera të ngjashme me këto. Por vetëm prej trupit nuk do të mundte dikush që të gjente kënaqësi.

Përveç kësaj nga kënaqësitë e tjera disa janë të vërteta dhe disa të gënjeshtra, disa vetëm mendore sipas shkencës dhe teorisë dhe të tjera trupore sipas ndjenjave. Nga kënaqësitë trupore disa janë fizike dhe në të njejtën kohë nevojat, pa të cilat është e pamundur jeta, të cilat janë ushqimet që zëvendësojnë konsumimin dhe veshjet e domosdoshme, disa janë përsëri fizike jo vetëm nevoja siç janë sipas natyrës dhe sipas ligjit gjenetik, marrëdhëniet (sepse ato ndihmojnë në riprodhimin e gjinisë njerëzore, por është e pamundur të jetojë dikush në virgjëri pa to) dhe të tjerat s'janë as nevoja fizike siç janë pija dhe epshet dhe bollëku i të mirave që i kalojnë nevojat, sepse ato nuk ndikojnë as në vuajtjen e jetës, as në vazhdimësinë gjinisë por shkaktojnë dëme. Ai që jeton sipas vullnetit të Perëndisë duhet që të plotësojë nevojat dhe njëkohësisht kënaqësitë fizike të vërë në rend të dytë kënaqësitë fizike dhe jo të domosdoshmet, të bëra me kohë dhe në mënyrë e masë që duhen, ndërsa të tjerat është mirë patjetër ti shmangë.

Si kënaqësi të mira duhet të quhen ato që nuk janë të përziera me dëshpërimin as shkaktojnë pendesë as lindin difekte të tjera, as e kalojnë masën, as na shkëpusin për shumë kohë nga veprat e rëndësishme, ose na skllavërojnë.

ETËRIT E PERËNDIMIT

BENEDIKTI (480-547)

Benedikti ka lindur në vitin 480 në Nursi prej prindërve të pasur dhe shprestarë. Studimet e larta i kreu në Romë, por në moshën njëzetvjeçare braktisi gjithçka dhe filloi të ushtrohet në një zonë malore. Më pas qëndroi për tre vjet në skarpitetet e Subiaco, ku bëri një jetë të rreptë asketike. Aty qethet murg dhe ndihmohet prej ava Romanit. Benedikti themeloi dymbëdhjetë qinovia me nga dymbëdhjetë vëllezër. Në vitin 529 shkoi në Monte Cassino ku themeloi manastirin e famshëm të urdhrit benediktin. Benedikti fjeti më 547. Kisha e shpalli shenjt dhe kujtimi i tij kremtohet më 14 Mars. Sot ka shumë murgj romanokatolikë që quhen benediktë. Jeta e Benediktit u bë e njohur nga Grigori i Madh në vëllimin e dytë të librit *Dialogues*, që u shkrua në vitin 547, pra 50 vjet pas vdekjes së tij. (*Jacques Le Goff, Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar, Toena, Tiranë 1998, faqe 471*).

Shkrimet: 1) *Regula Benedicti* e përbërë nga 73 kapituj dhe flet për rregullat dhe çështjet e ushtrimit të monakizmit. Benedikti theksonte vlerën e *uratës* dhe të *punës së dorës* (ora et labora). Lidhur me *uratën* përfshihet studimi i Shkrimit të Shenjtë, ndërsa me anën e punës fizike i jep murgut dimension kozmik, human dhe kreativ. (*Zef Mirdita, Krishtenizmi ndër shqiptarë, Drita, Zagreb 1998, faqe 144*).

KASIDORI (490-580)

Kasidori (Flavius Magnus Aurelius Cassiodorus Senator) ka lindur në vitin 490 në Kalabri. Ai studioi për drejtësi dhe fillimisht e nisi karrierën si këshilltar i babait të tij, guvernatorit të Sicilisë. Gjatë viteve 507-536 shërbeu në poste të larta të shtetit romak. Rreth viteve 537-538 ai largohet nga Italia dhe shkon në Kostandinopojë, ku qëndroi për afro dy dekada, duke u marrë me çështjet fetare. Qëndrimi në Kostandinopojë e ndihmoi për përmirësimin e njohjes rreth besimit. Kasidori u përpoq të lidhte ndarjet kulturore që ekzistonin ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, duke gërshetuar kulturën greke me atë latine. Në vitin 540 tërhiqet nga jeta politike dhe themeloi manastirin Vivarium, në pronën e familjes së tij që ndodhej në brigjet e detit Jon. Kasidori ngriti një bibliotekë me synim që të sillte kulturën greke te lexuesit latinë. Shkrimet e tij bënë që shumë njerëz të ktheheshin në besimin e drejtë. Ai vdiq në vitin 580.

Shkrimet: 1) *Himnet* (pjesë të zgjedhura nga festat panagjirike). 2) *Kronikat*, të cilat e kanë zanafillën nga Adami dhe përfundojnë në vitin 519. Kjo vepër ka shpëtuar e pjeshme. 3) *Historia e gotëve*, e cila bën fjalë për historinë e fiseve gotë deri në vitin 526. 4) Interpretimi i Psallmeve. 5) *Mbi Shpirtin* (De Anima), vepër që u shkrua rreth viteve 540. 6) *Institutiones Dirinarum et Saecularium Litterarum* (543-555). 7) *De Artibus ac Disciplinis Liberalium Litterarum* etj.

MARTINI I BRAGAS (515-580)

Martini lindi në vitin 515 në Panoni. Fillimisht e gjejmë murg në Palestinë dhe vite më vonë në Spanjë. Rreth viteve 570 dorëzohet mitropolit i Bragas të Spanjës. Martini u shqua si një drejtues i mirë i grigjës duke u përballur me herezitë e kohës. Fjeti në vitin 580. Kisha e Perëndimit e shpalli shenjt dhe kremtohet më 20 mars.

Shkrimet: 1) *Formula Vitae Honestae*, e cila flet për çështjet themelore të jetës së krishterë. 2) *Fjalimi për korrigjimin e bujqve* (De Correctione Rusticorum) që bën fjalë për interesimin e fshatarëve të zonës në adhurimin. Martini shkroi për tema të së Drejtës Kanonike, Liturgjikës etj.

DIONIS EKSIGU (+545)

Dionisi e kishte origjinën nga Skithia, e cila atëherë ishte provincë romake. Nuk dihet koha e lindjes së tij. Njohim vetëm se gjatë viteve 500-545 ishte murg në Romë. Ishte njohës i kulturës greke, të cilën e reflektonte në perëndim. Fjeti në vitin 545.

Shkrimet: 1) Vepra të karakterit kohor janë *Rreth Pashkës*, ku përshkruhet mënyra aleksandrine e përlllogaritjes së Pashkës. Dionisi llogariti që Krishti kishte lindur në vitin 754 nga themelimi i Romës. 2) *Koleksioni i kanoneve*, u shkrua në Romë rreth vitit 500 dhe përmban kanonet sinodike të lindjes dhe perëndimit deri në vitin 451. Janë të përkthyer dhe 50 kanonet apostolike. 3) Përkthime. Dionisi përktheu nga greqishtja në latinisht jetën e Pahomit, historinë e prerjes së kokës së Joan Pagëzorit etj.

GRIGORI I TURIT (538-594)

Grigori ka lindur më 538 në Francë. Në moshën 35-vjeçare u hirotonis peshkop i Turit. Grigori ishte peshkopi i 18-të i Turit duke vazhduar traditën e familjes. Duhet theksuar se pesë peshkopë nga paraardhësit ishin prej fisit të tij. Pjesën më të madhe të jetës së tij e kaloi në Tur, ku pozita e favorshme gjeografike e mundësoi që Grigori të takonte njerëz me influencë. Grigori ka vdekur në vitin 594. Kisha e Perëndimit e ka shpallur shenjt dhe e kremton më 17 nëntor.

Shkrimet: 1) *Historia Frankorum*, e cila u shkrua në vitin 591 dhe përbëhet nga dhjetë libra. Libri i parë deri tek i katërti tregojnë për historinë e botës nga Adami deri në vitin 575. Librat e tjerë tregojnë për kristianizmin e frankëve deri në vitin 591, jetën e Shën Servatit, pushtimin e Galisë nga Klovis si dhe histori të mbretërve frankë deri në vdekjen e Sigebertit. 2) *Jeta e Etërve* përmban rreth njëzet jetë shenjtorësh duke përfshirë peshkopë, klerikë, murgjër, igumenë, heremitë etj. Në këtë vepër Grigori synonte të nxirrte në pah mënyrën e jetesës së krishterë. Shën Iliduis është lëvdur për pastërtinë e shpirtit të tij, Shën Brachio për përkushtim në leximin e Shkrimit të Shenjtë, Shën Patrokli për besimin e patundur, Shën Niketi, i Lionit për drejtësinë dhe autoritetin dhe ndjenjën e përgjegjësisë episkopale etj.

ISIDORI I SEVILJES (570-636)

Shkrimtari i fundit i Perëndimit për periudhën e tretë të Literaturës së Etërve është Isidori i Seviljes, i cili ka lindur në vitin 560 në Karqidonë. Gjatë mesjetës librat e tij qenë të detyrueshme nëpër shkolla. Rreth viteve 600 u bë episkop i Seviljes. Në vitin 619 kryesoi Sinodin e Seviljes dhe më 633 atë të Toledos. Isidori i Seviljes u mor seriozisht me çështjet liturgjike. Ai fjeti në vitin 636 dhe kujtimi i tij kremtohet në Perëndim më 4 prill. Me Isidorin e Seviljes përfundon Literatura e Etërve Perëndimorë.

Shkrimet: 1) *Libri i Etimologjive* (Etymologiae) ose (Origines) në 20 libra. Bëhet fjalë për Enciklopedinë e famshme, e cila përfshin tema teologjike, fetare në përgjithësi, të natyrës shoqërore, si dhe çështje të jetës së përditshme. 2) *Për burrat e shquar* (De Viris Illustribus) ku flet për burrat e shquar spanjollë. (Jacques Le Goff, *Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar*, Toena, Tiranë 1998, faqe 490).

BIBLIOGRAFIA

- Akademia e Shkencave, Fjalor i Gjuhës së sotme Shqipe, Tiranë 1980.
- Akademia e Shkencave, Fjalor Drejtshkrimor i Gjuhës Shqipe, Tiranë 1976.
- Akademia e Shkencave, Fjalor i Gjuhës së sotme Shqipe, Tiranë 1984.
- Arkimandrit Justini, Nga thesari i Shenjtorëve, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2004.
- Atë Jovan Chani, Ungjijtë e së Dielave, St. Louis 1930.
- Athanasi i Madh, Andoni i Madh, përktheu Teodor Bendo, botim i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë 2006.
- Bibla, Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re, Diodati i Ri, 1991-1994, botimet “La buona novella”, Brindisi.
- Bibla, Dhiata e Vjetër dhe Dhiata e Re, botimet ECM, 1993.
- Didie Zhyllia, Fjalori i filozofisë, shtëpia botuese Enciklopedike, Tiranë 1994.
- Edvin E. Jacques, Shqiptarët, vëllimi I, Kartë e Pendë, Tiranë 1995.
- Erasmus Schmid, Concordance to the Greek nev Testament, Astir, Athens 1990.
- Fran Luli, Fjalor Biblik dhe i Termave Kishtarë, botimet Camaj-Pipa, Shkodër 2004.
- Fori Tërpini, Si e gjeta rrugën e Dritës, predikime fetare e morale, botimet Koti, Korçë 2001.
- Imzot Nikë Prela, Fjalori Biblik, botimet Drita, Ferizaj 1994.
- Imzot Nikë Prela, Fjalori Biblik, Ferizaj 1994.

- Jacques Le Goff, Qytetërimi i Perëndimit Mesjetar, Toena, Tiranë 1998.
- Maksim Çuko, Përmes Shkrimeve, Tekno Paper, Tiranë 2005.
- Moikom Zeqo, Mes lakontit dhe Krishtit, Onufri II, Medaur, Tiranë 2000.
- Nestle-Aland, Novum Testament Graece, Deutsche Bibelgesellschaft, Stuttgart 1993.
- Pavli Qesku, Fjalor Anglisht-Shqip, Edfa, Tiranë 2000.
- Pavli Qesku, Fjalor Shqip-Anglisht, Edfa, Tiranë 1999.
- Protopresviter Tomas Hopko, Besimi Orthodhoks, vëllimi I, përkthyer nga Arqimandrit Joan Pelushi), botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1997.
- Protopresviter Thomas Hopko, Besimi Orthodhoks, vëllimi III, Shkrimi i Shenjtë dhe Historia e Kishës, përkthyer nga Imzot Joan Pelushi, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2000.
- Strongs Exhaustive Concordance of the Bible, World Bible Publishers.
- Shën Vasili i Madh, Kryepeshkop i Qesarisë së Kapadoqisë, Mbi Shpirtin e Shenjtë, përkthyer nga At Joan Pelushi, botim i KOASH-it, Tiranë 1996.
- Shën Augustini, Rrëfimet, Gjurmët e shpëtimit në dramën e jetës, përktheu Çlirim Mukli, Plejad, Tiranë 2006.
- Tajar Zavalani, Histori e Shqipnis, Phoenix, Londër 1966.
- Uratore e Kishës Orthodokse, e përktheu Imzot Fan S. Noli, e botoj Peshkopata e Amerikës, Boston, Mass. 1941.
- Uratore e Vogël, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2004.
- Zef Mirdita, Krishtenizmi ndër shqiptarë, Drita, Zagreb 1998.

ARTIKUJ GAZETASH, REVISTASH DISPENSA DHE BROSHURA

- Aristidhi, dëshmor, Ngjallja, shtator 2005, faqe 8.
- Atë Joan Mihalcesku, Historia universale e kristianizmit, dispensë e përkthyer nga rumanishtja prej Teodor Papapavlit, Tiranë 1993.
- Atë Justini, Pahomi i Madh, Ngjallja, maj 2002, faqe 9.
- Atë Justini, Kirili i Aleksandrisë, Ngjallja, janar 2005, faqe 10.
- Dhimitër Beduli, Dispensë, Leksione (Apologjitika, Patrologjia, Pimantika, Liturgjika, Historia e Kishës), botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1998.

- Efthimi i Madh, Ngjallja, janar 2003, faqe 11.
- Jetë Shenjtorësh, Nr.5, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1996.
- Jetë Shenjtorësh, Nr.6, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1996.
- Jetë Shenjtorësh, Nr.7, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1996.
- Jovan Joco, Të dhëna mbi mbretin e Shenjtorëve dhe disa shenjtorë, Korçë.
- Kristaq Balli, Himni i Himneve, Tempulli Nr. 12, Korçë 2007, faqe 60.
- Himni Akathist, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 2003.
- Moikom Zeqo, Rrëfimet e Augustinit në shqip, sfida e një kryevepre mbijetuese, Ballkan, 4 mars 2007, faqe 16-17.
- Nga kryeveprat e Gojartit, copë të zgjedhura, broshurë e përkthyer nga Sotir Papahristo, Kryepiskopata Orthodhokse e Shqipërisë, Tiranë 1944.
- ”Kanoni i Madh”, “Ngjallja”, mars 1996, faqe 4.
- The Rudder (Pedalion), dispensë e përkthyer nga Aleksandra Koço, Luna Printing Co, Nju Jork 1983.
- Thënie për dashurinë e krishterë, përkthyer nga Rozeta Baba dhe Elena Krakulli, Kambanat, dhjetor 2006, faqe 37.
- ”Urata e Pashkës”, “Ngjallja”, maj 1995, faqe 7.

PASQYRA E LËNDËS

Parathënie

KREU I PARË

FILLIMET E LITERATURËS PATERISTIKE (100-325)

Etërit Apostolikë

Klimi i Romës (92-101)

Letra e parë drejtuar Korinthusve

Ignati i Antiokisë (70-107)

Për Kishën e Filadelfisë

Polikarpi i Smirnit (70-156)

Letër drejtuar Filipianëve

Barnaba

Hermas (142-155)

Bariu i Hermasit

Vizioni i parë

Porosia e parë

Porosia e dytë

Parabola e parë

Papia i Jerapolit (70-150)

Didakia

Didakia e dymbëdhjetë apostujve

Përndjekjet ndaj krishterimit nga perandorët romakë

Të krishterët në Betani. Dilema e Plinit

Përgjigja e Trajanit

Sulmet ndaj krishterimit nga filozofët paganë

Celsi

Luçiani i Samosatës

Porfiri

Apologjistët kristianë

Kodrati

Aristidhi i Athinës

Apologjia e Aristidhit

Ariston i Pelës së Palestinës

Justin filozofi (100-167)

Apologjia e parë

Eukaristia në apologjinë e Shën Justinit

Tatian Siriani (+120)

Miltiadhi

Apolinari i Hierapolit

Athinagora i Athinës

Apologjia e Athinagorës

Theofili i Antiokisë (169-180)

Melito i Sardës

Hermia filozofi (+150)

Literatura Apokrife dhe Anonime

Apokrifet e Dhiatës së Re

Veprat Apokrife

Letrat Apokrife

Apokalipsat Apokrifë

Shkollat Teologjike të Lindjes

Shkolla e Aleksandrisë

Shkolla e Qesarisë

Shkolla e Antiokisë

Panteni (+200)

Letër për Diognetin

Klimi i Aleksandrisë (150-216)

Origjeni (185-254)

Prologu i komentit të Kantikut të Kantikëve

Grigori i Neoqesarisë (210-275)

12 Kanonet e Grigorit të Neoqesarisë

Irineu i Lionit (140-202)

Kundër herezive

Besimi i Kishës

Tertuliani (155-235)

Mbi lutjen

Hipoliti i Romës (170-235)

Pagëzimi dhe Mirosjat në Traditën Apostolike të Hipolitit

Falenderimi në Traditën Apostolike të Hipolitit

Qipriani (210-258)

Njëshmëria e Kishës katolike

KREU I DYTË

LULËZIMI I LITERATURËS PATERISTIKE (325-451)

Themeluesit e Monakizmit

Andoni i Madh (251-356)

Pahomi (290-346)

Isidor Pilusioti (360-440)

Eftimi i Madh (377-473)
Etërit e Mëdhenj dhe Mësuesit Ekumenikë
Athanasi i Madh (295-373)
Andoni i Madh
Tri letrat e Athanasit të Madh
Mishërimi i Fjalës së Perëndisë
Grigor Teologu (328-390)
Mbi Birin
Ligjëratat e Pashkës
Kundër eunomianëve
Vasili i Madh (329-379)
Mbi Shpirtin e Shenjtë
Eksorcizmi për ata që vuajnë nga demonët
Fjalimi drejtuar të rinjve
92 Kanonet e Vasilit të Madh
Kreshma
Joan Gojarti (344-407)
Mbi priftërinë
Urata e Pashkës
Ndikimi i gruas mbi burrin
Për Eutropion
Krishti lindet
Triumfi i kishës
Jeronimi (331-420)
Për Eustikian
Ambrozi i Milanos (339-397)
Për pendimin
Augustini (354-430)
Rrëfimet

Grigori i Madh (540-604)
Mesha e Dhuratave të Parashenjtëruara
Etër të Lindjes
Efrem Siriani (306-373)
Jonai dhe nevitët
Shfaqja e dytë
Kirili i Jerusalemit (313-386)
Katekizmi i parë
Ngjallja e të vdekurve
Pendimi
Grigori i Nisës (335-395)
Mbi virtytin
8 kanonet e Grigorit të Nisës
Rreth lutjes “Ati ynë “
Kirili i Aleksandrisë (375-444)
Mbi njëshmërinë e Krishtit
5 kanonet e Kirilit të Aleksandrisë
Isak Siriani (375-460)
Pastërtia e shpirtit
Durimi
Etër të Perëndimit
Silvestri (+335)
Leoni i Madh (+461)
Papë Martini (+655)

KREU I TRETË
RËNIA E LITERATURËS PATERISTIKE (451 – 749)

Roman Melodiozi (490-560)

Shkurtorja e Krishtlindjeve

Joani i Shkallës (525-600)

Mbi lutjen

Për përgojimin

Sofroni i Jerusalemit (580-637)

Jeta e Oshënares Maria

Maksim Konfessori (580-662)

400 thënie rreth dashurisë

Lufta e demonëve

Andrea i Kretës (660-740)

Kanoni i madh

Kozma Melodiozi (+750)

Kanoni i Krishtlindjeve

Josif Himnografi (+842)

Kanoni i Akathistit

Joan Damaskini (680-750)

Mbi ikonat

Rreth kënaqësive

Etërit e Perëndimit

Benedikti (480-547)

Kasidori (490-580)

Martini i Bracas (515-580)

Dionis Eksigu (+525)

Grigori i Turit (538-594)

Isidori i Seviljes (560-636)

Bibliografia
Pasqyra e Lëndës

